

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE DHE KULTURORE TË  
SHQIPTARËVE - SHKUP

# BALLKANOLOGJIA

- 5 -

Akte të Konferencës shkencore ndërkombëtare

- ***BALLKANI DHE GLOBALIZIMI*** -

*Shkup, 27 tetor 2022*



Shkup, 2023

*Botues:*  
*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*  
*Biblioteka: Ballkanologji*

*BALLKANOLOGJIA*

- 5 -

*Për botuesin:*  
Prof. dr. Skender ASANI

*Këshilli organizues / Redaksia vendore:*

Skender ASANI  
Sefer TAHIRI  
Nora MALIQI ZYLALI  
Zeqirija IBRAHIMI  
Sevdail DEMIRI  
Izaim MURTEZANI  
Isamet BAKIU

*Këshilli i redaksisë ndërkombëtare:*

Vasil TOLE (Shqipëri)  
Teuta SHALA PELI (Kosovë)  
Ana ÇUPESKA (Maqedoni e Veriut)  
Rexhep SHKRIJEL (Sanxhak, Serbi)  
Ekaterina TARPOMANOVA (Bullgari)  
Galip ÇAG (Turqi)

ISBN: 978-608-4897-85-9

[www.itsh.edu.mk](http://www.itsh.edu.mk)

Copyright©ITShKSh, 2023  
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin

Ky botim financohet nga:

Република Северна Македонија  
Министерство за култура



Republika e Maqedonisë së Veriut  
Ministria e Kulturës

Akte të konferencës shkencore ndërkombëtare  
BALLKANOLOGJIA - Edicioni V

- *BALLKANI DHE GLOBALIZIMI*



## PËRMBAJTJA:

DISA FJALË RRETH BOTIMIT.....	7
<b>LEONTINA GEGA-MUSA: RIBËRJA E TRADITËS ME ELEMENTE TË KULTURËS GLOBALE.....</b>	12
<b>EDUART CAKA: BASHKËJETESA TEK SHQIPTARËT NË KONTEKSTIN MULTIKULTURALIST TË PROCESIVE GLOBALIZUESE.....</b>	23
<b>HIDAJETE AZIZI: EMRAT VETJAKË PËRBALLË GLOBALIZIMIT.....</b>	32
<b>RINI USEINI: TENDENCAT E NDËRLIDHJES ME ATDHEUN TEK POPUJT BALLKANIK.....</b>	43
<b>VJOSA OSMANI: NDIKIMI I GLOBALIZIMIT NË DISKURSET E SHQIPES... </b>	50
<b>SHPRESA ISMAJLI: RRETH DISA PRIRJEVE TË ZHVILLIMIT TË SHQIPES NË GLOBALIZËM.....</b>	61
<b>VALDETA KASAPI: PËRDORIMI I GJUHËVE NË MEDIA, VLERË DHE SFIDË E MULTIKULTURALIZMIT NË MAQEDONINË E VERIUT .....</b>	65
<b>AFËRDITA ABDULLAHI: GJUHA E TË RINJVE TË KOSOVËS NË EPOKËN E GLOBALIZIMIT .....</b>	75
<b>EDONA JAHIU: VËSHTRIMET AKTUALE TË REXHEP ISMAJLIT PËR SHQIPEN NË KONTEKST BALLKANIK.....</b>	80
<b>ERJON PAPAGJONI: KONFLIKTI RUSO-UKRAINAS: NJË LUFTË QË KËRCËNON EDHE BALLKANIN?.....</b>	96
<b>ARDIAN RAMADANI: NDIKIMI I LUFTËS RUSI - UKRAINË NË BALLKAN - RREZIK PËR PAQEN DHE STABILITETIN.....</b>	102
<b>MUHAMED JASHARI: PRANIA E RUSISË POST - SOVJETIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR .....</b>	107
<b>FATON MURSELI: NDIKIMI I MEDIAVE NDAJ EUROSKEPTICIZMIT NË MAQEDONINË E VERIUT.....</b>	126
<b>ISAMET BAKIU: MIGRIMI SI FENOMEN GLOBAL DHE SHTETI KOMBËTAR .....</b>	136
<b>YLBERZA HALILI: FOLKLORI URBAN: GRAFITET SI SHPREHJE E FOLKLORIT .....</b>	156
<b>ERMAL MEHMETI &amp; JETA STAROVA - MEHMETI: NDIKIMI I GLOBALIZIMIT NË MUZIKËN POPULLORE SHQIPTARE.....</b>	164
<b>ALFRED HALILAJ: ZHVILLIME TË FAREFISNISË NË ZONAT PARAURBANE. RASTI I SHQIPËRISË. ....</b>	170
<b>ALBAN DOBRUNA: BASHKËSIA E TARIKATEVE TË KOSOVËS DHE SFIDAT NDAJ GLOBALIZIMIT .....</b>	196



## DISA FJALË RRETH BOTIMIT

Termi globalizim kohëve të fundit është bërë njëri më të popullarizuarit, ndërsa përdoret shumë nga politikanët, biznesmenët, juristët, përfaqësues të shoqërisë civile, gazetarët e shumë profesionistë të fushave të ndryshme.

Me globalizim zakonisht emërtojmë një sërë procesesh, të cilat shtojnë apo shpejtojnë lidhjet e pjesëve të ndryshme të botës me njëra-tjetrën, duke formuar një rrjet të vetëm marrëdhëniesh. Globalizimi synon që bota edhe më shumë të funksionojë si "fshat global" përkatësisht tenton avancimin e lidhshmërive të ndryshme midis njerëzve, që u takojnë identiteteve apo kulturave të ndryshme.

Globalizimi është gërshetim i dukurive të ndryshme, të cilat së bashku ndikojnë në mënyrë rrënjësore ndaj jetesës së njerëzve në planet, marrëdhëniet me njëri-tjetrin, kulturat apo institucionet.

Ky proces, dekadën e fundit, ka shtuar ndikimin ndaj shoqërive në shtetet e ndryshme ballkanike, ndërsa hulumtimet duhet të jenë sa më të thella në drejtim të kuptimit të dinamikave dhe pasojave që i ka ai.

Tre aspektet më të rëndësishme të globalizimit dhe që përjetohen drejtpërdrejtë nga masat janë ekonomia, komunikimi dhe lëvizja e lirë. Marrëdhëniet ekonomike midis vendeve të Ballkanit dhe botës janë bërë më intensive, eksporti dhe importi janë rritur, që do të thotë se tregtia e jashtme e Ballkanit nuk funksionon pa ekonominë globale. Nën ndikimin e globalizimit shoqëritë ballkanike janë shndërruar në shoqëria konsumuese.

Shoqëritë ballkanike në planin e komunikimit dhe lëvizjes së lirë janë pjesë e rrjetit global.

Natyrisht se globalizimi ka ndikim ndaj identitetit të popujve të Ballkanit përkatësisht identitetit gjuhësor, kulturor e etnik të tyre, por në anën tjetër funksionimi i shoqërive dhe shteteve mbi baza etnike krijon mburojë ndaj ndikimeve të kulturës universale në epokën globale.

Pikërisht ndikimi i globalizimit ndaj Ballkanit përkatësisht identitetit të tij tërësor dhe identiteteve të pjesëshme të tij ka qenë fokusi kryesor i edicionit të 5-të i konferencës shkencore ndërkombëtare të Ballkanologjisë,

me temë “Ballkani dhe globalizimi”, me një interesim shumë të madh të studiuesve nga të gjitha trevat shqiptare, ballkanike dhe më gjerë.

Konferencën e shpalli të hapur drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani, i cili theksoi rëndësinë e madhe të studimeve ballkanike, për të cilat Instituti po jep kontributin e tij shkencor duke zhvilluar pesë vjet me radhë një konferencë të tillë ku bëhen bashkë studiues kredibil jo vetëm nga Ballkani por edhe më gjerë, me qasjet më të reja shkencore për ballkanologjinë.

Në fillim u bë promovimi i përmbledhjes së kumtesave të konferencës së katërt të Ballkanologjisë me temën bosht “Ballkani ndërmjet integritimit europian dhe bashkëpunimit rajonal.

Më pas, studiues të ndryshëm nga universitete dhe institute të ndryshme paraqitën temat e tyre në lidhje me Ballkanin dhe globalizimin.

Punimet e konferencës tradicionale shkencore ndërkombëtare janë sublimuar në botimin e edicionit të pestë të revistës shkencore "Ballkanologjia", e cila nga ky vit është me Këshill redaktues ndërkombëtar, krahas redaksisë vendase.



*Hapja e konferencës së pestë të Ballkanologjisë*





*Drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani përshëndeti konferencën shkencore “Ballkani dhe globalizimi”*



*Fjalë përshëndetëse nga Xhemal Çupi, në funksionin e ministrit të Diasporës*



*Fjalë përshëndetëse nga Lulzim Aliu, në funksionin e zëvendësministrit të Arsimit dhe Shkencës*



*Fjalë përshëndetëse nga Ylber Sela, në funksionin e drejtorit të Agjencisë për Zbatimin e Gjuhëve*



*Fjala e koordinatorit të konferencës shkencore ndërkombëtare “Ballkanologjia”, Sefer Tahiri*



*Në kuadër të konferencës shkencore u promovua edicioni i katërt i revistës shkencore “Ballkanologjia”*

Leontina Gega-Musa  
 Instituti Albanologjik - Prishtinë

## RIBËRJA E TRADITËS ME ELEMENTE TË KULTURËS GLOBALE

### Abstrakt

*Në këtë punim trajtohet procesi i globalizimit, si proces aktual i dinamikës së zhvillimit shoqëror e kulturor, si dhe globalizmi si tendencë për krijimin e një ideje të një trendi të ri global botëror, proces ky i cili ndikoi në shfaqjen e karakteristikave themelore të ndryshimeve tani më të formuara kulturore në kontekstin e provokimeve të bashkëkohësisë. Në rrethanat dhe kushtet e globalizimit dhe të vërshimit teknologjik, skema tradicionale e komunikimit të vlerave kulturore dhe kontakti kulturorë ka ndryshuar, prandaj edhe shpërndarja e traditës po bëhet në mënyra dhe kontekste të ndryshme. Sot vazhdimësia e traditës, nuk mund të nënkuptojë vetëm transmetimin e saj në kohë dhe hapësirë, por edhe ndërtimin e koncepteve të reja, përmes përzgjedhjes dhe përshtatjes së vlerave dhe besimeve të cilat arrijnë në të tashmen dhe konfirmojnë identitetin kolektiv.*

*Ky proces është përcaktues edhe në ngjizjen e një varg ritesh, konkretisht familjare, të cilat në rrethana të reja i nënshtrohen modifikimit dhe rrjedhimisht transformimit. Sigurisht se një progres i këtillë në sferën e etnokulturës, shfaq edhe nevojën e domosdoshme për hulumtime dhe trajtime sidomos të çështjeve si: Cilët janë faktorët që ndikuan në ndryshimin e qarkullimit të vlerave identifikuese etnokulturore? Cilat elemente tradicionale të riteve familjare kanë mbijetuar? Cilat janë elementet e reja në (ri)aktualizimin e këtyre riteve në bashkëkohësi? Cili është ndërveprimi i këtyre elementeve brenda proceseve kulturore e shoqërore, që mund të ndikojë që në një kohë të ardhme ato të merren edhe si 'tradicionale'? Për të gjitha këto çështje, punimi është bazuar në të dhëna empirike nga terreni dhe në literaturë teorike përkatëse.*

**Fjalët çelës:** globalizimi, tradicionalja, riti, konteksti, (ri)aktualizimi



Në kulturën tradicionale sot janë të dukshme ndryshimet e karakteristike themelore të krijuara nga provokimet e bashkëkohësisë. Në këtë ndryshueshmëri gjithsesi se një rol përshpejtues pati procesi i globalizimit. Globalizimi si proces, konsiderohet se i ka fillimet e tij në të kaluarën e largët, por si koncept shfaqet konkretisht nga vitet e gjashtëdhjeta të shekullit XX. Globalizimi përkufizohet si proces universal ose grup procesesh të cilat krijojnë ndërvarësinë në mes shtetesh e shoqëri, duke i ndërlidhur ato në një sistem modern botëror. Ky proces përfshin një ndërvarësi fushash të ndryshme si ekonomike, komunikuese e sociale, të ndihmuar nga sistemet e reja të transportit, që mundësojnë lëvizjen dhe mobilitetin e njerëzve në botë, si dhe konsumin masiv. Ndërkaq, zhvillimi i mediave elektronike konsiderohet të ketë ndikuar në masë të madhe në ndërgjegjësimin global të një ideje dhe në ngritjen e vetëdijes mbi botën si një tërësi (Limani, 2018). Antropologu Appaduari konsideron se ky proces kompleks ndryshimesh e përshtatjesh, të shteteve dhe shoqërive të ndërvarur në një ekonomi kulturore globale, nxit tensionin ndërmjet homogjenizimit kulturor dhe heterogjenizimit kulturor. Ai këtë ndërveprim e kanalizoi brenda një kornize elementare, të ndarë midis pesë dimensionesh, si: etno-sfera, tekno-sfera, finanso-sfera, media-sfera dhe ideo-sfera (Appaduari, 1990:296).

Ndër studiues të tjerë që u morën me procesin e globalizimit kulturor, i cili tani më është një realitet, pati edhe mendime kontradiktore rreth kuptimit të këtij procesi dhe koncepti. Disa nga ata konsiderojnë se procesi i globalizimit është një kërcënim për kulturën lokale, sidomos kur përhapet me anë të disa elementeve të caktuara kulturore nga ana e shteteve perëndimore të fuqishme ekonomikisht dhe politikisht. Si elemente kulturore të përhapura konsiderohen restorantet e McDonaldit, Coca-Cola e famshme gjithandej në botë, e deri te seritë televizive meksikane e holivudiane që kanë ndikuar në amerikanizimin e kulturës lokale (Kadriu, 2009:49). Element tjetër kulturor i përhapur nga gastronomia mund të konsiderohet edhe ushqimi tradicional japonez sushi nga Lindja e largët, që viteve të fundit po preferohet dhe konsumohet edhe në rajonin tonë. Po kaq edhe ato karakteristike të ushqimit turk, si dyner, lahmaxhun, pide etj., për të shtuar edhe ato elemente kulturore të veshjeve, konkretisht të fustaneve në shitoret e dedikuara si veshje nusesh dhe të imituara nga seriali aq i shikuar për jetën e Sulltan

Sulejmanit. Siç shihet pra, globalizmi kulturor duke mundësuar qarkullimin e kulturave, rrit kontaktet ndërkulturore dhe formon norma e njohuri të përbashkëta me kultura të ndryshme duke mundësuar që elemente të caktuara kulturore të kalojnë kufijtë kombëtar e rajonal.

Studiues të tjerë konsiderojnë se ndikimi i procesit të globalizimit kulturorë në tjetërsimin e individëve nga traditat e tyre, mund të jetë modest në krahasim me ndikimin e vetë modernitetit. Giddensi konsideron se moderniteti si ide komplekse dhe shumë e kontestuar do të thotë abstraktim i praktikave sociale dhe kulturore të veçanta kulturore lokale, por që moderniteti gjithashtu institucionalizon dhe rregullon praktikat kulturore me të cilat lidhet përkatësia ndaj një vendi dhe komuniteti (Giddens, 1995; Tomlinson, 2003:272). Edhe Anttonen konsideron se ideja e evolucionit kulturor është drejtpërdrejtë e lidhur me procesin e modernizimit, dhe i përcakton traditën dhe modernen si kategori dikotomike.

Dikotomia e traditës dhe modernes konstruktin rrëfimin historik sipas të cilit jeta shoqërore dhe shoqëritë janë bazuar së pari në traditën, nënkupton kështu kontinuitetin kulturor statik dhe konzervativizmin, derisa moderniteti e përcjell traditën, duke i dhënë kuptim ndryshimeve kulturore dhe fundit të traditës. [...] Dikotomia e traditës dhe e modernitetit është aksiomë teorike moderne mbi ndryshimet shoqërore, sipas së cilës modernizmi qëndron për zhdukje të pakët dhe eventuale të traditës (Anttonen, 2005:34).

Për këto arsye, tradita e trashëguar nga e kaluara nuk mund të merret gjithmonë si e kundërta e modernitetit dhe e shkëputur nga interpretimi i traditës në të tanishmen. Sepse si procesi i modernizimit dhe i globalizimit, sot merret si pasqyrim i një kulture materiale e shpirtërore lokale përball asaj globale, por edhe të asaj rurale në mjediset urbane. Dhe ashtu siç e konsideron Durkheimi, këto dy tendenca kundërthënëse shkojnë duke plotësuar njëra tjetrën, ndërsa Tomlinson konsideron se globalizmi më shumë pasuron sesa që shkatërron identitetet, prandaj 'globalizimi është në të vërtetë globalizimi i modernitetit dhe moderniteti është pararojë e identitetit' (Tomlinson, 2003:271; Kadriu, 2009:51).

## Mbijetesa e tradicionales në kontekst global

Çështje thelbësore e hulumtimit në folkloristikë gjithsesi se vazhdon të jetë tradita edhe pse me zhvillimin dhe ndryshimet në disiplinë, ka ndryshuar edhe mënyra se si folkloristët e kuptojnë traditën. Ajo nuk është më vetëm diçka që përcillet nga një gjeneratë në tjetrën, si mënyrë për ruajtjen e të kaluarës së tyre kulturore. Por, në vend të kësaj, si elemente të traditës vendosen 'ato karakteristika mbi të cilat prehen grupet në luftën e tyre për ruajtjen e ndjenjës së identitetit grupor'. (Sims&Stephens, 2005:64-65).

Një tregues i rëndësishëm për traditën është koncepti i vazhdimësisë, sepse një grup i përsërit vetëm gjërat e rëndësishme për formimin e bashkësisë së tyre dhe nuk i përsërit ato të parëndësishmet, të cilat edhe nuk kalojnë në traditë. Vazhdimësia nuk nënkupton pandryshueshmëri të formës origjinale të traditës gjatë përsëritjes, por kontinuiteti i saj 'më shumë nënkupton indet e rëndësishë që i lidhin traditat me grupet'. Prandaj, Sims dhe Stephens konsiderojnë se:

Kjo na ndihmon të kuptojmë se tradita jo çdoherë lëviz "në vijë të drejtë", nga e kaluara në të ardhmen apo nga një gjeneratë në tjetrën. Tradita përfshin edhe hapësirën dhe kohën: ajo përcillet nga një grup në tjetrin, nga një individ në individ tjetër, nga vendi në vend, brenda grupeve dhe kornizave të tyre. (Sims&Stephens, 2005:68).

Nisur nga ky përkufizim i traditës, ky nocion na shfaqet si një kuptim dinamik që vjen nga e kaluara, por jo i përhershëm në kohë, por si një proces në kontinuitet, i cili përcillet nga një zhvillim dhe ndryshueshmëri, e krijuar gjatë jetës së njerëzve. Prandaj, kultura tradicionale shpirtërore sot, nuk paraqet tërësinë e asaj kulture tradicionale të dikurshme, por paraqet një kulturë tradicionale aktuale, ku për shkak të faktorëve të ndryshëm gjithnjë diçka humbet apo transformohet, duke pranuar forma e dukuri të reja, të cilat shfaqen në periudha të caktuara, por që në të ardhme do të mund të bëhen edhe vetë pjesë e 'traditës kulturore'.

Pra, në kohën e globalizimit, trajtuar si proces aktual i dinamikës së zhvillimit shoqëror e kulturor, ose i globalizimit vështruar si tendencë për krijimin e një ideje të një trendi të ri global botëror, na shfaqet edhe dilema e imponuar, se cilat janë karakteristikat themelore të ndryshimeve tani më të



formuara kulturore në kontekstin e provokimeve të bashkëkohësisë. Me shfaqjen e këtyre dilemave përballet edhe folkloristika, e cila po e studion folklorin e krijuar në rrethana të reja dhe të ndryshme nga ato rrethana shoqërore të cilat e patën kushtëzuar krijimin e tij dhe përcjellë atë ndër gjenerata të ndryshme, si një kulturë tradicionale. Sot folkloristika ka në objektin të gjitha ato zhanre tradicionale që bëjnë jetë aktive krijuese produktive, të cilat kanë një bazë sociale, ideore e estetike brenda-folklorike, si dhe ato rite, doke e zakone tradicionale, që edhe pse nuk janë të nënkuptueshme për këtë shkallë zhvillimi shoqëror, riaktivizohen në kushtet e reja të jetës së sotme përmes ekzekutimit të pjesshëm nga bartësit e folklorit, dhe me anë të cilave bëhet diferencimi midis folklorit tradicional dhe atij të sotëm aktual (Uçi, 2007:377-385). Për këtë arsye shumica e folkloristëve konsiderojnë se kjo disiplinë mundet dukshëm të kontribuojë në kuptueshmërinë e vlerave transkulturore.

### **Ribërja e riteve me elemente kulturore globale**

Hulumtimi i riteve tradicionale në bashkëkohësi, dëshmon se sa do që është zhdukur të praktikuarit e riteve magjike në format e tyre arkaike, si dhe besimi në forcat mistike, ato sot manifestohen gjatë kremtimeve me anë të relikteve dhe elementeve, të cilat dëshmojnë një vazhdimësi kulturore, e cila nëpërmjet traditës në familje shpreh vazhdimësinë e saj të çdo individ. Tradita kulturore gjatë procesit të saj evolutiv, sa do që t'i rezistojë ndikimeve të faktorëve të ndryshëm në shoqëri, ajo ka prirje të pranojë edhe elemente të reja të cilat i prodhon realiteti social dhe kulturor, si dhe pranon elemente të reja shpesh të modifikuara dhe të ndikuara edhe nga kultura të tjera. Prandaj, Giddens konsideron se:

Tradita nuk është plotësisht statike, sepse ajo rizbulohet nga çdo brez i ri, kur trashëgojnë trashëgiminë kulturore nga paraardhësit e tyre. Tradita nuk i reziston ndryshimit në masën që i përket një konteksti në të cilin ekzistojnë disa përcaktues të veçantë kohorë dhe hapësinorë, brenda të cilëve ndryshimi mund të marrë çdo formë kuptimplote. (Giddens, 1995:44).

Prandaj, mu për shkak të një morie ndryshimesh ato duhet të trajtohen edhe nga ana e kontekstit aktual. Dundes kontekstin e përkufizon si mjedis



të dukshëm në të cilën ndodh performanca (Sims&Stephens, 2005:137). Prandaj, studimi i kontekstit të një riti është i nevojshëm të lidhet me mjedisin specifik shoqëror, ekonomik dhe kulturor brenda të cilit ai kryhet. Është e qartë se edhe atëherë kur një ritual i përsëritur, mbetet i pandryshuar në kohë, kuptimi i tij mund të ndryshojë thellësisht prej natyrës së kontekstit fillestar. Studiuesi Cannadine, i cili është marr me kontekstin, kryerjen dhe kuptimin e ritualit, konsideron se: Asnjë analizë që kufizohet vetëm te teksti, dhe lë mënjanë mënyrën e kryerjes dhe përshkrimin "e thellë" të kontekstit, nuk mund të shpresojë të ofrojë një shpjegim historik bindës për "kuptimin" e ritualit dhe të ceremonialit [...](Cannadine, 2014:143).

Për të analizuar transformimet/modifikimet e një riti familjar, si pasojë e rrethanave të reja të globalizimit dhe të vërshimit teknologjik, kur përcjellja e 'tradicionales' shpërndahet në mënyra dhe kontekste të ndryshme, në vazhdim do të fokusohem në ndryshimet që po ndodhin brenda një riti kalmi të ceremonialit të dasmës në atë të 'ritit të kënasë', i cili vazhdon të praktikohet në mënyrë kremtimi simbolik edhe sot.<sup>1</sup> Padyshim se për të analizuar ritin e kënasë fillimisht duhet bërë dallimin e ritit të dikurshëm dhe kremtimit të sotëm. Me ritin nënkuptohet ngjarja, ceremonia e përcjellë me rituale të ndryshme, të cilat bëhen sipas një rregulli të përcaktuar nga tradita për raste të caktuara të jetës, e në të cilat dominojnë emocionet e vërteta, besimet, besëtytnitë, ndërsa me kremtim nënkuptohet festimi i një dite apo një momenti të rëndësishëm të jetës, gjatë të cilit edhe pse nuk kryhen rituale me rregulla të caktuara si më parë, pa emocione e besëtytni, ato kryhen në mënyrë simbolike, në ambiente publike, siç janë restorantet dhe mund të konsiderohen vetëm si shfaqje të aranzhuara.

Simbolika e ritit të kënasë, që nënkupton ngjyrosjen e gjymtyrëve të grave është e njohur për shumë kultura në botë, e në kulturën tradicionale shqiptare është manifestuar si riti i natës së kënasë, i cili organizohet gjatë ceremonisë së dasmës në shtëpinë e vajzës e cila bëhej nuse. Bazuar në teorinë e Gennepit, i cili fenomenin e iniciacionit e mbështet në procesin e ka-

---

<sup>1</sup>Për ndryshimet e ritit të kënasë në bashkëkohësi, punimi është mbështur në bashkëbisedimin me të intervistuarat, të cilat me dëshirë e kanë realizuar këtë rit në hapësira restorantesh, si dhe në intervistën me menaxheren e njërës nga agjencitë që merren me organizimin edhe të këtij riti në hapësira publike.

limit nga një fazë në një fazë tjetër në jetën e çdo individi, që nënkupton kalimin nga një moshë në një moshë tjetër, ose nga një pozitë sociale në një tjetër (Gennep, 1960), atëherë riti i kënasë që realizohej dikur në familjen e nuses përkufizohet në kategorinë e riteve të kalimit. Ky rit kalimi i ceremonialit të dasmës tradicionale, i cili realizohej dikur në familjen e nuses, sot na shfaqet si kremtim i ritit të dikurshëm me elemente ceremoniale të një kulture të re, e cila po përvetësohet dhe adaptohet edhe në kulturën shqiptare si refleksion i ndryshimit socio-kulturor në jetën e përditshme.

Nën ndikimin e konceptit të moralit patriarkal, i cili ka mbizotëruar për një kohë të gjatë në traditën shqiptare, në familjen e vajzës që martohej nuk mbizotëronte atmosferë gëzimi, prandaj edhe solemniteti i dasmës ishte i kufizuar rreth ritualit tradicional të ritit të kënasë, që praktikohet natën e fundit para martesës, në shtëpi të vajzës e cila bëhej nuse. Për këtë veprim solemn ekzistojnë emërtime të ndryshme, si: ‘nata e bojës’, ‘nata e kanës’, ‘kënaqegje’. Kësaj ceremonie i paraprinte në të kaluarën një sërë ritesh si: ‘marrja e masës’ ose ‘këputja e penit’, ‘ndarja e vades’, ‘dërgimi i petkave’, ‘shprishja e gërshetit’ etj.<sup>2</sup> Me një fjalë e tërë ceremonia e dasmës në shtëpi të vajzës ishte e përqendruar rreth përgatitjes së saj për tu bërë nuse. Pra, një natë para ditës së dasmës, rreth nuses mblidheshin gratë, vajzat e familjes së gjerë, po edhe shoqet e nuses, të cilat ia shprishnin gërshetat asaj, veprim ky simbolik me të cilin nusja e ardhshme largohej nga vajzëria, ia lyenin flokët (në periudhën e më hershme me bojë,<sup>3</sup> e cila me vonë u zëvendësua me

---

<sup>2</sup>Këto rite të ceremonisë së dasmës tradicionale të dikurshme, sot janë zhdukur plotësisht, sepse vajza-nuse e bën vetë përzgjedhjen e fustaneve të nevojshme për ceremoni dhe kujdeset për dukjen e saj të stilisti.

<sup>3</sup>Ky rit kalimi që simbolizon shkëputjen e periudhës së vajzërisë dhe kalimin në atë të nuses, me ritualin engjyrosjessë tepes së kokës ose të një fije floku me ngjyrë të zezë, është i njohur që heret në kulturën tradicionale shqiptare. Pas përhapjes së besimit mysliman, kjo bojë u zëvendësua me këna dhe filloi praktikimi i lyerjes së duarve me pika ose të gishtave të duarve me këna, por edhe të një trekëndëshi si brenda shuplakës dhe jashtë dorës. Ky trekëndësh sipas disa studiuesve është simbol i plleshmërisë, gjurmë e mbetur nga mitologjia ilire, e cila lidhet me amuletet ilire të cilat poashtu ishin simbol i plleshmërisë (Mustafa 1979:157-170; Stipçeviq 1979:19-46). Sot, siç na tregon menaxherja e agjencionit dhe organizatorja e ritit të kënasë në restorante, nuses i lyhen vetëm shuplakat e duarve me këna,

këna, me të cilën i lyenin edhe gishtat e duart). Kjo këna dërgohej së bashku me 'petkat e nuses' (veshmbathje e dërguar në formë dhurate enkas për nusen) një javë më parë nga shtëpia e dhëndrit. Me këna i lyenin gishtat e duarve edhe vajzat e pranishme, gjë për të cilën supozohet se paraqet mbetje vizuale të pastrimit (purifikimit) të martesave nga lashtësia kur bëheshin martesat në grupe të vajzave në një ditë dhe me shpenzime të njëjta për aq djem sa vajza (Pllana, 2004:126-127).

Sigurisht se për një kontekst kohor të caktuar, ky rit mbart në vete vulën e kohës, duke treguar për një strukturë të së kaluarës dhe për shkallë të caktuara të zhvillimit shoqëror. Sot, përkundër një ndryshimi esencial në kuptimin e martesave tradicionale, ku rol kyç luan përfshirja emocionale në një lidhje martesore, ky rit vazhdon të realizohet edhe pse bashkëkohësia e ka bërë më të lehtë dhe praktikë që riti i vënies së kënasë të improvizohet dhe performohet në një kontekst të ri kremtimi në salla e restorante dhe me një kosto të lartë, të cilën çdo familje nuk mund ta përballojë. Dukuri të këtilla janë të njohura edhe për kultura të tjera, ku martesat edhe pse ishin të përhapura dhe të zakonshme, në dekadat e fundit normat e kësaj martese kanë rënë ndjeshëm dhe martesat ka ndryshuar nga një rit universal i kalimit në një kremtim të spikatur të jetesës së klasës së mesme (Pauli & van Dijk, 2017:257).

Por, siç vëren Gilmour 'shoqëritë moderne kanë akoma nevojë për mitin e ritualin ...' (Cannadine, 2014:139), prandaj ky rit u rikthye vetëm si veprim simbolik<sup>4</sup>, sepse nusja në kontekstin aktual vije në kremtimin e natës së kënasë e rregulluar nga sallonet estetike. Krahas dekorimit të sallave si për dasma, po edhe për natën e kënasë, në lokalet e këtilla ofrohet mundësia edhe e improvizimit të vënies së kënasë në mënyrë spektakolare. Këtë formë spektakolare e bën fakti se organizimi i ritit tani bëhet nga agjenci të caktua-

---

ndërsa shoqet e saja prezente gjatë këtij riti, po me të njëjtën këna e vizatojnë në shuplak të dorës shkronjën e parë të emrit të nuses. Kjo këna nuk zgjat më shumë se disa ditë.

<sup>4</sup>E intervistuar tregon se, derisa gjyshja e saj pati një ritual të kënasë tradicionale, në ambientin e shtëpisë së saj të prindërve, nëna e saj që i takon një gjenerate tjetër dhe të arsimuar, nuk pati dëshirë që të bëjë këtë ritual gjatë martesës, sepse e ka konsideruar si një besytyni të paqëndrueshme, ndërkaq ajo ka shprehur vetë dëshirë që ta organizojë, duke angazhuar agjencinë që këtë rit ta bëjë në mënyrë simbolike në restorant.

ra për raste të këtilla.<sup>5</sup> Agjencitë përbëhet nga një "profesioniste" e cila angazhon 6 ose 8 vajza të cilat të veshura me veshje tradicionale ose fustane të kuq (sipas dëshirës së klientës), vallëzojnë, mbajnë qiri në duar dhe këndojnë. Pra, ndryshe nga sa ndodhte me parë, tani kremtimi kryhet në mënyrë të "përsosur", në kuptimin që çdo detaj është mirë i menduar nga "profesionisti" aq sa spektatorët, në rastin konkret gratë e ftuara, mund të mendojnë se kështu ka qenë gjithmonë.

Gjithashtu, duhet theksuar edhe faktin se në kohën në të cilën jetojmë, kultura po plasohet/shitet si rezultat i proceseve intensifikuese të konsumimit dhe komercializimit, prandaj edhe shtrohet pyetja se si këto procese, e përdorin kulturën, po edhe atë tradicionale, duke e ndryshuar/modifikuar për nevojat e tregut. Përveç kësaj, konsumatori nuk përfshin vetëm konsumimin e objekteve dhe shërbimeve, por gjithashtu edhe vlerat, idetë, shfaqjet artistike dhe mediatike. Në këtë mënyrë, ato që konsumohen e përcaktojnë identitetin tonë, edhe pse ne e dimë se ai i nënshtrohet transformimit të vazhdueshëm dhe ridefinimit. Nga ana tjetër, çështja e komercializimit është çështja e industrisë dhe biznesit, në të cilën kultura është thjesht një mjet (Martinoska, 2018:29). Prandaj, duke parë improvizimin e këtij riti nga këndvështrimi i kthesave, si rezultat i ndryshimeve shoqërore e ekonomike globale dhe kulturore, shtohet edhe nevoja për përpjekje sistematike për të analizuar ato brenda një kornize krahasuese dhe kontekstuale.

Ndikimi i kulturës globale bashkëkohore, ka bërë që viteve të fundit edhe pse ende në raste të rralla, të praktikohet një formë krejtësisht e re e këtij kremtimi, pa asnjë element të përbashkët me atë të ritit tradicional. Në disa kultura perëndimore, në raport me rajonin e Ballkanit, është praktikë që vajza, po edhe djali të cilët janë të gatshëm të kalojnë nga statusi i tyre i beqarisë në atë martesor, të organizojnë për shoqërinë e tyre të afërt një kremtim të njohur në kulturat e tyre si 'Nata e vajzërisë' ose 'Nata e beqarisë', me

---

<sup>5</sup>Menaxherja e agjencisë me të cilën bashkëbiseduam theksoi se i tërë dekori i sallën sigurohet nga agjencioni i saj si për ritin e kënasë, po edhe për ritet tjera si i lindjes ose syntisë, varësisht nga interesimi i klientit. Për ritin e kënasë ky agjencion siguron edhe veshjen e vajzave përcjellëse të nuses, sipas kërkesës, si dhe këngëtarin e cila i këndon këngët tradicionale përcjellëse për këtë rit.

të cilën shënohet ndryshimi në statusin e tyre social. Ky lloj kremtimi mund të themi se ka të njëjtin funksion me ritin e kalimit të njohur në kulturat tradicionale. Por, ky lloj kremtimi i 'Natës së vajzërisë' ende nuk mund të quhet i përgjithësuar për kulturën shqiptare. Po që se mbështetemi në përkufizimin e Eduard Kale për subkulturën, i cili thotë se "në studimet kulturore ka një pajtim se subkulturat i karakterizojnë edhe sistemet dhe domethëniet e veçanta, statusin, gjërat materiale, pjesërisht edhe vlerat dhe se kështu paraqiten stilet e veçanta" (Kadriu, 2007:313), atëherë edhe këtë lloj kremtimi si stil i veçantë, mund ta klasifikojmë në kategorinë e një subkulture, e cila nuk i ka përmasat përgjithësuese dhe se ende merret si dukuri kremtimi i huazuar nga një kulturë globale.

## Përfundim

Procesi i globalizimit, krijoi mundësi dhe hapësirë për një tempo të përsheptuar të evoluimit të traditës kulturore, e cila nën ndikimin efaktorëve të ndryshëm në shoqëri, shfaqi prirje të pranojë elemente të reja, të cilat i prodhon realiteti social dhe kulturor, si dhe aso elementesh të reja shpesh të modifikuara dhe të ndikuara edhe nga kultura të tjera. Ndërveprimi i këtyre elementeve brenda proceseve kulturore e shoqërore mund të ndikojë që në një kohë të ardhme ato të merren edhe si tradicionale, duke shfaqur dhe krijuar gjithmonë mundësinë e krijimit të dallimeve me atë kulturë tradicionale tani më të studiuar dhe evidentuar në botime përkatëse.

## Literatura

- Anttonen**, A. 2005. Tradition through Modernity-Postmodernism and the Nation-State in Folklore Scholarship. Helsinki: Finnish Literature Society.
- Appadurai**, A. 1990. "Disjuncture and difference in the global cultural economy." [online]. Theory, Culture & Society (SAGE, London, Newbury Park and New Delhi). Vol.7:295-310. [qasur shtator, 2022]  
[https://pages.mtu.edu/~jdslack/readings/CSReadings/Appadurai\\_Arjun\\_Disjuncture\\_and\\_Difference\\_in\\_the\\_Global\\_Cultural\\_Economy.pdf](https://pages.mtu.edu/~jdslack/readings/CSReadings/Appadurai_Arjun_Disjuncture_and_Difference_in_the_Global_Cultural_Economy.pdf)
- Cannadine**, D. 2014. "Konteksti, Kryerja dhe Kuptimi i Ritualit: Monarkia Britanike dhe "Shpikja e traditës" në vitet 1820-1977." ff. 137-221 në E. Hobsbawm-T. Ranger (editor). Shpikja e traditës. Përkthyes Enis Sulstarova dhe Doan Dani.

- Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
- Dundes**, Alan. 1965. *The Study of Folklore*, Prentice Hall.
- Gennep**, A. 1960. *The Rites of Passage*. Chicago: The University of Chicago Press.
- Giddens**, A. 1998. *Posledice modernosti*. Përkthyes Vesna Biga dhe Mladen Lazić. Beograd: Filip Višnjić.
- Kadriu**, L. 2007. "Të rinjtë, traditat kulturore dhe ritet e kalimit.", *Gjurmime Albanologjike – Folklor dhe Etnologji* 36/2006:311-329. Prishtinë: Instituti Albanologjik.
- Kadriu**, L. 2009. *Glokalizimi - përceptime etnokulturore*. Prishtinë: Instituti Albanologjik.
- Limani**, A. 2018. "Globalizimi bota e ndërlidhur dhe e ndërvarur." [online]. URL: [qasurshtator, 2022].  
[https://www.academia.edu/35835082/GLOBALIZIMI\\_BOTA\\_E\\_ND%C3%8BRLIDHUR\\_DHE\\_E\\_ND%28RVARUR](https://www.academia.edu/35835082/GLOBALIZIMI_BOTA_E_ND%C3%8BRLIDHUR_DHE_E_ND%28RVARUR)
- Мартиноска**, А. 2018. "Традиција и современост-неколку теориски перспективи на народната култура". *Македонски фолклор* XL/73: 23-32. Скопје: Списание на Институтот за фолклор "Марко Цепенков".
- Mustafa**, M. 1979. "Këngët dhe ritet e kënasë në disa treva të Kosovës.", *Gjurmime Albanologjike – Folklor dhe Etnologji* VIII-1978: 157-170. Prishtina: Instituti Albanologjik.
- Pauli**, J., Rijk, D. 2017. "Marriage as an end or the end of marriage? Change and continuity in Southern African marriages." *Anthropology Southern Africa* 39(4): 257-266. [online] URL: [qasur shtator, 2022]. [https://www.academia.edu/30576295/Marriage\\_as\\_an\\_end\\_or\\_the\\_end\\_of\\_marriage\\_Change\\_and\\_continuity\\_in\\_Southern\\_African\\_marriages](https://www.academia.edu/30576295/Marriage_as_an_end_or_the_end_of_marriage_Change_and_continuity_in_Southern_African_marriages)
- Pllana**, Sh. 2004. *Studime në fushë të folklorit*. Prishtina: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.
- Sims**, M. C., Stephens, M. 2005. *Living Folklore*, Utah: Utah State University Press/ Logan.
- Stipçeviq**, A. 1979. "Amuletet ndër ilir në kohën e parahistorisë.", *Gjurmime Albanologjike-Histori* VIII-1978: 19-46. Prishtina: Instituti Albanologjik.
- Tomlinson**, J. 2003. "Globalization and Cultural identity." [online]. URL: [qasur shtator, 2022]. [https://www.academia.edu/14982419/Globalization\\_and\\_Cultural\\_Identity](https://www.academia.edu/14982419/Globalization_and_Cultural_Identity)
- Uçi**, A. 2007. "Folklori shqiptar-Midis së kaluarës dhe të sotmes." *Estetika e Folklorit*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Eduart Caka

Instituti i Historisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë

# BASHKËJETESA TEK SHQIPTARËT NË KONTEKSTIN MULTIKULTURALIST TË PROCESIVE GLOBALIZUESE

## Abstrakt

*Bashkëjetesa ka qenë njëra prej shtyllave kryesore mbi të cilën e mbështetën ligjërimin e tyre rilindasit shqiptarë gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe fillimeve të shek. XX. Kjo, veç të tjerash, edhe me qëllimin e krijimit të një uniteti etniko-kulturor midis pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme fetare të një kombi vetëm, fenomen të cilin nuk e hasim tek fqinjët e tjerë ballkanikë. Kështu, ndonëse një shekull më parë bashkëjetesa na shfaqej si një "pengesë" në procese nacionaliste, ndryshe ndodh në kontekstin globalist ku multikulturalizmi përbën sfidën kryesore të shoqërive moderne. Parë nga ky këndvështrim, bashkëjetesa tek shqiptarët del në pah si një vlerë dhe "model" për shoqëritë e tjera që përballen me diskriminimin, ksenofobinë dhe urrejtjen e "tjetrit". Përmes kësaj kumtese tentoj të evidentoj veçoritë e fenomenit të bashkëjetesës tek shqiptarët si dhe sfidat me të cilat ajo përballlet në kontekstin e multikulturalizmit në epokën globale duke u përpjekur t'i përgjigjem edhe pyetjes se a mund të jetë bashkëjetesa shqiptare një model për të tjerët.*



## Hyrje

Studimet mbi multikulturalizmin kanë vijuar të zhvillohen paralelisht me proceset globalizuese që ka përjetuar njerëzimi, aspekt i cili na lë të kuptojmë se moria e rasteve dhe qasjeve hulumtuese mbi këtë fenomen, sot kanë arritur në pikën kulminante. Për rrjedhojë, trajtimi teorik i multikulturalizmit ka konstatuar në një spektër tejet të gjerë, i cili ka ngërthyer brenda vetes

aspekte që kanë të bëjnë me etninë, kulturën, filozofinë, artin, kulturën etj., duke u vlerësuar nga disiplina të ndryshme shkencore dhe plotësuar në këtë mënyrë kornizën shkencore të studimit të kësaj fushe. Në këtë kuadër, punimet më të fundit në këtë drejtim i referohen kryesisht fenomeneve apo gjeografive të caktuara duke i analizuar ato sipas teorive apo pikëpamjeve multikulturaliste.<sup>6</sup>

Në praktikë, multikulturalizmin dhe diskutimet mbi të i vërejmë më së shumti në vendet e zhvilluara, të cilat kanë vijuar vazhdimisht të thithin emigrantë nga vende e kultura të ndryshme. Kështu, gjatë proceseve integruese të këtyre minoriteteve në shoqëritë kryesisht perëndimore, aspekte të ndryshme si ajo në rrafshin juridik, etnik, fetar apo kulturor janë tema diskutimi për shoqëritë dhe institucionet akademike përkatëse, kjo në mënyrë që grupet e ndryshme të huaja të mund të bëhen pjesë e shoqërisë së vendit përkatës. Parë nga ky këndvështrim, mund të thuhet se Shqipëria qëndron në periferi të studimeve dhe diskutimeve mbi këtë fushë, pasi si një vend i brishtë ekonomikisht, ajo nuk përballet me problematika të ngjashme. Mirëpo, nisur edhe nga debatet që ndodhin në Perëndim mbi multikulturalizmin dhe aspektin e përkatësive të ndryshme fetare në veçanti, tradita e bashkëjetesës që ka ekzistuar te shqiptarët, ndoshta mund të shërbejë si një pikë orientuese për problematikat me të cilat përballet shoqëritë e zhvilluara në këtë drejtim.<sup>7</sup>

---

<sup>6</sup> Do të ishte e pamundur dhe jashtë qëllimit të kësaj kumtese të japim një bibliografi të studimeve që janë kryer mbi multikulturalizmin apo trendet e studimeve në këtë lëmi. Për një trajtesë të shkurtër të këtij nocioni dhe disa prej punimeve kryesore që janë kryer në këtë drejtim, shih *The Ashgate Research Companion to Multiculturalism*, ed. Duncan Ivison, New York: Routledge, 2010. Ndërsa për një trajtim të multikulturalizmit në kontekstin filozofik, shih Naomi Zack, "Multiculturalism", *Stanford Encyclopedia of Philosophy, Second Edition*, ed. Donald M. Borchert, f. 421-427.

<sup>7</sup> Fakti se bashkëjetesa fetare te shqiptarët mund të shërbejë si një shembull edhe për vendet e tjera, është një realitet i evidentuar vazhdimisht prej aktorëve të fesë, shkencës dhe politikës në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Ndër figurat më të rëndësishme botërore që e ka vlerësuar këtë trashëgimi të vyer, është edhe Papa Françesku, i cili e theksoi këtë aspekt gjatë vizitës së tij në Shqipëri më 2014. Për më shumë, shih Eduart Caka, *Dialogu Ndërfetar; Një Qasje Teoriko-Praktike dhe Realiteti Shqiptar*, Tiranë: West Print, 2015, f. 191-194; Eduart



Kjo përvojë e bashkëjetesës ndërjetare të shqiptarët konsiston në prezencën e tre besimeve tradicionale, atij katolik, ortodoks e islam, të cilët konsistojnë edhe në formuesit e hartës fetare të shqiptarëve. Aty nga fundi i shek. XIX religjioneve në fjalë do t'u shtoheshin edhe ungjillorët. Po ashtu, gjatë dekadave të para të shek. XX në Shqipëri do të transferohej edhe kryegjyshata e bektashinjve, urdhër i cili aktualisht gëzon të drejtat e një komuniteti fetar më vete. Kështu, teksavijmë në vitet 1990 në Shqipëri u njohën zyrtarisht nga shteti të pesta komunitetet fetare në fjalë, duke e formësuar në këtë mënyrë edhe hartën fetare. Listës së mësipërme duhet t'i shtohet edhe bashkësia e vogël e hebrenjve që jetojnë në vend, të cilët kanë hapur në vitin 2010 edhe sinagogën e parë duke e formalizuar komunitetin e tyre.<sup>8</sup>

Krahas organizimeve që bashkësitë fetare në vend kanë kryer gjatë dekadave të fundit me synimin e promovimit të bashkëjetesës ndërjetare, edhe vetë shteti shqiptar e ka mbështetur dhe promovuar këtë traditë institucionalisht brenda dhe jashtë Shqipërisë. Këtë element e vërejmë qartësisht të sanksionuar edhe në preambulën e kushtetutës, ku shkruhet:

*"Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim të Zotit dhe/ose të vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare..."*<sup>9</sup>

Ndonëse në kontekstin formal institucionet dhe shteti në Shqipëri e promovojnë bashkëjetesën ndërjetare si një element përbashkues dhe vlerë që e shëndosh shoqërinë, analiza e vërtetë fillimisht duhet të konsistojë edhe në ato dinamika joformale e jozyrtare që e formojnë këtë traditë, ndërsa më pas të evidentohen sfidat me të cilat përballet kjo traditë veçanërisht në epokën e proceseve globalizuese të Shqipërisë, por edhe në frymën e ndryshimeve që po ndodhin vitet e fundit me rritjen e rrymave ekstremiste në Europë.

---

Caka, "Religious Co-existence and Interreligious Dialogue Activities in Albania", *Journal of Balkan Studies*, no: 1, vol: 7, Bursa: 2016, f. 101-102.

<sup>8</sup> E. Caka, *Dialogu Ndërfetar...*, f. 162.

<sup>9</sup> *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, Tiranë: Qendra e Botimeve Zyrtare, 2017.

## **Institucionalizimi i bashkëjetesës: arritjet në Shqipëri gjatë proceseve globalizuese**

Nëse krerët e komuniteteve fetare të viteve 1930 dhe klerikët më në zë të kohës, të cilët njëkohësisht ishin edhe intelektualë *par excellence* si Fan S. Noli, Gjergj Fishta, Hafiz Ali Korça et. Folën dhe shkruajtën për një kohezion të shoqërisë shqiptare ku besimi duhej të shërbente si një element përbashkues, institucionalizimi i bashkëjetesës ndërjetare në Shqipëri do të ndodhte pas viteve 1990, më saktësisht në vitin 1999 me krijimin e institucionit të Komunitetit Shtetëror për Kultet.<sup>10</sup> Kështu, duke ndjekur një linjë kronologjike do të përpiqemi të parashtrijmë disa prej ngjarjeve dhe akteve kryesore që e kanë karakterizuar institucionalizimin e bashkëjetesës ndërjetare në Shqipëri duke e ndjekur në linjën fetare dhe atë shtetërore.

Në aspektin e kontributit të bashkësive fetare, mund të thuhet se aktiviteti i tyre në promovimin e bashkëjetesës ka filluar që në fillimin e viteve 1990 kur shqiptarët e rifituan të drejtën e besimit dhe filluan rindërtimin e institucioneve religjioze. Kështu, ndër aktivitetet kryesore që u ndërmorën në këtë drejtim mund të përmenden takimet e mbajtura ndërmjet krerëve të komuniteteve në kuadër të takimeve të dialogur ndërjetar, një proces i promovuar dhe kryer prej kishës katolike. Në këtë drejtim vlen të theksohet veçanërisht vizita e Papa Gjon Palit II që zhvilloi në Shqipëri në vitin 1993, por dhe ajo e Papa Françeskut më 2014.<sup>11</sup>

Një hap tjetër me rëndësi në kuadër të kontributit të bashkësive fetare për zhvillimin dhe thellimin e marrëdhënieve të mira ndërjetare, është edhe

---

<sup>10</sup> Këtu nuk nënkuptojmë krijimin e komuniteteve fetare në Shqipëri, të cilat u formësuan si bashkësi gjatë viteve 1920-30 përmes kongreseve të përgjithshme që mbajtën, por për institucionet ndërkonfesionale që u formësuan në vitet 1990 pas një lufte gjysmëshekullore të regjimit komunist ndaj fesë dhe besimit në Zot. Për më shumë detaje në lidhje me proceset e formimit të komuniteteve fetare gjatë gjysmës së parë të shek. XX dhe rëndësisë që ato i dhanë bashkëjetesës, shih Roberto Morocco dela Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, përkthyer nga Luan Omari, Tiranë: Shtëpia botuese “Elena Gjika”, 1994; E. Caka, *Dialogu Ndërfetar...*, f. 154-155.

<sup>11</sup> Për më shumë detaje mbi vizitën e Papa Gjon Palit II në Shqipëri si dhe aktivitetet e mbajtura ndërmjet krerëve të komuniteteve fetare të vendit në kuadër të dialogut ndërjetar gjatë viteve 1990-2010, shih E. Caka, *Dialogu Ndërfetar...*, f. 166-170.

formimi i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë në vitin 2007. Kjo nismë përbën edhe hapin e parë që shteti ndërmori në institucionallizimin e bashkëjetesës në Shqipëri. Këshilli në fjalë përbën edhe institucionin më të lartë në kuadrin e bashkërendimit të aktiviteteve ndërfetare në vend si dhe promovimin e bashkëjetesës ndërmjet bashkësive konfesionale, besimtarëve të thjeshtë dhe shoqërisë shqiptare në tërësi.<sup>12</sup>

Një aktivitet i Këshillit në fjalë në bashkëpunim me qeverinë shqiptare ishte edhe parakalimi në Paris i kryeministrit të Shqipërisë i shoqëruar prej krerëve të katër komuniteteve fetare në marshimin që u mbajt me rastin e sulmit terrorist të kryer ndaj revistës satirike Charlie Hebdo. Veprimi i delegacionit shqiptar jo vetëm që pati një jehonë në shtypin europian, por gjithashtu shfaqti zyrtarisht edhe shembullin se si pjesëtarë dhe përfaqësues të komuniteteve të ndryshme fetare mund të bashkëpunojnë në dobi të koherencës dhe paqes.<sup>13</sup>

Nga ana tjetër, edhe vetë shteti shqiptar, duke filluar që nga preambula e kushtetutës që përmendëm më lart, e ka promovuar zyrtarisht bashkëjetesën ndërfetare që ka ekzistuar vazhdimisht në vend. Kjo mbështetje nuk ka funksionuar vetëm përmes përkrahjes që i ka dhënë komuniteteve fetare duke iu krijuar lehtësitë e nevojshme, por edhe në përdorimin e kësaj vlere në nismat politike që shteti ka ndërmarrë. Kështu, në vitin 2012 Shqipëria mori presidencën e Këshillit të Europës për një periudhë gjashtëmujore, mandat të cilin e kreu nën moton "të bashkuar në diversitet", duke reflektuar kështu traditën e mirë të bashkëjetesës këtu, një vlerë e cila është njëra prej prioriteteve të Bashkimit Europian.

Shembujt e mësipërm na tregojnë se në aspektin institucional ekziston vullneti dhe bashkëpunimi i shtetit dhe komuniteteve fetare për ta zgjeruar, thelluar dhe promovuar bashkëjetesën ndërfetare. Mirëpo, ndonëse në nivelin burokratik situata duket optimiste dhe funksionale, në nivelin e besimtarëve apo shoqëror, gjendja paraqet disa anomali, të cilat ngrejnë pikëpyetje në kokën e studiuesit kur flitet për bashkëjetesën ndërfetare në Shqipëri dhe

---

<sup>12</sup> E. Caka, *Religious Co-existence...*, f. 111.

<sup>13</sup> Po aty.

mundësinë e shërbimit të saj si një shembull për problemet që hasen në këtë drejtim në shoqëritë e zhvilluara dhe klimën globaliste në përgjithësi.

## **Sfidat në lidhje me funksionalizimin e bashkëjetesës ndërfetare në Shqipëri**

Rritja e frymave ekstremiste në politikën europianedhe krizat që e kapluan botën gjatë viteve të fundit duke filluar me periudhën e pandemisë dhe tanimë me luftën që po zhvillohet në Ukrainë ka bërë që herë pas here të krijohen debate të ashpra në lidhje me minoritetet etnike dhe fetare që jetojnë në vende të ndryshme të Bashkimit European. Sigurisht që në hapësirën shqiptare nuk vërehen ende pozicionime të tilla politike, por ekzistenca e debateve të ngjashme na shtyn të shtrojmë disa pyetje në lidhje me faktin se sa funksionale është bashkëjetesa ndërfetare në Shqipëri. Në këndvështrimin tonë, ashtu si në pjesën e mësipërme ku institucionalizimi i bashkëjetesës u analizua në prizmin e bashkësive fetare dhe shtetit, edhe në trajtimin e problematikave të institucionalizimit të saj qasja jonë do të konsistojë në ato që lidhen me shtetin dhe të tjerat që ndalen te aspektin fetar.

Më konkretisht, ndonëse zyrtarisht shteti shqiptar e mbështet dhe e nxit thellimin bashkëjetesës ndërfetare në vend, në aspektin intelektual e shkencor nuk është hedhur thuajse asnjë hap në këtë drejtim. Si një vend me një trashëgimi kaq të pasur fetare e bashkëjetese, kjo tematikë dhe disiplina shkencore që lidhen me të si Historia e Religjioneve apo Religjionet Krahasuese nuk njihen në universitetet shqiptare. Në Shqipëri ende nuk ka një katedër universitare, institut kërkimor apo fakultet që e trajton sipas metodologjive shkencore historinë e fesë dhe të bashkëjetesës në vend. Për rrjedhojë, informacionet dhe tradita e akumuluar në këtë drejtim mbetet e pafORMALIZUAR, pa një strukturë dhe e pambështetur në qasje shkencore porse qëndron në nivelet e mitit e legjendës. Në këtë kontekst, bashkëjetesa ndërfetare do të dukej vetëm një ligjërim i përditshëm, por i patreguar dhe paruajtur në kontekstin historik. Për më tepër, një neglizhim i tillë ndikon edhe në mosruajtjen e trashëgimisë historike në lidhje me këtë temë. Për ta përmbledhur, mund të themi se, për sa kohë që shteti e përdor bashkëjetesën ndërfetare thjesht në ligjërimin e përditshëm por nuk hedh hapa në institu-

cionalizimin e kësaj praktike, ruajtja dhe trajtimi i kësaj vlere në aspektin shkencor mbetet një sfidë e rëndësishme për vendin.<sup>14</sup>

Ndërsa diskutimi i dytë në lidhje me bashkëjetesën ndërjetare dhe sfidat me të cilat përballlet ajo, lidhet me një temë që është diskutuar prej më shumë se një shekulli: me faktin se kjo bashkëjetesë buron nga toleranca që besimtarët kanë ndaj njëri-tjetrit, apo me neglizhencën që e karakterizon shqiptarin në përgjithësi ndaj religjionit.

Pikëpamja e parë nuk kërkon një shtjellim të thellë, pasi vetë besimet dhe klerikët flasin për tolerancën dhe nevojën e bashkëjetesës, ndërkohë që në thelb kanë një qasje ekskluziviste.<sup>15</sup> Ajo që duhet trajtuar në këtë pikë, është më së shumti pikëpamja e dytë, sipas të cilës mund të flitet më së shumti për një neglizhencë se bashkëjetesë. Ndonëse një qasje dhe konstatim të tillë e vërejmë më së shumti te veprat e udhëtarëve e diplomatëve të ndryshëm perëndimorë që e vizituan hapësirën shqiptare gjatë shek. XIX, fenomene si ato të kriptokristianizmit apo dëshmi të kohës na shtyjnë ta datojmë më herët ekzistencën e një teze të tillë. Një rast i tillë është dhe dëshmia e bashkëshortes së ambasadorit anglez në Perandorinë Osmane M. Wortley Montague, ecila, që në shek. XVIII e përshkruan kështu qasjen e shqiptarëve ndaj fesë:

*"Por, nga të gjitha fetë që kam parë, ajo e arnautëve mua më duket më e veçanta. Ata që janë lindur në Arnautlluk, Maqedonia e Lashtë, dhe ruajnë ende të njëjtin guxim dhe trimëri, ndonëse emrin maqedonas e kanë humbur. Ata janë milicia më e mirë në perandorinë turke dhe e vetmja që arrin të vërë*

<sup>14</sup> Praktikisht në disa fakultete jepet lënda e historisë së religjioneve por lektorët janë të papërgatitur profesionalisht për ta mbajtur një lëndë të tillë. Kjo lidhet me mungesën e departamenteve ku mund të fitohet një doktoraturë në fushën e Historisë së Religjioneve por edhe faktit se literatura e përdorur në leksione mbi këtë temë, por edhe tezat e shkruara kanë mungesë të theksuar metodologjike.

<sup>15</sup> Sipas Endresen, kleriku mysliman ia atribuon tolerancën ndërjetare klimës së favorshme për jetimin e fesë që krijoi Perandoria Osmane, ai katolik e lidh me substratin e krishterë që gjendet te të gjithë shqiptarët para se ata të konvertoheshin në besime të tjera, ndërsa për dervishin bektashian e gjitha shtresa mistike e feve është mbledhur në frymën mistike bektashiane, e cila është autentike te shqiptarët. Për më shumë detaje, shih Cecilia Endresen, *Is the Albanian's religion really "Albanianism"?: Religion and nation according to Muslim and Christian leaders in Albania*, Wiessbaden: Harrassowitz Verlag, 2012, f. 224.

frerët mbi jeniçerët. Janë ushtarë këmbësorë... Vishen dhe armatosen me shpenzimet e tyre, të veshur me pëlhurë të bardhë e të pastër e të ashpër, me armë të një gjatësie të stërmadhe, të cilën ata e hedhin mbi shpinë, a thua se nuk e ndiejnë peshën e saj; kurse prijësi i tyre këndon një lloj kënge të palëmuar, jo të pakëndshme, dhe të tjerët e ndiqnin në kor. Ky popull jeton ndërmjet të krishterëve dhe muhamedanëve, dhe duke mos qenë i aftë në debatet ndërmjet tyre, deklarojnë se janë krejtësisht të paaftë për të gjykuar se cila fe është më e mira. Por, për të qenë të sigurt se nuk e refuzojnë plotësisht të vërtetën, ata ndjekin me shumë urtësi të dyja fetë. Të premtëve ata shkojnë në xhami dhe të dielave në kishë; duke thënë (për t'u shfajësuar) se në Ditën e Gjykimit ata e kanë të siguar mbrojtjen nga profeti i vërtetë. Por, se cili është ky, ata nuk janë në gjendje ta përcaktojnë që në këtë botë. Besoj se nuk ka racë tjetër të njerëzimit të cilët kanë një opinion kaq modest për kapacitetin e tyre."<sup>16</sup>

Autorët dhe studiuesit e huaj kanë qëndruar vazhdimisht mbi këtë temë duke theksuar faktin se lidhjet fafifisnore të shqiptarët kanë preluar gjithnjë para fetarizmit të tyre. Këtu ka ndikuar pluralizmi fetar të shqiptarët por edhe periudha e sistemit komunist, në të cilin u luftua feja dhe besimi duke proklamuar ateizmin. Madje, shteti shqiptar në këtë periudhë e përcaktoi në kushtetutën e vet ndalimin e fesë dhe karakterin ateist të tij.<sup>17</sup> Për një hark kohor prej gjysmë shekulli tradita dhe jeta fetare e shqiptarëve u ndërpre në mënyrë radikale duke u orientuar me detyrim drejt një kahu krejtësisht të ndryshëm, gjë e cila do të ndikonte edhe në vetëdijen fetare dhe jetën shpirtërore të njerëzve që lindën dhe jetuan gjatë asaj periudhe.

Ndikimet dhe ndryshimet që solli periudha e regjimit komunist në jetën fetare të njerëzve dallohen qartësisht në një anketim të bërë me studentët e Universitetit të Tiranës fill pas rivendosjes së sistemit pluralist në Shqipëri në vitin 1990. Kështu, në lidhje me përkatësinë e tyre fetare apo faktin nëse besonin apo jo, mbi 51% e studentëve të anketuar janë shprehur se nuk i

<sup>16</sup> *Letrat e zonjës Mary Wortley Montague*, përktheu nga anglishtja Arjol Guni, Shkup: Logos-A, 2014, p. 102.

<sup>17</sup> Përveç se e ndaloi besimin dhe shpalli zyrtarisht ateizmin duke luftuar haptazi klerikët dhe fenë, komunizmi u përpoq të ndërtojë një prototip të ri (Njeriu i ri) që ishte i zhveshur nga feja. Për më shumë detaje, shihC. Endresen, *Is the Albanian's religion really "Albanianism"?*..., p. 70; E. Caka, *Dialogu Ndërfetar...*, f. 159.

përkasin asnjë besimi. Ndërsa në aspektin e besimit apo jo, 77% deklaroheshin si jobesimtarë, 14% si besimtarë normalë dhe vetëm 6% shpreheshin se ishin të lidhur fort pas besimit të tyre.<sup>18</sup>

Rastet e mësipërme nxjerrin qartësisht në pah faktin se, ndonëse Shqipëria njihet si një vend me larmishmëri konfesionesh ku mbizotëron bashkëjetesa ndërjetare, e vërteta është se mungesa e institucioneve shkencore ka bërë që të mos jemi të qartë në burimin dhe natyrën e kësaj bashkëjetese, përmasat dhe gjendjen reale të saj, si dhe faktin se sa do mundet të ekzistojë ajo, apo nëse mund të eksportohet si një shembull i mirë për ato shoqëri që përballen me vështirësi në këtë drejtim. Ndoshta mungesa e një mosargumentimi të saktë e shkencor të bashkëjetesës të shqiptarët do të ishte edhe përgjigja negative që mund t'i jepet pyetjes nëse kjo vlerë mund të eksportohet te të tjerët. Kjo, për faktin se një fenomen i tillë lipset të trajtohet pikësëpari shkencërisht me të gjitha faktorët dhe dimensionet kulturore, zakonore e historike që kanë ndikuar në formësimin e kësaj tradite.

## Përfundime

Sot shtetas të shumtë shqiptarë jetojnë në vende të ndryshme të botës, ku janë ambientuar me shoqëritë përkatëse duke kontribuar pozitivisht në zhvillimin e tyre. Ndonëse me besime të ndryshme nga shoqëritë e vendeve ku jetojnë, fakti është se shqiptarët nuk janë shquar në asnjë shtet për qasje ekstremiste, veçanërisht në aspektin fetar. Në vetvete ky fakt përbën një vlerësim pozitiv për kulturën e shqiptarëve veçanërisht në respektimin e "tjetrit", qoftë ky në aspektin etnik, politik apo dhe fetar. Pikërisht një konkluzion i tillë na shtyn të mendojmë se tradita e shëndoshë e bashkëjetesës ndërjetare të shqiptarët, duket se ka funksionuar pozitivisht në përshtatjen dhe jetesën e tyre brenda shoqërive multikulturaliste. Nga ana tjetër, vetë institucionet përkatëse të shtetit dhe komuniteteve fetare u bie për detyrë të bëjnë më shumë në studimin dhe argumentimin shkencor të fenomenit të bashkëjetesës, gjë e cila do të ishte një kontribut më shumë në këtë drejtim.

---

<sup>18</sup> Për më shumë të dhëna mbi anketimin në fjalë, shih Markus W. Peters, *Përballjet e historisë së Kishës Katolike në Shqipëri (1919-1996)*, Qendra Botuese Shoqata Jezuite, Tiranë 2010, p. 259.

Hidajete Azizi

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*

## EMRAT VETJAKË PËRBALLË GLOBALIZIMIT

### Abstrakt

*Në këtë punim synojmë të nxjerrim në pah ndikimin që mund të ketë globalizimi si fenomen në procesin e rrjedhës së zhvillimit të antroponimeve (emrave vetjakë). Theksi do të vihet mbi antroponiminë e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe i njëjti do të bëhet objekt krahasimi me antroponiminë e shqiptarëve të Kosovës e të Shqipërisë. Dihet që antroponimet janë njësi të onomastikës të cilat më shumë sesa patronimet e toponimet i nënshtrohen ndryshimeve që vijnë si rrjedhojë e zhvillimeve shoqërore, politike e kulturore. Ata ndryshojnë sikundër ndryshon edhe botëkuptimi i njerëzve dhe koncepti i tyre edhe mbi modën ndërsa moda sot ndërlihet pikërisht me proceset globalizuese në të gjitha sferat e jetës, përfshirë këtu edhe antroponiminë. Sot, në kohë globalizmi, përgjithësisht, si emra modernë konceptohen emra të huaj që kanë një trend përdorimi në nivel botëror. Megjithatë, edhe ky koncept ndryshon dukshëm sipas popujve dhe sipas shtrirjes rajonale edhe brenda suazave të një etnie. Kjo është arsyeja pse bëhet krahasimi i antroponimisë së Maqedonisë me atë të Kosovës e Shqipërisë. Të dhënat e punimit mund të shërbejnë për të arritur në supozimin se globalizimi kulturor që po ndodh në epokën tonë përmes komunikimit masiv me ndihmën e internetit i cili çdo ditë e më shumë po ndikon në rrafshimin e dallimeve midis kulturave të ndryshme të botës, mund të luajë rolin e një pushtuesi të ri të botës. Antroponimia shqiptare bashkë me gjuhën e kulturën, ka njohur shumë pushtime të mëdha nga të cilat, megjithatë, ka mbijetuar. Pyetjes se cilat janë sfidat përballë këtij "pushtuesi" të ri kulturor, do të mundohemi t'i përgjigjemi përmes analizave që mbështeten në të dhënat e hulumtimit tonë.*





## Hyrje

Në situatat e reja të globalizimit gjithnjë e më shumë po merr përmasa të reja turri i papërmbajtur i popujve, rajoneve, shteteve, grupeve të ndryshme e individëve drejt hapjes ndaj botës. Në përpjekjet e tyre për t'u integruar në një shoqëri të hapur, jo të gjithë janë të përgatitur mjaftueshëm për t'u ndeshur e përballur me gjuhë, me kultura, politika e civilizime të tjera, të ndryshme, të huaja, prandaj edhe jo të gjithë janë të përgatitur për të ruajtur mjaftueshëm unin e tyre e veçoritë etnike e kulturore. Vetë globalizimi si fenomen nënkupton rrafshimin e ndarjeve etno-kulturore. Së këndejmi, me rritjen e kontakteve ndërkombëtare dhe me fluksin e madh të migracioneve, zbehja e këtyre veçorive në këtë përballje të madhe me përzjerje kulturash, mendësish e zakonesh është e pashmangshme, madje, herë-herë edhe zhdukja e disa prej tyre mund të bëhet e pashmangshme.

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë ka lehtësuar skajshmërisht komunikimin masiv të njerëzve përmes internetit. Ky komunikim është bërë pjesë e përditshmërisë ndërsa lehtësia e qasjes deri te llojllojshmëria e informacioneve që vijnë nga i gjithë globi ka bërë që njerëzit të përfshihen, herë me vetëdije e herë pa të, në një formë të re të menduari, që çon drejt unifikimit të gjuhëve e të kulturave të ndryshme. Kjo mënyrë e re e të menduari po merr përmasa të një pushtimi të ri të botës që, krahas globalizimit ekonomik e politik, po prodhon edhe një globalizim kulturor respektivisht një globalizim gjuhësor për të mbizotëruar ajo gjuhë e kulturë që ndjehet më me prestigj.

Në gjuhë ky fenomen diktohet në të gjitha segmentet e saj, duke filluar me leksikun nga sfera e zbulimeve të reja të teknologjisë, ku është më i pranishëm, për t'u shtrirë në të gjitha sferat e tjera të leksikut të përgjithshëm. Herë me nevojë, e më shumë pa të, si një ndër gjuhët më me prestigj që po fiton statusin e gjuhës globale, anglishtja është e pranishme si në gjuhën e shkruar, ashtu edhe në gjuhën e folur. Së këndejmi, ndikimi i prirjeve globalizuese do të jetë i pashmangshëm edhe në leksikun e përveçëm (në veçanti në emërtimet e bizneseve) respektivisht në fushën e antropomisë, si një ndër degët e gjuhësisë.

Studiuesja Marija Leontiq thotë që emrat vetjakë janë "...*fjalë më të përbashkëta, më individuale, më ndërkombëtare, por edhe më nacionale*".<sup>19</sup> Antroponimia e popujve të ndryshëm çdoherë ka njohur ndikime e ndërthurje me gjuhë e kultura të huaja me të cilat ka ecur krah për krah në rrugën e zhvillimit historik. Sidomos pushtimet e mëdha kanë pasur një ndikim të skajshëm. Gjatë rrugëtimit të vet historik, edhe populli shqiptar ka njohur pushtime nga më të ndryshme që, bashkë me kulturat e religjionet që kanë përhapur, kanë lënë gjurmë të thella e të pashlyeshme në të gjitha sferat e jetës, e ndër to edhe në procesin e emërvënies gjë që dukshëm e ka ndryshuar pamjen e antroponimisë shqiptare. Këto ndikime kanë krijuar një paradigme të emrave vetjakë që me kohë janë pranuar si emra të traditës, meqë janë përdorur ndër shekuj. Megjithatë, kjo antroponimi edhe sot e gjithë ditën, herë më shumë e herë më pak, ruan identitetin e saj kombëtar, ani pse në vetvete ngërthen tërë atë bagazh të larmishëm kulturash, religjionesh e gjuhësh me të cilat ka pasur kontakt ndër shekuj. Kështu, tradita shqiptare e emërtimit zakonisht ka ngërthyer në vete emra simbolikë kombëtarë dhe emra me burim të huaj, kryesisht të traditës fetare. Nëse sot mund të pohojmë që antroponimia shqiptare ka arritur të dalë nga këto pushtime në të kaluarën duke u bërë ballë shekujve edhe përmes ruajtjes gjallë të emrave që lidhen me origjinën si shenjë identifikimi, parashtrohet pyetja se si po gjendet ajo sot në përballjen me globalizimin? A mund të flasim për një rrezik që i kanoset antroponimisë shqiptare nën ndikimin e globalizimit?

Është e vërtetë që të prirë nga synimet integruese drejt një bote të hapur, te shumë popuj të botës, ndër ta edhe te shqiptarët, po ndryshon edhe ndjesia e kulturës së emërtimit, njerëzit gjithnjë e më shumë po parapëlqejnë emra të huaj vetjakë që kanë një trend përdorimi në nivel botëror të cilët konceptohen si emra modernë a si emra të pranueshëm nga më shumë popuj. Arsyet janë nga më të ndryshmet. Sipas nesh spikat tendenca për të qenë në modë dhe tendenca që në kushtet e ekonomisë së tregut t'i bëhet sa më i lehtë brezit të ri përfshirja në shoqëritë e huaja.

---

<sup>19</sup> Marija Leontiq, *Turските elementi во мakedонските имиња и презимиња*. (Disertacion), Shkup, 2003.

Tendenca për të qenë në modë mund të vërehet lehtëzi vetëm po t'i hidhet një sy platformave të ndryshme të internetit e në veçanti rrjeteve sociale ku individët kanë filluar gjithnjë e më shumë të përdorin emra të modifikuar a të ndryshëm nga ata që në të vërtetë i kanë, për t'u ndjerë më të afërm me një komunitet global në vend të kombësisë së cilës i takojnë. Mjafton të kujtojmë këtu vetëm disa nga emrat e fytyrave që për publikun janë bërë të njohura përmes biznesit së tregtisë së spektaklit: *Mozzik* për *Gramos*, *Tayna* për *Doruntina*, *Cozman* për *Ylber*, *Gjiko* për *Asdren*, *Majk* për *Kastriot* e të tjerë. Ndryshimi i ndjesisë së kulturës së emërtimit për t'u dukur sa më në modë mund të vërehet edhe në zbehjen e traditës shqiptare të emërtimit në të cilën, ndër tjerash, kanë qenë mjaft të pranishëm emra vetjakë që kanë ripërtërirë emrat e të parëve në zinxhirin e familjes dhe emra besëtytnorë.

Ndryshimet demografike dhe migracionet kanë një rol shumë të theksuar në ndryshimet që po ndodhin në antroponiminë shqiptare. Për prindërit e rinj që gjithnjë e më pak janë tradicionalë, duket që karakteri kombëtarizues i emrave nuk ka një rol të theksuar, ani pse emri vetjak bashkë me gjuhën janë dy shtylla të identifikimit kombëtar. Mbase, ky karakter edhe mund të paraqiste pengesa për t'u përshtatur në mjedisin ku synojnë të integrohen prandaj edhe krijohet përshtypja që te ta sikur ndjehet një pasiguri për t'u identifikuar me një emër kombëtar. Kjo, në veçanti, mund të dëshmohej me përdorimin e spikatur të emrave të huaj ndërkombëtarë te popullsia e diasporës shqiptare që kohëve të fundit gjithnjë e më shumë po shënon rritje. Ndikimi i kësaj popullsie nuk është i vogël edhe te popullata e origjinës.

Megjithëse globalizimi si fenomen është shtrirë në shumë vende të botës, ndryshimet që po i pëson antroponimia nën ndikimin e tij nuk janë të njëtrajtshme për të gjithë popujt dhe për të gjitha kulturat. Madje, edhe brenda një populli, mund të vërehen ndryshime të theksuara në mënyrën dhe në nivelin e ndikimit të rrjedhave globale. Kështu ndodh edhe te shqiptarët në përgjithësi. Se sa është i shprehur ky ndikim te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut dhe te shqiptarët përreth (Kosovë e Shqipëri) mbase mund të ndihmojnë edhe statistikat rreth përdorimit më të shpeshtë të emrave viteve të fundit. Këto statistika flasin për faktin që globalizimi, ani pse nuk

është një fenomen i ri, ai çdo ditë e më tepër po fiton përmasa të reja edhe në fushë të antropomisë. Shtrirja e emrave të huaj që nuk kanë qenë shumë të njohur më parë në repertorin e emrave vetjakë të shqiptarëve po bëhet gjithnjë e më aktuale. Elementet e huaja që për më shumë arsye janë shtresuar në sistemin antropomik shqiptar në vazhdimësi në të kaluarën, tani më kanë kaluar në elemente të traditës, për t'i lëshuar udhë elementeve të reja që po vijnë nën ndikimin e globalizimit dhe të kulturave e gjuhëve me të cilat shqiptarët kanë një lidhje më të shprehur. Këto ndikime që po reflektohen me shumëllojshmërinë e emrave të huaj po kalojnë te shqiptarët në zakone të reja që rëndë po e goditin sistemin antropomik shqiptar. Në këtë mënyrë, pamja e antropomisë së shqiptarëve në përgjithësi sot reflekton një ndërthurje të identitetit shqiptar me kultura e tradita të ndryshme, që janë pjesë e globalizimit në botën moderne, ndërsa në disa rajone të veçanta, kjo pamje reflekton një veshje plotësisht të huaj.

Në Shqipëri, dekadat e fundit, që nga demokratizimi i saj e deri më sot, emrat e huaj u konceptuan si emra të modës të cilët në vazhdimësi shënonin epërsi krahas emrave kombëtarë: atyre me burim nga shqipja e emrave historikë që ndërlidhen me gjenealogjinë tonë. Emrat kombëtarë, që u përdorën disa dekada të sistemit monist, u ndjenë të stërpërdorur e të dalë jashtë mode, madje, herë-herë, u ndjenë edhe të imponuar. Të imponuar u ndjenë sepse dekada të tëra emrat e kulturave të huaja (europiane e anglo-amerikane) ndaj të cilave Shqipëria ishte e izoluar dhe emrat fetarë qenë të ndaluar për përdorim. Sprapsja ndaj imponimit të përdorimit të emrave kombëtarë që i pritur nga ana e popullatës në kohën e demokratizimit. Tranzicioni nga një shtet i mbyllur, çfarë ishte Shqipëria, në një shoqëri të lirë me një fluks të madh të lëvizjeve demografike, e me këtë edhe tranzicioni nga një disiplinim i rëndë në fushën e antropomisë në një hapje të menjëhershme drejt shoqërive të reja do të lindë emra të rinj të ndikuar nga ngjarje e dukuri të ndryshme nga arena bashkëkohore ndërkombëtare. Këtij fenomeni do t'i ndihmojë dukshëm edhe nevoja e emigrantëve për t'u integruar në shoqërinë e re. Ky tranzicion flet për faktin që antropomimia ndjek rrugën e vet spontane që e trason vetë populli dhe nuk duron mbyllje të imponuara nga instanca të dirigjuara nga lart. Për rrjedhojë, do të marrë hov të paparë përdorimi i emrave të huaj dhe do të zbehet dukshëm përdorimi i

emrave me burim vendës. Ndër emrat e huaj, si te popujt e tjerë ashtu edhe te shqiptarët, spikasin ata që në gjenealogji lidhen me religjionin të cilit i përket populli. Rikthimi i emrave të mbështetur në fenë krishtere e islame në procesin e emërvënies mund të ndërlidhet me dy faktorë. I pari mund të ndërlidhet me lirinë fetare e cila paraprakisht qe e ndaluar. Mbështetur në këtë faktor, menjëherë pas demokratizimit të vendit, janë rikthyer emra të traditës fetare, qoftë për të ripërtërirë emrat e të parëve në zinxhirin e familjes, qoftë për të shprehur ndjenjat e tyre fetare. Faktori i dytë mund të ndërlidhet me prirjen për të përzgjedhur emra që kanë mbështetje në religjionin që i përkasin por që njëherazi kanë fituar edhe një prestigj global a një prirje përdorimi te më shumë popuj. Kjo lë të nënkuptojmë se shumë emra të këtillë kanë krijuar një prestigj si emra të modës. Pikërisht këta emra të cilët jo çdoherë përzgjidhen duke u mbështetur në motivin fetar (mbase më shumë duke u mbështetur në shijet subjektive estetike) dhe të tjerë emra laikë që mbështeten në kulturat e ndryshme të popujve që kanë krijuar një prirje përdorimi te më shumë popuj, si *Rihana, Xhoana, Xhoel, Kevin, Leonard, Grejs, Alis, Gabriel, Alana, Amara, Kian, Dion, Dejvid* etj., do të mund të konceptoheshin si emra të ndikuar nga procesi i zhvillimeve globale. Madje, ndikimi i globalizimit ndjehet jo vetëm në zgjedhjen e emrave, por edhe në mënyrën se si shkruhen ata. Kështu, shumë emra të huaj që bartin shqiptarët tani shkruhen ndryshe nga trajta e mëparshme tradicionale, njëjtë si në gjuhën apo kulturën nga e cila vjen, pa iu nënshtruar rregullave të drejtshkrimit të shqipes. Bie fjala, në vend të trajtave të emrave, si *Sara, Ema, Mikel, Sofia, Xhoana, Xhoela*, gjejmë trajtat e shkruara: *Sarah, Emma, Michael, Sophie, Johanna, Joela*.

Në kushtet e sotme të globalizimit, këta emra janë lehtë të qasshëm përmes internetit me ndihmën e të cilit zhvillohen mjetet e komunikimit: telefonisë celulare, televizionit satelitor, mediave elektronike e rrjeteve sociale, pa të cilat, sot rrallë kush funksionon. Faqet e internetit janë të stërmbushura me emra modernë për fëmijë të cilët mund të gjenden me një klikim të vetëm. Ndikimi që kanë tele-novelat e realiteteve të ndryshme kulturore bëhet i pashmangshëm. Viteve të fundit spikat realiteti kulturor turk, si rezultat i të cilit ka lindur një numër i madh i emrave orientalë edhe në Shqipëri. Një rol të rëndësishëm në përhapjen e emrave të huaj të kulturave

të ndryshme ka edhe përzgjedhja e këtyre emrave nga fytyrat e njohura për publikun, për mediat e për rrjetet sociale. Këto përzgjedhje nga ana e tyre bëhen model edhe për masat e gjera. Të gjithë këta emra vijnë e shtrihen me një fluks të paparë dhe ndryshojnë ndër vite duke zënë epërsi sipas shijes individuale, sipas shijes lokale apo sipas shijes globale për modën. Nga të dhënat statistikore për Shqipërinë, në 10 vitet e fundit, asnjë prej 10 emrave më të përdorur nuk është emër me burim nga shqipja, ndërsa ndër emrat më të shpeshtë për vitin 2022 përmenden: *Amelia, Ajla, Aria, Leandra, Klea, Melisa, Amaris, Noel, Aron, Joel, Amar, Mateo, Luisetj*.<sup>20</sup>

Ndryshe nga Shqipëria, në Kosovë, sipas të dhënave të statistikave, pesë emrat që i prijnë listës së emrave me përdorim më të dendur që nga viti 1980 e deri në vitin 2011, janë, që të gjithë, emra me burim nga shqipja ose të historisë kombëtare.<sup>21</sup> Për gjatë gjithë kësaj periudhe, vijon ajo që studiuesi GjovalinShkurtaj e quan "moda atdhetare e emrave të përveçëm". Situata shoqërore-politike ishte faktori kryesor që ndikoi në ndjenjën e ruajtjes së identitetit kombëtar të shqiptarëve të këtyre trojeve si pasojë e peshës së rëndë të dhunës së drejtpërdrejtë të ushtruar nga pushtuesi serb. Në vitin 1999 fitohet një bazë paradigmatiche e emrave të mbështetur në motivin kombëtar deri më 95%.<sup>22</sup> Kjo është periudha kur Kosova, me përdorimin e emrave kombëtarisht të motivuar deri më 95%, krijon një opozitë të theksuar kundrejt paradigmes së krijuar me emra të huaj në këtë periudhë në Shqipëri. Mbështetur në këto rrethana, ndikimi i globalizimit në sistemin antroponimik të shqiptarëve të Kosovës në këtë periudhë nuk arriti që t'i japë një fytyrë të huaj e ta tjetërsojë atë ashtu siç ka ndodhur në Shqipëri. Megjithatë, edhe këtu dekadat e fundit globalizimi po shtrin ndikimin e tij duke i dhënë një kah tjetër ecurisë së zhvillimit të deritanishëm të sistemit antroponimik. Numri i emrave të huaj të cilët po shtrihen në fondin e emrave vetjakë këtu, po vjen duke u rritur gjithnjë e më shumë. Këta emra nisën të përdoren me një denduri më të madhe menjëherë pas luftës së fun-

<sup>20</sup> <http://www.instat.gov.al/> "Top 10 emrat e përdorur vitin e fundit", INSTAT, Republika e Shqipërisë, Instituti i Statistikave. Shkarkuar më 2 shtator 2022.

<sup>21</sup> <https://ask.rks-gov.net/media/3764/emrat-ne-kosove-2912.pdf>, Republika e Kosovës, Qeveria, Zyra e Kryeministrit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë, dhjetor 2017.

<sup>22</sup> Begzad, Baliu, *Onomastikë dhe identitet*, Prishtinë, Era, 2012, f. 53.

dit në Kosovë. Në fillim, ata u përdorën, përveç tjerash, edhe si rrjedhojë e respektit ndaj politikës e diplomacisë amerikane e europiane, e cila dha një kontribut të jashtëzakonshëm në këtë luftë. Më vonë, këta emra erdhën e u shtrinë në sistemin antroponimik gjithnjë e më fuqishëm nën ndikimin e globalizimit, mirëpo, asnjëherë nuk e arritën epërsinë që e kanë sot në Shqipëri. Madje, statistikat e viteve të fundit në Kosovë flasin për faktin që emrat që i prijnë listës së emrave më të përdorur ndryshojnë dukshëm nga ata të Shqipërisë. Nëse në Shqipëri lista e emrave më të përdorshëm ngërthen në vete një llojlojshmëri më të pasur, këtu spikasin emrat me burim oriental. Emrat e këtij burimi për një kohë të gjatë (deri në vitet e '80-ta) patën fituar statusin e emrave tradicionalë, herë të mbështetur në traditën fetare, herë të mbështetur në motivin e trashëgimisë, e herë në motivin e modës a në shijet individuale. Sot, nga të dhënat që na ofrojnë statistikat, emrat e kësaj gurre, janë pothuajse plotësisht të ndryshëm nga ata tradicionalë myslimanë, gjë që lë për të menduar se këta emra të rinj, kohëve të fundit po përdoren më shumë në cilësinë e emrave modernë të ndikuar nga kultura orientale, shumë e pranishme në mediat e shqiptare.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2019 dhe 2020, ndër emrat më të shpeshtë dalin emrat, si *Alea, Ajla, Asja, DuaInara, Amar, AjanTiar, Noar, Omer* etj.,<sup>23</sup> të cilët mund të jenë pranuar nga popullata si emra të rinj a modernë, që mund të tingëllojnë më shumë si emra ndërkombëtarë, sesa si emra tradicionalë të mbështetur në petkun fetar. Megjithatë, fakti që kësaj liste i prijnë emrat me burim oriental mund të ndërlihet edhe me përkatësinë fetare të popullatës së kësaj ane.

Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut ndërkaq asnjëherë nuk dolën fitimtarë kundrejt ngarkesës së theksuar me emra të huaj, kryesisht të burimit oriental. Kjo ngarkesë është e pranishme në sistemin antroponimik të tyre edhe sot, megjithëse në disa rajone të veçanta të Maqedonisë së Veriut, emrat kombëtarë në vazhdimësi kanë krijuar epërsi. Sipas të dhënave për vitin 2019 të Entit Shtetëror të Statistikës, listës së emrave për të dyja gjinitë i

---

<sup>23</sup> <https://ask.rks-gov.net/sq/> Agjencia e Statistikave të Kosovës, “Statistikat e Lindjeve në Kosovë” për vitin 2019. Publikuar më 12/06/2020, shkarkuar më 5 Janar 2022.

prijnë ata me burim oriental.<sup>24</sup>Deri në vitet e '90-ta, listës së emrave me përdorim më të dendur i prijnë ata të cilët sot i trajtojmë si emra tradicionale. Këta emra mund të kenë pasur mbështetje, para së gjithash, në religjionin të cilit i takojnë pjesa dërrmuese e shqiptarëve të kësaj ane, mirëpo një pjesë e mirë e tyre, në periudha të ndryshme mund të kenë marrë edhe tiparin e emrave moderne, prandaj edhe kanë ndryshuar ndër mote. Bie fjala, nëse për vitet e '60-ta, sipas statistikave tona nga materiali i vjelë në terren, ndër emrat më të shpeshtë figurojnë emrat, si *Ramadan, Bajram, Fatime, Hava* (që mund të kenë një mbështetje më të fortë në motivin fetar); për vitet '70-të, në cilësinë e emrave më të përdorshëm dalin emra të tjerë, si *Naim, Muhamed, Emine, Suzana*; ndërsa në vitet '80-të, emrat, si *Orhan, Fatime, Semran*. Ndryshimi më i madh mund të vërehet që nga vitet e '90-ta, atëherë kur paradigma e emrave me burim nga gjuhët orientale vjen e bëhet gjithnjë më e larmishme me shtrirjen e emrave të cilët nuk kanë pasur një përdorim të theksuar në vitet e mëparshme, me emra, si *Amir, Bunjamin, Elmedina, Azra*. Pas viteve 2000, kjo paradigme fiton një pamje të re me emra të rinj si, *Omer, Amar, Omar, Furkan, Sara, Jusra, Bushra, Kanitaetj*. Nga të dhënat e sipërpërmendura mund të vërehet se emrat që mund të kenë një mbështetje më të madhe fetare janë të pranishëm në të gjitha periudhat, ndërsa viteve të fundit, fondi i emrave me burim oriental pasurohet me emra të rinj, motivimi i të cilëve, krahas mbështetjes fetare, mund të shpjegohet edhe me ndikimin gjithnjë e më të fuqishëm të globalizimit si fenomen.

Ajo që bie në sy këtu është fakti që prirja për të përdorur emra të rinj, moderne, është e pranishme si në Shqipëri e Kosovë, mirëpo kjo prirje, nuk ka krijuar një kthesë të madhe në përdorimin e emrave ndërkombëtarë, ashtu si në Kosovë e, sidomos, në Shqipëri, por ka krijuar një kthesë të madhe në përdorimin e emrave të kulturës orientale. Me gjasë, fenomeni i globalizimit në procesin e emërvënies të shqiptarët e Maqedonisë së Veriut akoma nuk ka arritur të ndikojë dukshëm në shkëputjen e tyre nga tradita e së kaluarës për të përdorur, para së gjithash, emra orientale (të cilët në vazhdimësi kanë krijuar epërsi), por edhe emra kombëtarë. Këtë supozim e

<sup>24</sup> www.stat.gov.mk, Enti Shtetëror i Statistikës, „Северна Македонија во бројки”, 2020, f. 17.



mbështesim në prirjen që po hetohet kohëve të fundit për të përzgjedhur emra ndërkombëtarë, të cilët mund të ndërliken edhe me identitetin kombëtar - meqë gjejnë shpjegim edhe në gjuhën shqipe – si, *Hana, Dora, Leandra, Lisa, Debora, Ron, Rina* etj., dhe me prirjen për të përzgjedhur emra kombëtarë a me burim nga shqipja që mund të ndërliken edhe me identitetin fetar i cili supozohet që shprehet përmes emrave me burim nga gjuhët orientale, si *Hana, Dua, Tuba, Samir* etj. Nëse për Shqipërinë e Kosovën ndikimi i globalizimit do të mund të shpjegohej me prirjen e popullatës për të kaluar nga tradita e përdorimit të emrave kombëtarë në traditën e emrave ndërkombëtarë, në Maqedoni ky ndikim mbase do të mund të shpjegohej me shtrirjen e një fluksi të emrave të rinj që paraqesin vazhdimësinë e traditës së përdorimit të emrave të huaj, kryesisht me burim nga gjuhët orientale, e më pak me emra ndërkombëtarë. Emrat ndërkombëtarë që në të kaluarën janë shtrirë në fondin e emrave vetjakë, si *Dianë, Albert, Margarita, Zhaneta, Zhaklina, Denis, Robert, Eduard, Antigona, Elizabetë, Rolanda, Laurë, Leonorë, Leontinë, Nora* etj., sot përdoren më rrallë, për t'i lëshuar udhë emrave të tjerë si: *Olta, Elion, Leonit, Eda, Ema, Ernes, Alen, Nita, Mia, Fabijan, Ina* etj., ashtu siç përdoren shumë rrallë edhe emrat orientale që kanë krijuar një traditë përdorimi në të kaluarën, për t'i lëshuar udhë emrave të rinj, si *Rejana, Lara, Alaja, Inara, Anik, Nejla, Tiara, Esra, Jusra, Edina, Talja, Jara, Din, Agan, Anik, Iman* etj., ose trajtave të reja të emrave të këtij burimi, si *Anuar, Davud, Merjem* në vend të *Enver, Daut, Mejrem*, etj., me qëllim që sa më lehtë të kuptohen në kultura të ndryshme dhe të tingëllojnë sa më modernë.

Një prirje e përgjithshme që po merr përmasa më të mëdha është përdorimi i emrave sa më të shkurtër dhe më të lehtë për shqiptim. Te shqiptarët e Maqedonisë, dhe jo vetëm, për qëllime praktike, kjo prirje po reflektohet jo vetëm në përdorimin e emrave të huaj ndërkombëtarë, si *Mia, Una, Nita, Tea* e të ngjashëm, por edhe te emrat e tjerë, pa marrë parasysh origjinën e tyre, si te emrat be burim nga shqipja, si *Lea, Dua, Ajka, Mal, Lira, Lis, Kron, Lir, Unik, Bora* etj., të cilët janë po aq modernë, sa janë modernë edhe ata me burim oriental, si *Hira, Afra, Xhan, Iman* etj. E, dallimet që mund të vërehen në sistemin antroponimik ndërmjet shqiptarëve të Shqipërisë, Ko-

sovës e Maqedonisë, dhe, në veçanti, të popullatës në mërgim, do të mund të mbështetnin mendimin e studiuesit Çlirim Bidollari kur thotë se emrat vetjakë "*shërbejnë si dëshmi e nivelit kulturor të brezit që i vë*".<sup>25</sup>

Se ç'rrugë do të ndjekin prindërit në të ardhmen, nuk mund ta themi. A do të zënë vend të pazëvendësueshëm emrat e huaj në traditën shqiptare ashtu siç po zënë vend fjalët e huaja në leksikun e përgjithshëm, sidomos në sferën e teknologjisë? A do ta shpërfaqin identitetin kombëtar përmes etiketës që bart emri vetjak apo do t'i kalojnë kufijtë drejt Europës duke e fshehur këtë identitet nën petkun e një emri të huaj ndërkombëtar? A do të bëhet brezi i ri në situatat e reja globalizuese i vetëdijshëm se në rrugëtimin e vet, bashkë me popujt e tjerë, mund dhe duhet të hapërojë drejt së ardhmes pa u tjetërsuar, qoftë edhe vetëm përmes emrit vetjak? A do të ndryshojnë kahe ethet e modernizimit, nga e huaja drejt vetvetes, për t'i pranuar emrat vetjakë kombëtarë si një ndër faktorët konvergjues për të gjithë shqiptarët? Për të gjitha këto përgjigje, mbetet për t'u parë.

Prirja e deritashme tregon që herë pas here, në momente të caktuara, mund të rikthehen emrat që për një kohë më të gjatë edhe mund të kenë shkuar në harresë. Mbështetur në këtë, mund të supozojmë se edhe trendi i parapëlqimit të emrave të huaj, në të ardhmen do të mund të zëvendësohej me një trend të ri ku instinkti i ruajtjes së identitetit kombëtar mund të vinte në rend të parë. Sinjalet se mund të ndodh kjo në një të afërme jo të largët, vijnë nga burimet më me influencë në masat më të gjera, siç janë mediat dhe bota e showbizit. Emrat me burim nga shqipja, si *Diell, Ajër, Ajka, Zë, Nalta, Kren, Jonart, Erlis, Duam, Ambla, Kroi Art, Toka*, etj., që fytyrat e njohura publike në mesin e shqiptarëve kanë përzgjedhur për foshnjat e tyre, mund të jenë një motiv i mirë për lindjen e një mode të re, atë të rikthimit të emrave të origjinës. Mbetet të shpresohet se në të ardhmen, pasi të jenë stërpërdorur emrat e huaj ndërkombëtarë, te shqiptarët të lind sërish një modë kombëtare e emrave për t'u ndjerë më të afërt me rrënjët dhe kulturën e vet.

---

<sup>25</sup> Çlirim Bidollari, *Tradita dhe risi në fondin e emrave të shqiptarëve (antroponimikoni shqiptar)*, Studime Filologjike, nr. 1-2, 2001, f. 53.

RINI USEINI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup*

## TENDENCAT E NDËRLIDHJES ME ATDHEUN TEK POPUJT BALLKANIK

### Abstrakt

*Kultura shpirtërore krijohet në brendësi të shoqërisë ku ke lindur dhe ku jeton e mëshirohesh me të. Kjo kulturë kultivohet edhe brenda gamës së gjerë shoqërore në një bashkësi ku jeton. Si e tillë ajo gjithmonë qëndron brenda individit. Edhe në raste kur je larg bazamentit përsëri nuk je i shkëputur. Teoria difuzive etnologjike e shpjegon këtë mënyrë të lidhjes së njeriut me bazamentin jetësor dhe është një ndër teoritë e çasjes etnologjike që shpjegon dhe ndërlidhjen e njeriut me globalizimin dhe folklorizimin e tij shpirtëror me vendlindjen duke e lënë atë në një situatë tranzite. Kjo ka ndodhur dhe ende ndodh me shumë popuj të Ballkanit të cilët kanë migruar në vendet perendimore por ende janë të lidhur në mënyra të ndryshme me trungun jetësor, duke i ruajtur me shumë fanatizëm disa tradita që nuk i ruajnë vendasit e tyre. Në këtë kuptim do të numërojmë disa nga elementet folklorike dhe kulturore të cilët e afrojnë njeriun me vetveten e tij të origjinës duke e mbajtur të lidhur dhe të pashkëputur kulturalisht me trungun jetësor të tij.*

**Fjalët kyçe:** *Kultura shpirtërore, difuzioni, mihrimi, Ballkani, folklorizim*



Identiteti ballkanik është relacional dhe transgjenerativ, ai është i rrënjosur në kontekste historike dhe politike dhe është dinamik dhe i pasigurt. Ajo që mund të argumentojmë është se njerëzit që rriten në diasporë përjetojnë një ballkanizim të identitetit. Ballkanizimi është fillimisht një term gjeo-politik që nënkupton vende, rajone ose shtete kombëtare që ndahen ose janë copëtuar nga konflikti ose dhuna.<sup>26</sup> Asnjë nga këto nuk është befasuese dhe

<sup>26</sup> K. E. Fleming, Orientalism, the Balkans, and Balkan Historiography, "The American Historical Review, Vol. 105 No. 4", (Oct., 2000), f. 1219.

është në përputhje me natyrën familjare dhe kolektive të kulturës ballkanike, si dhe me kontekstin historik dhe politik në të cilin ekzistojnë pjesëmarrësit. Pra mund të ketë gjithashtu një konotacion negativ. Në kohë të ndryshme dhe hulumtime të ndryshme janë përdorur mënyra të ndryshme për të përshkruar fragmentimin e identitetit përmes traumës dhe konfliktit, zakonisht nëpërmjet forcave të jashtme mbi të cilat kemi pak ose aspak kontroll.<sup>27</sup> Tek njerëzit e Ballkanit që rriten në diasporë, kjo ndodh përmes diasporës/emigrimit të krijuar nga konflikti, ballkanizimit të identitetit ndër breza, kjo ka ndodh me gjyshërit dhe prindërit tanë që u rriten në Jugosllavi dhe më pas duhet të zgjedhnin një identitet të ri.

Me Ballkanizim nënkuptohet lidhja me kulturën përmes mjeteve juridike popullore dhe kjo është diçka që i dallon nga miqtë e tyre të lindur në vendet perendimore. Politika është pjesë e pashmangshme e identitetit të njerëzve, pavarësisht nëse duan apo jo.<sup>28</sup> Dhe kjo ndërlidhet dhe me të qenurit aq atdhedashës më shumë se ata që realisht janë brenda arealit vendor ballkanik. Tendencë është që të gjithë popujt ballkanik të ndërlidhen me vendlindjen e tyre, qoftë për të qenë të pranishëm materialisht ashtu edhe moralisht. Në këtë pikëpamje shpeshëherë dhe konfliktet që shprehimisht kanë qenë të pranishme në mes vendeve ballkanike janë shprehur dhe në raportet e popujve të këtyre vendeve dhe në diasporë, në ballafaqimet konfliktuoze me njëri tjetrin. Nëse këtë tendencë ndërlidhëse e shohim në raport me ruajtjen e identitetit mund të themi se në kohët e fundit kemi rikthim të elementeve tradicionale pra një ndjenjë e folklorizimit ballkanik.

Shumë shoqata kulturore aktivizohen në diasporë me pjesëmarrje masive, në ngjarje kolektive që lidhen me rajonin. Edhe transmetimi dhe ruajtja e traditës është më e theksuar në vendet e jashtme se në vendet autoktone. Kjo ka të bëjë me teorinë e rrahëve koncentrik apo teorisë së difuzionit në kontekstin etnologjik ku qendra ndryshon më shpejt se periferit e saj.<sup>29</sup> Psh ka raste kur dasmat shqiptare në ShBA bëhen me të gjitha konturet e traditës sikurse në të kalurën e në vendlindje nuk shihet dicka e tillë pasi ka rënë në

<sup>27</sup> Maria Todorova, *Imagining the Balkans*, New York, 1997, f.116

<sup>28</sup> Milica Bakic-Hayden, Robert M. Hayden, *Orientalist Variations on the Theme "Balkans": Symbolic Geography in Recent Yugoslav Cultural Politics*, *Slavic Review*, Vol. 51, No. 1, 1992, f.3-4.

<sup>29</sup> David Laitin, *Hegemony and culture*, University of Chicago Press, Chicago, 1986, f.19

nivelin e kulturalizmit perendimor apo globalizimit. Poashtu po të njëjtit kanë rikthyer edhe disa tradita kulturore në vendlindje duke i bërë edhe normative, sepse shpenzojnë shuma të mëdha për të treguar superioritetin e tyre financiar brenda shoqërisë së vendlindjes. Kjo shihet në ceremonitë e dasmave, ceremonitë e ndryshme familjare, të cilat dalin jashtë normave ekonomike tradicionale në aspektin konsumues e jo në qëllimin e vetëm, në aspekt te ahengut. Poashtu nëpër rrugë gjatë kthimit në diasporë sheh shumë ballkanas që me vete marrin dhe ushqime tradicionale e që i quajnë nacionale edhe pse në të vërtet janë ballkanike.

Diaspora ballkanike ka disa pjesë specifike që mund të komplikojnë gjithashtu ndjenjën e përkatësisë. Një gjë aktuale është politizimi i identitetit dhe nacionalizmit në disa komunitete diasporike që shpesh e bënë të vështirë për njerëzit të gjejnë vendin e tyre në një komunitet diasporik. Kështu që njerëzit mund të përpiqen të ndërtojnë një ndjenjë kohezive të identitetit vetëm për t'u përballur nga nacionalizmi dhe vetë urrejtja nga e cila u përpoqën t'i shpëtonin familjet e tyre. Shumë njerëz i përjetojnë enklavat etnike diasporike si mbajtëse të një grupi të caktuar vlerash ose besimesh, të cilat ndonjëherë mund të jenë tradicionale dhe/ose nacionaliste. E megjithatë, kjo ndonjëherë mund të jetë lidhja e vetme me vendin e origjinës ose kulturën, kështu që shumë njerëz të rritur në diasporë që mund të jenë rritur me vlera të tjera dhe ndikime të tjera dhe mund të kenë vështirësi të gjejnë vendin e tyre në një komunitet diasporik dhe mund të kenë vështirësi në gjetjen e njerëzve me mendje të njëjtë, të cilët gjithashtu ndajnë prejar-dhjen e tyre kulturore dhe kuptimin e asaj pjese.<sup>30</sup>

Një tjetër gjë është feja. Nuk mund të flasim për të gjitha kontekstet diasporike, por nga biseda me bashkëatdhetar kuptojmë se feja është një pjesë përcaktuese më e spikatur e identitetit sesa mund të jetë në Ballkan. Për shembull, nëse je shqiptar i Maqedonise në Europë dhe dëshiron të mësosh folklor, të shkosh në shkollë shqipe ose të ndjekësh ndonjë ngjarje kulturore, ata janë pothuajse ekskluzivisht të lidhur me komunitetin fetar musliman. Realisht shumë njerëz shkojnë në xhami apo kishë për arsye kul-

---

<sup>30</sup> Pierre Bourdieu, *Outline of a theory of Practice*, Cambridge University Press, Cambridge, 1977, f.166.

turore dhe komunitare më shumë sesa për arsye fetare. Por jo të gjithë ndihen të sigurt duke e bërë këtë.

Një gjë që haset shpesh lidhet me hapësirën relative, shumë njerëz nga Jugosllavia formësuan identitetin e tyre përmes "trans-lokalizmit", që do të thotë se njerëzit mund të identifikohen me qytetin, fshatin ose rajonin e tyre dhe jo me vendin e tyre të origjinës, gjë që ka kuptim, duke ditur se si Ballkani mund të jetë i larmishëm në aspektin rajonal. Për shembull, dikush mund të identifikohet me faktin se është nga Struga dhe jo nga Maqedonia e Veriut apo më shumë njihet Veleshta se Struga etj. Ose dikush mund të identifikohet se është nga Hvari ose nga Adriatiku në vend që të jetë nga Kroacia. Për ata që rriten në diasporë, nuk e kanë atë nuancë identiteti. Ato priren të kenë pjesën ballkanike dhe më pas atë kanadeze/amerikane/ evropiane apo çfarëdo qoftë.<sup>31</sup>

Një tjetër cilësi ballkanike ka të bëjë dhe me të kaluarën e përbashkët e cila në shumë raste nuk ka qenë e njëjtë për të gjithë. Disa popuj jetuan si pronar e të tjerët me trauma. Kur përrjetojmë trauma, ajo copëton ndjenjën tonë të vetvetes, të identitetit tonë, të mënyrës se si e shohim botën dhe ata që na rrethojnë, marrëdhëniet tona me ato gjëra. Kur flasim për traumën ndër breza, është përvoja e traumës që u përcillet brezave që mund të mos e kenë përjetuar vetë traumën, por të ndjejnë ndikimet. Për shembull, pasardhësit e të mbijetuarve të luftës jugosllave ende tregojnë shenja se janë ndikuar nga kjo. Kjo shihet si një traumë shumë brezash, si diçka që jo vetëm që është transmetuar nga prindërit tanë nga konfliktet e viteve 90-te, por realisht çdo brez ka përjetuar luftën, qoftë ajo e Dytë Botërore, Lufta e Parë Botërore, Luftërat Ballkanike etj. Dhe ende flasim dhe dëgjojmë për luftën realisht.

Diçka për të cilën mund të flitet por që mund të jetë gjithashtu e vërtetë për disa njerëz, është ndikimi i komunizmit. Njerëz të ndryshëm patën përvoja të ndryshme nga Jugosllavia e Titos. Ekziston një hulumtim më i ri epigenetik që tregon se trauma mund të transmetohet në mënyra shumë të prekshme në ADN-në tonë. Në thelb, ajo që tregon hulumtimi është se fa-

---

<sup>31</sup> Rebecca West, Black Lamb and grey Falcon, A journey through Yougoslavia, New York, penguin, 1982, f.22.

milja është pika kryesore e transmetimit të traumave ndër breza. Epo, në diasporë, kjo është edhe pika kryesore e transmetimit të identitetit dhe kulturës. Ne mësojmë se kush jemi kulturalisht nga familja jonë. Pra, nëse ajo traumë ndër breza është e pranishme, kjo është fragmentimi i ndjenjës sonë të identitetit dhe të kuptuarit të kulturës sonë dhe marrëdhënies sonë me të. Gjëja tjetër është gjithashtu se për shumë prej atyre që përjetuan vitet e 90-ta, prindërit tanë u rritën në Jugosllavi. Shumë e konsideronin veten jugosllavë mbi çdo gjë tjetër dhe papritmas u detyruan të zgjidhnin një identitet tjetër qoftë atë që e ndienin apo në një mënyrë të dhunshme, në një mënyrë që ishte në kundërshtim të dhunshëm me identitetet e tjera – dhe nëse ata ndjeheshin multietnikë, ajo dhunë bëhej eksponenciale.

Pra, në diasporë, duke mësuar për veten dhe kulturat nga anëtarët e familjes që vetë po luftojnë me identitetin dhe që mund të kenë pësuar trauma dhe/ose të kenë trashëguar trauma vetë del në përfundim se kjo nuk të çonë në një ndjenjë kohezive të identitetit dhe vetes.

Nuk është ekzagjerim të thuhet se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor mbështetet në pjesëmarrjen e diasporës së saj në vendet e origjinës. Potenciali i diasporës për të prezantuar në mënyrë krijuese në vendin e tyre të origjinës përvojat, njohuritë, rrjetet dhe vizionet e fituara jashtë vendit është i madh dhe padyshim çelësi i suksesit të rajonit. Duke përfituar nga mundësitë gjatë punës jashtë vendit, shumica e anëtarëve të diasporës kanë ende një përkushtim të fortë ndaj atdheut të tyre, të gatshëm të ndajnë njohuritë dhe përvojën e tyre me bashkëqytetarët e tyre. Megjithatë, që shtetet e Ballkanit Perëndimor të gëzojnë përfitimet e plota të dinamikës së diasporës ndërkombëtare, duhet të krijojnë struktura të dallueshme dhe transparente emigracioni që lejojnë transferimin e shpejtë të informacionit ndërmjet komuniteteve si dhe përfitimet që të jenë të lëvizshme midis diasporës dhe vendeve të origjinës.

Me fjalë të tjera, për të zhbllokuar potencialin, burimet dhe kapacitetet e diasporës, për të ndihmuar zhvillimin e rajonit të tyre të origjinës, ato duhet të përfshihen në të gjitha dialogët e politikave përkatëse. Arkitektët e politikave duhet të krijojnë një rrugë të qartë për diasporën që të ketë fjalën në vendimmarrje të rëndësishme dhe strategjike në nivel shtetëror, gjë që do të ndihmojë gjithashtu në krijimin e një mjedisi inkurajues dhe pozitiv midis

tyre dhe diasporës së tyre. Kjo ndërmarrje është një detyrë e konsiderueshme për çdo qeveri, sa më shpejt që Ballkani Perëndimor të fillojë të shfrytëzojë potencialin e diasporës, aq më shpejt mund të priten përfitimet. Siç shihet diku tjetër, politikat e diasporës tregojnë rezultate të vërteta vetëm shumë dekada më vonë. Pra identiteti i tyre i lidhur me vendet e origjinës mund ti bëjë ato sa bashkëpunues aq dhe të kënaqur me sukseset e hapësirave të tyre familjare dhe e cila është një frymë e njëjtë tek shumë popujt e Ballkanit të emigruar në vendet perendimore dhe jo vetëm.

## Rezume

Në këtë punim është tentuar të jepet një shpjegim më i detajizuar në lidhje me tendencën e ndërlidhjes të banorëve të Ballkanit të cilët jetojnë në vendet perendimore me vendlindjet e tyre. Ky ballkanizim shprehet në forma të ndryshme, sikurse thamë nëpërmjet të traumës së përbashkët të cilën e kanë aluar në një shtet të përbashkët sikurse ishte Jugosllavia por dhe me problemet e mëvonshme ndërmjet popujve të Ballkanit të cilat janë transferuar dhe në shtetet ku veprojnë seeps shprehimisht janë të lidhur me hapësirën gjeografike ku veprojnë në mënyrë indirekte. Diaspora ballkanike ka gjetur dhe forma të tjera se sit ë bashkëveproj me vendlindjen duke shkuar në shkolla apo në objekte kultike të cilat siç thamë më shumë shëndrrohen në baza qëndrore të bashkëpunimit intra komunitar apo intra vendor se sa vetë qëllimi i vajtjes në këto objekte për arsye që janë të parapara. Problemi kryesor i disa prej komuniteteve është se sit ë ndihmojnë bashkëvendasit në vendlindje, për çka dhe kanë hapur klube dhe fondacione të ndryshme. Në brendësi të punimit ka dhe qasje teorike që kanë të bëjë me shpjegimin e ndikimit në jetën e përditëshme apo në folklorizimin e jetës njerëzore, si ndërlidhja me ushqimet vendore, me aktivitetet kulturore muzikore dhe jo vetëm. Në fund jepet një ide se si këto bashkëpunime do kishin kontribuar më së miri në vendlindjen e tyre me rikthimin e tyre por dhe me punën e tyre indirekte nga larg qoft nëpërmjet të financimit apo të veprimtarisë indirekte punuese.



## Conclusion

In this paper, an attempt has been made to give a more detailed explanation regarding the tendency of the Balkan residents who live in Western countries to connect with their hometowns. This balkanization is expressed in different forms, as we said through the common trauma which they have caused in a common state such as Yugoslavia, but also with the subsequent problems between the peoples of the Balkans who have been transferred and in the countries where the seeps operate expressly are related to the geographical space where they operate indirectly. The Balkan diaspora has found other ways to interact with the homeland by going to schools or cultic objects which, as we said, are more central bases of intra-community or intra-local cooperation than the very purpose of going to these objects for reasons that are foreseen. The main problem of some of the communities is that they are helped by their compatriots in their homeland, which is why they have opened various clubs and foundations.

Inside the paper, there are also theoretical approaches that have to do with explaining the impact on everyday life or on the folklorization of human life, such as the connection with local foods, with musical cultural activities and more. At the end, an idea is given of how these like-minded people would have contributed best to their hometown with their return but also with their indirect work from afar, whether through financing or indirect work activity.

## Bibliografi

- Bourdieu Pierre, *Outline of a theory of Practice*, Cambridge University Press, Cambridge, 1977.
- Fleming K. E., *Orientalism, the Balkans, and Balkan Historiography*, "The American Historical Review, Vol. 105 No. 4", (Oct., 2000).
- Hayden Milica Bakic, Robert M. Hayden, *Orientalist Variations on the Theme "Balkans": Symbolic Geography in Recent Yugoslav Cultural Politics*, *Slavic Review*, Vol. 51, No. 1, 1992.
- Laitin David, *Hegemony and culture*, University of Chicago Press, Chicago, 1986, f.19
- Todorova Maria, *Imagining the Balkans*, New York, 1997.
- West Rebecca, *Black Lamb and grey Falcon, A journey through Yugoslavia*, New York, Penguin, 1982,

Vjosa Osmani  
Instituti Albanologjik i Prishtinës

# NDIKIMI I GLOBALIZIMIT NË DISKURSET E SHQIPES

## Abstrakt

*Globalizimi si proces, e ndikimi i tij në sfera të ndryshme të jetës, është bërë një nga temat e shpeshta të diskutimeve në ditët e sotme, para së gjithash për shkak të transformimeve që kanë ndodhur e po ndodhin nën ndikimin e tij, por edhe për shkak të pikëpamjeve e divergjencave të shumta për të.*

*Në këtë punim kemi trajtuar pikërisht ndikimin e këtij procesi në komunikimin gjuhësor, konkretisht në diskurset e shqipes. Së këndejmi, kemi pasur parasysh disa synime, si:*

- Të trajtojmë globalizimin si proces transformimi
- T'i trajtojmë rrethanat në të cilat ka filluar dhe është zhvilluar ky proces
- Të trajtojmë ndikimin a ndryshimet që kanë pësuar e vazhdojnë të pësojnë diskurset e shqipes në këto rrethana

*Për këtë qëllim kemi analizuar disa tekste të periudhave të ndryshme, përmes të cilave jemi munduar të japim një pasqyrë e qartë e këtij ndikimi. Ndërkaq, shembujt që kemi përdorur janë nga më të ndryshmit dhe janë marrë kryesisht në gazetatat: "Rilindja", "Bujku", "Koha Ditore", por edhe në tekste të tjera, që kanë trajtuar probleme ekonomike dhe politike.*



## Koncepti globalizim

### Lindja, zhvillimi dhe efektet e globalizimit në jetën shoqërore

Dihet se termi globalizim ka filluar të përdoret në vitet '60 të shekullit XX. Edhe në periudhën para viteve'60 ka pasur ndryshime shoqërore,

mirëpo, ato janë zhvilluar shumë ngadalë, duke prekur vetëm fusha të caktuara të jetës. Megjithatë, këto ndryshime, apo siç quhen shpesh, këto tendenca globalizuese, edhe pse asnjëherë nuk kanë pasur përmasat e globalizimit të sotëm modern, kanë shtyrë shumë studiues të pohojnë se "*globalizimi*" është vetëm një term i ri, dhe jo një fenomen krejtësisht i ri në historinë njerëzore. Kjo për faktin se, siç theksojnë ata, disa nga karakteristikat e globalizimit, si: rritja e tregtisë ndërkombëtare, roli i madh i korporatave multinacionale, ndikimet ndërkulturore etj., nuk janë zhvillime krejtësisht të reja në historinë botërore. Në këtë kontekst, i ri konsiderohet vetëm ritmi me të cilin po zhvillohet sot ky proces, si dhe përmasat e tij, dhe jo globalizimi si fenomen.

Së këndejmi, ata që janë marrë dhe vazhdojnë të merren me këtë proces kanë pikëpamje divergjente për origjinën dhe zhvillimin e tij. Ka autorë që lindjen e globalizimit e lidhin me kolonizimin helenik të Italisë së Jugut (shek. VIII-VII para Erës së Re), ndikimin politik dhe kulturor helen, apo me atë që njihet si "*qytetërimi helenik*", i cili ndikoi që greqishtja e vjetër të bëhej "*gjuhë universale*" e kulturës së antikitetit. Disa lindjen e globalizimit e lidhin me kohën kur Johan Gutenberg shpiku makinën e parë të shkrimit (1439), shpikje kjo që pati një ndikim mjaft të madh në komunikimin mes kulturave të ndryshme. Të tjerët konsiderojnë se një rol të madh luajti krijimi i kompanive të para shumëkombëshe British East India Company (1600-1874) dhe Dutch East India Company (1602-1798), apo krijimi i një ndër korporatave të para me ndikim global, General Electric (1892), të cilat, me shtrirjen e shërbimeve të tyre në vende të ndryshme të botës, i hapën rrugë komunikimit në nivel botëror, e së këndejmi, krijimit të një sistemi të unifikuar ekonomik.

Një pikëpamje mjaft e përhapur është edhe ajo sipas së cilës në zhvillimin e globalizimit kanë ndikuar: revolucioni industrial, revolucioni amerikan e ai francez, luftërat botërore etj., të cilat kanë ndikuar në risistemimin e jetës shoqërore a në krijimin e sistemeve të reja shoqërore..

Ndërkaq, për Anthony Giddens, një ndikim të madh në përhapjen e dukurive globale kanë pasur mediat. Madje, ai konsideron se, fakti që sot jetojmë në "një botë", në një pjesë të madhe është rezultat i fushës ndërkombëtare të veprimit të medias së komunikimit (Giddens, 2007:521).

Në këtë kontekst, Giddens përmend katër agjencitë kryesore të lajmeve në botë: France Press (1835), Associated Press (1846), Reuters (1851) dhe United Press International-UPI (1958), të cilat janë përgjegjëse për pjesën më të madhe të lajmeve ndërkombëtare që transmetohen në të gjithë botën (Giddens, ibid.:522).

Studiues të tjerë mendojnë se globalizimi ka filluar pas Luftës së Dytë Botërore (1945), kohë kjo kur në Evropë u krijuan dy kampe, të cilat, deri në vitin 1989, kur u përmbys socializmi, ishin arenë e kontradiktave midis dy sistemeve të kundërta. Së këndejmi, globalizimi si fenomen supozohet se e ka zanafillën pikërisht pas përfundimit të kësaj lufte, kur ndikimi i dy blloqeve politike e ushtarake u shtri në të katër anët e botës (Munishi: 2008, 326). Ndërkaq, periudha pas viteve '90 mund të konsiderohet një etapë e re, sidomos për Evropën. Rënia e Bashkimit Sovjetik e qoi botën drejt dominimit të një fuqie të vetme, e në të njëjtën kohë e futi atë përfundimisht në epokën e globalizimit. Kurse, përparimet teknologjike i kanë dhënë, dhe po i japin shtysë përhapjes më të shpejtë të këtij fenomeni.

Pra, siç shihet nga kjo paraqitje kronologjike, globalizimi, si proces transformimi, ka ndodhur në periudha të ndryshme dhe nën ndikimin e faktorëve të shumë. Ndërkaq, si ka ndikuar ky ndryshim shoqëror në gjuhë, veçanërisht në diskursin ekonomik dhe politik në Kosovë do të shohim në vazhdim.

## **Ndikimi i globalizimit në diskursin ekonomik dhe politik në Kosovë**

Dihet se globalizimi është një proces transformimi, të cilin, para së gjithash, e diktojnë kërkesat në rritje në fushën e ekonomisë. Megjithatë, siç thekson edhe Klaus Müller, dinamika e globalizimit shtyhet përpara nga forca ekonomike, por efektet e tij vepruese ndihen edhe në fushën e politikës ([http://www.ersj.eu/repec/ers/papers/10\\_1\\_p13.pdf](http://www.ersj.eu/repec/ers/papers/10_1_p13.pdf)). Së këndejmi, ekonomia dhe politika, duke qenë sferat ku marrëdhëniet midis individëve, shoqërisë e shteteve janë mjaft të theksuara dhe të shpejta, kanë krijuar kushte të favorshme për ndikime të gjuhëve të huaja, sidomos të anglishtes, si një "*lingua franca*" botërore, në diskursin ekonomik dhe politik të vendeve

të ndryshme. Ky ndikim, i cili është rrjedhojë e fuqisë ekonomike dhe politike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka bërë që sot globalizimi të ketë një ndikim të madh edhe në diskutet e shqipes.

Kur trajtohen këto diskutet, gjithsesi duhet të kihet parasysh kontekstet në të cilat janë zhvilluar politika dhe ekonomia e Kosovës, sepse, diskutet e terminologjia janë pasqyrë e këtyre sistemeve dhe ndryshojnë krahas ndryshimit të tyre. Në këtë vazhdë, për të parë se si kanë evoluar, apo si kanë ndryshuar në rrjedhë të kohës këto diskutet, kemi analizuar disa tekste, që pasqyrojnë sistemet ekonomike dhe politike të periudhave të ndryshme në Kosovë, nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, kur filloi procesi i globalizimit, e deri më sot. Konkretisht, do të analizohen tekste të kohës kur Kosova ishte pjesë integrale e Jugosllavisë, të viteve '90, kur ishte pjese integrale e kësaj federate, por kishte krijuar një sistem paralel, si dhe të periudhës së pasluftës, kur u krijua një realitet tërësisht i ri ekonomik dhe politik.

Siç dihet, nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore (1945), kur u shpall Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, e deri më 1948 në Kosovë mbizotëroi sistemi i tipit Sovjetik. Ndërkaq, në vitin 1948, pasi që Tito i prishi raportet me Stalinin, Jugosllavia u distancua ideologjikisht nga sistemi Sovjetik dhe iu bashkua Bllokut të Vendeve të Painkuadruara. Po ashtu, u hoq dorë edhe nga modeli i ekonomisë së planifikuar centraliste, në të cilin mungonte plotësisht prona private. Si rrjedhojë e kësaj, në fillim të viteve '50, u krijua një sistem unik socialist, i njohur si "Sistemi Socialist Vetëqeverisës", i cili nuk ishte as i tipit Sovjetik, e as i atij kapitalist. Gjatë kësaj periudhe Jugosllavia, por edhe Kosova si pjesë integrale e saj, mbështetej në një masë të madhe në pronën private dhe në ekonominë e lirë të tregut. Pra, për dallim nga vendet tjera komuniste, në të cilat pronat ishin shtetërore, në Jugosllavi ato i takonin shoqërisë. Ndërmarrjet zhvillonin aktivitete të pavarura, ndërkaq punëtorët kishin rol vendimmarrës.

Një sistem i tillë natyrisht që ka ndikuar edhe në ndryshimin e diskuteseve, konkretisht të terminologjisë së këtyre fushave. Prandaj, për nga përmbajtja, terminologjia politike e ekonomik në këtë periudhë është pasqyrë e këtyre dy ideologjive.

Në tekstet të cilat i kemi analizuar, ndër termet ekonomike dhe politike, më të zakonshme janë: *marrëdhanye ndërkombëtare, sovran, marrëdhanye*

*ekonomike, bashkëpunim industrial, kombinat bujqësor, naftëpërçues, Komision i Kuvendit federativ, Komitet qendror, Këshilli ekzekutiv federativ, liberalizim i importit, Lidhje e komunistëve, vetëqeverisje, transformim revolucionar i shoqnisë, organizatë shoqnore politike, Organizatë e Lidhjes së Komunistëve, reformë ekonomike e shoqnore. Kolektiv punues i kooperativës bujqësore, kooperativë, botëkuptime burokratike, botëkuptime etatiste, botëkuptime konservative, botëkuptime shoviniste, botëkuptime nacionaliste, procese demokratike, marrëdhënie vetëqeverisëse e demokratike, dhomë federative, arenë ndërkombëtare, vetëqeverisje socialiste, sistem shoqnor-ekonomik, sistem i vetëqeverisjes, vetëqeverisje shoqnore dhe punëtore, sipërmarrje, këshill afarist, organizatë punuese, organizatë zejtare etj.*

Megjithatë, edhe ky sistem rezultoi si i pasuksesshëm. Së këndejmi, në vitet '70 roli i shtetit në ekonomi u rrit, kështu që ndryshoi edhe qasja ndaj ekonomisë së lirë të tregut.

Në këto rrethana, në vitin 1974, lindi ajo që Schmitt e quan "*egoizëm republikan*", ku hapësira politike dhe ekonomike u definua sipas vijave nacionale (Schmitt, 2012:195). Në të njëjtën kohë, me Kushtetutën e vitit 1974, Kosova u bë njësi autonome në kuadër të Republikës Federative të Jugosllavisë. Në bazë të së drejtës kushtetuese, ajo ishte e pavarur në shumë sfera, ndër të tjera edhe në atë ekonomike, financiare, në sferën e marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare etj. Së këndejmi, deri në fillim të viteve '80 vendi kishte lidhje mjaft të mira me tregjet botërore të të dyja blloqeve, si me ato të bllokut socialist, ashtu edhe me ato të bllokut kapitalist. Partnerët kryesorë tregtarë ishin Gjermania, SH.B.A-të, Italia, BRSS-ja, Çekosllovakia, Bullgaria, Rumania, e në një përqindje shumë të ulët edhe Shqipëria. Marrëdhëniet e tilla vazhduan deri në vitin 1989.

Ky kontekst i ri ekonomik e politik, natyrisht që ndikoi edhe në diskutet e fushave përkatëse në Kosovë. Në këtë periudhë, krahasuar me periudhat e mëhershme, vërehet një numër më i madh i njësive terminologjike që shprehin karakteristikat e globalizmit, si: elementet që shprehin rritjen e tregtisë ndërkombëtare, ekonominë e lirë të tregut, rolin më të madh të korporatave multinationale, marrëdhëniet ekonomike dhe politike ndërkombëtare etj. Megjithatë, shumica e njësive gjuhësore terminologjike karakterizojnë diskursin socialist-komunist,

Njësi terminologjike të fushës së ekonomisë dhe politikës, që i kemi hasur më shpesh, në tekstet të cilat i kemi analizuar janë: *unitarist, nacionalist, byrokrat, ideologji hegjemoniste, anarkoliberalist, barazi nacionale, revolucion socialist, aspiratë demokratike sociale e nacionale, federalizëm, bashkësi vëllazërore, hegjemonistë serbomëdhenj, fuqi imperialiste, marrëdhënie shoqërore-ekonomike, socializëm vetëqeverisës, shoqëri unike, sistem centralist i vetëqeverisjes, klasë punëtore, menaxher, platformë ideopolitike e Partisë, ekonomi e tregut, tekno-liberal, shoqëri socialiste vetëqeverisëse, ekonomi unike jugosllave, ndërnacional, treg unik, treg i lirë, pavarësi ekonomike relative, hegjemonizëm ekonomik dhe politik, pluralizëm i interesave nacionale, pluralizëm vetëqeverisës, nihilizëm nacional, nacionalizëm, internacionalizim, patriotizëm socialist, unitarizëm jugosllav, etatizëm, centralizëm, marrëdhënie bashkëkohore nacionale, marrëdhënie ndërnacionale, bashkësi socialiste vetëqeverisëse, forca progresive, internacionalizëm socialist etj.*

Në vitin 1989, me humbjen e pozitës kushtetuese brenda Jugosllavisë, Kosova, përveç që humbi autonominë politike, u dëmtua shumë edhe në sferën ekonomike. Këto zhvillime natyrisht që ndikuan edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në humbjen e tregjeve, sidomos të atyre eksportuese, rënien e aktiviteteve prodhuese, rënien e investimeve etj. Në këtë periudhë ndodhën ndryshime thelbësore edhe në sferën politike. Për shkak të rrethanave të përmendura më lart, u krijua një sistem politik, i cili nga perëndimorët quhej "*shoqëri paralele*" (Schmitt, 2012:248). Përmes Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), që ishte lëvizja e parë demokratike në Kosovë, por edhe partive të tjera, si: Partisë Socialdemokratike të Kosovës (PSDK), Partisë Shqiptare Demokristiane (PSHDK), Partisë Fshatare të Kosovës (PFK), Partisë Liberale të Kosovës (PLK), Partisë Parlamentare të Kosovës (PPK) etj., u vunë bazat e një sistemi demokratik pluralist. Megjithatë, rrethanat në të cilat vepronin këto parti nuk ishin të favorshme, kështu që, nuk kishin mundësi dhe hapësirë të ushtronin aktivitete të mirëfillta demokratike e pluraliste. Sidoqoftë, programet e tyre ishin ndërtuar mbi bazën e zhvillimeve demokratike perëndimore. Liria, të drejtat e njeriut, pavarësia, ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës, zhvillimi ekonomik, demokratizimi i marrëdhënieve shoqërore dhe hapja ndaj botës ishin vetëm disa nga elementet e diskursit gjatë kësaj periudhe.

Në këto rrethana, kërkesat e jetës së përditshme për të mbijetuar, kanë rritur gjithsesi nevojën për komunikim global. Prandaj, kjo është periudha kur fillon të vërehet qartë, jo vetëm një numër i madh i njësive gjuhësore terminologjike që e karakterizojnë globalizimin, por edhe një zëvendësim i njësive të diskursit socialist-komunist me ato që reflektojnë këtë proces. Një transformim i tillë, shprehet qartë përmes njësive gjuhësore terminologjike: *represion, konferencë, Komision Evropian, krizë globale, rezolutë, samit, Union Evropian, infrastrukturë bankare, valutë evropiane, markë gjermane, Bankë e përbashkët e Unionit Evropian, transformim monetar evropian, procese ekonomike integruese evropiane, Evropë e bashkuar, Bashkësi Evropiane, sovranitet, tërësi e re ekonomike dhe politike, infrastrukturë demokratike dhe parlamentare, njësi e bashkuar ekonomike dhe politike, treg i përbashkët, bipolaritet i superfuqive, asociacion, prosperitet evropian, integritet, organizatë ndërkombëtare, delegacion, zgjidhje globale, marrëdhënie diplomatike ndërkombëtare, aleancë përëndimore, operacione paqësore, vëzhgues ndërkombëtarë, koordinator, demokratik, delegacion, liberal, zgjedhje parlamentare, pavarësi, autonomi, organe legale, falimentim, afarist, ndërmarrje private, revokim, kompetencë, sovran, konstituiv, financim, protestë, identitet nacional, antikushitetues, rrymë demokratike etj.*

Pas përfundimit të luftës (1999) Kosova hyri në një fazë të re të tranzicionit, jo vetëm politik dhe ekonomik, por shoqëror në përgjithësi. Tranzicioni, si proces transformues, sigurisht që nuk ndodhi vetvetiu. Përkundrazi, u nevojiti ndërtimi i një strategjie, e cila përmbante ide e qëllime të qarta, që përcaktonin rrugën nëpër të cilën duhej të kalonte vendi gjatë këtij procesi. Në këtë kohë Kosova ishte nën administrimin civil të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Roli i këtij misioni ishte i shumëfishtë: të ndërtonte një administratë të përkohshme vendore derisa të formoheshin institucionet demokratike vetëqeverisëse, të mbikëqyrte zhvillimin e këtyre institucioneve, të përkrahte rindërtimin e infrastrukturës, zhvillimin ekonomik, themelimin e forcave policore lokale, sundimin e ligjit, ruajtjen e rendit etj.

Diskurset ekonomike dhe politike të kësaj periudhe pasqyrojnë më së miri këto strategji. Në tekstet e mëposhtme shihet se janë të shpeshta njësitë:



*Kosovë e lirë, Kosovë demokratike, paqësore, prosperuese, e pavarur, integrim, Bashkim Evropian, struktura veriatlantike, zhvillim i shpejtë ekonomik, stabilitet ekonomik, procese demokratike, korrupsion, status politik, standard, administratë ndërkombëtare, mision ndërkombëtar, qeveri vendore, transfer i kompetencave, decentralizim i pushtetit, zgjidhje e statusit, struktura paralele, integrim i minoriteteve, kryeadministrator, përmbushje e standardeve, bashkëpunim ndërkombëtar, ridefinim i raporteve, zbatim i standardeve, diplomaci, status quo, qëndrueshmëri ekonomike, bruto produkt vendor, stabilitet makroekonomik, resurse humane, investitorë ndërkombëtarë, investime kapitale, donacione ndërkombëtare, stabilitet makroekonomik etj.*

Ndërkaq, pas shpalljes së pavarësisë (2008) janë krijuar rrethana të reja dhe mjaft specifike. Në këtë kontekst të ri, në të cilin Kosova synon të portretizohet si pjesë e Perëndimit, e zhvillimeve dhe e vlerave globale, janë kristalizuar disa ide mbi të ardhmen e vendit. Së këndejmi, për të përqafuar modelet perëndimore janë bërë dhe po vazhdojnë të bëhen reforma të thella në sfera të ndryshme, e veçanërisht në sferën ekonomike dhe politike. Derisa, para shpalljes së pavarësisë reformat kishin për qëllim të ndërtonin një shoqëri të lirë e demokratike, e së këndejmi të përgatisnin vendin për statusin përfundimtar, pas shpalljes së pavarësisë ato janë orientuar, para së gjithash, kah tregu dhe stabiliteti ekonomiko-politik. Prandaj, sot flitet kryesisht për ndërtimin e infrastrukturës demokratike e krijimin e kushteve tjera për integrimin euro-atlantik të Kosovës. Në rrethana të tilla, nevoja e komunikimit ekonomik dhe politik në një rrafsh shumë më të gjerë-global s'ka si të mos ndikojë edhe në ndryshimin, apo shfaqjen e diskurseve të reja. Meqenëse komunikimi ndërmjet institucioneve ekonomike dhe politike të vendeve të ndryshme kryhet në gjuhën angleze, për shkak të fuqisë ekonomike dhe politike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ndikimi i anglishtes është i madh në të gjitha gjuhët, e sidomos në gjuhët e vendeve në tranzicion, siç është Kosova.

Kështu, Norman Fairclough, kur flet për tranzicionin në Rumani, pohon se vendet post-komuniste kanë qenë të prira të miratojnë edhe format më ekstreme të liberalizimit ekonomik, si një mënyrë për t'u distancuar nga e kaluara e tyre socialiste. (Fairclough, 2006:58) Në librin e tij "*Language and Globalization*", ky studiues, përveç tjerash, flet edhe për rishkallëzimin ose

ripërshtatjen e diskursit në Rumani, si rrjedhojë e tranzicionit nëpër të cilin po kalon ky shtet. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Kosovën e trojet tjera shqiptare. Tranzicioni, si proces transformimi, e ka çuar shoqërinë shqiptare drejt prioriteteve të reja ekonomike dhe politike, e së këndejmi edhe drejt përshtatjes së diskurseve ndaj këtyre prioriteteve.

Prandaj, pohimet e Fairclough, Munishi i trajton edhe në kontekstin e sotëm të shqiptarëve dhe të shqipes. Së këndejmi, rishkallëzimin e gjuhës shqipe në përgjithësi, dhe shqipes standarde në veçanti, ai e sheh në tri rrafshë: në rrafshin vendor, si përshtatje të shqipes me rrethanat e reja, në rrafshin makro-rajonal, si përshtatje të shqipes me integrimet evropiane, dhe në përgjithësi, në rrafshin global si përshtatje të shqipes me dukuritë dhe proceset globalizuese (Munishi, 2008:337). Ndërkaq, rishkallëzimi dhe ripërshtatja e diskursit ekonomik dhe politik, sipas tij, reflekton aspiratat për ekonominë e lirë të tregut, për ndërtimin e institucioneve demokratike, për integrimin në BE dhe në NATO, për thithjen e investimeve të huaja etj. (Munishi, ibid:338). Pra, këto synime, si pjesë e diskursit të përditshëm politik e ekonomik në Kosovë, janë vetëm disa nga faktorët të cilët kanë ndikuar në përhapjen e proceseve të globalizimit në vendin tonë, e së këndejmi edhe në shfaqjen e diskurseve të reja ekonomike dhe politike, e të njëjseve gjuhësore terminologjike që përbëjnë këto diskurse.

Në tekstet, e analizuar, të cilat pasqyrojnë ngjarje ekonomike dhe politike të kësaj periudhe, kemi hasur një numër të madh të njëjseve gjuhësore terminologjike, që kanë hyrë kryesisht nga gjuha angleze, si: integrim euroatlantik, raport i progresit, zhvillim i shpejtë ekonomik, *çrrënjosje e varfërisë ekstreme dhe urisë, partneritet global për zhvillim, qeverisje e mirë, transparente dhe demokratike, zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, stabilitet politik, integrim euroatlantik, integrim global, krizë ekonomike globale, krizë bankare, krizë financiare ndërkombëtare, lëvizje e lirë e njerëzve dhe kapitalit, administrim biznesi, bruto produkt overdraft, depozitë, licencim, bilanc tregtar, aksionar, asete, banka komerciale, investime kapitale, resurse humane, transaksione, agjent fiskal, agjent tregtar, reforma financiare, transaksion, koncesion, likuiditet, konkurrencë e lirë, inovacione financiare, politika monetare dhe fiskale etj.*

## Përfundime

Duke i analizuar tekstet para viteve '90, kemi vënë re se shumë njësi terminologjike, si: *marrëdhënie ndërkombëtare, marrëdhënie ekonomike, bashkëpunimin industrial, ekonomi e tregut, dukuri tekno-liberaliste, zhvillim ekonomik, treg unik, treg i lirë etj.*, janë rrjedhojë e ndikimit të diskursit të globalizimit. Megjithatë, për shkak të rrethanave të njohura politike dhe ekonomike, këto marrëdhënie nuk zhvilloheshin në një plan të gjerë global, siç zhvillohen sot.

Mbështetur në zhvillimet ekonomike dhe politike, mund të themi se tranzicioni në Kosovë ka filluar në fillim të viteve '90, me lëvizjen për liri dhe demokraci, me iniciativën relativisht të zhvilluar private, me krijimin e sistemit pluralist, me krijimin e disa organizatave qeveritare dhe joqeveritare etj. Të gjitha këto ndryshime, veçanërisht ato të sistemit politik, janë reflektuar edhe në diskurset e në njësitë gjuhësore terminologjike që i përbëjnë këto diskurse. Njësitë: *plan global, diplomaci botërore, diplomaci evropëndimore e amerikane, bashkësi ndërkombëtare, Evropë e bashkuar, tërësi e re ekonomike, politike etj.*, të cilat i kemi hasur në diskursin e përditshëm ekonomik dhe politik të kësaj periudhe, reflektojnë më së miri këtë transformim.

Ndërkaq, siç theksuam edhe më lart, Kosova hyri në fazën përfundimtare të tranzicionit vetëm pas përfundimit të luftës. Reformat e thella, që janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen, në sfera të ndryshme, e sidomos në atë ekonomike dhe politike janë reflektuar edhe në diskurset përkatëse. Sot, kur flitet për ndërtimin e infrastrukturës demokratike e krijimin e kushteve tjera për integrimin euro-atlantik të Kosovës, janë bërë pjesë e pandashme e diskursit njësi të shumta gjuhësore terminologjike, fjalë e togfjalësha të cilat i reflektojnë këto synime.

Disa nga to, siç i pamë edhe në tekstet e mësipërme, janë: integrim në strukturat veri-atlantike, raport i progresit, zhvillim i shpejtë ekonomik, *partneritet global për zhvillim, qeverisje e mirë, transparente dhe demokratike, sundim i ligjit, zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, stabilitet politik, integrim euroatlantik, integrim global, lëvizje e lirë e njerëzve dhe kapitalit etj.* Të shumta janë edhe njësitë e reja të ekonomisë së tregut, sidomos ato që kanë hyrë me privatizimin e sistemit bankar, si: *alokim, agjent, asete, admi-*

*nistrim biznesi, audit/auditor, bord, bruto produkt, overdraft, depozitë, licencë, bilanc tregtar, aksionar, banka komerciale, investime kapitale, resurse humane, transaksione, agjent tregtar, reforma financiare, koncesion, konsumator, likuiditet, konkurrencë e lirë, staf, remitanca, deflacion, barkod, probabilitet, subvencion, valutë, gjirollogari, cash etj.*

## Literatura

- Berber**, Benjamin (1995), *Jihad vs. McWorld*, shih. Harvard Journal of Law & Technology Volume 9, Number 2, Summer, 1996
- Chomsky**, Noam, *What the World is Really Like: Who Knows It -- and Why*, shih. <http://www.chomsky.info/books/reader02.htm>
- Chomsky**, Noam, *Political positions of Noam Chomsky-Views on globalization*, shih: [http://en.wikipedia.org/wiki/Political\\_positions\\_of\\_Noam\\_Chomsky#Views\\_on\\_globalization](http://en.wikipedia.org/wiki/Political_positions_of_Noam_Chomsky#Views_on_globalization).
- Fairclough**, Norman (2006), *Language and Globalization*, Routledge, Taylor & Francis Group, London and New York.
- Giddens**, Anthony (2007), *Sociologjia*, Çabej, Tiranë
- Islamaj** Shefkije, *Aspekti gjuhësor i globalizimit dhe shqipja standarde*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Kulturën dhe Letërsinë Shqiptare, Prishtinë, 2008
- Levitt, Theodore (1983), *The Marketing Imagination: New, Expanded Edition*, The Free Press.
- McLuhan** Marshall, Herbert, (1964), *"Understanding Media"*, shih. [https://en.wikipedia.org/wiki/Marshall\\_McLuhan#Understanding\\_Media](https://en.wikipedia.org/wiki/Marshall_McLuhan#Understanding_Media).
- Munishi**, Shkumbin (2008), *Globalizimi, komunikimi gjuhësor dhe gjuha shqipe*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 27/1, Prishtinë.
- Müller**, Klaus & Pickel, Andreas (2011), *Global Power and Politics*, Trent University, Peterborough, Ontario, Canada
- Oliver** Jenes, Schmitt (2012) *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë.
- Steger**, B. Manfred, *Globalisation and Social Imaginaries: The Changing Ideological Landscape of the Twenty-First Century*1, cit. sipas Journal of Critical Globalisation Studies, Issue 1 (2009)
- Warwick**, Johannes, shih. [http://www.qkzhpeja.org/konferenca/Buletini\\_nr\\_2.pdf](http://www.qkzhpeja.org/konferenca/Buletini_nr_2.pdf)  
[https://nadjabuka.wordpress.com/2010/05/02/kultura-dhe-gjuha-perballe-globalizimit/-Këtu\\_janë\\_nxjerrë\\_disa\\_nga\\_të\\_dhënat\\_për\\_lindjen\\_dhe\\_zhvillimin\\_e\\_globalizimit](https://nadjabuka.wordpress.com/2010/05/02/kultura-dhe-gjuha-perballe-globalizimit/-Këtu_janë_nxjerrë_disa_nga_të_dhënat_për_lindjen_dhe_zhvillimin_e_globalizimit).  
<http://www.dardania.biz/vb/upload/showthread.php?t=24041>-

Shpresa Ismajli  
Instituti Albanologjik i Prishtinës

## RRETH DISA PRIRJEVE TË ZHVILLIMIT TË SHQIPES NË GLOBALIZËM

### Abstrakt

*Dukuria e globalizmit, e përhapur në përmasa botërore në radhë të parë përmes shkëmbimeve ekonomike dhe kulturore, ka prekur sot të gjitha fushat e jetës. Kjo dukuri, ndërlidhet ngushtësisht me përhapjen dhe ndikimin e anglishtes, si gjuhë e kulturës, e ekonomisë dhe e politikës. Ndër faktorët e shumtë që ndikojnë në përhapjen e ndikimeve të globalizmit, rol më të rëndësishëm kanë: ndërkombëtarizimi i tregjeve, lëvizja e popullsisë, dhe sidomos përparimi i teknologjisë. Veçanërisht, përmes mediave dhe internetit, anglishtja sot është gjuha kryesore e komunikimit në mbarë botën. Ky ekspansionizëm i anglishtes ka bërë që sot të flitet për anglishten si gjuhë globale, që lind nga nevoja për të pasur një gjuhë për komunikim botëror. Kur bëhet fjalë për anglicizmat në gjuhët e tjera, përfshirë edhe shqipen, autorë të shumtë mendojnë se në një të ardhme të afërt, falë teknologjisë moderne, gjuhët evropiane do të gjasojnë më shumë me njëra-tjetrën se sa që mund të paramendohet sot, me përjashtim të ndonjë zhvillimi të veçantë gjuhësor.*

Anglishtja, si gjuhë që shoqëron proceset e globalizmit, ushtron ndikim të fuqishëm në shumë gjuhë botërore, e padyshim edhe në gjuhën shqipe. Duke qenë se çështjet gjuhësore që lidhen me dukurinë e globalizmit janë të shumta, në këtë punim do të trajtohen disa prirje të zhvillimit të shqipes nën tryshninë e gjuhëve të huaja, e sidomos të anglishtes.

Në rrethanat e krijuara në dhjetëvjeçarët e fundit në hapësirat shqiptare në Ballkan, shtrirja e ndikimit të anglishtes në gjuhën shqipe është zgjeruar në përmasa të mëdha. Demokratizimi i shoqërisë shqiptare dhe integrimi i saj në proceset evropiane, pastaj pavarësia e Kosovës dhe prania e mekanizmave ndërkombëtarë në Kosovë, kanë mundësuar që shqipja të hapet ndaj dukurive të globalizmit dhe të intensifikojë kontaktet me anglishten, edhe si

gjuhë e globalizmit, edhe si gjuhë e kontaktit të drejtpërdrejtë (në Kosovë edhe formalisht anglishtja është gjuhë zyrtare). Në Kosovë anglishtja vjen nga të gjitha burimet dhe me të gjitha varietetet: britanike, amerikane, madje edhe indase në kohën e UNMIK-ut, anglishtja e europianëve dhe të tjerëve.<sup>32</sup>

Ndikimet e huaja në gjuhën shqipe vërehen në disa rrafshet e sistemit të saj. Dihet që rrafshi leksikor është terreni më i përshtatshëm për pranimin e trysnivenga gjuhëte huaja. Rritja e veprimtarive kulturore, proceset e integrimi ekonomike dhe orientimi drejt integrimi të përgjithshme në ekonominë e tregut dhe në botën euro-atlantike të tërë botës shqiptare, kanë krijuar një hapësirë shumë të gjerë të qarkullimit të dendur të fjalëve, të shprehjeve dhe të mënyrave të folurit të gjuhës angleze dhe me to edhe të tjera ndërkombëtare në gjuhën shqipe në një shkallë që ajo nuk e ka njohur më parë.<sup>33</sup> Anglishtja, duke qenë gjuhë globale, është duke ushtruar një ndikim të fuqishëm në terminologjinë shumë fushave, në radhë të parë të fushës së terminologjisë informatike e të internetit, pastaj të fushës së ekonomisë dhe në përgjithësi të fushës administrative. Terminologjia e saj ose po depërton në formë të huazimeve të thjeshta dhe përmes kalkeve.

Sikundër dihet, pjesa më e madhe e termave të teknologjisë informative dhe të internetit kanë hyrë bashkë me sendet apo veprimet e lidhura me to, si: *kompjuter, printer, skaner, laptop, maus, toner, e-mail, ueb sajt, link, pastaj startoj, selektoj, klikoj, sevoj, skanoj, logoj, çatoj, donladoj* etj., pra për shkak të nevojës për t'i emërtuar inovacionet nga fusha tekniko-teknologjike. Të shumta janë edhe huazimet nga fusha e ekonomisë dhe biznesit, si: *auditim, alokim, donacion, grant, risk, suficit, subvencion, tender, prokurim, fond, transakcion* etj.; pastaj nga fusha e modës: *sfilatë, dizajn, bo-di, xhinse, luk* etj.; nga fusha e muzikës: *live, band, Dj, remiks, performoj, performancë, hip hop, rep, reper* etj. Shumica nga këto fjalë janë bërë të zakonshme në përditshmërinë tonë.

<sup>32</sup> Rexhep Ismajli, *Pse të shtrohet tani dhe këtu një tematikë e këtyllë?*, në Studime 20, AS-hAK, Prishtinë, f. f.215.

<sup>33</sup>Rexhep Ismajli, libri i cituar, f. 214.

Ndikimet e globalizmit janë vënë re edhe në nënsistemet tjera të shqipes, më të theksuara shfaqenë rrafshin sintaksor, në rrafshin morfologjik ndikimet janë më të pakta.

Njëra ndër dukuritë që është vlerësuar nga studiuesit si një prirje e zhvillimit të shqipes në globalizëm është analitizmi sintaksor. Zëvendësimi i ndërtimeve sintetike me analitike në përgjithësi po gjen shtrirje gjithnjë e më shumë në gjuhën shqipe. Një dukuri e tillë mjaft e përhapur është zëvendësimi i rasës dhanore pa parafjalë me kallëzoren ose rrjedhoren me parafjalë: *përgjigjem ndaj pyetjeve* ose *përgjigjem në pyetjet* në vend të *u përgjigjem pyetjeve*; *bëjnë presion ndaj grevistëve* në vend të *u bëjnë presion grevistëve* etj., ku siç shihet *parafjala ndaj + rrjedhorja* ka zëvendësuar dhanoren. Kjo dukuri e analitizmit rrit shkallën e komunikimit gjuhësor, por nga ana tjetër cenon origjinalitetin dhe bukurinë e shqipes.<sup>34</sup>

Një prirje në rritje e shqipes nën ndikimin e gjuhëve të huaja është ndryshimi i transivititetit të foljeve, përdorimi i foljeve kalimtare me kundrinë të drejtë, në vend të foljeve jokalimtare që kërkojnë kundrinë të zhdrejtë. Shtrirja e kësaj dukurie po zgjerohet në shumë folje të shqipes me përdorim kalimtar, si: *votoj VV* në vend të *votoj për VV*, *telefonoj shokun* në vend të *i telefonoj shokut*, *këshilloj një mjek* në vend të *këshillohem nga një mjek* etj.

Një dukuri që ka ngjallur që moti shqetësimin e gjuhëtarëve, është rrudhja e përdorimit të së kryerës së thjeshtë, duke favorizuar rritjen e përdorimit të së kryerës (perfektit), nën ndikimin e gjuhëve perëndimore: *si ka hyrë Kurti në politikë dhe a ka qenë bashkëpunëtor i Adem Demaçit...; Më 1945 ka ardhur në Kosovë...* etj.

Ndikime të huaja vërehen edhe në rendin e fjalëve. Në shqipen e vjetër rendi i fjalëve në fjalinë kryesore ishte mjaft i lirë, por sidomos në narracion mbizotëronte rendi kallëzues – kryefjalë.<sup>35</sup> Në shqipen e sotme nën ndikimin e gjuhëve perëndimore me rend të ngulitur, ky rend erdhi duke u përmbysur, saqë rendi kryefjalë – kallëzues po merr përparësi edhe në fjalitë e varu-

<sup>34</sup> Anila Omari, Vëzhgime rreth ndikimeve të shqipes nën ndikimin e gjuhëve të huaja, SNGJLKSh, 27/1, f.234.

<sup>35</sup> Anila Omari, libri i cituar, f.236.

ra. Ndërtime të tilla, si: *ashtu siç ne duam, ashtu siç ndërkombëtarët kanë kërkuar* etj. hasen gjithnjë e më shumë.

Në rrafshin morfologjik, nën ndikimin e globalizimit, është shfaqur një prirje për ngurtësimin e lakimit të emrave të shqipes. Si pasojë e huazimit të drejtpërdrejtë nga gjuhë jooptimore, kjo dukuri është përhapur edhe në gjuhën shqipe, emrat e përveçëm të huaj, po shpeshherë edhe emrat shqip, shkruhen pa mbaresa rasore. Kjo dukuri shfaqet edhe në përdorimin e emërtimeve të shkurtuara. Pa mbaresa rasore ndeshen shkurtesa të ndryshme si: *OKB vendosi, kërkohet ndihmë për FSK* etj.

Me gjithë këto prirje të reja, për të cilat koha do të tregojë a do të arrijnë të përgjithësohen në gjuhë apo jo, në dekadat e fundit gjuha shqipe është zhvilluar me ritme të papara, leksiku i saj është pasuruar jashtëzakonisht dhe sintaksa është zhdërvjelltësuar dhe ndërlikuar shumë.

## Literatura

- Ismajli, Rexhep. *Pse të shtrohet tani dhe këtu një tematikë e këtillë?*, në Studime 20, AShAK, Prishtinë.  
 Munishi Shkumbin. *Shqipja në epokën e globalizimit*, Prishtinë, 2015.  
 Sejdiu Rugova, Linditë. *Përshatja e trajtave foljore të gjuhës angleze në gjuhën shqipe*, në Studime, AShAK, Prishtinë.  
 Omari, Anila. *Vëzhgime rreth ndikimeve të shqipes nën ndikimin e gjuhëve të huaja*, SNGjLKSh, 27/1.



Valdeta Kasapi

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup*

# PËRDORIMI I GJUHËVE NË MEDIA, VLERË DHE SFIDË E MULTIKULTURALIZMIT NË MAQEDONINË E VERIUT

## Abstrakt

*Multikulturalizmit, si term, nga shumë ekspertë të fushës i jepen disa definicione, si bashkëjetesë, disa e përshkruajnë si respektim të kulturës së tjetrit, respektim apo pranim i gjuhës së tjetrit, por parimisht multikulturalizmi vlerësohet si akt i lartë demokratik, sidomos në një shtet shumetnik e divergjent siç është Maqedonia e Veriut dhe shumë shtete tjera të Ballkanit.*

*Njerëzimi që nga fillimi i ekzistencës së tij ka pasur nevojë të përcaktojë disa rregullore që duhet të respektohen nga anëtarët e komuniteteve, me qellim që jeta e përbashkët të jetë më e pranueshme, midis vete të jenë më të qartë, për të pasur komunikim të ndërsjellë me ç'rast, të mos ketë kufij ndaj individëve të veçantë, por këto rregullore të kodifikuara të zgjerojnë mënyrën e të menduarit dhe të shprehurit.*

*Gjuha është mjeti themelor e lidhur ngushtë me karakterin e një kombi apo komuniteti. Nëpërmjet etnografisë së shprehjes shpaloset karakteri, virtyti dhe tiparet e një populli dhe të një bashkësie të caktuar shoqërore, ndërkaq që mediumi ka qenë dhe mbetet dritare e pasqyrimit të këtyre vlerave. Përmes mediumit si pasqyrë ne tregojmë sfondin kulturor dhe arsimor.*



## Hyrje

Si term, multikulturalizmi në mbarë botën është i pranuar, por jo mjaftueshëm është stimuluar apo nxitur në çdo komunitet apo shtet duke e përfshirë këtu edhe pranimin e gjuhës së tjetrit, në shumë dimensione e konkretisht në mediat e Maqedonisë së Veriut, edhe pse në mbarë rajonin,

përshëndetja e parë në gjuhën shqipe është dëgjuar mu nga Televizioni i Maqedonisë, në muajin prill, të vitit 1967, që do të thotë fillon me një paraqitje prej 10 minutash dhe atë jo çdo ditë të javës, në shekullin XX dhe deri në vitin 2002 me një zgjerim prej 9 orësh dhe deri në vitin 2012 me një program të veçantë nga komunitetet tjera, që do të thotë në dekadën e dytë të shekullin XXI arrin "kulminacionin e duhur", programor-gjuhësor, me shumë mangësi në aspektin financiar si dhe kuadrit profesional.

Në këtë shekull të globalizimit, kur ne po jetojmë, në botën mediatike, në një epokë mediatike zhvillimi i shpejtë i teknologjisë shkaktoi tronditje në botën e medias në përgjithësi. Kjo fazë u përball me mediat e papërgatitura në nivel global, veçanërisht ato elektronike, në shumë aspekte, konkretisht gjuha, kultivimi dhe ruajtja e gjuhës së standardizuar është shumë e vështirë për t'u ndjekur. Tanimë është krijuar nevoja përriorganizimindherirregullimin e mediave, si nga aspekti ligjor ashtu edhe nga ai teknologjik në media: nevojitet trajnimi i gazetarëve dhe gazetarisë në përgjithësi, sidomos në aspektin gjuhësor, gjë që është elementi më i rëndësishëm i komunikimit, ndërkohë që sot ky segment nuk theksohet apo synohet mjaftueshëm.

**Hipotezë 1:** *Shkrim-leximi gjuhësor dhe liria e fjalës me mirësjellje gjuhësore edhe ndaj gjuhës së tjetrit, ka një ndikim të fortë në forcimin e kapaciteteve dhe vlerave demokratike të medias elektronike në vendin tonë.*

**Hipotezë 2:** *Përfshirja e mediave elektronike si promovuese dhe mbrojtëse e multikulturalizmit/ interkulturalizmit, përmes gjuhës së folur dhe të shkruar në këtë periudhë globalizimi.*

Multikulturalizmit, si term, nga shumë ekspertë të fushës i jepen disa definicione, disa e trajtojnë si **bashkëjetesë**, disa e përshkruajnë si **respektim të kulturës së tjetrit**, respektim apo **pranim i gjuhës së tjetrit**, por parimisht multikulturalizmi vlerësohet si akt i lartë demokratik, sidomos në një shtet shumetnik e divergjent siç është Maqedonia e Veriut dhe shumë shtetet tjera të Ballkanit.

**Për multikulturalizmin jepet interpretim përshkrues shumëkrahësh.**

"Multikulturalizmi - është **bashkëjetesë e kulturave të ndryshme**, ku fjala "kulturë" nënkupton krijim të grupeve racore, fetare ose kulturore dhe manifestohet përmes sjelljes së përbashkët kulturore, supozimeve dhe vle-

rave, modeleve apo paraqitjes së mendimeve dhe stileve të komunikimit<sup>36</sup>, ndonjëherë shfaqet si "**pluralizëm kulturor**", si një kornizë ose metodë e organizimit të shoqërisë - e cila ndonjëherë përshkruhet si "**politika të dallimeve apo diversitetit**", "identitet në politikë", si term kryesor për politika të ndryshme të qeverisë, duke përfshirë këtu çështjen e përdorimit të gjuhës, integrimin në shoqëri, mbështetjen për festivalet kulturore dhe qendrat e komuniteteve.<sup>37</sup>

Multikulturalizmi është një ideologji që inkurajon institucionalizimin e komuniteteve me shumë kultura. Në thelb, ajo i referohet pamjes demografike të një vendi, lagje, qyteti, shkolle, organizate apo kombi. Termi multikulturalizëm mbetet 'problematic' sepse nënkupton ekzistencën e shumë kulturave të ndryshme dhe sidomos në Ballkan është e paqartë se çfarë do të thotë në thelb multikulturalizmi. Termi multikulturalizëm i referohet shumëllojshmërisë së elementeve në lojë, situatave të bashkëjetesës midis kulturave të ndryshme dhe aq, thjesht ekzistenca e shumë kulturave në të njëjtin vend apo hapësirë, ndërkaq koncepti interkulturor/ ndërkulturor është dinamik dhe domosdoshmërisht tregon një marrëdhënie, shkëmbim me një grup rrjedhash dinamike, gjegjësisht takime të individëve me origjinë të ndryshme kulturore. Interkulturalizmi thekson marrëdhëniet ndërmjet kulturave dhe domosdoshmërinë e njëra-tjetrës, ndërveprimet. Interkulturalizmi do të thotë të përballesh me problemet që lindin mes bartësve të diversiteteve kulturore, pranimin dhe respektimin e tyre. Do ta quaj urë vepruese midis kulturave të ndryshme.

Multikulturalizmin dhe interkulturalizmin i shikojmë si dy fusha të cilat duhet të trajtohen jo nga i njëjti këndvështrim.

Një nga problemet kryesore të "zbatimit" të idesë së multikulturalizmit buron ng apamjaftueshmëria e përdorimit të saktë të termit kur ai shfaqet në kontekst të diskutimit për sistemin shtetërornganjëraanë,dhejetënshoqërore nga ana tjetër. Kështu, ne mund ta diskutojmë multikulturalizmin në lidhje me marrëdhëniet pakicë-shumicë, grupet etnike të marginalizuara ose të

<sup>36</sup>Jasna Vaçovska-Nedij, Irena Rajçinovska-Pandeva, "Иднината на новинарското образование", УДК:378:070, *artikull shkencor*, 1 Shkurt, faq.221.

<sup>37</sup> <https://www.ifla.org/publications/defining--multiculturalism>, 3.3.2021,10:33h.

përfshirë të etnisë, komuniteti brenda shteteve dhe ngjashëm.<sup>38</sup>

Si term multikulturalizmi në mbarë botën është i pranuar, por jo mjaftueshëm është stimuluar apo nxitur, apo më mirë të themi se jomjaftueshëm është ndërvepruar në këtë drejtim të secili komunitet apo shtet duke e përfshirë këtu kryesisht edhe pranimin e gjuhës së tjetrit, e cila mbetet bosht kryesor identifikimi.

Gjuha është e lidhur ngushtë me karakterin e një kombi ose komuniteti. Përmes etnografisë shpaloset karakteri, virtytet dhe karakteristikat e një populli dhe të një bashkësie të caktuar shoqërore. Gjuha apo mirësjellja ndaj gjuhës apo njohja e standardeve gjuhësore është dhe do të mbetet shprehje e traditave kulturore dhe është e lidhur ngushtë me organizimin politik dhe të përgjithshëm, me traditat dhe zakonet e çdo vendi dhe populli.

Një nga faktorët që ndikon, gjithsesi, në ndërgjegjësimin gjuhësor të profileve të ndryshme sociale, është padyshim media. Vetë fjala "medium" vjen nga fjala latine "medium" që do të thotë ajo që është në mes, që përfaqëson mesin, rrugën e mesme, ndërmjetësin, një urë përmes së cilës transmetohet veprimi<sup>39</sup>. Secili prej nesh është në kontakt me median gjatë ditës, veçanërisht me median elektronike. Qytetarët dhe audienca marrin informacion për gjithçka kryesisht përmes gjuhës.

Gjuha është elementi themelor i cili i lidh kulturat e ndryshme, qoftë ajo e folur, e shkruar, gjuha e simboleve etj, në shumë dimensione edhe pse në mbarë rajonin, përshëndetja e parë në gjuhën shqipe është dëgjuar mu nga Televizioni i Maqedonisë, në muajin prill, të vitit 1967, që do të thotë fillon me një paraqitje prej 10 minutash dhe atë jo çdo ditë të javës, në shekullin XX dhe deri në muajin gusht të vitit 2002<sup>40</sup>, me një zgjerim prej 9 orësh

<sup>38</sup> Milan Mesiq: Multikulturalizmi: Sfidat sociale dhe teorike, Zagreb 2006, faq. 189,190.

<sup>39</sup> A. Pajaziti, *Fjalori i sociologjisë*, Logos-A&SEEU, Shkup, 2009, fq.392;

<sup>40</sup> "Në gusht të vitit 2002, dy ditë pas fillimit të fushatës zgjedhore, programi në gjuhën shqipe në MTV 3 papritmas u zgjerua nga dy orë e gjysmë në nentë orë përditë, në bazë të aplikimit të rregullave të Marrëveshjes së Ohrit. Marrëveshja Bazë e Ohrit fton bashkësinë ndërkombëtare të promovojë mediat në gjuhët e komuniteteve të ndryshme etnike". Përgatitur nga Ana Karlsrajter, *Mediat në shoqëritë shumë-gjuhësore, Liria dhe përgjegjësia*, Vienë, 2003, Tanja Popoviç, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, fq. 32.

duke anashkaluar më pas edhe një dekadë të tërë, që në muajin tetor të vitit 2011 të mundësohet kanal i veçantë<sup>41</sup> nga komunitetet tjera edhe ai satelitor që do të thotë në shekullin XXI arrihet "kulminacioni i duhur" programor-gjuhësor, me shumë mangësi në aspektin e kuadrit profesional dhe të financave. Kjo ndodh në RTVM ku 'parapagues direkt' janë të gjithë qytetarët e vendit, pa dallim etniteti, feje dhe kulture.

"Shoqëria kulturore maqedonase para demokratizimit kishte një fobie, madje ndonjëherë edhe paradoksale"<sup>42</sup> thotë Aleksandar Çomovski dhe sa i përket fillimit të redaksisë shqipe në RTVM ai deklaroi: "Ato ishin shenja respekti për barazinë e kontrolluar pa ndonjë shpërthim të veçantë indigjen. Se nuk kishte ndershmëri në njëfarë mënyre tregoj nga fakti se, si tani për një kohë të gjatë, gërshetimi kulturor i krijimeve, rrallëherë ishte një motiv për informacion të përbashkët. Çdogjë ishte e izoluar personalisht dhe mendoj se është rezultat i fillimeve të viteve 70, thjesht, ishte një shqiptarofobi klasike"<sup>43</sup>.

Ndërkohë që "shtetet duhet të zhvillojnë politika me të cilat do ta zbatojnë përdorimin e gjuhëve të pakicave në mediumet elektronike. Politika duhet të bazohet duke i analizuar dhe vlerësuar nevojat e përfaqësuesve të pakicave që të ruhet dhe zhvillohet identiteti i tyre"<sup>44</sup>

Ndryshe, në Maqedoninë e Veriut, për herë të parë thyhen barrierat e bilingualitetit kur njësinjal televiziv nga Shqipëria të vinte në Maqedoninë e Veriut, ishte pikërisht sinjali i parë i TV Alsat në satelit dhe sinjali për herë të parë fillon transmetimin në vitin 2004, në Shkup, ndërsa si televizion ka ekzistuar, që nga vitin 2003 në Shqipëri. Edhe pse "mbështetja nga ana e qeverisë çdokund është e rëndësishme parësore që të mbijetojnë mediat në gjuhë të ndryshme si dhe institucionet shtetërore duhet të jenë të vetëdijshme për përgjegjësinë e tyre dhe të krijojnë kushte në korniza juridike"<sup>45</sup>, të cilat do të

<sup>41</sup>Intervistë e realizuar: Harun Ibrahim, dhjetor 2021, Shkup.

<sup>42</sup>Intervistë e realizuar: Aleksandar Çomovski, tetor 2021, Shkup.

<sup>43</sup> Ibid. Aleksandar Çomovski, tetor 2021, Shkup.

<sup>44</sup>"Насоки за употреба на малцинските јазици на радио и телевизија", Октомври, 2003, ISBN 10: 90 - 7598908 - 3 ISBN 13: 978 - 90 - 75989 - 08 - 3, faq 8.

<sup>45</sup> "Duke ndjekur shembullin e Zvicrës, Luksemburgut, Finlandës dhe Danimarkës duhet shqyrtuar mekanizmat e mbështetjes indirekte siç janë politika tatimore dhe shpenzimet

jenë të përshtatshme për mediat në gjuhë të ndryshme<sup>46</sup>. Duhet hulumtuar mundësitë për të definuar rregulloret ligjore që do të sjellin diskriminimin pozitiv<sup>47</sup>, megjithatë, ky medium (TV Alsat) nuk kishte ndihmesë nga institucionet vendore<sup>48</sup> dhe u ballafaqua me shumë sfida dhe peripeci, thotë kryeredaktori i këtij medium, Admir Qose. "Në fokus nuk ka qenë vetëm informimi, shpalosja e kulturës, arsimit, veshja dhe traditat si dhe të drejtat tona. Kërkonim barazi, ndërkohë që, nga viti 2006 dëgjonim nga autoritetet maqedonase, sidomos në periudhën e Gruevskit frazat "proshiruvanje na pravata, na çoveckite prava"<sup>49</sup>. Nuk është zgjerim, ne kemi lindur këtu dhe janë këto të drejta natyrore që lindin me njeriun. Ne kemi përmbushur ligjin dhe nenet e Kushtetutës së vitit 1991 dhe hiç më tepër se kjo. Sipas tij: Ne kemi demaskuar këtë të metë"<sup>50</sup>.

Nuk duhet harruar edhe marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat civile e politike si dhe Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe liritë themelore të njeriut ku garantohet liria e të shprehurit pa mare parasysh kufijtë<sup>51</sup>, gjithashtu në "deklaratën e KB për minoritetet në nenin 4(1) thek-

postare në mënyrë që t'i mundësohet veprimi i pavarur i mediave", Frajmut Duve, *Mediat në shoqëritë shumë-gjuhësore, Liria dhe përgjegjësia*, Vjenë, 2003, faq.11.

<sup>46</sup> Ibid, "Komiteti i ministrave evropian rekomandon që shtetet anëtare të OSBE-së se organet nacionale përgjegjëse për dhënien e lejeve për emetues privat duhet kujdes të veçantë në promovimin e pluralizmit në medime gjatë realizimit të misionit të tyre. (Shtojcë e rekomandimit Nr.P(99) 1 për promovimin e pluralizmit në medime, neni 1, Rregullimi i pronësisë: emetim programi dhe shtypi). Dokumenti i Gjenevës i OSBE-së, Kreu VII, kërkon mbështetje të veçantë nga shteti për informim adekuat të medimeve elektronike, me qëllim të planifikimit të programit, mes tjerash identitetin e gjuhës së minoriteteve".faq 29.

<sup>47</sup>Përgatitur nga Ana Karlsrajter, *Mediat në shoqëritë shumë-gjuhësore, Liria dhe përgjegjësia*, Vjenë, 2003.

<sup>48</sup> "Politika shtetërore duhet të japë mbështetje shërbimit publik, radios dhe televizionit e cila realizon një game të gjerë dhe balansuese të programeve informative, arsimore, kulturore dhe zbavitëse me kualitet të lartë, midis tjerash, të mbështet nevojat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare," *Насоки за употреба на малцинските јазици на радио и телевизија*, Октомври, 2003.

<sup>49</sup> Intervistë e realizuar: Kryeredaktor i TV Alsat, Admir Qose, dhjetor, 2021, Shkup.

<sup>50</sup> Ibid. Admir Qose.

<sup>51</sup> "Насоки за употреба на малцинските јазици на радио и телевизија", Октомври, 2003, ISBN 10: 90 - 7598908 - 3 ISBN 13: 978 - 90 - 75989 - 08 - 3, faq.25.

sohet se shtetet duhet të marrin masa ku është e nevojshme, të sigurojnë përdorimefektivitetëdrejtavenjerëzoretë minoriteteve"<sup>52</sup>.

Në këtë shekull të globalizimit, ku zhvillimi i shpejtë i teknologjisë shkaktoi tronditje në botën e medias në përgjithësi ndryshoj shumëçka. Çdokush mund të informohet për të drejtat e njeriut në mbarë botën, për të drejtat kushtetuese të çdokomuniteti, krahasuar me mëparëkurnukkishte qasje në shumë institucione relevante kyçe të shtetit. Vetë fakti i arritjes satelitore nga Tirana në Shkup në atë periudhë dëshmon se përparimi shpejt i teknologjisë ka lehtësuar dhe ka krijuar mundësinë e qasjes në shoqëri. "Valëzimi demokratik në Maqedoninë e Veriut, në të vërtetë nënkuptonte thyerjen e centrizmit monoetnik dhe të raportit kulturor, ndërkohë, shqiptarët arritën një periudhë të vetë emancipimit, si në aspektin kulturor, arsimor dhe civilizues. Ajo tendencë është një ngarkesë. Shoqëria maqedonase nuk ishte ende gati dhe as tani mendoj se nuk është e gatshme për të ashtuquajturin multikulturalizëm apo interkulturalizëm"<sup>53</sup>, pavarësisht që sipas nenit 6, të Marrëveshjes së Ohrit, "Kultura, arsimit dhe përdorimi i gjuhës", thuhet se: "Palët ftojnë bashkësinë ndërkombëtare duke përfshirë dhe OSBE-n, ta shtojnë ndihmën e tyre ndaj projekteve në sferën e mediave, për forcimin e mëtejshëm të mediave radio, televizione dhe të shtypura duke përfshirë mediat në gjuhën shqipe dhe mediat multi-etnike. Palët njashtu ftojnë bashkësinë ndërkombëtare të zgjerojë programet profesionale të mediave për trajnimin e pjesëtarëve të komuniteteve që nuk janë shumicë në vend"<sup>54</sup>, gjithashtu edhe sipas Statutit Evropian për Gjuhët kërkohet që "shtetet anëtare të lehtësojnë aksesin deri te veprat e krijuara në gjuhët rajonale ose të pakicës duke u mundësuar përkthimin, dublimin, post-dublimin dhe nëntitrimin, dhe nëse është e nevojshme të bëhet edhe inkurajimi dhe financimi i shërbimeve kërkimore për përkthim dhe terminologji".

Se ky rrugëtim i quajtur interkulturalizëm mbetet me pak shpresë dhe e njëanshme, këtë e dëshmon edhe kryetari i Shoqatës së Gazetarëve në Maqedoninë e Veriut, Mlladen Çadikovski, icili thotë se "nuk ka vullnet për ta

---

<sup>52</sup>Ibid, faq 27.

<sup>53</sup>Ibid. Aleksandar Çomovski, tetor 2021, Shkup.

<sup>54</sup>Tanja Popoviç, *Mediat në shoqëritëshumë-gjuhësore, Liria dhe përgjegjësia*, Vjenë, 2003, faq,24.

inkuadruar gjuhën shqipe në televizionet maqedonase në vend", pavarësisht arsyeve të cilat i japin, aspektin ekonomik, teknologjik, kuadrin etj. Sipas sÇadikovskit, i cili është njëkohësisht edhe kryeredaktor i TV 24, "janë fokusuar te gjuha e simboleve për të cilën 'luftoj' që të grumbullojmë financa që kjo të mos ndërpritet", ndërkohë që gjuhën e dytë zyrtare siç është shqipja e që sipas tij është i nevojshëm titrimi, megjithatë nuk ka iniciativë, si dhe nismën e këtij hapi e sheh sëpari tek servisi publik.

Si regjisorë kryesorë, por edhe aktorë që drejtojnë këto procese vërtet kyçe, shfaqen patjetër organet e pushtetit por edhe vet mediat në vendin tonë veçanërisht televizionet, të cilat historikisht tregojnë një ndikim serioz në shoqëri dhe në publik.

Kur flasim për një vend si Maqedonia e Veriut, një vend multi-etnik që përfshi ndisa kultura gjuhësore dhe mosnjohja e gjuhës dhe kulturës së tjetrit i nxjerr në pah, shfaq dhe përhap paragjykimet dhe stereotipat, nga të cilat më pas vjen përhapja e jotolerancës, etnocentrizmi, etno-nacionalizmi, sigurisht i bazuar në injorancën e kulturave të tjera nga shoqëria e tyre. Një komentues maqedonas në vitin 2000 thekson: "Ne nuk kemi gjuhë të ur-rejtjes por kemi gjuhë të frikës. Nuk e dimë çka shqiptarët mendojnë sepse nuk e dimë gjuhën e tyre. Ashtu që ata na frikojnë neve (...)." <sup>55</sup> Meqenëse jetojmë në shekullin XXI shekullin e globalizimit dhe konsiderohemi një vend pluralist me kapacitet edhe vlera demokratike, masat duhet të merren përmes arsimit dhe mediave dhe asnjë hapësirë nuk duhet të lihet për thellimin e këtyre problemeve. Ambiciet tona për të ruajtur dhe krijuar një gjuhë të rrjedhshme, sipas rregullave gramatikore, njohja e gjuhës së tjetrit janë tregues të fortë dhe bindës se ne zhvillojmë njëkohësisht kulturën gjuhësore me të cilën do të ngremë nivelin e komunikimit, që është një nevojë vërtet serioze në kohët e fundit, kohë globalizimi, veçanërisht në vendet që ushqejnë multikulturalizmin dhe shumëgjuhësinë.

Ideja e multikulturalizmit po vjen ngadalë në jetë me jetën tonë pas, (migrimi ekonomik, social, politiketj) dhe para interkulturalizmit në arsim

---

<sup>55</sup>Mark Thompson, *Slovenia, Croatia, Bosnia and Herzegovina, Macedonia (FYROM) and Kosovo. International Assistance to Media* (Vienna: OSCE Representative on Freedom of the Media, 2000), 6, thirrur: *Mediat në shoqëritë shumë-gjuhësore Liri dhe përgjegjësi*, Vienë, 2003, faq. 38.



ka ende detyra të mëdha për tu bërë. Kjo fushë është sfida më e madhe pedagogjike sot. Si në historinë e saj të re gjermane në traditat e saja të edukimit, duke kërkuar zgjidhje të mundshme, nuk duhet të marrim pa kritikë përvojat e huaja, por të zhvillojmë atje zgjidhjet tona, bazuar në besimin tonë dhe në nevojat tona kulturore e kombëtare shekullore. Detyra e parë dhe kryesore është të zhvillojmë vetëdijen për veten dhe për qenien kulturore, kombëtare, gjuhësore dhe fetare, sepse do të mësojmë të njohim dhe duam tonat, të mësojmë të respektojmë edhe të tjerët<sup>56</sup>.

## Përfundimi

Të vetëdijshëm se ne po jetojmë në botë mediatike, në një epokë mediatike, dhe kjo fazë u përball me mediat e papërgatitura në nivel global, veçanërisht ato elektronike, e veçmas në vendin tonë, në shumë aspekte, konkretisht gjuha, kultivimi dhe ruajtja e gjuhës së standardizuar është shumë e vështirë për t'u ndjekur. Tanimë është krijuar nevoja për riorganizimin dhe ri rregullimin e mediave, si nga aspekti ligjor ashtu edhe nga ai teknologjik në media: nevojitet trajnimi i gazetarëve dhe gazetarisë në përgjithësi, sidomos në aspektin gjuhësor, gjë që është elementi më i rëndësishëm i komunikimit, ndërkohë që sot ky segment nuk theksohet apo synohet mjaftueshëm.

Multikulturalizmi, ideali i një jete harmonike të grupeve me kultura të ndryshme në kontekstin e një shoqërie pluraliste, ka qenë një parim formues i strukturës sociale dhe zhvillimit të vendeve demokratike që nga vitet 1970. Megjithatë, multikulturalizmi nuk është vetëm një teori e re, e cila e percepton diversitetin aktual kulturor si një pasuri shoqërore, por edhe një kornizë e re politike për vendosjen e marrëdhënieve shoqërore në të cilat kulturat e ndryshme mund të zhvillojnë lirisht identitetet e tyre, duke marrë pjesë në të njëjtën kohë në forcimin e përbashkët shoqëror dhe institucionet kulturore.

Duhet të përmendim se shumëgjuhësia është një kriter për BE-në. Sistemi mediatik dhe zhvillimi i medias janë shumë të lidhura me përparimin kulturor dhe arsimor të një komuniteti, të popullit, por edhe të një shteti, veçanërisht në rastin e Maqedonisë së Veriut. e cila si shoqëri multikulturore

---

<sup>56</sup>Ana Sekuliq-Majurec: Interkulturalizmi në arsim- bazat e shoqërisë multikulturore, faq. 683-685

mban në pëllëmbë të dorës varietete të shumë kulturave, traditave dhe mentaliteteve. Toleranca e ndërsjellë mes këtyre subjekteve dhe lidhja e tyre e çon vendin shumë hapa përpara në rrugën e demokratizimit arsimor, kulturor dhe mediatik.

*Ëndrra ime do të jetë një shoqëri multikulturore, një shoqëri e larmishme ku çdo burrë, grua dhe fëmijë të trajtohen në mënyrë të barabartë. Unë ëndërroj për një botë ku të gjithë njerëzit e të gjitha racave punojnë së bashku në harmoni. - Nelson Mandela*

## Bibliografi

- Bosna i Hercegovina, Vijeće ministara (2006) Strategijaintegriranjabaosne i Hercegovine u Evropsku uniju, Direkcijazaevropskeintegracije, faq. 1. - 198.; URL: [www.dei.gov.ba/bih\\_i\\_eu/najvazniji.../dokumenti\\_direkcije/?id=2620](http://www.dei.gov.ba/bih_i_eu/najvazniji.../dokumenti_direkcije/?id=2620)(ožujak,
- Baçovska-Nediq** Jasna, Rajčinovska-Pandeva Irena, "Иднината нановинарското образование", УДК:378:070, *Artikull Shkencor*, 1 shkurt.
- Karlsrajter** Ana, Popoviç Tanja, *Mediat në shoqëritë shumë-gjuhësore Liriad-hepërgjegjësia*, Vienë, 2003.
- Mesiq** Milan: *Multikulturalizmi: Sfidat sociale dhe teorike*, Zagreb 2006.
- Mark** Thompson, *Slovenia, Croatia, Bosnia and Herzegovina, Macedonia (FYROM) and Kosovo. International Assistance to Media* (Vienna: OSCE Representative on Freedom of the Media, 2000), 6
- Pajaziti** Ali, *Fjalori i sociologjisë*, Logos-A&SEEU, Shkup, 2009
- Sekuliq-Majurec** Ana: *Interkulturalizmi në arsim–bazat e shoqërisë multikulturore*.
- Vlada Republike Hrvatske (2011) *Izvešće o ispunjavanju obveza iz Poglavlja 23. „Pravosuđe i temeljna prava“*, Zagreb, str. 1. - 67.; URL: <http://www.mvep.hr/custompages/static/hrv/files/pregovori/5/p23.pdf> (veljača, 2014). <http://pecanik.net/sto-je-zapravo-multikulturalizam/>
- "Насоки за употреба на малцинските јазици на радио и телевизија", Октомври, 2003, ISBN 10: 90 - 7598908 – 3 ISBN 13: 978 - 90 - 75989 - 08 – 3
- Për informatashtesë: Office of the High Commissioner on National Minorities Prinsessegracht 22, 2514 AP The Hague.
- <https://www.ifla.org/publications/defining--multiculturalism,3.3.2021>
- Intervista të realizuara:
- Admir Qose, dhjetor, 2021, Shkup.
- Aleksandar Çomovski, tetor, 2021, Shkup.
- Mladen Çadikovski, dhjetor, 2021, Shkup.

Afërdita Abdullahi

Instituti Albanologjik i Prishtinës

# GJUHA E TË RINJVE TË KOSOVËS NË EPOKËN E GLOBALIZIMIT

## Abstrakt

*Tashmë është bërë i dukshëm fakti i përdorimit gjithnjë e më shpesh i termit globalizëm. Duket se bota në të cilën jetojmë, këto dekadat e fundit, po na paraqitet ndryshe, në kuptimin se po shfaqet një "sistem i ri" botëror. Kjo duket në të gjitha marrëdhëniet si; politike, ekonomike, kulturore, etj. dhe ka bërë që raportet e ndërvarësisë në mes të shoqërive të vinë gjithmonë e në rritje, kështu që ngjarjet nënjëpjesë të botës, ku më shumë e ku më pak, tëndikojnë në njerëzit dhe në shoqëritë e tjera.<sup>57</sup> Globalizimi dhe proceset integruese kanë ndikuar edhe në diskurset e shqipes, duke i reflektuar të gjitha këto procese ekonomike, politike dhe kulturore nëpër të cilat po kalon shoqëria shqiptare.<sup>58</sup>*

*Edhe gjuha shqipe, është ajo e cila nuk mundi t'i shpëtoi globalizimit. Ndikimi i gjuhëve të huaja është shumë i dendur, sidomos ndikimi nga anglishtja tek të rinjtë. Ajo që na shqetëson më shumë për gjuhën, është gjuha standarde dhe ndikimi nga gjuhët e huaja, ku dhe gjuhën në këtë epokë e shohim si një mjet komunikimi. Trajtimi im është gjuha e të rinjve, e cila në ndikimin e gjuhëve të huaja, ka sjellë edhe shumë fjalë të reja në të folmen e përditshmërisë dhe të rrugës, dhe në shkrimet që bëhen nëpër portale dhe rrjete të ndryshme sociale, pra me anë të gjuhës së folur dhe asaj të shkruar.*



---

<sup>57</sup> Mimoza Kore, *E ardhmja e shqipes standarde në proceset integruese*. Seminari ndërkom-bëtar përgjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë 2008, f. 263.

<sup>58</sup> Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Prishtinë 2015, f. 29.

## Gjuha e të rinjve sipas disa studiuesve

Çështja e ndikimit të gjuhës angleze në gjuhën shqipe, padyshim se është parë e trajtuar edhe nga studiuesit tanë. Sipas studiueses Shefkije Islamaj, rezultatet e projektit *WebCharacterization* të OCLC-së 4 të realizuar në vitin 2002, deri 72% e përmbajtjeve tekstore në sajte janë në gjuhën angleze, 7% në gjuhën gjermane, 6% në gjuhën japoneze, 3% në spanjishte e 3% në frëngjishte dhe 9% në të gjitha gjuhët e tjera të globit<sup>59</sup>. Kur i kemi parasysh këto shifra, tash pas kaq shumë vitesh, me plot gojë mund të themi se anglishtja është gjuhë "zyrtare". Në këtë kontekst të ri të krijuar duhet pasur parasysh ndikimin e anglishtes si gjuhë globale, ndikim ky që shfaqet pothuajse në të gjitha gjuhët e botës. Po ashtu, me një shtrirje së fundi dhe përmes artit, sidomos muzikës, sportit, lëmin e medimeve, dyqaneve, restoranteve, teknologjisë etj. Slengu i Prishtinës po ndikohet në masë të madhe nga anglishtja si gjuhë lingua Franca. <sup>60</sup>Për të njëjtin ndikim të anglishtes në shqipe edhe studiues Munishi tregon se si në Kosovë, anglishtja ka hyrë në rrugë të ndryshme. Pas vitit 1999, ajo ka ardhur si gjuhë e misionit (mision language – sh.m) bashkë me misionet ndërkombëtare, të cilat qenë vendosur pas përfundimit të luftës, si dhe përmes organizatave, programeve e projekteve të ndryshme të asistencës teknike, të cilat kishin si qëllim të ndihmonin për ngritjen dhe për zhvillimin e burimeve njerëzore të institucioneve qeveritare.<sup>61</sup>

Ndërkaq, në anën tjetër për këtë fenomen shoqëror, studiuesi i shquar, Gjovalin Shkurtajt hekson se ; na kërcënon rreziku i një "shqipanglitalishteje", siç e quan ai, prandaj në qoftë se nuk duam që një shqipe e përçudnuar të përçudnojë edhe mendjen e shqiptarëve, duhet që shteti dhe krejt shoqëria e qytetëruar shqiptare të shkunden nga letargjia dhe të dalin nga mjegullnaja e kësaj shqipanglitalishteje që rrezikon të na kaplojë."<sup>62</sup>

<sup>59</sup>ShefkijeIslamaj, Aspekti gjuhësor i globalizimit dhe shqipja standarde, Seshioni shkencor në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 2008, Prishtinë.

<sup>60</sup>Rinor Matoshi, Sociolinguistika shqipe për slengun, (Shembulli i Prishtinës), Shkup, 2019, f.58.

<sup>61</sup>Shkumbin Munishi, Shqipja në epokën e globalizimit, Prishtinë, 2015, f. 47

<sup>62</sup>Gjovalin Shkurtajt, Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe, Tiranë, 2003, f.78.

Ky fenomen më së shumti vërehet nga të rinjtë, të cilët nëmasë të madhe po e përdorin gjuhën angleze duke filluar nga adoleshentët. Kjo gjuhë, është e përdorur në shumë rajone të Kosovës, mirëpo konsiderohet që Prishtina është nismëtare e këtij lloj komunikimi, të pranuar dhe tashmë e bërë gjuhë standarde e të urbanizuarve apo siç i quajnë "underground tipave". Gjuha e komunikimit nga të rinjtë ka ndikuar, sidomos nga përdorimi i shumtë i rrjeteve sociale, ku del me veçanti të shumta dhe me ndikime të gjuhëve të huaja, duke sjellë edhe shumë fjalë të reja në të folmen e përditshmërisë dhe të rrugës, po ashtu edhe në shkrimet që bëhen nëpër portale dhe rrjete të ndryshme sociale.

Zhvillimi i të gjitha këtyre fushave sidomos të atyre shoqërore, mediale, kulturore etj., ka bërë që këto huazime të jenë gjuhë e komunikimit ndërkombëtar. Shqetësim shumë i madh për gjuhën është ndikimi i globalizimit në komunikimin elektronik, ku çdo ditë e më shumë po e rrezikon shqipen nga mbytja e fjalëve të huaja, por edhe nga gabimet e natyrave të ndryshme dhe të pakuptimshme nga shqipja standarde. Ky komunikim i cili zakonisht përdoret më shumë nga të rinjtë, ka ndikim të madh gjuhësor.

Rrjetet sociale në përgjithësi kanë një ndikim të madh të standardit të gjuhës në fushën leksikore, fonetike dhe sintaksore. Nuk ka rëndësi se si shkruajmë apo komunikojmë, por vetëm që fjalët e përdorura të jenë aty ku është e nevojshme.

Nga komunikimi elektronik marrim informata të ndryshme, kemi kontakte me gjuhë të ndryshme të botës. Tash, në shumë faqe të rrjeteve sociale kemi programe të përkthyer në gjuhën shqipe, ku sado pak na lehtëson përdorimin e tyre, sidomos për ata njerëz të cilët nuk i njohin gjuhët e huaja.

Në kërkimet tona, sidomos nga fjalori i të rinjve, kemi hasur huazime të panevojshme të përdorura të fjalëve të huaja, ku në disa forma gjuhësore dalin edhe me shkurtesa të shumta. Në shumicën e rasteve, flasim apo shkruajmë vetëm në gjuhën angleze, por ka raste edhe kur përdorin vetëm ndonjë fjalë, jo do të thotë të gjithë fjalinë. Sip.sh:shkurtesa e fjalës *ok*, e cila është shumë e shpeshtë dhe përdoret shumë, në vendqetë përdorin fjalën shqipe në rregull, ose mirë.

*Cool*, (që do të thotë je shumë fantastik, i qetë, i ftohtë). Për shembull; *Je shumë cool*. Po dukesh shumë cool. Fjala *like*- (pëlqej); tek adoleshentët e

hasim fjalën e përdorur llajkma, p.sh., *Njeri llajkma foton që e qita*, në vend që të thonë shok ose shoqe, pëlqema foton. Kur disa të rinjve, ju pëlqen ndonjë vajzë, gjithmonë shprehen me fjalën **baby** apo **sweety**; p.sh., *Ua, ti baby koke shumë sweety a!* D.m.th. e dashur, e ëmbël.

Po ashtu, përdorin edhe fjalën **in** (i kohës); shembull; *Kjo çika koka shumë in*. Kur duan të bëjnë ndonjë kompliment, përdorin fjalën **nice**; për shembull, *Po dukesh nice*, në vend të shprehjes po dukesh bukur.

Boma **add**- për më prano, e përdorin kur duan të kenë edhe një shok në rrjetin social, d.m.th. ta pranojnë për shok. Kur duan të mos e tregojnë veten sidomos në rrjetin Fejsbuk, përdorin diçka që nuk është e vërtetë dhe me shkurtesa të fjalëve. P.sh., *Me fb fake (fejk) ish* – d.m.th. nuk është fejsbuku i vet, nuk është i vërtetë, nuk është ai person. Termi i përdorur me shkurtesën *Bro (brother), kshyreni foto flesh*, në vend që të thuhet vëlla shikoje foton shpejt. **Just a minute** – në vend që të përdorin fjalën shqipe, prit një minutë. Në këtë fjali, kemi gjithë fjalinë e plotë të përdorur në gjuhën angleze.

Poashtu, ndeshim termin, **Be rigback**; me shkurtesën e përdorur (**brb**), d.m.th. kthehem menjëherë. Fjala **before** me shkurtesën (b4); për ty .

Tek përshëndetjet e adoleshentëve, gati se gjithnjë hasim përdorimin e fjalës ; **Seeyou**, por në të shumtën e rasteve përdorin më shumë shkurtesën (**cu**);- d.m.th. për fjalën shihemi, mirupafshim. Por, ka raste kur e përdorin edhe fjalën **bay**- për mirupafshim. Te termi **Bestfriends**, përdorin shkurtesën (bf)- në vend që të përdorin fjalën miku më i mirë. Një i ri, kur dëshiron që të fshij diçka përdor fjalën **delete** (dillite), në vend të fjalës fshije. Shoqet zakonisht, kur organizojnë që të shkojnë në ndonjë ndejë, i drejtohen njëra tjetrës me fjalët; **Baby**, a je për me shku sonte nënighclub?. Në vend që shoqe, a po shkojmës onte në ndejë apo (klub nate). Fjala baby ka kuptime të ndryshme, në shqip do të thotë bebe (foshnjë), mirëpo të rinjtë e përdorin në mënyra të ndryshme, ku beby i thonë shoqes, bebes etj.

Kemi edhe shumë e shumë shembuj të tjerë të anglicizmave ,të përdorur edhe në muzikën e të rinjve ,sidomos në muzikën e quajtur rep; si; **nice, baby, sweety, love, brother, sister**, etj.

Kështu që, këto dukuri shoqërore, me ndasi e dallime, janë më problematike për shoqërinë dhe më së shumti për rininë tonë kosovare. Edhe pse

fjalor, ndikime dhe huazime të fjalëve të huaja nuk dyshohet që gjithmonë do të ketë, ashtu sikur edhe ka pasur, mirëpo përvetësimi dhe shfrytëzimi i tyre çdokund, e veçmas në institucione të rëndësishme publike, mendoj që nuk është e pëlqyer. Prandaj, përpjekja për një kulturë të zhvilluar gjuhësore që parakupton në rend të parë respektin dhe kujdesin jo vetëm për gjuhën, po edhe për trashëgiminë tonë intelektuale në tërësi, është kusht qenësor për të ardhmen tonë gjuhësore dhe për të ardhmen tonë kulturore në përgjithësi.

Si përfundim, do të theksoja që kjo gjuhë komunikuese e të rinjve, por edhe nga kategoritë e ndryshme në internet dhe rrugë, tregon për mos njohuritë që posedojmë si shoqëri në njohjen e një standardi gjuhësor si nëpër portalet e ndryshme por edhe në komunikimin në rrugë. Prandaj këto pakujdesi në aspektin gjuhësorë, e jo vetëm tek të rinjtë, por edhe të kategoritë e tjera, ka sjellë deri tek një pakujdesi në shkrim dhe komunikim të gjuhës.

E megjithatë, të gjitha këto dukuri, e veçmas e folura dhe e shkruara e këtyre të rinjve, të lë për të menduar, se sa do të mund ta flasin dhe të shkruajnë ndonjëherë gjuhën e pastër shqipe, a do të munden ti largojnë fjalët e huaja nga fjalori? Çfarë do të bëjnë ata mbas një moshe, si do ta rikthejnë të folurit normal, dhe sa do ti largojnë fjalët e mbrapsura, ngase kur përdoret një gjuhë si në të folurën, po ashtu edhe në të shkruarit me fjalë të huazuara atëherë ato vetëm se janë përvetësuar dhe ngelin në mendjen e tyre, mirëpo të gjitha këto mbesin të shikohen me kohën. Me shpresë, që mos të përdorën fjalët e huaja, por vetëm fjalët e gjuhës sonë të bukur shqipe.

## Literatura

**Gjovalin** Shkurtaj, Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe, Tiranë 2003.

**Shefkije** Islamaj, Aspekti gjuhësor i globalizimit dhe shqipja standarde, Sesioni shkencor në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 2008, Prishtinë.

**Shkumbin** Munishi, Shqipja në epokën e globalizimit, Prishtinë, 2015.

**Mimoza** Kore, E ardhmja e shqipes standarde në proceset integruese. Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë 2008.

**Rinor** Matoshi, Sociolinguistika shqipe për slengun, (Shembulli i Prishtinës), Shkup, 2019.

**Edona Jahiu**

*Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës*

# VËSHTRIMET AKTUALE TË REXHEP ISMAJLIT PËR SHQIPEN NË KONTEKST BALLKANIK

## Abstrakti

*Ky punim ofron një përmbledhje të pikave kryesore të veprës studimore të vitit 2015 nga Rexhep Ismajli lidhur me pozitën, veçoritë fonetike, shkallën e përkimeve leksikore e gramatikore të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike. Sado me dokumentim të reduktuar, ai bën një vështrim tipologjik të kujdesshëm të fakteve gjuhësore, për t'i shfaqur më qëndrueshëm aspektet ku ka (mos)përputhje mes këtyre gjuhëve. Do të analizohet se si Ismajli shfrytëzon mjeshhtërisht botimet ekzistuese të shumë studiuesve vendës e ndërkombëtarë, por edhe evidencat arkeologjike, gjeografike e mitologjike, për të arritur përfundime më të përforcuara lidhur me burimin origjinal të ballkanizmave, e duke mbushur kështu boshllëkun e një fushe të etur për studim, me anë të përditësimit dhe përkrahjes së hipotezave të shumëgjashme. (Mos)përkimet relevante në kontekst janë trajtuar me mprehtësi. Studimi i tij ka shënuar ngritje cilësore në hapjen e dyerve për ta shoshitur më tej këtë temë komplekse.*

**Fjalët kyçe:** *kontekst ballkanik, gjuhët e Ballkanit, përkime gjuhësore, hipoteza të shumëgjashme*



## Hyrje

Historia e ballkanistikës në një pjesë të mirë të saj lidhet me atë të gjuhëve indoevropiane, përkatësisht zhvillimet diakronike të gjuhëve të afra gjeografikisht dhe kulturalisht, siç është rasti i gjuhëve që fliten në Gadishullin Ballkanik shekuj me radhë. Kjo, sepse në një ndarje të përbashkëte më



tëgjjerë, që të gjitha ato i përkasin grupit të gjuhëve indoevropiane. Ndër to është edhe gjuha shqipe, e cila, bazuar në zhvillime fonetike e morfo-sintaksore, megjithëse e dokumentuar vonë, konsiderohet pasardhëse e njëres nga gjuhët më të lashta të Ballkanit.

Pas vërtetimit shkencor të përkatësisë në gjuhët indoevropiane më 1854 nga Franc Boppi, shqipja është vënë nën llupën e shumë studiuesve botërorë për t'ia gjetur vendin apo degën adekuate, varësisht rregullsive gramatikore e fonetike përkuese mes gjuhësh simotra, e atyre që janë të veçanta për të, të cilat në rrjedhë të kohës kanë sjellë format e sotme. Kjo, për shkak të asocial-cioneve më të afra mes disa prej tyre, strukturës së ngjashme paradigmatiske emërore e foljore. P.sh. megjithëse të gjitha janë pjesë të familjes indoevropiane, gjuhët neolatine kanë më shumë të përbashkëta në krahasim me ato sllave. Shqipësi i është kushtuar kjo vëmendje, jo për ndonjë interes të madh në gjetjen dhe interpretimin e formave gjuhësore, por gjatë analizës së çështjeve që lidhen me gjuhët indoevropiane e ballkanike.

Arsyeja e një degëzimi të pëртеjmë të gjuhëve indoevropiane është zhvillimi paralel e njëkohësisht ndërndikimi reciprok mes tyre, i cili ka shkaktuar përkime mjaft të vëреjtshme dhe me interes për t'u studiuar. Është e nënkuptueshme se lidhjet historike, gjeografike, kulturore e bashkëpërkimet e tjera i kanë dhënë shkas shfaqjes apo bartjes së këtyre veçorive, por gjithsesi duhet siguruar një gjykim më i mbështetur e më i precizuar për të arritur në përfundimetë qëndrueshme.

Këto kontakte i kanë lënë gjurmët në pothuajse të gjitha sferat. Për këtë arsye, studiuesit janë vënë në kërkim të burimit të këtyre ngjashmërive të manifestuara edhe në gjuhë, duke u nisur nga veçoritë morfo-sintaksore deri tek ato fonetike. Në kuptim të ngushtë, gjuhë ballkanike sipas Ismajlit janë: shqipja, greqishtja, maqedonishtja, bullgarishtja, arumanishtja, meglenorumanishtja, rumanishtja jugdanubiane, torllakishtja, turqishtja evropiane, megjithëse edhe disa gjuhë sllave i kanë këto dukuri në gjuhët e tyre.

Disa qëndrime lidhur me burimin e këtyre përkimeve të pazakonta janë pranuar me rezerva, sepse janë konsideruar subjektive, siç është rasti i këmbënguljes së Sandfieldit për burimin e ballkanizmave nga greqishtja. E disa të tjera janë më të pranueshme e të bazuara në ato burime të pakta

ekzistuese, siç është ndikimi i substratit dhe i bashkëjetesës e afrisë mes popujve.

Pas gjetjeve fillimisht sporadike e intuitive, është trasuar rruga për studime më serioze e sistematike për ta përqasur leksikun, tiparet gramatikore të këtyre gjuhëve. Studiuesi më i thellë i historisë së shqipes, ndër të tjera, edhe i përkatësisë së saj në grupin e gjuhëve ballkanike, është akad. Rexhep Ismajli. Mbështetur në hulumtime e teori ekzistuese, përfshirë studimet e veta të mëparshme, Ismajli ka arritur që nëpërmjet shoshitjeve të gjetjeve e evidentimeve, ndërtimeve të brendshme, të ofrojë një lëndë të pasur edhe në këtë fushë. Për disa shpreh rezerva e disa i mbështet duke u bazuar në dëshmi e argumente.

### **Qëllimi i punimit**

Punimi ka për qëllim të shpalosë vështrimet e fundit të akademikut Rexhep Ismajlit lidhur me pikëtakimet e veçantitë mes gjuhësh të vjetra, e ato që kanë rrjedhur prej tyre, të cilat fliten ose kanë qenë aktive në një kohë brenda Gadishullit Ballkanik. Literaturë bazë është libri "Studime të shqipes në kontekst ballkanik" (2015). Kjo vepër citohet e parafrazohet më së shpeshti përgjatë punimit dhe përbën veprën e cituar në rastet kur jepet vetëm numri i faqes, për të mos e përsëritur referencën e njëjtë. Kështu, duke paraqitur pjesët më të spikatura e dëshmitë orientuese nga autorë rrallë të përmendur në literaturën shqipe, synohet që tështyhen përpara studimet krahasuese e historike të shqipes në kontekst ballkanik.

### **Fillet e ballkanistikës**

Krahas vështrimeve skematike e sipërfaqësore lidhur me hetimin e ngjashmërive mes gjuhësh që fliten në Ballkan, studiuesi i parë që i ka adresuar shkencërisht këto ngjashmëri unike gjuhësore e kulturore mes këtyre gjuhëve është filologu sloven, B.J. Kopitari, duke thënë se në vendet ballkanike "*sundon vetëm një formë gjuhësore, por me tri lloje lënde gjuhësore, nga të cilat njëra është vendëse, ndërsa dy të tjerat kanë ardhur nga perëndimi dhe nga lindja*".

Mikloshiqi në monografinë e tij të njohur "Die slavischen Elemente im Rumunischen", duke ia atribuar këto të përbashkëta shtresës së lashtë autoktone, i renditi dukuritë gjuhësore të përbashkëta të cilat i ka vërejtur si: formimin e së ardhmes me foljen *dua*, njëjtësimin e formës së rasave gjinore, dhanore, rrjedhore, rimarrjen e kundrinave me anë të trajtave të shkurtra (shih më gjerësisht Demiraj 1994). Weigandi e Mikloshiqi përkrahnin mendimin se e kanë prejardhjen nga substrati trak, linguisti danez, Sandfieldi, këmbëngulte për rolin e greqishtes në konsolidimin e këtyre ballkanizimeve, e studiues të tjerë, kryesisht sllavë, e kanë përmendur rolin e sllavishtes në shfaqjen e tyre, me gjithë mungesën e raporteve gjenetike mes këtyre gjuhësh. Siç e qartëson më përgjithshëm Demiraj (1994:44), "si rrjedhim i ndikimeve të ndërsjella midis gjuhëve të Gadishullit Ballkanik si edhe i ndikimeve të kushtëzuara nga fatet e përbashkëta historike të popujve të këtij gadishulli, në këto gjuhë janë përfutur një varg tiparesh të përbashkëta, që nuk ndeshen në gjuhë të tjera i.e., ose që duket qartë se, edhe kur ndeshen në ndonjë gjuhë tjetër, këtu ato janë një zhvillim i brendshëm ballkanik." Dhe, natyrisht se këto zhvillime të numërta e mjaft domethënëse gramatiko-re, e kërkojnë një rindërtim krahasues e shpjegim shkencor të thellë.

Sai përket mënyrës lidhore, Demiraj (2002:865) thotë se ajo "ka pësuar ndryshime largvajtëse si nga ana kuptimore-funksionale, ashtu edhe nga ana formale". Megjithatë, ajo është dukuri ballkanike e zhvilluar edhe në shqipe- duke e zëvendësuar paskajoren *për të punuar me të punoj*. Por, ekzistojnë elemente zhvillimesh të cilat janë shfaqur paralelisht në gjuhët përkatëse. "Në rastin e ndonjë zhvillimi paralel, faktori i përbashkët nuk duhet kërkuar medoemos te substrati i vjetër ballkanik, sado që edhe ndikimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i këtij në ndonjë rast nuk duhet përjashtuar patjetër" (Demiraj 1994:16). Ndërsa lidhur me dukurinë e trajtave të shkurtra të përemrave vetorë, Demiraj (1994:122) thotë se "faktori kryesor që i ka dhënë shkas rimarrjes së kundrinave të shprehura nëpërmjet përemrave vetorë të vetës së tretë, në zanafillë do të ketë qenë dëshira e folësit për ta konkretizuar e për ta përcaktuar më mirë përmbajtjen kuptimore të atyre përemrave".

E lidhur me njëjtësimin e rasave gjinore e dhanore" më të përhapurat kanë qenë ato që e shihnin shfaqjen e dukurisë në shqyrtim nën ndikimin e substratit të vjetër ballkanik, apo nën ndikimin e greqishtes a të latinishtes,

apo edhe si një dukuri që, të paktën, në disa nga gjuhët ballkanike duhet konsideruar si një zhvillim i brendshëm, i pavarur" (Demiraj 1994:75).

Në termat e Trubeckoit nga shkolla e Pragës, gjuhët ballkanike janë pjesë e lidhjes gjuhësore ballkanike, pra jo të një familjeje gjuhësore, për shkak se nuk tregojnë bashkëpërkim sistematik fonetik, e që do të konsistonte në një familje gjuhësore. Shtresimi kohor i këtyre dukurive duhet vënë në kuadrin e periudhës në të cilën kanë vepruar, e që dokumentimi i vonshëm i disave prej tyre e vështirëson këtë proces hulumtimi.

### **"Studime historike të shqipes në kontekst ballkanik"**

Studimi i vitit 2015 i akademikut Rexhep Ismajlit përbën një përmbledhje e njëkohësisht thellim të hulumtimeve në disa tematikame fokus më të gjerë, e në disa të tjeramëtë ngushtë. Megjithëse shqipja e lashtë apo protoshqipja ka dokumente të reduktuara si dhe vonë të shfaqura, që do të mund të shërbenin si dëshmi për ta shpjeguar gjendjen e saj mijëra vjet më parë, përpjekjet për të ofruar pasqyrë të këtyre proceseve nuk kanë pushuar. Arsyeja pse po i referohemi me këtë nocion është se "me termin protoshqipe ...shprehet një qëndrim neutral ndaj çështjes së prejardhjes konkrete të gjuhës shqipe" (Bokshi 2010:22).

Libri fillon nga një seri të dhënash për kontaktin e gjuhëve lashtoballkanike me parashqipen, gjendjen gjuhësore të Ballkanit në lashtësi: të dhëna lidhur me gjuhët e vjetra me pak material të ruajtur: frigjishtja, mezishtja, dakishtja, trakishtja, paragreqishtja (pellazgishtja), makedonishtja e lashtë, ilirishtja, mesapishtja, venetishtja në kapitullin: *Diskutime të vona për raportet e shqipes me gjuhët lashtoballkanike dhe indoeuropiane*. Këto të dhëna janë relevante për këtë temë, meqë "shqipja është vetë vazhdim i një gjuhe të tillë të lashtë nëpër të gjitha transformimet e mundshme të kontaktit me gjuhët e tjera (Ismajli 2015:8)

Autori thekson ngjashmërinë mes shqipes dhe mesapishtes në optativin; alternimet fonetike, toponimete zhvillime të tjera gjuhësore që do ta bënin atë të afërt me ilirishten ose dialektet e saj. E shoqëron këtë me pohimin se "në albanistikë mbisundon mendimi se shqipja është gjuhë indoeuropiane tipit satəm, grup më vete, me prejardhje në lashtësi nga ilirishtja.." (Ismajli

2015:160). Natyrisht se paradigmat strukturore nuk njihen dhe idetë e tilla janë e do të mbeten të mjegullta sa i përket shkallës së vërtetësisë. Duke qenë se dukuritë e lartpërmendura janë të manifestuara mjaft dukshëm në shqipe, i bie se ndër zonat e rëndësishme të kontaktit mes këtyre gjuhëve, kanë qenë edhe vendet ku flitet shqipja. Dhe pikërisht për këtë arsye, sipas Ismajlit (2015:18), "shqipja është pjesëmarrëse në të gjitha tiparet karakteristike për Sprachbundin ballkanik si: nyja e prapavendosur, dyfishimi i objektit, përdorimi i parafjalëve në vend të rasave, shkrirja dativ/ gjenitiv, shkrirja qëllim/ lokacion, relativum generale, pastaj folje ndihmëse + folje e mbaruar, futuri volo, futuri i shkuar si kushtore, perfekti habere, evidencialët, krahasimi analitik, etj." Studimi ngjitet e zbret shkallë-shkallë në kohë, duke potencuar afritë e ndeshura, cilësitë e përkimeve si dhe argumentet e sjella për çështje komplekse, si ndikimet e shumëfishta të gjuhëve pushtuese e supozimete tjera lidhur me prejardhjen e vendin e saj krahas gjuhëve indoevropiane e ballkanike.

### **Qëndrimet për prejardhjen e shqipes**

Në këtë studim mëtej, zënë vend diskutimet, dilemat dhe teoritë kryesore lidhur me prejardhjen e shqipes, nga të cilat më e njohura, e të cilën e përkrah me argumentegjeografike e gjuhësore (sado të pakta që ekzistojnë) edhe vetë Ismajli, megjithëse thotë se "nuk e dimë a mund të themi që është dëshmuar prejardhja ilire, sepse për ta dëshmuar, duhet ta kishim ilirishten dhe atë nuk e kemi" (f.167). Thunman më 1784 kishte nxjerrë përfundimin se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve, e shqipja pasardhëse e ilirishtes. Edhe Ismajli shpjegon se ky nuk është qëndrim i shprehur vetëm nga shqiptarët, por është plotësisht në përputhje me përfundimet e nxjerra hershëm nga albanologë të huaj: "Hipoteza për prejardhjen ilire të shqiptarëve, në të vërtetë, burimin e ka qysh te letrat e Leibnitz-it dhe është formuluar tek autorë si J. Thunmann e të tjerë më vonë, para se të shfaqej tek autorët arbëreshë. Në albanologjinë shqiptare ajo ka ardhur përmes albanologjisë serioze të së kaluarës, nga G. Meyer, H. Pedersen e të tjerë dhe jo nga arbëreshët" (Ismajli 2015:105). Thunmani e përkrahte tezën për prejardhjen trakase të rumunëve, e ilire të shqiptarëve. Këtë tezë e kanë përkrahur edhe

studiues me nam si: Leibnitz, Thunmani Hamp, Jokli, Matzingeri, Desnic-kaja, Pedersen, Pisani etj. Këtë Ismajli e mbështet edhe bazuar te huazimet greko-romake, të cilat e kishin vërshuar shqipen e vjetër gjatë pushtimeve. "Më pak e kritikueshme mbetet hipoteza ilire: huazimet latine dhe greke të lashta me shumëçka atje të çojnë" (f.114). Kjo për shkak se, siç thotë ai, "fakti se shqipja ka huazime greke të lashta dhe latine të hershme edhe në raport me gjuhët romane perëndimore, interpretimi i plotë i tij dhe ikontekstit përkatës vjen e merr peshë për të ritheksuar hipotezën përbijërinë ilire të shqipes." (Ismajli 2015:133-134).

Demiraj edhe qëndrimet rreth kohës së kalimit të saj nga gjuha e vjetër në atë shqipe, i shpreh duke iu referuar drejtpërdrejt ilirishtes si paraardhëse. "Shndërrimi i shkallëshkallshëm i ilirishtes në "bijën" e saj, shqipen, duhet të jetë kryer midis shekujve IV-VI të e.r., d.m.th. gjatë periudhës midis fazës së fundit të ndikimit të fuqishëm latin mbi ilirishten dhe ardhjes së sllavëve" (Demiraj 1994:46).

Mjaft e përhapur është edhe teoria e prejardhjes trakase – e mbështetur nga Weigandi, Hirti, Barici, Dechevi, për shkak të bindjes së përhapur që ilirishtja i takonte grupit *kentum*, megjithëse kishte përjashtime edhe në ato pak fjalë që njihen, madje Cimohovski mbështeste mendimin se ilirishtja i takon grupit *satem*. Sa i përket këtij qëndrimi Ismajli (2015:169) thotë: "teoria për prejardhjen trakase të shqipes mund të jetë një episod interesant për studimet e gjuhësisë, por mua më duket se nuk qëndron".

Weigandi po ashtu vinte në pah mungesën e terminologjisë detare në shqipe, d.m.th. huazimin e saj nga latinishtja e greqishtja. Hampi kishte thënë se mungesa e terminologjisë detare nuk dëshmon asgjë, dhe këtë e vërteton më fuqishëm edhe Ismajli (1987), i cili përmend fjalë shqipe edhe në këtë fushë. Sipas Ismajlit suksesshëm, Hampi e kishte vërtetuar se "fjala det është fjalë e vjetër IE në shqipen" (f.154). Lidhur me këtë kundërgument të Weigandit, shtohet një arsytim mjaft objektiv: "Por po të nisim ashtu, çdo gjë bëhet absurde. Merrni trupin tonë: flokë, faqe, fytyrë, shpinë, llërë, kofshë, të gjitha janë fjalë latine, qiell, gjel, qen, peshk, etj. po ashtu. A do të thotë kjo që shqiptarët s'kanë qenë as në fusha as në male, se s'kanë njohur pjesë të trupit e çka jo tjetër? Anglezët fjalët për ushqimet prej mishi i kanë frënge" (f.154). Po ashtu, e parafrazon Rossetin, i cili thoshte "mungesa e një

terminologjie autoktone të peshkimit provon vetëm atë se stërgjyshërit e shqiptarëve kanë jetuar në një epokë të lashtëlarg bregut të Detit Adriatik". Pastaj, përmendet teoria e prejardhjes nga dako-mezishtja nga Georgievi, përfundimet e të cilit thoshin se shqipja rrjedh nga një dialekt dako-mez (f.121). E Hasdeu mendonte se rrjedh nga dialekti trako-epirot.

Thekson lidhjet e veçanta me armenishten si dhe me gjuhët verievropiane: baltishte, sllavishte, gjermanikishte, në fonetikë e struktura morfologjike, me të cilat e lidh refleksi i \*o së shkurtër në a \*ind. Ai nuk e lë pa e theksuar se "për shkak të të dhënave të pakta për ilirishten, trakishten e dako-mezishten del e vështirë vendosja e plotë e lidhjes gjenetike të shqipes me këtë apo atë gjuhë të lashtë të Ballkanit" (Ismajli 2015:44). Shqyrtohen idetë e Matzingerit, di Giovinet, e studiuesve të tjerë, qëkishin shprehur pikëpamjet lidhur me supozimet e mundshme për origjinën e gjuhës shqipe, mes të cilave edhe teza që e kundërshtojnë prejardhjen ilire. "Një ide të tillë që shqipen e sheh të një bijërie të ndryshme nga ilirishtja e nga trakishtja parimisht nuk mund ta mohojmë" (f.109). Pra, nuk shfaq siguri të njëqindpërqindtë, pasur parasysh faktet e reduktuara burimore, por lë hapësirë për sjelljen e diskutimeve të reja bazuar në korrespondencat potenciale mes dialektesh apo gjuhësh brendaballkanike.

### **Shqipja-gjuhë satem**

Me gjithë vjetërsinë që duhet ta ketë gjuha indoevropiane (emërtim ky konvencional) e lëvizjet drastike në strukturë të brendshme e të jashtme, është vërejtur njëfarë prerjeje apo ndarjeje e lashtë dialektore e gjuhës indoevropiane në bazë të reflektimit të guturaleve.

Hap i ri në çështjen e afrive të shqipes me gjuhët e tjera është shënuar me artikullin e Gustav Meyerit: "Vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indogjermane" (1883), i cili e kishte ndarë pasurinë origjinale të shqipes nga elementet huazuese, e gjithashtu kishte bërë analizë të sistemit fonetik. Ai arriti në përfundimin e argumentuar bindshëm dhe të pranuar nga albanologë të rëndësishëm (Pedersen, Jokli, Çabej, Hamp, Desnickaja etj), se "shqipja është një gjuhë indoevropiane lindore dhe njëkohësisht, gjuhë indoevropiane veriore". Si gjuhë lindore e bëjnë reflekset e palataleve

indoevropiane në spirante *s,z,th,dh*, kurse veriore (me baltishten, sllavishten, gjermanikishten) e bën refleksi i o-së indoevropiane në a (noctis-natë, ostis-asht), zhdukja e perfektit me dyfishim. Edhe pse Meyeri disa forma foljore i lidhi me latinishten, Pedersen i preu udhën këtij pohimi, duke e vërtetuar shkencërisht se ndikimi i latinishtes ishte zero.

Kështu, Gustav Meyeri me të drejtë e kishte vendosur shqipen te grupi satem, për shkak të shfaqjes së këtyre guturaleve në *th, dh, s,z*, pranitur nga fakti se në shqipe guturalet spirantizohen. Më saktësisht, buzoprapaqiellzoret janë shndërruar në të spirantizuara, d.m.th. kalojnë nga mbylltore në fërkimore në shqipe afër zanoreve të përparme (\*penque – pesë), për ç'arsye është e konsideruar si gjuhë satem. Në bazë të materialit të paktë të ofruar nga ilirishtja, ajo është konsideruar gjuhë *kentum*.

Megjithatë, "ka pasur për ilirishten, sa e njohim, edhe argumente që donin ta tregonin satem, dhe të atilla që e shfaqnin kentum. Kemi emrin Bersiminium – Podgorica e sotme, që, mbase, është quajtur kështu, pra kemi pasur palatale që është bërë z" (Ismajli 2015:153). Ismajli e thekson faktin se ky thjeshtim nuk është krejtësisht i përligjur, pasi ka shembuj si *smakra* (mjekër), që mëtojnë t'i japin asaj një vend qendror. Pikërisht ky karakter satem i shqipes i ka distancuar shumë studiues dhe ka nxitur rishqyrtime serioze. Mirëpo, "meqë ilirishten nuk e njohim, rindërtimet e ligjeve fonetike mund të jenë arbitrare, prandaj edhe ka pasur diskutime lidhur me karakterin centum apo satem të ilirishtes" (Ismajli 2015:136-137). Theksohen teoritë që vetë ilirishten e vendosnin në grupin kentum. "Ka pasur dhe diskutime, sidomos nga dijetarët që ilirishten e mbanin për një gjuhë centum, ndërsa shqipja është gjuhë satem, kështu që nuk mund të rridhte nga një gjuhë centum. Prandaj iu drejtuan trakishtes, karakteri satem i së cilës nuk diskutohet" (f.129).

Diskutimi për këto probleme e (mos) përputhje, karakterin satem apo kentum të ilirishtes, ka rezultuar pa shuarje dilemash rreth prejardhjes së shqipes. Argumentimi më i mbështetur është përkatësia e shqipes në grupin satem, për shkak të spirantizimit të guturaleve indoevropiane, mirëpo shtrohet pyetja se sa u përgjigjet ilirishtja këtyre veçorive fonetike.



## Lidhjet e veçanta të shqipes me rumanishten

Lidhje të veçanta janë relacionet gjuhësore mes shqipes dhe rumanishtes, të cilave Ismajli ua kushton një pjesë të konsiderueshme të librit. Pasi jep të dhëna të përgjithshme lidhur me shtetin e Rumanisë, popullsinë e saj, Ismajli përpiket të japë shpjegime më të gjera lidhur me prejardhjen e një grupi të konsiderueshëm fjalësh të ngjashme në të dyja gjuhët (me dokumentim shkrimor në të njëjtin shekull) si dhe huazimet e përbashkëta latine, të cilat Weigandi i shihte të ardhura përmes shqipes në rumanishte. Sa u përket latinizmave, bazuar në vëzhgimet e Hazdeut, i cili kishte analizuar anën gjuhësore të tyre, Ismajli del në përfundim se "latinizmat e shqipes janë më arkaikë" (Ismajli 2015:290), duke e përligjur kështu gjetjen se shqipja mund të ketë ushtruar ndikim në rumanishten, por edhe si rezultat i jetesës së përbashkët. Po ashtu, sa i përket fondit roman, dallimet që i paraqesin këto gjuhë, sipas Ismajlit (f.274-275), janë të natyrës kronologjike (varësisht se kur kanë filluar kontaktet). Edhe Çabej (1976:74) thekson se "historia e këtyre lidhjeve ka mbetur gjer më sot e pasqaruar.." E, lidhur me prejardhjen potenciale të tyre, Çabej (1976) i përmendte tri mundësi: nga shqipja, rumanishtja (që si mundësi kundërshtojë për shkak të pamundësisë shpjeguese brendasistimore rumune) ose nga një burim i tretë. Derisa sllavizmat, thekson Ismajli (f.452), janë dukshëm më të shumtë në rumanishte. Përmenden edhe punimet e Alexandru Philippidet, si studiues i historisë dhe gjuhës rumune, që e pranonte se disa nga fjalët janë huazime nga shqipja. Me këtë çështje është marrë edhe Meyeri, i cili një pjesë të tyre e shihte me burim të shqipja. Pastaj ato të Brâncușit (f.332), i cili i interpretonte këto huazime si dëshmi të ndikimit të elementit trako-dakas, si dhe është marrë me elementet e fjalëformimit, rotacizmin e prapavendosjen e njëjës shqese. "Kemi parasysh faktin që nyja e prapme në rumanishte është përfutur pas shekullit VIII të e.r., d.m.th. pas ndërprerjes së kontakteve të drejtpërdrejta midis stërgjyshërve të shqiptarëve dhe atyre të rumunëve, atëherë duhet pranuar që një ndikim i drejtpërdrejtë i shqipes mbi rumanishten në këtë rast vështirë se mund të jetë ushtruar"(Demiraj 1994:104). "Mendohet se prapavendosja e njëjës në shqipen e rumanishten i parapriu paravendosjes" (f.334). Lidhur me këtë çështje, Ismajli e citon Schumacherin

(f.403), i cili thoshte se kjo veçori e rumanishtes paraqet imitim të prapavendosjes në shqipe. Ismajli potencon se prapavendosja e nyjës në shqipe (më herët se sh. VII-VIII), është më e lashtë se në rumanishte (pas sh. VIII), "prandaj bëhet e mundshme hipoteza për ndikimin eventual të shqipes mbi rumanishten" (Ismajli 2015:453). Derisa janë vërtetuar edhe bashkëpërkime në ndërtimin e disa përemrave të formuar me përngjitje (Demiraj 2013). Përkimet rezultojnë të jenë mjaft të vjetra. "Në një anë kemi elementet leksikore të përbashkëta midis shqipes e rumanishtes, në anën tjetër një shpjegim gramatikor që flet për lashtësinë e elementeve nyjore" (Ismajli 2015:186). Ai thekson qëndrimin e Eric Hampit se ekziston një grup fjalësh që e vendosin parashqipen mjaft herët në kontekst karpato-ballkanik, p.sh. kuptimi i fjalës *vatra* (f.186). Siç shihet, cilësia e përkimit mes këtyre fjalëve është mjaft e madhe, e që në mënyrë indirekte na thërret për hulumtim serioz. "Ngjashmëria midis këtyre dy gjuhëve shtrihet në fonetikë, në strukturën gramatikore (fleksion nominal, sintaksë e verbit), në leksik, në formimin e fjalëve, në frazeologji e në proverba, në tërë sistemin gjuhësor" (f.278). Këtë e përforcon fakti që i kanë mbijetuar kohës, e janë ende pjesë aktive leksikore dhe

Ismajli e thotë përgjithshëm (2015:316) "...elementet e përbashkëta të saj me shqipen, rrjedhin nga një komponent i rëndësishëm i trashëguar..." .

Pastaj edhe dukuria e rotacizmit përbën tjetër zhvillim fonetik të përbashkët, në shqipe *n-r* (në toskërishte), e në rumanishte *l-r*. Jepet gjetja e Brâncușit (f.307) se dialekti toskë ka më shumë ngjashmëri me rumanishten sesa ai gegë, megjithëse gjeografikisht kjo e fundit qëndron më afër me Rumaninë, duke e arsyetuar këtë me fqinjësinë e dikurshme, kur toskët jetonin më afër zonës trako-romane. Pastaj edhe të autorit tjetër, Sextil Pușcariu (f.309), i cili kishte thënë: "stërgjyshërit tanë kanë jetuar me stërgjyshërit e shqiptarëve". Pastaj paraqiten ngjashmëritë mes tyre në strukturë (f.382-388). Ismajli (f.292) përmend faktin se këto ngjashmëri u kanë shërbyer si pretekst përkrahësve të hipotezës për prejardhjen trakase të shqipes, p.sh. Georgievit.

Pa dyshim se njësitë e përbashkëta leksikore dhe zhvillimet flasin për një kontakt e fqinjësi të vazhdueshme mes shqiptarëve e rumunëve. Për shembull fjalë korresponduese me rumanishten që i paraqet edhe Ismajli

janë: avull – abure, baltë – baltă, bardhë – barză, bashkë – bască, bollë – balaur, bredh – brad, brez – brîu, bukur – a se bucura, buzë – buză, dhallë – zară, droje, droe – droaie, flutur – fluture, gardh – gard, gërresë – gresie, gropë – groapă, gurmaz – gurmaz, gushë – guşă, gjemb – ghimpe, gjysh – ghiuj, këlbazë – gälbează, kulpën – kurpen, kurth – kursă, mal – mal, moshë – moş, mëz – mînz, mugull – mugur, negull – negură, nepërkë – năpîrcă, përrua – pîriu, qafë – ceafă, rëndës – rînză, sorrë – cioară, shkrumb – scrum, shtrep – strepede, shtrungë – strungă, tharbët – sarbăd, thark – cark, thërimë – fărîmă, urlë – urdă, vatër – vatră, vjedull – viezure.

Këto bashkëpërkime duhen hulumtuar shkencërisht nëse janë të shpjegueshme prej njëres nga gjuhët apo ndonjë burim i tretë a substrat. E Ismajli thekson kushtin që rrit gjasat e fjalës për t'u konsideruar origjinalisht shqipe: "nëse një fjalë shqipe e pahuazuar hyn në një vorbull etimologjik, me ndryshimet dëshmon lidhje të zgjeruara fjalëformuese dhe kuptimore, ndërsa në rumanishten del e izoluar, kjo do të thotë se kjo fjalë në këtë gjuhë është huazim nga shqipja:"(Ismajli 2015:455). Edhe Sandfieldi i shihte me burim nga shqipja dhe nga substrati i përbashkët.

Megjithatë, rumunët nuk janë shprehur hapur apo në favor rreth mundësisë së ndikimit të shqipes në trajtat e gjuhës së tyre. "Në përgjithësi, brezi i përmendur i studiuesve rumunë ngul këmbë te mohimi i mundësisë së ndonjë ndikimi të shqipes në rumanishten sa u përket elementeve të përbashkëta të dy gjuhëve"(Ismajli 2015:379). Nyjën dhe përcaktorët e tjerë këto dy gjuhë i kanë të prapavendosur. E siç thotë Demiraj (1994:99) "prapavendosja e nyjës shquese është ndër ballkanizmat më tipikë". Kështu, "në gjuhën shqipe dhe në rumanishte është zhvilluar prej kohësh prirja për t'i prapavendosur përcaktorët e pavetëmjaftueshëm të emrit" (Demiraj 1994:163). Një numër më i madh evidencash do t'i mbushte hapësirat boshe dhe do ta sqaronte e hetonte kronologjinë e zhvillimeve gjuhësore gjatë rrjedhës së shekujve. "Në trajtimin e raporteve të shqipes me rumanishten implikohen vështrime të natyrës diakronike, tipologjike, areale e të kontaktit të gjuhëve bashkë me qëndrimet përkatëse në fushë të metodës, herë-herë në kundërshtim me njëri-tjetrin" (Ismajli 2015:288). Një vështrim sinkronik e tipologjik i trajtave do të vërtetonte qoftë ndikim të elementeve të substratit ose të njëres gjuhë te tjetra.

## Përmbledhje studimesh rrallë të përmendura

Në këtë pjesë do të përmbliidhen shkurt të dhënat të cilat i paraqet Ismajli lidhur me rezultatet e studimeve të disa autorëve shqiptarë e të huaj, rrallë të përmendur në literaturën shqiptare: për përkimet specifike në morfo-sintaksë e fonetikë, qëndrimet e tjera për vendin e shqipes, prejardhjen e saj, aspekte të tjera etno-kulturore, qoftë përbashkuese apo ndarëse mes gjuhësh ballkanike.

Ismajli paraqet qëndrimet e autorëve lidhur me territorin ku kanë banuar shqiptarët, nëse ai do të duhej të ketë qenë i romanizuar për shkak të huazimeve latine të pranishme në të etj. Do të përmenden disa prej tyre, mbështetur te po ky studim që përbën korpusin e punimit.

Vihen në theks studimet e Porzigut (f.77) lidhur me përkimet e shqipes me armenishten, greqishten, baltishten si dhe përkimet fonetike mes tyre. Po me armenishten e greqishten format e aoristit *pashë, thashë* i lidhte G. Klingenschmitt (f.84) të cilat lindën nga grupet zanore *pae thae*. E Simona Klemenčič (f.123) në disertacionin e saj i kishte përfshirë dhjetëra paralele leksikore shqip-baltisht-sllavisht-gjermanikisht.

Joachim Matzingeri (Ismajli 2015:103-104) pohonte se shqipja mund të mos jetë pasardhëse e asnjërës nga gjuhët që ishin pjesë e hipotezave (ilirishtes e trakishtes), por e një gjuhe të pavarur. Ai gjithashtu është marrë me sistemin fonetik të trakishtes, palatalet e të cilit kishin zhvillim satem (ashtu si shqipja). I paraqet raportet mesapo-shqipe të trajtuara nga Joachim Matzinger, p.sh. ngjashmëria mes tyre tek optativi si dhe pikëpamjen e tij lidhur me lëndën e krahasueshme të saj me shqipen p.sh. me foljet: në mënyrën dëshirore, në të kryerën e thjeshtë dhe te perfekti.

Benjamin Fortson i shihte të patestueshme hipotezat ilire e trakase (f.79) dhe këto dy gjuhë i shihte të afra me njëra-tjetrën, aq shumë, sa e propozonte degën trako-ilire. E James Mallroy (Ismajli 2015:82), tezën ilire e shihte pothuajse krejtësisht të ndërlidhur me pjesën territoriale të shtrirjes së shqipes, për ç'arsye i dukej supozim i mundshëm. Përmendet teza e Budimirit që ilirët përbëjnë indoevropianët më të lashtë në Mesdhe.

Gjithashtu, vëmendje i kushtohet punës së studiueses ruse, Agnja Desnickaja, e cila ishte marrë në veçanti me lidhjet e shqipes me gjuhët

baltike, raportet me gjuhët gjermanike, arsyetimin apo hedhjen poshtë të argumentimit të Weigandit se mungesa e terminologjisë detare dëshmon prejardhjen trakase. Siç e shpjegon edhe Ismajli, është normale që, duke qenë se ilirët kanë pasur raporte të afërta e fqinjësi me grekët e romakët, të kenë huazuar edhe fjalë nga ta, ashtu siç ka ndodhur anasjelltas. E Di Giovine e ka kryer studimin për raportin/krahasimin e shqipes me trakishten, dako-mezishten. Diskutohen rezultatet nga Tagliavini, Malcolmi, Buda, Kristo Frashëri e shumë të tjerë. Me shpalosjen e këtyre të dhënave, ofrimin e dëshmive, që origjinalisht janë në gjuhë të shumta botërore, u jepet hov hulumtimeve si dhe mundësi vlerësimi për cilësinë e argumenteve.

### **Kritika ndaj studimeve tendencioze**

Në këtë libër, ndër të tjera, Ismajli me të drejtë kritikon ashpër studiuesen serbe Olga Mišeska-Tomić, e cila në një punim shkencor të botuar ndërkombëtarisht, tenton të aludojë se ka ndarje të thellë mes shqiptarësh, duke e quajtur standardin gjuhë të dytë për Kosovën. E që ndër të tjera, thoshte: "shqipja gege është në mënyrë inherente e pakuptueshme për folësit e shqipes toske". Pra mëton të presupozojë se ka vështirësi komunikimi mes shqiptarësh të të dyja dialekteve, duke aluduar në theksim të idesë së ndarjes. Ismajli (2015:22) me bazë faktesh e komenton kështu: "është më shumë se injorancë linguistike e kulturore të konsiderosh se shqipen standarde, që për bazë të saj e ka sistemin e variantit letrar të toskërishtes, shqiptarët e Kosovës (jo të Kosovës e Metohisë!, jo të 'provincës serbe'!), apo të tjerë e flitkan si gjuhë të dytë, madje njësoj si folësit nativë të greqishtes, të maqedonishtes apo të serbishtes!". Në vlerësimin e tij të mëtejme (f.24), ai shton se "me mosnjohje të këtilla të materialeve të shqipes nuk është e mundur të nxirren përfundime të mbështetura për çfarëdo krahasimi ballkanik apo tjetër. Serbezllëku me të cilin i jepte të drejtë vetes autorja me mungesa kështu elementare në njohjen e gjuhës për të gjykuar nuk arsyetohet..."

Kritikohen edhe mendimet e arkeologut Vladislav Popović, i cili sipas Ismajlit, megjithëse nuk i fshihte vlerësimet politike, deklaronte se ishte objektiv në qëndrimet e tij, dhe me këtë supozim, e quante tezën ilire

surrogat të varfëruar, duke e kundërshtuar kështu prejardhjen e shqipes nga lashtësia. Gjithashtu i jep kritika lidhur me qëndrimet e tij për emërtimet e vendeve. "Mendimi për rrjedhën e shqip, shqiptar nga Scupi, Shkup nuk duket të ketë gjasë, ndërsa vazhdimi i Scupi në Shkup përmes zhvillimeve të shqipes është krejt i saktë". (Ismajli 2015:304)

Ai shpreh revoltën për shkak të botimit të këtyre punimeve në revista me renome botërore, duke ushtruar kështu ndikim në perceptimin ndaj shqiptarëve e trojeve të tyre. "Kjo mungesë elementare njohjesh, apo edhe anim i motivuar politikisht deri në keqdashje në një seri të botimeve Springer, me bord serioz botues ndërkombëtar, gjithsesi të revolton edhe pas kaq vitesh" (Ismajli 2015:24). Kështu, studimet qartësisht tendencioze nxitin polemika apo dilema në imazh ndërkombëtar të shqipes dhe janë në funksion të keqinformimit të qëllimshëm për një popull që e konsiderojnë armik.

## **Përfundim**

Ky libër voluminoz e përmbajtjesor i Ismajlit përmban trajtim të përimtësishëm të çështjeve që ndërlidhen me shqipen në raport me gjuhët e Ballkanit, qysh nga gjurmët e para të tyre, e deri në gjetjet e shekujve të fundit, të cilat janë mbështetur në evidencat e pakta. Nëntemat e përfshira janë mjaft të rrahura nga albanologë shqiptarë e të huaj, pikëpamjet e të cilëve janë shtruar e interpretuar objektivisht në këtë studim të 2015-s. Mjetet gramatikore të pasvendosura, trajtat e shkurtra përemërore, identifikimi i disa ngjashmërive të tjera në sistemin fonetik, të cilat me gjithë mungesën e evidencave arkeologjike, gjuhësore e etnike, përbëjnë disa nga elementet ballkanike të zberthyera thukët e shkencërisht në studim. Më tej i ka thelluar pikëpamjet e mëparshme lidhur me raportet mes shqipes e rumanishtes.

E pamë se me gjithë transformimet e skajshme të pësuarra përgjatë shekujve në të gjitha sistemet, lidhshmëria në sisteme gjuhësore, sado e zbehtë, është ekzistuese dhe lejon shtrimin e hipotezave përkatëse. Kjo shëtitje nëpër periudha të ndryshme, nga shekujt e lashtë deri në ditët e sotme shërben për t'i kristalizuar më bindshëm dhe si të mbështetura bindjet dhe për t'i paraqitur më shkencërisht hipotezat e mbështetura. Interpretimi etimologjik paraqitet mjaft i vështirë, megjithatë, të dhënat kanë vlerë

orientuese për gjetjen e korrespondueseve të sakta. Sipas Ismaljit, megjithëse ka pak material, glosat e ilirishtes janë të interpretueshme përmes shqipes,, fakt që ndikon në animin e tij në këtë hipotezë lidhur me prejardhjen e saj. Gjithashtu, pohimi se ka dilema edhe rreth kësaj, hap shtigje më të gjera lidhur me vërtetimit më të plotë ose hedhjen poshtë të kësaj hipoteze.

## Literatura

- Bokshi B.** (2010). Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes, Prishtinë: ASHAK.
- Çabej, E.** (1976): Studime gjuhësore I-VI, Prishtinë: Rilindja.
- Demiraj Sh.** (1989). Gjuha shqipe dhe historia e saj, Prishtinë: Rilindja.
- Demiraj Sh.**(1994). Gjuhësi ballkanike. Shkup.
- Demiraj, S.** (2002). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Prishtinë: ASHAK.
- Ismajli** (1987). R.: Artikuj për gjuhën shqipe, Prishtinë: Rilindja.
- Ismajli, R.** (2015). Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik. Prishtinë: ASHAK

Erjon Papagjoni

*Instituti i Historisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë*

## KONFLIKTI RUSO-UKRAINAS: NJË LUFTË QË KËRCËNON EDHE BALLKANIN?

### Abstrakt

*Konferenca "Ballkani dhe globalizimi" mbahet në Shkup, në Maqedoninë e Veriut, territori më i masakruar nga grupet e armatosura ultranacionaliste të tre shteteve pretendente në vitet përpara luftës ballkanike, me qëllim sigurimin qysh përpara luftës, të shumicës etnike mbi pjesën e pretenduar, pse jo, edhe "pastërtinë" e plotë të territorit. Nga një kronikë e kohës thuhet se në Manastir ndodhnin deri në pesë atentate në ditë. Një qytet prej vetëm 15 mijë banorësh ky.*

*Në atë kohë jo vetëm tavolinat e zyrave të ministrive dhe të shtabeve ushtarake, por edhe ato të kafeneve të zakonshme zihen nga bisedat ku shqyrtoheshin ndryshime kufijsh, ndërtime aleancash të reja, prishje aleancash të vjetra, hartash gjeografike. Po sot, në epokën e internetit, tregtisë së lirë, të drejtave të pakicave, sa të largëta janë vertet ato kohë? A kemi ndryshuar vertet? Lufta në Ukrainë është rasti i fundit që na deshmon se në thelb, kohët nuk kanë ndryshuar dhe aq shumë sa ç'mendonin e shkruanin plot studiues e politologë të njohur. Europa e gjeti paqen vetëm pas dy luftërash botërore, luftëra që i zhveshën fuqitë e medha europiane nga pushteti mbi pjesën tjetër të botes që kaloi në qendra të tjera, që pas 45' diktojnë rregullat e lojes së madhe dhe rolet e aleateve me të vegjël.*

*Me këtë punim përpiqem të bëj një analizë të pasojave që mund të përcjell lufta ruso- ukrainase, me bazë shkakësore konfliktet ndëretnike, mëritë e vjetra historike dhe pakënaqesitë me kufijtë egzistues, mbi balancat e brishta të gadishullit tonë ku të gjithë ne, pamvaresisht kombësisë dhe fesë, jetojmë dhe shohim të ardhmen tonë.*





## Hyrje

A mund t'i lëkundin gjësimet e topave dhe kërcënimi i një lufte bërthamore, mbi një mijë kilometra larg që këtej, ekuilibrat dhe stabilitetin ende të brishtë të Ballkanit? Siç e kuptoni, është një pyetje retorike, pasi po-himi gjendet po aty. Pra, është krejt e mundshme. Jo thjesht sulmi i sotëm ushtarak i federatës ruse ndaj një shteti sovran si Ukraina, por gjithë dramat e hequra mbi kurriz të kombeve dhe popujve nëpër shekuj duket sikur kanë rishfaqur fytyrën e tyre të frikshme e tragjike, pasuar nga pushtimet dhe ripërcaktimet e kufijve përmes përgjakjeve. Duke bërë thirrje për vetëdijësimin e politikës ballkanike, evropiane e më gjerë, edhe kjo konferencë që mbahet këtu në Shkup, në Maqedoni, bën thirrjen e saj modeste në kërkim të zgjidhjeve racionale. Kësodore apelimi që bëhet historisënë kumtesat e shumta është mëse i dobishëm. Pikërisht territori i këtij shteti ku jemi mbledhur ka qenëmë i masakruari nga grupet e armatosura ultranacionaliste të të katër shteteve pretendente në vitet përpara Luftës Ballkanike, Serbëve, Bullgarëve, osmanëve dhe Grekëve, me qëllim sigurimin qysh përpara luftës, të një shumice etnike e territoriale mbi pjesën e pretenduar, pse jo, edhe "pastërtinë" e plotë të territorit. Nga një kronikë e kohës thuhet se në Manastir ndodhnin deri në pesë atentate në ditë. Mendoni, një qytet prej vetëm 15 mijë banorësh ky. Pra, urrejtjet e vjetra nacionaliste të ushqyera në kohë, barabatur me luftën e sotme në Ukrainë, duket se jo vetëm nuk janë fashitur, por gjejnë rast, kohë dhe konjuktura politike për të shpërthyer në ploja të përgjakshme mes shteteve e popujve, duke e vënë në dyshim efektivitetin e gjithë ideologjive të pajtimit, marrëveshjet dhe traktatet ndërshtetërore të paqes, tolerancës dhe pranimit reciprok, në një vëllazërim e mirëkuptim popujsh e shtetesh. Lufta në Ukrainë e zhvesh mendjen nga iluzionet gjumëndjellëse të sigurisë dhe pamundësia e shpërthimit të konflikteve të fjetura, të cilat ndizen lehtësisht nga pretekste e provokime demoniake.

Në kohën që flasim, pra gjatë Luftës Ballkanike 1912-1914, jo vetëm tavolinat e zyrave të ministrive dhe të shtabeve ushtarake, por edhe ato të kafeneve të zakonshme zienin nga bisedat ku shqyrtoheshin ndryshime kufijsh, ndërtime aleancash të reja, prishje aleancash të vjetra, hartash gjeografike. Po sot, në epokën e internetit, tregtisë së lirë, të drejtave të pakicave, sa

të largëta janë në tëvërtet ato kohë? A kemi ndryshuar njëmend? Lufta në Ukrainë është rasti i fundit që na dëshmon se në thelb, kohët nuk kanë ndryshuar dhe aq shumë sa ç'mendonin e shkruanin plot studiues e politologë të njohur dhe sot. Europa e gjeti paqen vetëm pas dy luftërash botërore, luftëra që i zhveshën fuqitë e mëdha europiane nga pushteti mbi pjesën tjetër të botës, pushtet i cili kaloi në qendra të tjera, duke nënkuptuar këtu më së pari SHBA dhe Bashkimin Evropian, që pas 45' diktojnë rregullat e lojës së madhe, nga njëra anë dhe rolet e aleatëve me të vegjël, siç janë edhe dy vendet tona, Shqipëria dhe Maqedonia, nga ana tjetër. Po kështu ngjet edhe me vendet e tjera ballkanike, qofshin pjesë e Bashkimit Evropian ose ende jo. As 30 vjet nuk kanë kaluar kur shpërbërja e Federatës artificiale të Jugosllavisë u mbyt në gjak e gjenocid, ndërsa as 13 vjet kur shqiptarët e Kosovës provuan një raprezalje të egër, gjer në gjenocid shfarosës nga segmentet kriminale të një shteti me frymëzim nacionalist, siç që klika e Milosheviçit.

Kjo çka thashë në thelb është ideja sunduese e krejt kësaj konference, me theks sa historik aq edhe politik. Historia thjesht vjen si referencë dhe cikël përvojash që nuk duhen përsëritur. Duke qenë një studiues dhe shtetas shqiptar, unë i njoh veçanërisht pozitat e bashkëkombasve të mi të shpërndarë në disa shtete ballkanike, filluar më së parime Kosovën, qëaktualisht mbahet në tensione politike për arsye nga më të shumtat, kryesisht nga mospranimi i pavarësisë së saj prej Serbisë; më pastaj me shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, ata në Malin e Zi, të cilët janë shndërruar falë marrëveshjeve në elemente konsituivë e shtetformues në republikat përkatëse, e gjer te shqiptarët e tjerët në krahinën e Çamërisë në Greqi. Gjykoj se shqiptarët, edhe pse të lënë në kufijtë e shteteve të tjerë fqinj për arsyet nga më të ndryshmet gjeostrategjike, ku nuk është aspak vendi për t'i përfolur, gjithsesi gjykoj se ata kanë vuajtur më shumë se të gjithë sivëllezërit e tyre, këtu në Ballkanin tonë të trazuar, peshën e copëtimit të kufijve, tëdasive, urrejtjeve, rrezikut, shtypjes së të drejtave kombëtare a pakicave kombëtare. Demonët e historisë, edhe pse në përgjithësi të dëbuar, nuk janë larguar, diku nëpër qoshet e vetëdijeve nacionaliste ende rrinë zgjuar. Këtë po e provojnë, së fundmi, ukrainasit nga megalomania ruse dhe gjoja e drejta e tyre e të qenit tutor, recidive të një mendësie perandorake që koha nuk e refuzon.

Shqiptarët, ndoshta, janë kombi në hapësirën ballkanike që e kupton më mirë gjendjen e Ukrainës dhe pushtimirus të saj. Paçka se shqiptarëve u janë shpërfillur të drejtat e tyre dhe jo njëherë janë dhunuar, u janë kufizuar gjer në zgrip e drejta e gjuhës, e identitetit dhe e kulturës së tyre, gjithsesi ata kanë luajtur një rol konstruktiv në krijimin e bashkëjetesës me të tjerët, siç po ndodh edhe në Maqedoninë e Veriut falë një koncepti të ri tëkësaj bashkëjetese në shekullin XXI si dhe të ndërveprimit të faktorëve relevantë mes etnive e popujve që jetojnë këtu. Pikërisht këto janë shenjëdhe simbolikë e qartë që, nga njëra anë jep shpresë për mirëkuptim dhe, nga ana tjetër, kërkon rivlerësim të principeve detyruese të respektimit të integritetit territorial të shteteve, moscenimit të kufijve, lirive dhe të drejtave etnike e kulturore të popujve që bashkëjetojnë në një shtet e territor të caktuar etj.

Do doja ta vë në pah edhe faktin se: prania në Ukrainë e një grupimi të vogël shqiptarësh shpërndarë në disa fshatra. Në Odesë ka rreth 5000 shqiptarë që janë vendosur aty kohë pas kohe. Ata kanë ardhur më së shumti mes një rrugëtimi të gjatë viseve të Ballkanit, prej Maqedonisë së Veriut, në Bullgari, Moldavi, në jug të Ukrainës, në stepat e Buxhakut dhe gjer në detin Azov, për t'i shpëtuar pushtimit turk. Në Moldavi ka disa fshatra në kufi me Ukrainën, si Dazi, Dujushku, Xhendrani, por mjaft shqiptarë u vendosën në Ukrainë, në pjesën jugore të saj, duke themeluar fshatrat e tyre, paçka se të varfra, duke ruajtur fort traditat, gjuhën, trashëgiminë kulturore folklorike në këngët, kostumet, vallet, zakonet, religjionin dhe në përgjithësi në antropologjinë e tyre. Më i madhi syresh është fshati Karakurt në Budzhak bri qytetit Bolhrad, pranë Odesës, pastaj vijnë fshatrat Gjeorgjevka, Devnevskoje dhe Gamovra. Shumë syresh, duke qenë kundër reformave dhe politikës shtypëse të Stalinit, u dëbuan në Siberinë e largët dhe humbën andej pa nam e nishan. Ende në këto fshatra flitet shqip. Në Odesa madje ka dhe dy rruge me emrat Velikaja Arnautska ("Shqiptari i madh") dhe Malenkaja Arnautska ("Shqiptari i vogël"). Shumica e kësaj popullsie e ardhur nga krahina e Korçës dhe Pogradecit 300 vjet më parë, iku prej aty për t'i shpëtuar raprezaljes së ushtrisë turke gjatë luftës ruso-turke 1768-1774, ndërsa një pjesëtjetër u zhvendos në Krime pas luftës së Krimesë më 1861. Paçka se të integruar me popullin ukrainas, ata ende edhe sot flasin dialektin e vjeter tosk, festojnë shën Gjergjin në kujtim të heroit të tyre kombëtar Gjergj Kas-

triotit Skënderbeut, duke e ruajtur të pacenuar simbolin e rezistencës antiosmane si pjesë të krenarisë dhe identitetit të tyre. Fan Noli dhe At Artur Liolini kanë mbajtur në bashkësinë shqiptare në Odesë mesha në kishën e tyre të ritit ortodoks. Edhe sot shqiptarët e atyre zonave e quajnë njëri-tjetrin "ga tantë", domethënë nga tanët... Në interesin e kësaj teme doja të përfshija edhe studiuesit sovjetikë ukrainas që kanë shkruar e studiuar rreth gjuhës shqipe, filluar nga filologu dhe historiani sovjetik Nikolaj Derzhavin, më pas Julia Ivanovna dhe gjer tek Anja Desniskaja, e cila në vitin 1957 çeli në Universitetin e Shën Petërburgut departamentin e gjuhës shqipe. E pra, si ndërlidhen fijet e historisë, të cilat në kohë të paqme krijojnë lidhje shpirtërore dhe vektor bashkëpunimi e respekti ndërnacional, sikundër sot në Zaporizhia, e lakuar kaq fort nga mediet botërore për centralin e saj bërthamor dhe rrezikun e një bombardimi, banojnë pikërisht edhe ngulmime të vogla shqiptarësh, të cilët janë shprehur me guxim dhe haptazi se do ta mbrojnë vendin e tyre, domethënë Ukrainën, atdheun e sotëm, nga invazioni rus, siç bënin dikur po njësoj me pushtuesit turq. Përkitje të tilla nuk janë thjesht kureshtare, por kanë një domethënie historike si fate njerëzish dhe popujsh në rrezik. Kjo është pikërisht përvoja historike që mund e duhet t'i japë leksion politikës për të gjetur udhën e arsyes.

Shqiptarët e kanë përvojatur historikisht raprezaljen e të tjerëve. Kjo ngjau dhe me shqiptarët e Kosovës, të cilët u dëbuan me dhunë nga veprimet genocidiste të klikës së një nacionalisti ekstrem si Slobodan Milosheviç, ku vetëm në Shqipëri erdhën gjysmë milioni kosovarë, po ashtu qindra mijëra të tjerë dyndën në Maqedoninë e Veriut dhe të tjerë akoma morën arratinë në shpëtim të jetës së tyre e fëmijëve nëpër vendet e botës. Ishte pikërisht e drejta dhe shkelja e vlerës morale ajo që e çoi botën euroatlantike dhe NATO-n të ndërhynte më në fund në Kosovë dhe ta ndalonte këtë akt gjenocidist. Mirëpo fantazmat e vjetra asnjëherë nuk janë larguar nga Ballkani, i cili për arsyt e njohura të pushtimeve nga shoqi-shoqi si dhe tri perandorive, ajo romane, ajo bizantine dhe ajo osmane, mundësuan shpërngulje masive popullsish, korrektura demografike e konvertime religjioze, të cilat u pasuan me përzierje kulturore, etnike e më gjerë, duke krijuar, në të shumtën e herës, premisat e dasive, luftërave ndëretnike, urrejtjeve, zhvendosjeve etj. Kjo memorie historike është ende aktive, andaj shtetet dhe kom-

bet në Ballkanin e trazuar përkujdesen që konfliktet të gjejnë rrugën e zgjidhjes përmes ndërveprimit, bashkëpunimit dhe tolerancës. Mirëpo rasti i pushtimit të Ukrainës si dhe gjithë zjarrmitë nacionaliste brenda kufijve të saj, të cilave u fryjnë enkas pushtuesit rus, kanë zgjuar pikërisht kujtesat përandorake duke iu larguar realiteteve të kohës, lirisë dhe të drejtave të popujve e të njerëzve.

Nuk do shumë mend të bësh një analizë të pasojave që mund të përcjellë lufta ruso-ukrainase, e motivuar me arsytet e dasive dhe konflikteve ndër-etnike, me meritë e vjetra historike dhe pakënaqësitë ndaj kufijve egzistues etj. A s'janë po këto motive që mund të ndizen befasisht nga politikat irredentiste edhe në Ballkanin tonë, sidomos nga mendësitë nacionaliste në balancat e brishta të gadishullit? Jetojmë pranë e pranë dhe shpesh të përzier nëpër qytete e fshatra, dhe prandaj e drejta e parë që duhet mbrojtur është e drejta njerëzore, e drejta për të jetuar në paqe, e cila prevalon mbi gjithë të drejtat e tjera. Andaj dhe përvojat e hidhura historike, sido që reciproke, bëhen mësim për përmirësime e rimodelime të marrëdhënieve midis kombeve dhe etnive, në integritetet e tyre shtetërore të vendosura dhe të padiskutueshme më. Mësimi i pakthyesëm qëna jep situata në Ukrainë lidhet pikërisht me faktin se të gjithë ne, pavarësisht kombësisë dhe fesë, duhet të jetojmë dhe shohim të ardhmen tonë, për të mos i vënë zjarrin dasive të diskutueshme dhe kujtesave të mbushura me urrejtje, përçarje, luftëra.

**Ardian Ramadani**

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup*

# **NDIKIMI I LUFTËS RUSI - UKRAINË NË BALLKAN - RREZIK PËR PAQEN DHE STABILITETIN**

## **Abstrakt**

Arsyeja e përzgjedhjes për trajtim të kësaj teme, që zgjon interesin dhe kërshtërinë e studiuesve, politologëve, si dhe aktorëve të politikbërjes, jo vetëm në arealin shqiptarë, por edhe më gjerë, është se prania ruse në Ballkan është një rrezik jashtëzakonisht i madh për paqen dhe stabilitetin e brishtë të këtij nënqielli, shtu këtu edhe përplasjen Ukrainë-Rusi, si dhe pozicionimin e këtyre shteteve të kësaj pjese të globit për Ukrainën e kundër Rosisë.

Prania ruse në Ballkan, performon në forma të ndryshme, për shembull në Serbi, kjo prani është tejet e dukshme dhe me prani të bazës humanitare ruse në Nish, si dhe me paralajmërimin për ndërtimin e një bazë tjetër ushtarake në Serbi, shtu këtu edhe mbrojtjen diplomatike të punëtorëve të këtyre bazave, që i bën agjentët rus të paprekshëm dhe të fuqishëm. Kësaj gjëje i ndihmon shumë edhe rusofilia në mesin e popullatës serbe, që e ndjejnë veten si viktimë të "Perëndimit", si dhe rusocentrizmi i shtetarëve dhe politikanëve serbë.

Në shtete tjera, prania ruse është në formë agjenturore dhe mëton të kundërshtojë çdo përpjekje për paqim dhe stabilizim të Ballkanit. Përpjekjet për destabilizim bëhen përmes rrjeteve agjenturore në Ambasadën e Federatës Ruse, ku agjentë të trajnuar që flasin shkëlqyeshëm gjuhët e rajonit, kapin me grepin e tyre "njerëz jostabil", apo i joshin edhe përmes të hollave, me qëllim informimin për ecejakun e akëcil institucionit apo organit.

Pas shpërbërjes së BRSS-së në vitin 1991, e deri më sot, intervenimet e Rosisë në shtetet përreth nxjerrin në pah faktin që megjithëse ariu rus mund të ishte i lodhur e i plakur, ai ngelet edhe më tej ari dhe sfidë.

Mes tjerash, në punim do të theksohet se përballë ndikimit rus, pranisë ruse gjetiu, implikimeve nga lufta me Ukrainën, Shqipëria, Kosova, M. e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, më shumë se kurrë duhen të jenë të rreshtuar dhe të vendosur në aleancën e tyre me Perëndimin, me SHBA-të dhe me Evropën, duke punuar në sinkron dhe në koordinim të vazhdueshëm.

Pas shpërbërjes së BRSS-së në vitin 1991, ngrehina që mbeti nga kjo shkërmoqe, Rusia, e sflitur tejmasë, mbeti me gjysmën e popullsisë sa kishte në tërësi BRSS-ja dhe me një ekonomi tejet të rrënuar, e që me projektionin e saj të fuqisë globale u dërrmua dhe u zbeh ndjeshëm.<sup>63</sup>

Megjithë faktin që ajo ruajti një sasi shumë të madhe të arsenalit nuklear, duke ia tejkualuar edhe SHBA-së, u pandeh se fuqia e ariut rus ishte zbehur dhe nuk do të rikuperohej lehtë. Por, përdorimi i fuqisë së saj në rajon, fillimisht në Çeçeni, më pas në Gjeorgji (2008), e më tutje në Ukrainë (2014 dhe 2022) e nxori në pah faktin që megjithëse ariu mund të ishte i lodhur e i plakur, ai ngelej edhe më tej ari.

Me një ekonomi të bazuar tërësisht në energji, me një BVP prej 2.5 trilionë \$, me të ardhura për frymë prej 18000 \$, me sasi të mëdha gazi dhe naftë që përbëjnë 2/3-tat e eksportit rus dhe gjysmën e të ardhurave të shtetit dhe 20 % të BVP-së,<sup>64</sup> shtetimi rus, e posaçërisht i presidentit të saj Putin, për ngritjen e fuqisë ruse, duke pasur si synim gllabërimin dhe përdorimin e taktikës së tokës së djegur, shkon në drejtim të asaj që e pat thënë në një rast presidenti i saj, në bisedë e sipër me një nxënës, duke e pyetur se ku janë kufijtë e Rosisë, e ky nxënësi i gJORë, duke u përpjekur t`i japë përgjigjen e saktë presidentit rus, përpëlitej më kot, për ta çuar presidentin rus që t`i përgjigjej furishëm, e citoj "kufijtë e Rosisë janë të pambarim".

Kjo është në fakt edhe strategjia ruse, zgjerim në të tëra anët, pa kufizime.

Në një botë multipolare, në një botë tejet viskoze, fuqia e Rosisë për destabilitet mund të jetë e madhe, krahas synimeve të bllokut perëndimor për stabilitet, sepse tendenca për rrënim është shumë me e lehtë se ajo për ndërtim dhe paqtim.

<sup>63</sup> Joseph S. Nye, JR, A i ka ardhur fundi shekullit amerikan ?, Logos A, Shkup, fq. 38, 2019

<sup>64</sup> Po aty, fq. 39

Megjithë faktin se krahasuar me SHBA-të dhe me Evropën në tërësi, sistemi i shëndetësisë publike ruse është në kaos, mortaliteti është shumë i madh<sup>65</sup>, lindshmëria është në rënie, e vetëm një universitet rus është i radhitur në 100 më të mirët në botë <sup>66</sup>, si dhe transformimi postsovjetik i Rusisë përpëlitet si anija "Titanik" mes identitetit evropian dhe atij sllavofil, zotërimi i një numri të konsiderueshëm raketash dhe kokash bërthamore <sup>67</sup>, zotërimi i burimeve njerëzore të talentuara, industria e fuqishme e mbrojtjes, e bëjnë atë burim të përhershëm rreziku dhe me potencial të madh për destabilitet.

Kjo fuqi e saj u pa në luftën e Sirisë, po shihet sot në Ukrainë, e mund të themi lirisht se edhe në shtete të caktuara në Ballkan ky ndikim nuk është aspak i vogël. Strategjet e botës ruse, duke e kuptuar faktin se ka përfunduar "momenti njëpolar" (Joseph S. Nyer, JR), po pluskojnë dhe po kalkulojnë me dinakëri në nivel rajonal.

E provuan këtë gjë disa herë në Maqedoninë e Veriut, edhe pse dështuan, qoftë drejtpërsëdrejti, qoftë përmes Serbisë (Rusisë në miniaturë), mandej në Mal të Zi, në Veriun e Kosovës, e mos të flasim për në Serbi.

Qasja ruse në Ballkan ambalazhohet në paketime të ndryshme dhe performon vazhdimisht. Rusia në Ballkan kishte mëtuar dhe ishte përpjekur vazhdimisht të ishte e pranishme në forma të ndryshme. Mjafton të përmendim idenë e Panballkanizmit, ide tipike ruse, e sajuar nga Adam Czartoryski (1770-1861), në cilësi të ministrit të jashtëm të Carit rus Aleksandër I, pasi Polonia u nda nga Rusia, Prusia dhe Austria, e i cili përmes kësaj formule donte të siguronte nxitjen e ballkanasve për luftë kundër Perandorisë Osmane <sup>68</sup>, për të zaptuar më pastaj këto territore, pas largimit të osmanëve, duke sllavizuar dhe ortodoksizuar këtë rajon në tërësi përmes ndikimit rus.

Sot qasja e Rusisë dhe përpjekja për ndikim në Ballkan vjen përmes Serbisë. Mos të harrojmë se e ashtuquajtura « qendër humanitare » e Rusisë në

<sup>65</sup> <https://donnees.banquemondiale.org/indicator/SP.DYN.CDRT.IN?locations=RU>

<sup>66</sup> [https://hedclub.com/en/publication/a\\_crib\\_sheet\\_for\\_rankings\\_of\\_russian\\_universities\\_2020\\_31/fr](https://hedclub.com/en/publication/a_crib_sheet_for_rankings_of_russian_universities_2020_31/fr)

<sup>67</sup> <https://css.ethz.ch/content/dam/ethz/special-interest/gess/cis/center-for-securities-studies/pdfs/CSSAnalyse312-FR.pdf>

<sup>68</sup> Hysamedin Ferraj, Skicë e mendimit politik shqiptar, Logos-A, Shkup 1999, fq. 115



Nish, përgjegjëse për gjithë Gadishullin Ballkanik, është gjithçka, por jo edhe qendër ku ka aktivitete humanitare <sup>69</sup>. Është qendër spiunazhi, aktiviteti subversiv, ku mësymja çdoherë është destabiliteti i Kosovës në veçanti, e i rajonit në përgjithësi. Vlen të theksohet se punëtorët e kësaj baze kanë imunitet diplomatik.

Agjencia ruse në veriun e Kosovës është poashtu tejet aktive. Mjafton të përmendet këtu rasti rishtar i gazetares ruse që punon në median shtetërore ruse Komsomolska Pravda, Daria Aslamova, me burrin e saj, edhe ky gazetar, Robert Valdec, të cilët me pretendimin se kishin për qëllim vizitën e manastireve në Banjska dhe në atë të Deçanit <sup>70</sup>, e për të cilën e kishin edhe bekimin e peshkopit Stefan të Kishës Ortodokse Serbe, ishin në aktivitete të hapura spiunazhi.

Në anën tjetër, mos të harrojmë se 151 nga 250 deputetë të Kuvendit të Serbisë janë anëtarë të grupit të miqësisë Serbi – Rusi <sup>71</sup>.

Në ditën kombëtare të Rusisë, të shënuar më 12 qershor, në pranimin e organizuar nga ambasadori rus në Beograd <sup>72</sup>, paria shtetërore serbe thuaja se shënonte ditën kombëtare serbe, e jo atë ruse, e ku ishin të pranishëm: Daçiçi, Brnabiçi, Dodiku, Selakoviçi, me ç' rast në fjalimin e tij ambasadori Harçenko, vuri theksin në vëllazërinë ruso-serbe dhe partneritetin strategjik në pajtim me marrëveshjen e nënshkruar mes presidentëve Putin dhe Vuçiç, që qartazi e troç Serbinë e bën Rusi në miniaturë në Ballkan.

Në anën tjetër, po ky ambasador, Aleksandër Bocan- Harçenko, më 8 gusht, lëshoi njoftimin e tij, ku theksoi se "Rusia do të ndërtojë bazën e saj ushtarake në Serbi". <sup>73</sup>

Pra, Rusia, është tejet aktive në Serbi, e tërthorazi me agjencurat e saj edhe në rajon. Një agjent rus i ambasadës ruse në Maqedoninë e Veriut, që fliste

<sup>69</sup> <https://ballkani.info/qendra-humanitare-ne-nish-ne-sherbim-te-sherbimit-sekret-te-rusise/>

<sup>70</sup> <https://aktuale.mk/fole-gazetarja-ruse-e-perzene-nga-kosova-daria-aslamova-i-tregoi-medias-serbe-se-cfare-iu-interesonte-dy-agjenteve-kosovare-qe-e-intervistua/>

<sup>71</sup> <https://telegrami.mk/intervista-e-plote-e-kurtit-per-la-repubblica-qe-beri-buje-te-madhe-rrezikojme-lufte-pas-serbise-qendron-putini/>

<sup>72</sup> <http://www.ambasadarusije.rs/>

<sup>73</sup> <https://abcnews.al/nje-dhemb-i-semure-ne-nofullen-e-nato-s-cfare-do-te-thote-ndertimi-i-nje-baze-ushtarake-ruse-ne-serbi/>

shqipe të kulluar, e që shihej në çdo aktivitet kulturor, që më vonë, për shkak të aktivitetit të tij edhe do të dëbohej nga MPJ e M.V., është dëshmia më e mirë që e dëshmon këtë që e thash më lart.<sup>74</sup> Ndikimi i llojit të këtij agjenti nuk ishte edhe i vogël në parti politike, bashkësi fetare e kështu me radhë. Andaj, një koordinim i vendosur dhe i bashkuar për të frenuar këtë ambicie dhe mësymje ruse për ndikim dhe dominim është më se i domosdoshëm.

Përballë këtyre fakteve dhe akteve, Shqipëria, Kosova, M. e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, më shumë se kurrë duhen të jenë të rreshtuar dhe të vendosur në aleancën e tyre me Perëndimin, me SHBA-të dhe me Evropën, të punojnë në sinkron dhe të koordinohen vazhdimisht.

Krejt kjo sepse përballë janë dy alternativa, o me Perëndimin, o me Rusinë. Balancim nuk mund të ketë, e as neutralitet.

## Bibliografia

### Libra

Joseph S. Nye, JR, A i ka ardhur fundi shekullit amerikan ?, LOGOS-A, Shkup 2019  
 Ferraj Hysamedin, Skicë e mendimit politik shqiptar, Logos-A, Shkup 1999,

### Faqe interneti

<https://donnees.banquemondiale.org/indicator/SP.DYN.CDRT.IN?locations=RU>  
[https://hedclub.com/en/publication/a\\_crib\\_sheet\\_for\\_rankings\\_of\\_russian\\_universities\\_2020\\_31/fr](https://hedclub.com/en/publication/a_crib_sheet_for_rankings_of_russian_universities_2020_31/fr)  
<https://css.ethz.ch/content/dam/ethz/special-interest/gess/cis/center-for-securities-studies/pdfs/CSSAnalyse312-FR.pdf>  
<https://ballkani.info/qendra-humanitare-ne-nish-ne-sherbim-te-sherbimit-sekret-te-rusise/>  
<https://aktuale.mk/fole-gazetarja-ruse-e-perzene-nga-kosova-daria-aslamova-i-tregoi-medias-serbe-se-cfare-iu-interesonte-dy-agjenteve-kosovare-qe-e-intervistua/>  
<https://telegrami.mk/intervista-e-plote-e-rtit-per-la-repubblica-qe-beri-buje-te-madhe-rrezikojme-lufte-pas-serbise-qendron-putini/>  
<http://www.ambasadarusije.rs/>  
<https://abcnews.al/nje-dhemb-i-semure-ne-nofullen-e-nato-s-cfare-do-te-thotendertimi-i-nje-baze-ushtarake-ruse-ne-serbi/>  
<https://alsat.mk/moska-do-ti-pergjigjet-debimit-te-diplomatit-rus-nga-shkupi/>

<sup>74</sup> <https://alsat.mk/moska-do-ti-pergjigjet-debimit-te-diplomatit-rus-nga-shkupi/>

Muhamed Jashari

Studiues, Shkup

## PRANIA E RUSISË POST - SOVJETIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

### Abstrakt

*Shembja e Bashkimit Sovjetik nga skena e historisë, solli një realitet të ri jo vetëm në kontekstin evropian por edhe më gjerë. Trajtimi i Rusisë post-sovjetike u shndërrua në objekt hulumtimi nëpër qendrat e ndryshme studimore dhe atë qoftë në studimet regjionale, evropiane, madje edhe ballkanike. Pasardhësi i tij, Federata Ruse, lindi në rrethana të kaosit ekonomik dhe politik të fundshekullit XX-të, kurse politika e jashtme e vendit përjetoj transformime. Në të vërtetë, lidërshipi politik dhe hartuesit e politikës ruse që nga vitet e 90'ta, u përqendruan në realizimin e dy synimeve kryesore, rritjen e ndikimit global të Rusisë dhe në të njëjtën kohë, zhvillimin ekonomik të saj. Andaj, për të arritur këto qëllime, politika ruse publikoi një numër të konsiderueshëm të dokumenteve zyrtare në të cilën trajtoheshin aspektet e ndryshme politike, të sigurisë, socio-ekonomike, ushtarake etj.. Ndonëse Ballkani Perëndimor destinim kryesor ka integrimin në mekanizmat euroatlantik, megjithëkëtë, interesimi për të nuk mungoi edhe tek aktorët e ndryshëm tejbalkanik!*

*Në suaza të këtij punimi do të flitet pikërisht për praninë dhe kufizimet e aktiviteteve të Federatës Ruse në Ballkanin Perëndimor, si një rajon mjaft i ndjeshëm i kontinentit evropian. Rrjedhimisht, deri në çfarë mase establishmenti rus u përqendrua në marrëdhëniet me Ballkanin Perëndimor dhe çfarë në të vërtetë përfaqëson Ballkani Perëndimor për shtetin rus!?*

**Fjalët çelës:** *Koncepti i Politikës së Jashtme, diplomacia energjetike, ekonomizimi i politikës, zgjerimi i NATO-s*



## Konceptimi "Ballkani Perëndimor"

Gjatë periudhave të caktuara historike, rajoni ballkanik është definuar sipas emërtimeve të ndryshme. Megjithatë, pavarësisht kësaj, rëndësia që ka pasur rajoni ballkanik për paqen në Evropë nuk është vënë në dyshim asnjëherë. Andaj, fati i saj u shndërrua në çështje që zgjoi interesim të madh në kancelaritë e diplomacisë evropiane.

Gadishulli Ballkanik historikisht ka pasur një rëndësi strategjike, pasi që vendndodhja e saj e bën atë një udhëkryq të tre kontinenteve - Evropës, Azisë dhe Afrikës. Që prej kohëve më të hershme për të cilët janë mbajtur kronika, qasja drejt tij (Ballkanit) si nëpërmjet detit ashtu edhe tokës, e bën atë të hapur ndaj mësymjeve dhe grindjeve politike, ushtarake dhe kulturore. Në të kaluarën, gjashtë perandori të huaja - persiane, romake, bizantine, osmane, austriake dhe ruse - u përpoqën të zotëronin, tërësisht ose pjesërisht.<sup>75</sup>

Gjer në shek. XIX, tokave evropiane të Shtetit Osman, evropianët iu referoheshin me termat si *European Turkey*, *Turkey d'Europe*, *Turkey in Europe* (Turqia Evropiane, Turqia e Evropës, ose Turqia në Evropë). Për herë të parë në literaturën politike, shprehjet "Ballkan" dhe "Gadishulli Ballkanik" u përdorën nga gjeografi gjerman August Zeune në vitin 1808. Kurse emërtimi i rajonit të Ballkanit me idiomën "Gadishulli i Evropës Juglindore" të përdorur për herë të parë në vitin 1863 nga konsulli austriak Von Hahn, doli në skenë pikërisht në periudhën kur shtetet e mëdha të Evropës filluan të interesoheshin intensivisht për këtë zonë.<sup>76</sup>

Transformimet e emërtimeve të rajonit duket se ishin në pajtueshmëri me synimet gjeopolitike të fuqive të mëdha. Madje, edhe emërtimet e kohëpas-kohëshme të Ballkanit, bartnin sfondin dhe dimensionin gjeopolitik. Edhe Jugosllavia e dikurshme e cila pas luftës së dytë botërore, me tepër sesa një shtet që bënte pjesë në konjunkturën e Evropës Lindore, u shndërrua në referencë për të përcaktuar një zonë të *painkuadruar* të strukturës bipolare.

<sup>75</sup> Hupchick, P. Dennis. *The Balkans from Constantinople to Communism*. Palgrave, 2001, fq.3.

<sup>76</sup> Davutoglu, Ahmet. *Thellësia Strategjike: Pozita Ndërkombëtare e Turqisë*, Logos-A, Shkup, 2010, fq.158-159.

Rajoni ballkanik në shek. XX iu ekspozua luftërave të ndryshme që përjetoi kontinenti, që nga Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore dhe luftërave në ish Jugosllavi të cilët kishin përmasa evropiane. Luftëra këto që në qarqet mediatike, politike dhe intelektuale prodhuan termin "*ballkanizim*" e cila u bë sinonim i ndasive, konflikteve etnike, dhe barbarive të ndryshme.

Duke u nis nga fakti që Ballkani është fqinj i Unionit Evropian, dhe me qëllim që Gadishulli Ballkanik mos të shndërrohet në një vrimë të zezë për paqen dhe sigurinë në Evropë, në fillim të shek. XXI, UE-ja doli me një vizion të ri për rajonin dhe rrjedhimisht rajonit iu dha një emërtim i ri. Vizioni afatgjatë i UE-së ishte "*Stabilizim-Asocimi i Ballkanit Perëndimor*".<sup>77</sup>

Në të vërtetë, ky term hyri në përdorimin politik (*por edhe shkencor*) për të paraqitur marrëdhëniet reciproke ndërmjet UE-së dhe disa shteteve ballkanike, për të cilën UE-ja në vitet 2000-ta iu kishte premtuar të ardhme evropiane. Përkufizimi i referohet shteteve që dikur ishin pjesë e Jugosllavisë plus Shqipërinë mirëpo pa përfshirjen e Sllovenisë. Aktualisht në diskursin zyrtar evropian, kur bëhet fjalë për vendet e Ballkanit Perëndimor, në kuadër të këtij përkufizimi bëjnë pjesë shtetet si Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Perspektiva e anëtarësimit në UE, u perceptua gjerësisht si metoda më e mirë për të ndihmuar këto vende për të kapërcyer trashëgiminë e rëndë të luftërave të viteve 1990 dhe për të siguruar paqen dhe stabilitetin e qëndrueshëm<sup>78</sup>.

Pavarësisht realitetit që shtetet të cilët bëjnë pjesë nën këtë emërtim nuk kanë nivel të njëjtë marrëdhëniesh bilaterale me UE-në, megjithatë ky emërtim vazhdon edhe më tej, pasi që synimi i këtyre vendeve për integrim në UE është kusht *sine qua non*. Në anën tjetër, zyrtarët evropianë në takime të ndryshme të nivelit të lartë në vazhdimësi kanë ripohuar qëndrimet se "Ballkani Perëndimor është pjesë e së njëjtës Evropë si UE-ja, dhe se Unioni Evropian nuk është i plotë pa Ballkanin Perëndimor". Kjo ishte deklarata e presidentes së Komisionit

<sup>77</sup> Ibrahim, Arta. *Integrimi i Ballkanit Perëndimor në UE*, Logos-A, Shkup, 2009, fq.58.

<sup>78</sup> Lehne, Stefan. "Geopolitics, the EU and the Western Balkans", *Policy Paper* nr. 42/2020, Institute for Democracy "Societas Civilis", Shkup, 2020.

Evropian Ursula von der Leyen në samitin e realizuar ndërmjet UE-së dhe Ballkanit Perëndimor i cili i zhvilloi punimet në Slloveni në tetor të vitit 2021.<sup>79</sup>

Pra si nocion mund të thuhet që kemi të bëjmë me një përcaktim gjeopolitik të vendosur nga UE-ja, me qëllim që të përafrojë truallin ballkanik me Brukselin në të cilën përpjekjet e shteteve të lartpërmendura do të kurorëzoheshin me anëtarësimin e plotë në union. Termi *Ballkan Perëndimor* e ruan konotacionin e përdorimeve të vjetra të Ballkanit nga perëndimorët, ngaqë, edhe pse pranohet se popujt e Ballkanit Perëndimor i përkasin historisë së Evropës, nënkuptohet se ata kanë shumë punë për të bërë dhe rrugë të gjatë përpara se të bëhen "evropianë" dhe pjesë e "Evropës".<sup>80</sup>

Hapësira gjeografike në të cilën tashmë ndodhet Ballkani Perëndimor është e rrethuar nga shtetet anëtare të UE-së dhe NATO-s. Pa dyshim se mosshpejtimi i integritetit të kësaj pjese të Evropës me UE-në dhe NATO-n krijoi mundësi për aktorët e ndryshëm jashtëregjional që të zgjojnë interesimin edhe më tej për Ballkanin Perëndimor dhe kësajsoj të sfidohet apo në rastin më ekstrem, të pengohet procesi integrues.

## **Koncepti "Ballkan Perëndimor" në qarqet intelektuale dhe politike ruse**

Ndonëse Enciklopedia e Madhe Ruse (*Bol'shaya rossiyskaya entsiklopediya*) 35 vëllimshme, e cila botohet që nga viti 2004 dhe me vëllimin e fundit të botuar në vitin 2017, *Ballkanin Perëndimor* nuk e njeh si term të veçantë, dhe pavarësisht faktit që kjo shprehje buron nga politika evropiane, megjithatë ajo ka hyrë në përdorim në sferën akademike, intelektuale dhe politike të Federatës Ruse.

Nëse i referohemi dokumenteve zyrtare të Federatës Ruse të cilët përcaktojnë prioritetet politike siç është Koncepti i Politikës së Jashtme, shohim që rajonit për të cilën flasim, diplomacia ruse nuk i është referuar

---

<sup>79</sup> Council of European Union. Slovenian presidency of the Council of the European Union. Press Release, *Prime Minister Janez Janša: The Western Balkans need the European perspective*. Marrur nga: <https://slovenian-presidency.consilium.europa.eu/en/news/prime-minister-janez-jansa-the-western-balkans-need-the-european-perspective/>

<sup>80</sup> Sulstarova, Enis. *Jam Evropë*, Logos-A, Shkup, 2012, fq.58-59.

me emërtimin *Ballkani Perëndimor* por janë përdorur fraza si *Ballkani - Koncepti i vitit 2000-*, *Shtetet e Evropës Juglindore -Koncepti i vitit 2008-*, dhe në Konceptin e vitit 2013 janë inkorporuar edhe shprehja *Ballkan* dhe *Evropë Juglindore*. Megjithatë, kjo assesi nuk paraqet shmangie të tërësishme nga përdorimi i termit *Ballkan Perëndimor*.

Interes paraqet një komunikatë shtypi e lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Federatës Ruse, të datës 11 shkurt të vitit 2005, i cili i referohet raporteve ruso-kroate, ku ndër tjerash thuhet që, "Palët..., shkëmbyen mendime për situatën në Evropën Juglindore me theks në nënrajonin e Ballkanit Perëndimor".<sup>81</sup> Bazuar në arkivin e komunikatava për shtyp të Ministrisë së Punëve të Jashtme ruse, kjo na rezulton të jetë rasti i parë ku në qarqet e diplomacisë ruse, në marrëdhëniet bilaterale me një shtet ballkanik hyri në përdorim shprehja *Ballkani Perëndimor*.

Interesante është fakti që në një vepër të botuar nga Akademia e Shkencave Ruse – Instituti i Studimeve Sllave, shprehja *Ballkani Perëndimor* konsiderohet si, "...historikisht e pakuptimtë dhe që nuk ka ekzistuar më parë".<sup>82</sup> Mirëpo, ky term tashmë ka zënë vend edhe në suaza të komunitetit akademik rus.

Kohëve të fundit, mbi politikën e jashtme ruse kundrejt Ballkanit, janë realizuar studime serioze nga institucione të rëndësishme shkencore siç është "Shoqata Ruse për Studime Ndërkombëtare" pranë Institutit Shtetëror të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Moskë (*МГИМО*), ku mes tjerash saktësohen raportet e Federatës ruse *vis-à-vis* Ballkanit Perëndimor.

Në këtë aspekt mund të themi që nëpër qendrat studimore dhe vendimmarjen politike ruse, termet *Ballkan* ose *Ballkani Perëndimor* përdoren duke mos paraqitur ndonjë dallim të rëndësishëm thelbësor. Pa marrë paraysh emërtimet të cilat i përjetoi rajoni ballkanik, qoftë si pjesë e Evropës Lindore ose Juglindore, por edhe tani si *Ballkan Perëndimor*, kjo aspak nuk e

<sup>81</sup> The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation. *Russian-Croatian Consultations*, Press Release, Marrur nga: [https://www.mid.ru/en/foreign\\_policy/news/1664318/](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1664318/)

<sup>82</sup> Nikiforov V. Konstantin. "Chetyre aspekta vostochnoyevropeyskoy transformatsii", Në, *Mezhdru Moskvoy i Bryusselem*, Akademia Ruse e Shkencave - Instituti i Studimeve Sllave, Moskë, 2016, fq. 11.

ul rëndësinë që ky rajon ka për Moskën zyrtare dhe arritjen e objektivave të politikës së jashtme ruse.

### **Ballkani Perëndimor në agjendën e prioritetëve ruse**

Tradicionalisht Moska është konsideruar si një vend që është përfshirë në Ballkanin Perëndimor që nga shekujt e mëparshëm, dhe i cili ka zhvilluar marrëdhënie mbi bazën historike, kulturore e politike me rajonin. Ballkani është konstruktuar si burim frymëzimi si dhe vendi ku Rusia huazoi tipare sakrale të ekzistencës së saj, siç është krishterimi, huazimi i alfabetit cirilik nga Perandoria Bizantine, artefaktet e ndryshme kulturore etj..<sup>83</sup>

Marrëdhëniet kulturore dhe fetare, për Perandorinë Ruse nënkuptonin që ajo e posedonte të drejtën e mbrojtjes së shteteve sllave ortodokse në Ballkan, atëherë kur në shek. XIX Perandoria Osmane gjithnjë e më tepër e humbte fuqinë. Gjatë kësaj periudhe, Rusia kishte për synim që nëpërmjet përdorimit efektiv të kishës ruse, të bashkojë shtetet ballkanike me anë të religjionit ortodoks.

Vendndodhja e rajonit ballkanik si një lokacion ndërmjet Detit të Zi, Detit Mesdhe, dhe Detit Adriatik në kontinuitet ka zgjuar interes tek qarqet politike të Rusisë edhe për faktin që kësaj Rusisë i mundësohej zbarkimi në ujërat e ngrohta. Megjithatë, nëse i kthehemi aspekteve historike të shekullit të kaluar, shohim që nuk është se ka pasur marrëdhënie të shkëlqyera ndërmjet Rusisë dhe Ballkanit. Nuk duhet harruar që pas revolucionit të territorit, Bashkimi Sovjetik dhe Mbretëria Jugosllave nuk kishin marrëdhënie diplomatike deri në vitin 1940. Madje, në Jugosllavinë e atëhershme (*Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene*) u strehuan të gjithë ata të cilët ikën nga regjimi bolshevik. Në anën tjetër, Kominternat- *Internacionalja Komuniste*, Jugosllavinë e konsideronte "...birucë të popujve" dhe "shovinistë të mëdhenj serbë – shtypës të maqedonasve, kroatëve, shqiptarëve, malazezëve, hungarezëve, gjermanëve dhe italianëve".<sup>84</sup>

<sup>83</sup> Samokhvalov, Vsevolod. *Russian-European Relations in the Balkans and Black Sea Region: Great Power Identity and the Idea of Europe*, Palgrave MacMillan, 2017, fq.48.

<sup>84</sup> Timofeev, Aleksey. "Myths about Russia and Dynamics of the Development of Russian Foreign Policy Interests in the West Balkans". Në, Petrović N. Žarko (red.). *Russia Serbia*



Bashkëpunimi politik, ushtarak dhe ekonomik i Jugosllavisë me sovjetikët i cili filloi në vitin 1940 ishte jetëshkurtër, për faktin që u pasua nga një ndërprerje në vitin 1948, pikërisht atëherë kur Jugosllavia komuniste u shndërrua në armik të Moskës po aq sa vendet kapitaliste.<sup>85</sup> Me një fjalë, pa varësisht asaj se Jugosllavia ideologjikisht ishte e afërt me Bashkimin Sovjetik, raportet e tyre i karakterizonte tensionimi dhe nuk kishin zhvillim normal.

Diplomacia ruse u bë e pranishme në zhvillimet që kaloi Ballkani në fillim të viteve të 90'ta, megjithatë në Konceptin e Politikës së Jashtme të Rusisë të vitit 1993 Ballkanit nuk iu kushtua aq rëndësi dhe prioritet. Shtetet e rajonit ballkanik në bazë të këtij dokumenti politik rus, trajtohen në pjesën e zonës së Evropës Lindore, e që për Rusinë ashtu siç thuhej në të (në Koncept), ...*historikisht përbën zonë të interesit*.<sup>86</sup>

Përdorimi i shprehjes *zonë e interesit* në vend të shprehjes *zonë e ndikimit* është një shprehje që na bie në sy. Historikisht koncepti i *sferës së ndikimit*, në mendimin politik rus, siç vë në dukje Dmitri Trenin nënkuptonte sferën që e ndanë nga rivalët e tjerë, dhe njëkohësisht ishte terren për të avancuar në kërkim të ndikimit dhe sigurisë<sup>87</sup>. Në anën tjetër, *sfera e interesit* është 'më e lehtë' dhe më specifike, pa kontroll ideologjik dhe politik.<sup>88</sup>

Marrëdhëniet e Moskës zyrtare me vendet e Ballkanit perëndimor, në formën aktuale u kuptimësuan në fund të viteve 90-ta dhe fillim të 2000-ve. Andaj, duket se ideja dhe propozimet për krijimin e një aleance ortodokse ose një "bashkimi sllav" midis Rusisë dhe Ballkanit mbetën vetëm në fazën retorike folkloriste!

*Relations at the beginning of XXI Century*. -ESSAY COMPENDIUM- ISAC Fund, International and Security Affairs Centre, Beograd, 2010, fq. 19-24.

<sup>85</sup> Samorukov, Maksim. *Illyuziya blizosti: ambitsii i vozmozhnosti Rossii na Zapadnykh Balkanakh*. Carnegie Moscow Center, 2017.

<sup>86</sup> Kontseptsiya vneshney politiki Rossiyskoy Federatsii. Ministria e Punëve të Jashtme të Federatës Ruse. *Diplomaticheskiy vestnik*, 1993, nr. 1-2.

<sup>87</sup> Trenin, Dmitri. "Russia's Spheres of Interest, not Influence", Në, *The Washington Quarterly*, Vëll. 32, nr. 4, 2009, fq. 4.

<sup>88</sup> Hast, Susanna. *Spheres of Influence in International Relations History, Theory and Politics*, ASHGATE, 2014, fq.18-39.

## Dimensionet gjeopolitike të kontakteve ruse - ballkanase

Gazeta ruse *Izvestiya* në një artikull të vitit 2000 shkroi se, "Asnjë vend i vetëm i Evropës Lindore, madje edhe ai më sllav dhe më ortodoks, nuk do të heqë dorë nga marrëdhëniet me Perëndimin për hir të Ruisë". Edhe pse prania e shtetit rus në Ballkan nuk ka qenë e një pozicioni dominues por ishte e dobët, përsëri ajo nuk ishte një zonë nga e cila Rusia do të hiqte dorë lehtësisht, veçanërisht pasi dukej se Perëndimi po hynte me shpejtësi.<sup>89</sup>

Përtej lidhjeve historike, kulturore (por edhe fetare) Federata Ruse në fillim të shek. XXI ishte në kërkim të rikthimit të aktiviteteve të saja në rajon. Shpeshherë në retorikën e politikbërësve rus në krye me presidentit Putin, Ballkani (*lexo: Kosova*) është përdorur në kontekst të prishjes së rendit normativ të pas Luftës së Ftohtë.<sup>90</sup>

Kriza e rëndë ekonomike dhe financiare që përjetoi shteti rus në vitet e 90-ta, zgjerimi i mëtejshëm i Aleancës së NATO-s (Poloni, Çeki, Hungari) dhe ndërhyrja e NATO-s në Kosovë në vitin 1999, padyshim që përbënin parametra të rëndësishme që duhej t'i merr parasysh udhëheqësia e ruse në riorganizimin e politikës së jashtme kundrejt Evropës Lindore në përgjithësi por edhe rajonit të Ballkanit në veçanti.

I gjithë ky realitet historik dhe politik, ishte faktor që Federata Ruse si aktor në skenën evropiane por edhe botërore, në mileniumin e ri të hyj nga një pozicion jo edhe aq i favorshëm krahasuar me shtetet tjera. Andaj, administrata e presidentit Putin me qëllim të ruajtjes së pranisë së saj në Ballkan, kishte të domosdoshëm që t'iu përshtatet këtyre konjunkturave, dhe mbi bazën pragmatike t'i ndërton raportet me vendet e rajonit.

Ballkani paraqet një rëndësi jo vetëm në strukturën bilaterale *Rusi vs Ballkan Perëndimor*, por ai është i rëndësishëm edhe për ecurinë e

<sup>89</sup> Gvosdev, K. Nikolas & Marsh Christopher. *Russian Foreign Policy: Interests, Vectors, and Sectors*, SAGE Publications Ltd, Washington D.C, 2014 fq.221-226.

<sup>90</sup> Bechev, Dimitar. "Russia in the Balkans: Conference Report". *The Balkans in Russia's Foreign Policy Strategy Russia and Conflict Resolution in the Balkans. The Economic Dimension Russian & Soft Power*. LSEE Research on South Eastern Europe & SEESOX South East European Studies at Oxford, *London School of Economics*, 2015.

marrëdhëniet *Rusi- UE*, dhe *Rusi – NATO*.<sup>91</sup> Politika e tanishme ruse në Ballkan thuhet se është një vazhdimësi e politikës së viteve të 70-ta. Ballkani është një rajon i rëndësishëm për Moskën për dy arsye themelore:

a) Së pari, është një zonë konkurrence me aktorë të tjerë si UE-ja, NATO, dhe SHBA-të, dhe

b) së dyti, rrugë për furnizimin energjetik në Evropë.

Kontrolli mbi këtë arterie është i rëndësishëm për formimin e marrëdhëniet ekonomike dhe politike në rajon.<sup>92</sup>

Rëndësinë që kishte Ballkani për politikën e jashtme të Federatës Ruse e shprehu edhe Vladimir Putin gjatë vizitës në rajon në qershor të vitit 2001, ku theksoi se, "Ballkani është emërtuar ndër prioritetet rajonale të Rusisë në Konceptin e politikës së jashtme" dhe se, "jo vetëm faktorë gjeopolitikë por traditat historike, afërsia gjeografike e rajonit me kufijtë rusë përcaktojnë rëndësinë strategjike të Evropës Juglindore për Rusinë".<sup>93</sup>

Faktorët gjeopolitikë konsiderohen ndër faktorët teje të rëndësishëm të interesimit të Federatës Ruse për Ballkanin Perëndimor. Në të vërtetë, ndenja e elitës politike ruse për ta perceptuar shtetin e tyre si *fuqi e madhe* madje edhe *evropiane* i ka shërbyer idesë së involvimit dhe pranisë së saj në Ballkanin Perëndimor.

Rusia në formën e saj qoftë cariste, sovjetike dhe tani post-sovjetike ka një histori përpjekjesh për të imponuar veten si një *fuqi e madhe* jo vetëm në kontinentin evropian por edhe në përmasat botërore.

Prania ruse në Ballkan ndër vite, do të mund të realizohej duke pasur në konsideratë mundësitë reale në arritjen e interesave të saja shtetërore. Për këtë shkak, Sergei Razov ish ambasador i Federatës Ruse në Poloni, theksoi ndryshimin e qasjes së qeverisë ruse kundrejt Evropës Lindore përfshirë Ballkanin, si dhe vendosjes së një qasje të mirëpërcaktuar në të cilën fokusi

<sup>91</sup> Entina, Ekaterina. Pivovarenko, Alexander. "Russia in the Balkans: The Balkans at the Epicentre of International Developments." Russian International Affairs Council- RIAC.

<sup>92</sup> Jagiełło, Bogusław. "The Balkan Kettle: Russia's policy towards the Balkans". Në, *Security & Defence Quarterly*, War Studies University, Poland, 3/2021, Vëll. 35. fq.52.

<sup>93</sup> Headley, James. *Russia and the Balkans: Foreign Policy from Yeltsin to Putin*. London, HURST & COMPANY, 2008, fq. 430.

është i përqendruar kryesisht në bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik mirëpo duke u bazuar në konsiderata pragmatike.<sup>94</sup>

Në përgjithësi, mund të thuhet që politika ruse kundrejt Ballkanit Perëndimor në vetvete bartte dimension tre vektorial. Ajo kryesisht është bazuar në sektorin energjetik, politikat e sigurisë dhe dimensionin identitar. S'do mend se politika energjetike në mënyrë të pakrahasueshme ka qëndruar më lartë se sa aspekti i sigurisë apo ai identitar, ndonëse dy të fundit, sidomos politikat në fushën e sigurisë -siç janë bashkëpunimi në sferën ushtarako-politike ose bashkëpunimi në menaxhimin e emergjencave-konsiderohen të një rëndësie të veçantë<sup>95</sup>.

Mirëpo, nëse nisemi nga fakti që vendet e Ballkanit Perëndimor busull orientuese kanë integrimin në strukturat euroatlantike, e cila tashmë kjo ka marr trajtën e një *identiteti politik*, narrativi i integritit evropian dhe vlerave perëndimore tejkalon thellësinë e lidhjeve kulturore-historike dhe emocionale me Federatën Ruse.

Në suaza të kushteve të atilla në të cilën u gjet rajoni i Ballkanit që pas rënies së Jugosllavisë, forca shtytëse e politikës së jashtme ruse ndaj Ballkanit u bë *ekonomizimi i politikës së jashtme*.

Detyra ekonomike e Rusisë në këtë rajon u konceptua si një çështje e përparësisë më të lartë gjeopolitike. Fokusimi mbi *ekonomizimin*, pasqyro interpretimin e përqendruar në një politikë të jashtme të mbështetur mbi benefitet e bashkëpunimit ekonomik si dhe mbi "pjesëmarrjen në proceset dhe institucionet globale të dominuara nga Perëndimi".<sup>96</sup>

Në këtë formë, ekonomizimi i politikës së jashtme i shërbeu jo vetëm promovimit të interesave ekonomike të Rusisë në një hapësirë e cila ka të ardhme evropiane, por ajo ishte edhe mjet i përvetësimit të shteteve të Ballkanit.

---

<sup>94</sup> Gvosdev K. Nikolas. "Gas, Guns, and Oil: Russia's "Rubble Diplomacy" in the Balkans". Në, *Wilson Center*.

<sup>95</sup> Sergeevna, Polina, Sokolova. "Yevro-atlanticheskaya Oriyentatsiya Zapadnykh Balkan", *Mirovaya Ekonomika i Mezhdunarodnyye Otnosheniya*. Vëll. 60, Nr.7, 2016, fq. 44.

<sup>96</sup> Petrillo, Roberta, Enza. "Russian foreign policy towards the Balkans: which perspective?", *ISPI - Istituto per gli studi di politica internazionale*, Nr..169, 2013, fq.1-7.

Fokusimi rus në Evropën Juglindore por në veçanti edhe në Ballkanin Perëndimor, kryesisht prioritet kishte interesat ekonomike dhe financiare, investimet, blerjen e pronave, etj..<sup>97</sup> Kjo përkoi me një rinisje të politikës ruse ndaj Ballkanit e cila paralel me bisedimet për statusin e Kosovës dhe projektet energjetike Rusia bëri një rikthim të fuqishëm, duke forcuar lidhjet me aktorët vendas.

Marrë në përgjithësi, në rajonin post-sovjetik, por edhe rajonin e Ballkanit Perëndimor, investimet ruse në sferën bankare, financiare u rritën, dhe ndonëse motivimet janë kryesisht komerciale, mirëpo do të ishte naive që të shpërfillnim dhe mos të marrim në konsideratë aspektin gjeopolitik<sup>98</sup>.

Madje, nuk është se Ballkani Perëndimor posedon një peshë të madhe ekonomike për Rusinë, nuk duhet harruar që mbi 70% e tregtisë së jashtme të vendeve ballkanike zhvillohet me shtetet e UE-së e cila përbën investuesin kryesor në rajon, vetëm 6.6% e Investimeve të Huaja Direkte vijnë nga Rusia dhe pjesa e Rosisë në tregtinë e jashtme rajonale është 3.9% për eksportet dhe 5.3% për importet<sup>99</sup>.

Kurse aksionet e vendeve të Ballkanit Perëndimor në tregtinë e Federatës ruse praktikisht nuk e kalojnë shifrën as prej 1%. Duke u nis nga ky realitet, marrëdhëniet serioze politike nuk mund të ndërtohen mbi një themel të tillë ekonomik.<sup>100</sup>

---

<sup>97</sup> Psh. kur jemi tek blerja e pronave në Mal të Zi llogaritej se rreth 30 mijë qytetarë rus, kishin blerë tokë dhe apartamente. Ish kryebashkiaku i Moskës Yuri Luzhkov gjithashtu ishte një ndër oligarkët rus që kishte blerë parcela toke, kurse blerja e pronave të tokës, ishte një mjet shtesë i aktiviteteve ekonomike ruse në vend. Sipas disa sondazheve, më shumë se 40% e pasurive të paluajtshme në Mal të Zi u përkisnin politikanëve dhe miliarderëve rusë, ndërsa në bazë të të dhënave nga ambasada ruse numri i shtetasve rusë me qëndrim të përhershëm në Mal të Zi arrinte shifrën ndërmjet 5000 dhe 7000. Shih në, Dusica, Tomovic. "Russians Dominate Foreign Ownership of Montenegrin Companies", Në, BIRN *BalkanInsight*, 18 Gusht, 2016.

<sup>98</sup> Lo, Bobo. *Russia and the New World Disorder*. Brookings Institution Press, Chatham house, London Washington, D.C. 2015. fq.28.

<sup>99</sup> Konrad-Adenauer-Stiftung, *The influence of external actors in the Western Balkans*, Berlin, 2018, fq. 5.

<sup>100</sup> Ponomareva, G.E. "Balkanskaya Politika Rossiyskoy Federatsii: v poiskakh poteryannogo vremeni?", Në, *Vneshnyaya Politika Rossii: Global'noye i Regional'noye Izmereniya*, Vëll. 1,

Në kontekstin ballkanik, kemi një situatë interesante të përfshirjes së veprimtarisë ekonomike dhe financiare ruse e cila jo domosdoshmërisht ka qenë e lidhur me përfitimin dhe aspektin komercial të kompanive ruse që operojnë në rajon.

Si shembull ilustrativ mund ta përmendim kompaninë ruse *Zarubezhneft* e cila ka nën kontroll dy rafineritë e naftës në Republika Srpska dhe që posedon monopol në tregun e produkteve me bazë naftë. Ajo raportoi për humbje të konsiderueshme financiare në këtë shtet, por në të njëjtën kohë nuk kishte sinjalizuar asnjë qëllim për t'u larguar.<sup>101</sup> Kjo ishte një tregues që fitimi ekonomik ishte i një rëndësie sekondare sesa ndikimi mbi Republika Srpska.

Se synimi i kompanive shtetërore ruse të cilët operojnë në shtetet e Ballkanit (*psh. Serbi*), nuk është vetëm aspekti ekonomik dhe dobia financiare, e dëshmon fakti që kompania *LUKoil* prej që kur operon në shtetin serb ka ofruar llojet të ndryshme të mbështetjes për institucionet lokale arsimore dhe shëndetësore, si dhe projekte që synojnë mbrojtjen e pasurisë kulturore e shpirtërore dhe promovimin e dialogut ndërkulturor.<sup>102</sup>

Konsiderojmë që kjo është një veçori interesante që përveç aspektit ekonomik kompanitë ruse në Serbi shtrijnë aktivitete tjera dhe luajnë rol edhe në dimensionet e ndryshme sociale dhe shoqërore të popujve dhe shteteve ballkanike. Në këtë formë, këto aktivitete kontribuojnë dhe janë pjesë e imazhit të soft-power- *fuqisë së butë* në të cilën Rusia synon që ta kultivojë gjithandej nëpër botë por edhe në Ballkanin Perëndimor posaçërisht në vendet sllavishtfolëse.

Prania ekonomike dhe tregtare ruse në Serbi ndër të tjerash ishte edhe një favor të cilin Beogradi ia kthente Moskës për shkak të qëndrimit që diplomacia ruse e mbante dhe e bllokonte njohjen e pavarësisë së Kosovës

---

Pjesa 1. Shoqata Ruse për Studime Ndërkombëtare (RAMI), Universiteti MGIMO - Moskë, 2016, fq.491.

<sup>101</sup> Secieru, Stanislav. "Russia in the Western Balkans Tactical wins, Strategic Setbacks", Në, *Brief/8, Geopolitical Series*, 2019, fq.1-8.

<sup>102</sup> *LUKOIL in the Republic of Serbia*. Marrur nga. <https://www.lukoil.com/Company/BusinessOperation/GeographicReach/Europe/LUKOILinSerbia>,

nga OKB-ja<sup>103</sup> Andaj, gatishmëria e Federatës ruse për të bllokuar njohjen e Kosovës nga OKB-ja dhe për të ofruar mbështetje diplomatike për Serbinë në organizatat e ndryshme ndërkombëtare duket se ka lehtësuar depërtimin e kompanive ruse në Serbi, dhe në këtë mënyrë duke i dhënë Moskës një levë më të madhe.<sup>104</sup>

## Narrativi rus për Ballkanin Perëndimor si një vatër krize

Rikthimi i intensifikimit të pranisë ruse në Ballkanin Perëndimor sidomos në gjysmën e dytë të 2000-ve, në bazë të raporteve ruse solli *Procesin e Berlinit* - i cili u lansua në vitin 2014, me qëllim që shtetet të shënojnë progres dhe reforma si pjesë e politikave zgjeruese evropiane. Sipas qarqeve intelektuale ruse, shpresa për anëtarësim dhe reformat në interes të UE-së tek vendet e Ballkanit Perëndimor, ndonëse mund të jenë në kundërshtim me interesat e tyre nacionale, zakonisht përdoren si bazë për të kufizuar ndikimin e jashtëm (*kryesisht rus*).<sup>105</sup>

Nuk ka dyshim që çdo shtet si anëtar i shoqërisë dhe sistemit ndërkombëtar, posedon të drejtën të kultivojë marrëdhënie bilaterale e multilaterale me vendet ose rajone të ndryshme, në këtë mënyrë të avancoj interesat e saja kombëtare. Mirëpo në rastin e Federatës ruse dhe të establishmentit politik rus, tendenca është që jo vetëm të promovohen interesat shtetërore, por në të njëjtën kohë të dobësohen interesat e aktorëve të tjerë, si pjesë e një luftë *hobsiane* për dominim dhe pushtet.<sup>106</sup>

Është e rëndësishme të përmendim që në bazë të *Këshillit Rus për Çështje Ndërkombëtare RIAC* - një *Think Tank* me kredibilitet të lartë në

<sup>103</sup> Rustemi Arlinda. Wijk, de Rob. Dunlop, Connor. Perovksa, Jovana. Palushi, Lirije. *Geopolitical Influences of External Powers in the Western Balkans*. The Hague Centre for Strategic Studies, 2019, (pa datë botimi), fq. 113.

<sup>104</sup> Stronski, Paul. Himes, Annie. *Russia's Game in the Balkans*, Carnegie Endowment for International Peace, 2019.

<sup>105</sup> Entina, Ekaterina. Pivovarenko, Alexander. Novaković, Dejan. "Where Are the Balkans Heading? A New Cooperation Paradigm for Russia", *Valdai Discussion Club Report*, Valdai Discussion Club, Moskë, 2018, fq. 8-9.

<sup>106</sup> Clark, David. Foxall, Andrew. *Russia's Role in the Balkans - Cause for Concern?* The Henry Jackson Society, 2014, fq.2.

Rusi- krijimit të imazhit të Rusisë në Ballkan si *fuqi e madhe* dhe *alternativë globale* e cila operon në suaza të multipolaritetit, i kanë kontribuar themelimi i Unionit Ekonomik Euroaziatik, operacioni ushtarak në Siri, bashkëpunimi me Turqinë e Iranin si dhe ndërveprimi me vendet e BRICS-it. Një perceptim i këtillë ndaj Federatës ruse tek aktorët e ndryshëm politik në Ballkan, konsiderohet ndër sukseset politikës së jashtme ruse kundrejt rajonit.<sup>107</sup>

Tek qarqe të ndryshme politike (*parti apo organizata politike*) në Ballkanin Perëndimor narrativi mbi Federatën Ruse si një *fuqi e madhe* dhe pjesë e sistemit multipolar zuri vend në diskutimet dhe paraqitjet e tyre publike.<sup>108</sup>

Vlen të përmendim që pas ngjarjeve në Ukrainë dhe aneksimit të Krimësë në vitin 2014, qarqet politike ruse intensifikuan bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm politikë në rajon për të krijuar disponimin anti-NATO. Në këtë kontekst, partia kryesore ruse "*Rusia e Bashkuar*" në Kongresin e saj të XV-të, të mbajtur në vitin 2016, nënshkroi një deklaratë bashkëpunimi me disa parti nga Ballkani Perëndimor, përfshirë Partinë Demokratike të Serbëve të Maqedonisë për "*krijimin e një territori ushtarakisht neutral në Ballkan*".<sup>109</sup> Padyshim që ky veprim shënoi orientimin prorus dhe anti-NATO të disa partive nga vendet e Ballkanit, por kjo lëvizje ishte më shumë simbolike sesa një veprim që do të kërcënonte seriozisht zgjerimin e NATO-s në vendet e Ballkanit Perëndimor, pasi që partitë udhëheqëse ballkanike nuk iu bashkuan kësaj agjende ruse!

Interesante paraqet fakti që në rastin e Maqedonisë gjatë trazirave në Kumanovë të datës 9 maj të vitin 2015, disa ditë më vonë shefi i diplomacisë ruse Sergej Lavrov para Asamblesë Federale ruse tha se "ngjarjet maqedonase drejtohen nga jashtë... pas gjithë kësaj qëndron ende dëshira për të ndi-

<sup>107</sup> Entina, Ekaterina. Pivovarenko, Alexander. "The Evolution of Russia's Presence in Southeast Europe and Russia's New Strategy". Russian International Affairs Council- RIAC.

<sup>108</sup> Psh. në *talk show*-in televiziv *Jadi Burek* - i cili transmetohet në orët e vona të mbrëmjes, në SONCE TV në emisionin me datë 6 prill të vitit 2022, lideri i një partie parlamentare maqedonase duke iu referuar politikës së jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndër tjerash tha: "*Ku është Kina, ku është Rusia, tash edhe ata janë fuqi botërore*"?!

<sup>109</sup> Balkan Insight. "Putin's Party Signs 'Military Neutrality' Agreements with Balkan Parties", Marrur nga: <https://medium.com/@balkaninsight/putins-party-signs-military-neutrality-agreements-with-balkan-parties-8f2bbad4c23>



kuar tek ai (ish kryeministri Gruevski: *shën. i ynë.*) për shkak të refuzimit të tij për t'iu bashkuar sanksioneve kundër Rusisë..<sup>110</sup> Madje, Sergej Lavrov poentoi faktorin shqiptar si element destabilizues për të minuar qeverinë. Ai shkoi aq larg sa që përmendi, "federalizimin e Maqedonisë... ndarjen e saj midis Bullgarisë dhe Shqipërisë... dhe krijimin e Shqipërisë së Madhe!"<sup>111</sup>

Narracionet e këtilla të cilët diplomacia ruse i përmend në kontekstin ballkanik, kryesisht përdoren me qëllim që në opinionin ndërkombëtar të krijohet perceptimi se Ballkani, pavarësisht pranisë perëndimore, edhe më tej është vatër e krizës. Sipas logjikës së Kremlinit sa më shumë që Perëndimi t'i kushtojë vëmendje Ballkanit, aq më pak do të angazhohet në rajonin post-sovjetik.

Pa dyshim që Zgjerimi i aleancës së NATO-s në Ballkanin Perëndimor gjatë viteve 2009, 2017 dhe 2020, fillimi i negociatave të anëtarësimit në UE për Serbinë, Malin e Zi, Shqipërinë e Maqedoninë e Veriut, ruajtja e stabilitetit në Bosnje - e konfirmuar edhe në samitin e NATO-s në Vilnius- dhe Kosovë përmes mekanizmave perëndimor praktikisht e shndërroi Ballkanin në pjesë të orbitës euroatlantike. Përsheptimi i procesit eurointegruës në Ballkanin perëndimor sidomos pas agresionit rus në Ukrainë (2022) e çimenton dhe përmbush synimet europianizuese të Ballkanit. Madje me këtë kurorëzohet përpyekja 30 vjeçare perëndimore që Ballkani t'i përqafojë vlerat evropiane.

## Përfundim

Nga gjithsej gjashtë shtete të Ballkanit Perëndimor, tre vende (Shqipëria, Mali i Zi, dhe Maqedonia e Veriut) tashmë janë pjesë e aleancës së NATO-s, Mali i Zi dhe Serbia janë në procesin negociues (përfshirë Shqipërinë dhe Maqedoninë e veriut) që në të ardhmen e afërt të bëhen anëtare të plotfuqishme me UE-në, kurse tek dy vende (Bosnja Hercegovina dhe Kosova) siguria varet pikërisht nga prania politike dhe ushtarake e UE-së dhe NATO-s të cilët garantojnë paqen dhe stabilitetin në truallin ballkanik.

<sup>110</sup> Federal'noye Sobraniye Rossiyskoy Federatsii. *Sovet Federatsii*. Nr. Cr-374, 20.05.2015.

<sup>111</sup> Ibid

Shtete e Ballkanit Perëndimor jo vetëm që destinim kryesor kanë anëtarësimin në UE dhe në NATO (*përveç Serbisë aktualisht*), por për ta nuk ka alternativë tjetër! Çdo rrugë tjetër jashtë strukturave euroatlantike Ballkanin e bën jostabil, të paqëndrueshëm dhe që i ekspozohet fërkimeve të ndryshme.

Ndërhyrja e NATO-s në BeH (1995) dhe Kosovë (1999), fillimi i procesit të Stabilizim Asocimit në vitin 1999 dhe roli kyç i diplomacisë perëndimore në përfundimin e konfliktit në Maqedoni në vitin 2001 përmes Marrëveshjes së Ohrit, konsiderohen si tregues të rëndësishëm që kontribuuan në kufizimin i rolit rus në rajon në fillim të shekullit XXI. Bazuar në këto parametra, për dallim nga hapësira post-sovjetike, Ballkani u vendos në prioritetet më të ulëta, andaj Federata Ruse ndoqi një politikë që fokusohej kryesisht në aspektin ekonomik por padyshim që kishin përmasa gjeopolitike.

Anëtarësimi i vendeve të kësaj pjese të Ballkanit në UE dhe NATO, edhe pse për Rusinë nuk përbën kërcënim të drejtpërdrejtë, kjo pasiqë Ballkani perëndimor është i shkëputur gjeografikisht nga kufijtë e Ruisë, por establishmenti rus, konsideron se zgjerimi NATO-s do të vijon drejt hapësirës post-sovjetike. Sado që Federata Ruse i intensifikon marrëdhëniet e saj me Ballkanin Perëndimor, ajo nuk është në pozitë dominuese për të imponuar vullnetin e saj mbi vendet e rajonit.

Dinamika e marrëdhënieve ruso-ballkanase diktohet edhe nga ecuria e marrëdhënieve ruso-perëndimore. Me një fjalë, sa më konstruktive dhe normale të ishin marrëdhëniet e Federatës Ruse me vendet dhe institucionet perëndimore (NATO, UE), aq më shumë një frymë e tillë reflektohet në Ballkanin Perëndimor dhe anasjelltas, çdo tension në këto marrëdhënie shfaqet edhe në kontekstin ballkanik.

Problemet e natyrave të ndryshme në Ballkanin perëndimor siç janë korrupsioni, mosfunksionimi i shtetit të së drejtës, minimi i demokracisë dhe tendencat separatiste në njërin anë vonojnë integrimin në kampin perëndimor, kurse në anën tjetër paraqiten si avantazhe të Ruisë dhe aktorëve të ndryshëm.

UE-ja por (edhe NATO-ja) mbetet synimi kryesor i rajonit dhe këtë e dëshmon edhe niveli i bashkëpunimit politik, ekonomik dhe tregtar e ushtarak. Asnjë mekanizëm tjetër rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor nuk

është alternativë dhe zëvendësues për UE-në, duke përfshirë iniciativat më të fundit siç ishte *Ballkani i Hapur*.

### Literatura:

**Bechev**, Dimitar. "Russia in the Balkans: Conference Report". The Balkans in Russia's Foreign Policy Strategy Russia and Conflict Resolution in the Balkans. The Economic Dimension Russian & Soft Power. LSEE Research on South Eastern Europe & SEESOX South East European Studies at Oxford, London School of Economics, 2015.

**Balkan Insight**. "Putin's Party Signs 'Military Neutrality' Agreements with Balkan Parties", Marrur nga: <https://medium.com/@balkaninsight/putins-party-signs-military-neutrality-agreements-with-balkan-parties-8f2bbad4c23>

**Clark**, David. Foxall, Andrew. Russia's Role in the Balkans –Cause for Concern? The Henry Jackson Society, 2014.

Council of European Union. Slovenian presidency of the Council of the European Union. Press Release, Prime Minister Janez Janša: The Western Balkans need the European perspective. Marrur nga: <https://slovenian-presidency.consilium.europa.eu/en/news/prime-minister-janez-jansa-the-western-balkans-need-the-european-perspective/>

**Davutoglu**, Ahmet. Thellësia Strategjike: Pozita Ndërkombëtare e Turqisë, Logos-A, Shkup, 2010.

**Dusica**, Tomovic. "Russians Dominate Foreign Ownership of Montenegrin Companies", Në, BIRN BalkanInsight, 18 Gusht, 2016.

**Entina**, Ekaterina. Pivovarenko, Alexander. "Russia in the Balkans: The Balkans at the Epicentre of International Developments." Russian International Affairs Council- RIAC.

**Entina**, Ekaterina. Pivovarenko, Alexander. Novaković, Dejan. "Where Are The Balkans Heading? A New Cooperation Paradigm for Russia", Valdai Discussion Club Report, Valdai Discussion Club, Moskë, 2018.

**Entina**, Ekaterina. Pivovarenko, Alexander. "The Evolution of Russia's Presence in Southeast Europe and Russia's New Strategy". Russian International Affairs Council- RIAC.

Federal'noye Sobraniye Rossiyskoy Federatsii. Sovet Federatsii. Nr. СТ-374, 20.05.2015.

**Gvosdev**, K. Nikolas & Marsh Christopher. Russian Foreign Policy: Interests, Vectors, and Sectors, SAGE Publications Ltd, Washington D.C, 2014.

**Gvosdev** K. Nikolas. "Gas, Guns, and Oil: Russia's "Rubble Diplomacy" in the Balkans". Në, Wilson Center.

**Hupchick**, P. Dennis. The Balkans from Constantinople to Communism. Palgrave,

2001.

- Hast**, Susanna. Spheres of Influence in International Relations History, Theory and Politics, ASHGATE, 2014.
- Headley**, James. Russia and the Balkans: Foreign Policy from Yeltsin to Putin. London, HURST & COM-PANY, 2008.
- Ibrahimi**, Arta. Integrimi i Ballkanit Perëndimor në UE, Logos-A, Shkup, 2009.
- Jagiello**, Bogusław. "The Balkan Kettle: Russia's policy towards the Balkans". Në, Security & Defence Quartelry, War Studies University, Poland, 3/2021, Vëll. 35. Konrad-Adenauer-Stiftung, The influence of external actors in the Western Balkans, Berlin, 2018.
- Kontsepsiya vneshney politiki Rossiyskoy Federatsii. Ministria e Punëve të Jashtme të Federatës Ruse. Diplomatcheskiy vestnik, 1993, nr. 1–2.
- Lehne**, Stefan. "Geopolitics, the EU and the Western Balkans", Policy Paper nr. 42/2020, Institute for Democracy "Societas Civilis", Shkup, 2020.
- Lo**, Bobo. Russia and the New World Disorder. Brookings Institution Press, Chatham house, London Washington, D.C. 2015.
- LUKOIL in the Republic of Serbia. Marrur nga. <https://www.lukoil.com/Company/BusinessOperation/GeographicReach/Europe/LUKOILinSerbia>,
- Nikiforov** V. Konstantin. "Chetyre aspekta vostochnoyevropeyskoy transformatsii", Në, Mezhdru Moskvoy i Bryusselem, Akademia Ruse e Shkencave - Instituti i Studimeve Sllave, Moskë, 2016.
- Petrillo**, Roberta, Enza. "Russian foreign policy towards the Balkans: which perspective?", ISPI - Istituto per gli studi di politica internazionale, Nr..169, 2013.
- Ponomareva**, G.E. "Balkanskaya Politika Rossiyskoy Federatsii: v poiskakh poteryannogo vremeni?", Në, Vneshnyaya Politika Rossii: Global'noye i Regional'noye Izmereniya, Vëll. 1, Pjesa 1. Shoqata Ruse për Studime Ndërkombëtare (RAMI), Universiteti MGIMO - Moskë, 2016.
- Rustemi** Arlinda. Wijk, de Rob. Dunlop, Connor. Perovksa, Jovana. Palushi, Lirije. Geopolitical Influences of External Powers in the Western Balkans. The Hague Centre for Strategic Studies, 2019, (pa datë botimi).
- Samokhvalov**, Vsevolod. Russian-European Relations in the Balkans and Black Sea Region: Great Power Identity and the Idea of Europe, Palgrave McMillan, 2017.
- Samorukov**, Maksim. Illyuziya blizosti: ambitsii i vozmozhnosti Rossii na Zapadnykh Balkanakh. Carnegie Moscow Center, 2017.
- Secieru**, Stanislav. "Russia in the Western Balkans Tactical wins, Strategic Setbacks", Në, Brief/8, Geopolitical Series, 2019.
- Sergeyevna**, Polina, Sokolova. "Yevro-atlanticheskaya Oriyentatsiya Zapadnykh Balkan", Mirovaya Ekonomika i Mezhdunarodnyye Otnosheniya. Vëll. 60, Nr.7, 2016.
- Sulstarova**, Enis. Jam Evropë, Logos-A, Shkup, 2012.

**Stronski**, Paul. Himes, Annie. *Russia's Game in the Balkans*, Carnegie Endowment for International Peace, 2019.

**Timofeev**, Aleksey. "Myths about Russia and Dynamics of the Development of Russian Foreign Policy Interests in the West Balkans". Në, Petrović N. Žarko (red.). *Russia Serbia Relations at the beginning of XXI Century. -ESSAY COMPENDIUM-* ISAC Fund, International and Security Affairs Centre, Beograd, 2010.

**Trenin**, Dmitri. "Russia's Spheres of Interest, not Influence", Në, *The Washington Quarterly*, Vëll. 32, nr. 4, 2009.

Faton Murseli  
Universiteti i Tetovës

# NDIKIMI I MEDIAVE NDAJ EUROSKEPTICIZMIT NË MAQEDONINË E VERIUT

## Abstrakt

*Ky hulumtim me tezën e globalizimit të Ballkanit mes eurointegrimit dhe euroskepticizmit ka si qëllim të nxjerrë në pah, rrjedhat politike në Maqedoninë e Veriut por edhe në Ballkan në tërësi, si pasojë e globalizimit të shumë segmenteve, por specifikisht atij mediatik dhe ndikimin e tij në rritjen ose jo të euroskepticizmit. Hulumtimi do të ketë një lidhje të domosdoshme me luftën në Ukrainë, që ka përshpejtuar rrjedha të ndryshme politike edhe në aspekt të integrimeve të vendeve të Ballkanit përëndimorë në Bashkimin Evropian. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria kanë filluar negociatat me BE-në, por si është reflektimi mediatik i kësaj, dhe si është përceptimi publik në kohën e një krize të sapokaluar nga pandemia Covid-19 dhe të një krize të sapofilluar energjetike.*

*Hulumtimi bazohet në metodën e analizës së përmbajtjes me anë të së cilës do të analizohen disa nga mediat në RMV, Shqipëri, Kosove dhe Serbi dhe se si këta media "ushqejnë" publikun me informacione sa i përket integrimeve evropiane. A është krijuar apo jo një "globalizim mediatik", a kemi fenomene që tentojnë që nëpërmjet hibriditetit medial të ritin euroskepticizmin, duke tentuar të ndikojnë në politikën shtetërore.*

*Besojmë se këto dhe përfundime të tjera që do të rrjedhin nga ky hulumtim do të jenë të vlefshme për të përcaktuar qartësisht drejtimet e popujve që jetojnë në Ballkan për aspiratat e tyre për integrim në Bashkimin Evropian. Me qenë se në Ballkan kryqëzohen kultura të ndryshme, ka shtete multietnike siç është edhe RMV-ja, domosdoshmërisht që të përfundojmë në atë se si popujt përmes kulturave të tyre të ndërtuara dekadash zhvillojnë idetë dhe punojnë për integrimet evropiane. Përfundim i vlefshëm do të ishte*

*edhe çështja se cilat do të ishin pasojat nga mosintegrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimorë në BE.*



## Hyrje

Vitet e fundit, fenomeni i euroskepticizmit është bërë një çështje mjaft e zakonshme për kërkimin e shkencave politike. Teza dhe punime të shumta nxjerrin në pah shkaqet dhe manifestimet e euroskepticizmit në vendet anëtare të BE-së, duke ofruar modele dhe tipologji të këtij fenomeni (Taggart, Szczerbiak, 2002; Vasilopoulou, 2009; Lubbers, Scheepers, 2010). Megjithatë, disa çështje kanë nevojë ende për një hulumtim të plotë, ne sot do të referojmë disa pika të shkurtra aq sa na mundëson edhe koha të hulumtimit tim mbi ndikimin e mediave në euroskepticizmin në Maqedoninë e Veriut.

Sigurisht që, ajo që është vërrejtur që në kohën e pandemisë, ishte Globalizimi i informacionit, mbi procesin të cilin mendoj që kanë referuar edhe studiuesit paraprak, sepse është temë boshte e kësaj Konferencë shkencore. Një segment i rëndësishëm, ishte edhe fluksi i madh i përdorimit të mediave, apo siç quhet rëndom ekspansioni i mediave të reja. Sipas një hulumtimi paraprak të bazuar në metodën e anketimit, në Qershor të vitit 2019, ku janë anketuar gjithësej 362 persona në formën online përmes "google forms", në pyetjen se nga cilat media informohen më shumë në lidhje me pandeminë, shumica dërmuese e të anketuarve ose rreth 70 % e tyre thonë që informohen nga mediat e reja, portalet dhe nga rrjetet sociale.

Nuk ka dyshim që sipas fluksit të përthithjes së informacioneve, mediat dhe sidomos mediat e reja apo thënë ndryshe mediat e internetit kanë një ndikim crucial në shumë dimensionë të jetës tonë shoqërore, në rastin tonë edhe në përhapjen e euroskepticizmit në këto momente të rëndësishme eurointegruese ku ndodhet vendi ynë dhe Ballkani Perëndimorë në përgjithësi.

## **Publikimet mediale dhe politika në kontekstin eurointegruese**

Një lidhje të pashmangshme të publikimeve mediale, studiuesit e shohin me politikën, sidomos kur është fjala tek integrimet europiane. Duhet të

theksojmë se me gjithë disa hapërimë të vogla pozitive të medias ballkanike në drejtim të një informacioni profesional, mungojnë përsëri hapësirat e studimeve të fenomeneve të ndryshme shoqërore. Në këtë kontekst, mediat janë vetëm bartëse të informacioneve që vijnë nga qeveritë e vendeve respektive për punën që ata bëjnë drejt integritetit në BE, apo edhe të informacioneve nga brifingjet dhe mbledhjet e deputetëve dhe të Parlamentit Evropian.

Kjo bartje informative, të cilën e bëjnë mediat në përditshmërinë e tyre, është e njëjtësuar, për shkak të njëjtësisht të informacionit, dhe nuk ka ndonjë efekt të madh në kontributin e përbashkët social apo përgjegjësinë shoqërore të mediave karshi aspiratave të vendeve tona për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Duke parë këto ndikime, respektivisht lidhjen e patjetërsueshme të medias me politikën vendore e ndërkombëtare, hulumtimin tonë e orientuam në dy shtigje kryesore. E para është se a ekziston euroskepticizmi, apo edhe pikëpyetjet rreth çështjes së zgjerimit të mëtejshëm të Bashkimit Evropian, tek partitë e Parlamentit Evropian, dhe e dyta si interferohet euroskepticizmi i vendeve anëtare të BE-se tek opinionin publik në Ballkanin Perëndimorë, përhapur kjo në masë të madhe përmes mediave, normalisht.

Mendojmë që qëndrimi i euroskeptikëve ndaj politikave specifike të Bashkimit Evropian ndikon drejtpërsëdrejti në zbatimin e tyre.

Kjo vlen veçanërisht për politikën e rëndësishme të BE-së përzgjerim. Mund të pranojmë se nuk ka asnjë qasje të vetme (apo të unifikuar) midis partive euroskeptike për çështjet e zgjerimit të mëtejshëm të BE-së. Pretendohet gjerësisht se partitë politike euroskeptike, të cilat kundërshtojnë shumicën e politikave të përbashkëta të BE-së, mbështesin zgjerimin, por kundërshtojnë integrimin e mëtejshëm pasi sipas tyre rritja e numrit të vendeve anëtare do ta zbehë procesin e integritetit dhe do të pakësojë efektivitetin e tij, si dhe do të pengojë procesin e mëtejshëm të integritetit (Taggart, Szczerbiak, 2002). Kjo qasje ishte me të vërtetë tipike për disa shtete, si Mbretëria e Bashkuar, e cila mbështeti zgjerimin, por kundërshtoi integrimin e mëtejshëm në BE (Lubbers, Scheepers, 2010). Pra, duket qartësisht se në politikën e brendshme të Bashkimit Evropian kemi dy qasje:

1. Qasje e zgjerimit të BE-së,
2. Qasje e integritetit të mëtejshëm.



Megjithatë, kjo nuk do të thotë se të gjithë euroskeptikët nga shtetet e tjera të BE-së mbështesin zgjerimin.

Në të njëjtën kohë, ne pajtohemi me Paul Taggart dhe Alex Zerbak sekundërshtimi ndaj zgjerimit të BE-së nuk është një tregues i euroskepticizmit të bazuar në parti (Taggart, Szczerbiak, 2008), dhe ka ende parti evropiane që nuk mbështesin zgjerimin e mëtejshëm të Bashkimit Evropian. Përsa i përket partive politike në shtetet kandidatë, përfshirë Ballkanin Perëndimor, kundërshtimi ndaj anëtarësimit në BE është një nga karakteristikat domethënëse të partive euroskeptike.

Vendimi i Bashkimit Evropian në Samitin e Selanikut në vitin 2003 për t'i dhënë dritë jeshile anëtarësimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor (BP) fillimisht fitoi mbështetje të padiskutueshme si nga elitat politike ashtu edhe nga shoqëritë në rajon.

Mirëpo, kohët e fundit, opinionioni publik për anëtarësimin në vendet aspirantë është karakterizuar nga tendenca në rritje drejt euroskepticizmit dhe, përkatësisht, ndikimi i partive euroskeptike po rritet, veçanërisht në Serbi dhe Maltë Zi.

Për shkak të këtyre çështjeve, mungojnë kërkimet për të analizuar ndikimin e euroskepticizmit në politikën e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimorë, si në aspektin e opinionit publik ashtu edhe në zhvillimin e euroskepticizmit të bazuar në partitë politike të vendeve të BE-së dhe të vendeve kandidatë. Një nga studimet e pakta që ofron një pamje krahasuese të euroskepticizmit në shtetet e Ballkanit Perëndimorë është nga Robert Belloni (Belloni, 2016). Në studimin e tij, ai nënvizon tre faktorë që ndikojnë në përhapjen e euroskepticizmit:

1. Faktorët utilitarë,
2. Politikë dhe
3. Sociokulturorë.

Qëllimi i punimit është të nxjerrë në pah qëndrimet e partive euroskeptike të vendeve anëtare të BE-së dhe të vendeve kandidatë të Ballkanit Perëndimorë për politikën e zgjerimit të BE-së në këtë rajon dhe të kuptojmë se deri në çfarë mase aktivitetet e medias ndikojnë në formësimin e opinionit publik rreth çështjes së integritimit në BE.

## Ideja e kundërshtimit të zgjerimit të BE-së

Për të identifikuar ata që kundërshtojnë idenë e zgjerimit të mëtejshëm të BE-së në Ballkan, nedotë Përdorim ndarjen e euroskepticizmit nga Paul Taggart dhe Alex Zerbiak në dy lloje: euroskepticizmi social dhe euroskepticizmi i bazuar në parti (Taggart, Szczerbiak, 2008). Lehtësia e përdorimit e ka bërë këtë klasifikim një nga më të përmendurit në këtë hulumtim.

Euroskepticizmi publik përcaktohet në procesin e zgjedhjeve, referendumeve, sondazheve të opinionit dhe vlerësimeve. Lloji i dytë, euroskepticizmi i bazuar në parti, ka të bëjë me sferën e veprimtarisë së partive politike, të cilat në sistemet demokratike janë mjetet për të shprehur gjendjen shpirtërore të shoqërisë. Për më tepër, klasifikimi më efektiv i euroskepticizmit të bazuar në parti është gjithashtu për shkak të ndarjes së tij në të fortë, që nënkupton një refuzim parimor të integritit evropian, dhe të butë, duke nënkuptuar kundërshtimin ose mospajtimin me një ose më shumë politika të BE-së (Taggart, Szczerbiak, 2008).

Së pari, kemi analizuar rëndësinë e çështjes së zgjerimit të mëtejshëm të BE-së për partitë politike euroskeptike të përfaqësuara në përbërjen aktuale të PE-së dhe theksojmë qëndrimet dhe aktivitetet e tyre specifike për këtë çështje. Kemi shqyrtuar programet partiake të 45 partive euroskeptike, të cilat kanë të paktën një anëtar të PE sipas të dhënave të vitit 2021. Bazuar në analizën e një numri të madh studimesh të euroskepticizmit me bazë partiake, ne i klasifikuam ato sipas klasifikimit të lartpërmendur në të butë ose të fortë. Përveç kësaj, kemi marrë parasysh pozicionimin e tyre ideologjik majtas ose djathtas dhe përkatësinë në grupet e PE-së.

Siç do ta shihni në tabelën që do të botohet në revistën tuaj shkencore, analiza rezulton se shumica e partive euroskeptike (29) nuk i kushtojnë vëmendje çështjeve të zgjerimit dhe nuk deklarojnë një qëndrim të qartë për këtë në programet e tyre partiake. Kështu, zgjerimi nuk shihet ngashumica e partive euroskeptike si një sfidë apo kërcënim për interesat kombëtare të shteteve të tyre të origjinës.

Megjithatë, gjatë votimit në Komisionin e Punëve të Jashtme të PE për miratimin e këtyre raporteve, ishte shumica e grupeve euroskeptike që votuan kundër, siç do ta shihni në tabelën e dytë të këtij hulumtimi. Kështu,

megjithëse shumica e partive euroskeptike në programet e tyre partiake nuk deklarojnë njëpozicion të qartë për politikën e zgjerimit të BE-së, deputetët e tyre kanë më shumëgjasa të kundërshtojnë zgjerimin e BE-së. Mirëpo sipas studimit, në përgjithësi, kundërshtarët euroskeptikë të zgjerimit të BE-sëmbeten në pakicë dhe PE është në favor të zgjerimit të mëtejshëm të BE-së dhe mbështet zgjidhjet në favor të zgjerimit.

## **Mendimi qytetar mbi zgjerimin e BE-së**

Është shumë me rëndësi për këtë hulumtim të potencojmë faktin se kur vendosin për zgjerimin e mëtejshëm të Unionit, politikanët dhe zyrtarët qeveritarë marrinparasysh mendimet e qytetarëve të shteteve anëtare, pra të shteteve të tyre. Sipas të dhënave të fundit të Eurobarometritpër vitin 2021,46% e qytetarëve të BE-së mbështesin zgjerimin e mëtejshëm të Bashkimit dhe 43%e kundërshtojnë atë. Megjithatë, të dhënat sociologjike të shteteve individuale ndryshojnë dukshëm siç do ta shihni në tabelën e tretë e përpiluar sipas rezultateve të eurobarometrit.

Sipas kësaj table, të publikuar në Shtator të vitit 2021, niveli më i ulët i mbështetjes për zgjerimin (nga 29 në 37%) është gjetur në Evropën Perëndimore dheVeriore, (Francë, Gjermani, Belgjikë, Holandë, Luksemburg, Austri, Finlandë, Suedi dheDanimarkë), me përjashtim të Irlandës me 58% mbështetje për zgjerimin. Siç po mundohemi të shpjegojmë, të gjitha partitë euroskeptike të PE-së që nuk mbështesin politikëne zgjerimit të BE-së vijnë nga e njëjta listë shtetesh.

Niveli më i lartë i mbështetjes për zgjerimin është i natyrshëm në shtetet relativisht të reja anëtare tëBE-sëdhe rajonet baltike, veçanërisht Lituania, Hungaria, Kroacia, Sllovenia dhe Polonia (nga 78 në62%). Të njëjtin nivel të lartë mbështetjeje tregon edhe Spanja (67%). Shumica e partiveeuroskeptike që mbështesin zgjerimin vijnë gjithashtu nga Evropa Qendrore dhe Lindore dhe ngaBalltiku.

Pjesa tjetër e shteteve, kryesisht në Evropën Jugore, u gjenden mes këtyre dy poleve mbështetjen për zgjerimin në masën 49-59%.

Në përgjithësi, këto të dhëna statistikore tregojnë një nivel të lartë korrelacioni midis opinionitpublik dhe euroskepticizmit të bazuar në parti në

çështjet e zgjerimit. Nga kjo rezultojmë se partitë nga shtetet kumbështetja për zgjerimin është më e ulët mund të ndjekin pikëpamjet e qytetarëve të tyre.

Niveli më i ulët i mbështetjes së qytetarëve të BE-së për anëtarësimin e anëtarëve të rinj ka tëngjarë që rezulton nga idetë për zvogëlimin e efektivitetit të forcës transformuese të BE-së në rajonin e Ballkanit Perëndimorë. Aspiratat e vendeve anëtare të BP-së për t'iu bashkuar BE-së përballen me opinionin e pafavorshëm publik në vendet anëtare të BE-së dhe, si pasojë e hezitimit të qeverive të disa vendeve anëtare për të mbështetur plotësisht politikën e zgjerimit të BE-së në rajonin. Një shembull i gjallë është pozicioni i fundit i Francës dhe Holandës për të bllokuar fillimin e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, që kërcënoi edhe integritetin e procesit të zgjerimit të BE-së në rajon.

Pasi që u munduam të japim një pasqyrim të euroskepticitizmit në partitë që kanë anëtarë të tyre (deputetë) në Parlamentin Evropian, sa i përket politikave të zgjerimit me Ballkanin Perëndimorë, do të zbresim në realitetin e Maqedonisë së Veriut.

## **Procesi eurointegrues në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Maqedonia e Veriut po tregon përparim në rrugën e saj drejt anëtarësimin në BE, pasi kontesti i emrit me Greqinë është zgjidhur përfundimisht. Po i potencojmë disa lëvizje politike që e vërtetojnë këtë siç është Marrëveshjes së Prespës, ku Maqedonia u riemërua në Maqedoninë e Veriut. Më 27 mars 2020, Maqedonia u bë anëtare e NATO-s (Maqedonia e Veriut i bashkohet NATO-s si Aleati i 30-të, 2020). Por nënshkrimi i marrëveshjes së Prespës nuk e zhvendosi apo as edhe nuk përshpejtoi procesin e negociatave me BE-në, pasi Bullgaria e bllokoi atë. Fillimi zyrtar i negociatave është vonuar, gjë që ka çuar në njëfarë zhgënjimi me politikën e BE-së për shkak të kapacitetit të dobët të saj (Sinoruka, 2022).

Maqedonia e Veriut ka zgjedhur një kurs pro-evropian me shpalljen e pavarësisë. Për një kohë, të gjithë drejtuesit e shtetit u përpoqën ta mbështesin atë. Ndryshimet në politikën e Maqedonisë ndodhën gjatë mandatit të

dytë të presidencës së Gjorge Ivanov (2009-2019), i cili kritikoi BE-në për investime të ulëta dhe rënie të interesit për integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE, të cilin Rusia dhe Kina e përdorën për qëllimet e tyre (Ivanov : Shfrytëzohet dështimi i BE-së në Ballkan nga Rusia dhe Kina, 2017).

Maqedonia e Veriut ka vazhduar punën për fillimin zyrtar të egociatave të anëtarësimit. Dhevetëm në maj 2022, Parlamenti Evropian i kërkon Këshillit të BE-së të fillojë negociatat (Shqipëriadhe Maqedonia e Veriut: Eurodeputetët kërkojnë që BE të fillojë bisedimet e pranimit, 2022).

Pothuajse të gjitha partitë politike në Maqedoninë e Veriut janë pro-evropiane. Në zgjedhjet e fundit në korrik 2020. Opinioni publik për çështjen e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE në përgjithësi tregon një nivel të lartë të përkushtimit publik ndaj idesë së anëtarësimit në BE (Tabela 5).

**Tabela 5:** Të dhënat për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në mbështetjen e BE-së

Viti	Për	Kundër	nuk e di
2009	95	4	1
2010	92	7	1
2011	87	9	4
2012	84	12	4
2013	76	19	6
2014	76	20	4
2015	80	14	6
2016	76	19	5
2017	72	21	6
2018	69	7	24
2020	. 74	10	16
2021	71	12	17

Burimi: hartuar nga autorët sipas të dhënave: Opinioni publik politik i Malit të Zi,  
<https://www.cedem.me/wp-content/uploads/2022/02/Pol-Public-Opinion-MNE-Dec-2021.pdf>

Megjithatë, mbështetja rekord për anëtarësimin në 2009-2010 ra disi në vitet në vijim. Në vitin 2020, që kur Maqedonia e Veriut ra dakord të fillojë negociatat e para-anëtarësimite BE-në, mbështetja publike për anëtarësimin në BE është rritur në 74%. Por për shkak të bllokadës së bisedimeve të pranimit të Greqisë dhe Bullgarisë, mbështetja për anëtarësimin në BE është e dobët, siç pasqyrohet në sondazhet e vitit 2021. Në përgjithësi, ndryshe nga Serbia dhe Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë një nivel shumë më të lartë të mbështetjes së BE-së.

## Konkluzione

1. Euroskepticizmi i partive nga vendet anëtare të BE-së, që janë të përfaqësuar në Parlamentin Evropian buron nga mendimi i brendshëm i opinionit publik (votuesve) në lidhje me zgjerimin e BE-së.

2. Euroskepticizmi në vendet aspirantë të Ballkanit Perëndimorë buron nga tejkëmbja e proceseve të Anëtarësimin, dhe nga vet joqartësia e pozicioneve politike të vendeve anëtare të BE-së.

3. Mediat nuk arrijnë të mbajnë të formësuar si duhet opinionin publik në Maqedoninë e Veriut për idenë e anëtarësimin në BE, gjë që ka rezultuar me rritjen e euroskepticizmit viteve të fundit.

## Bibliografia

**Taggart, P., Szczerbiak, A.** (2002). The Party Politics of Euroscepticism in EU Member and Candidate States. Retrieved from: [https://www.researchgate.net/profile/Aleks\\_Szczerbiak/publication/237536121\\_The\\_Party\\_Politics\\_of\\_Euroscepticism\\_in\\_EU\\_Member\\_and\\_Candidate\\_States/links/5534fb440cf2df9ea6a4122f/TheParty-Politics-of-Euroscepticism-in-EU-Member-and-CandidateStates.pdf](https://www.researchgate.net/profile/Aleks_Szczerbiak/publication/237536121_The_Party_Politics_of_Euroscepticism_in_EU_Member_and_Candidate_States/links/5534fb440cf2df9ea6a4122f/TheParty-Politics-of-Euroscepticism-in-EU-Member-and-CandidateStates.pdf)

**Vasilopoulou, S.** (2009). Varieties of Euroscepticism: The Case of the European Extreme Right. *Journal of Contemporary European Research* Vol.5, No.1, 2009, pp. 3-23.

**Vasilopoulou, S.** (2009). Varieties of Euroscepticism: The Case of the European Extreme Right. *Journal of Contemporary European Research* Vol.5, No.1, 2009, pp. 3-23.

**Lubbers, M., Scheepers, P.** (2010). Divergent trends of euroscepticism in countries and regions of the European Union. *European Journal of Political Research* Vol. 49, No.6, 2010, pp. 787-817.

Taggart, P., Szczerbiak, A. (2008). *Opposing Europe? The Comparative Party Politics of Euroscepticism*. Oxford: Oxford University Press, 2008. Retrieved from: <https://www.jcer.net/index.php/jcer/article/view/218/218>.

Western Balkans Regional Poll. (2020). International Republican Institute. Retrieved from: [https://www.iri.org/sites/default/files/final\\_wb\\_poll\\_for\\_publishing\\_6.9.2020.pdf](https://www.iri.org/sites/default/files/final_wb_poll_for_publishing_6.9.2020.pdf)

**Sinoruka F., Todorov S.** (2022). Bulgaria to Maintain Block on North Macedonia's Path to EU: Minister. Balkan Investigative Reporting Network. Retrieved from: <https://balkaninsight.com/2022/04/13/bulgaria-to-maintainblock-on-north-macedonias-path-to-eu-minister/>

Isamet Bakiu

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup*

## MIGRIMI SI FENOMEN GLOBAL DHE SHTETI KOMBËTAR

### Abstrakt

*Migrimi si fenomen shqetësues përfshin edhe shqiptarët si popull. Ata gjeneratë pas gjenerate shkrihen në enët për shkrirje "melting pot" të botës. Në 3.5% të popullsisë botërore edhe shqiptarët bëjnë pjesë në numrin e njerëzve që është trefishuar në dyzet vitet e fundit, pothuajse të gjitha rajonet e botës. Kjo shqetëson jo vetëm vendet nga nisen, por edhe vendet në tranzit dhe ato të destinacionit. Konfigurimet që miraton lëvizja e popullatës pasqyrojnë një sërë sfidash globale, politike, ekonomike, demografike, kulturore dhe të mjedisit. Lëvizshmëria kërcënon shtetin kombëtar, edhe nëse ai reziston fuqishëm. Nëse udhëtoni nga Vlora për Dhërmi sapo të ngjitni Llogoranë do lexoni një shkrim në një rën ngandalesat pranë rrugës për Dhërmi. Mbishkrimi në anglisht thotë: "No nation no borders" që në gjuhëshqipe do t'i vinte: "Pa kombe pa kufi." Porosia e kësaj shkresë është vizionare dhe tejkalon dallimetetnike dhe nuk parapëlqen pengesat doganore e kufitare. Kjo mendësi njëkohësisht e lufton edhe shtetinkomb dhe është një thirrje anarkiste që sparasheh shtete dhe kufinj. Përderisa rrethohet nga shtete me një mendësi nacionaliste, përshtetin komb unitar dhe për besimin ortodoks, plasimi i idesë në një shtet të tolerancës fetare dhe ndërnacionale merret edhe si dobësi. Identitetet transformohen, terma të tillë si multikulturalizmi, diskriminimi pozitiv dhe bashkëzhvillimi plaken dhe zëvendësohen nga kozmopolitanizmi, transnacionalizmi. Këto terme janë në kundërshtim me nacionalizmin, ngritjen e shtetit komb, pushtetndarjen në bazaetnike etj. Migrimi në masë bart me vete edhe vlerat kulturore, thesarin e trashëgimisë, por në vendet embëritjes ballafaqohen me masat mbrojtëse të shtetit komb i cili ka kushtespecifike të integritit. Megjithatë, popujt me kultura të ndryshme tentojnë përmes infrastrukturës ligjore demokratike të ruajnë mënyrën e jetesës nga vendet e origjinës.*



*Në punim do të paraqiten edhe të dhëna për emigracionin shqiptar dhe organizimin e tyre në disa vendedhe kontributin e tyre në ruajtjen e nacionalizmës dhe shtetit komb. Fenomeni i emigrimit është edhe i hershëm edhe mirë i njohur te shqiptarët, qoftë atje ku ata jetojnësi arvanitë, arbëreshë, arbanas, si arnautë ose kosovarë apo shqiptarë. Në periudha të ndryshme historike ata për njëarsye apo tjetër kanë lënë vatrat e tyre shekullore dhe janë shpërngulur, njëherë përkohësisht, pastajkanë ngelur përgjithmonë në vende edhe kanë përqafuar kulturën vendase dhe janë tjetërsuarose janë shkrirë në kombe të tjera, apo shprishen në tërë botën anë e mbanë.<sup>112</sup> Lindja e shteteve kombe, hapja e shkollave në gjuhët zyrtare ka mundësuar ngurtësimin e një identitetinacional. Sa mund kjo t'u qëndrojë ndikimeve të globalizimit është një çështje në vete.*

**Fjalë çelës:** Migrimi, shpërngulja, globalizimi, multikulturalizmi, diskriminimi pozitiv, kozmopolitanizmi, transnacionalizmi.



## **Shqiptarët në kontekstin e migrimit ndërkombëtar**

Dyndjet e popullatës kanë shkaktuar gjithmonë ndryshime në aspektin global, por gjithashtu e ka kërcënuar shtetin kombëtar, përkundër rezistencës së tij të fuqishme. Konfigurimet që ka migrimi si fenomen global ballafaqohen me një sërë sfidash globale, politike, ekonomike, demografike, kulturore dhe mjedisore. Edhe daljen e Britanisë së Madhe thuhet se një ndër faktorët e mundshëm ka qenë fluksi i madh i refugjatëve nga Siria dhe vendet tjera të krizave globale. Shpërngulja e disa miliona gjermanëve nga territori ku është Polonia, ka mundësuar zhvendosjen e shtetit kombëtar polak nga territori i origjinës dhe krijimi i një vendi më homogjen.

Bota sot është në një ndërvarësi në rritje dhe ajo nxjerr në pah pabarazitë në të gjitha sferat. "Nomadizmi dhe lëvizjet migratore bëhen tipare të hipermodernitetit, fenomenet migratore bëhen gjithnjë e më të larmishme, nga nomadizmi tek sedentarizimi, identitetet transformohen, nocioni i integritetit përballet me një krizë, terma të tillë si multikulturalizmi, diskrimini-

<sup>112</sup>Tjetërsimi përdoret në kontekst të dallimeve që kanë në krahasim me shqiptarët që jetojnë në shtetin kombëtar shqiptar, sa i përket gjuhës, kultures, mënyrës së jetesës etj.

mi pozitiv dhe bashkëzhvillimi plaken dhe janë zëvendësuar nga kozmopolitanizmi, transnacionalizmi, politikat e diasporës së vendeve të nisjes dhe qeverisja shumëpalëshe."<sup>113</sup>

Popullata botërore është trefishuar në 40 vitet e fundit dhe gjithashtu përqindja e migrimit e popullsisë botërore me 3,5 % shqatson shumë rajone të botës në krahasim me atë që ishte 30 vite më parë kur vetëm disa vende në botë ishin të shqetësuara. "Një "spërkatjeje" të kombësive të ndryshme, si kinëzët dhe indianët në mbarë botën, ose nga ndërtimi i thuajse -diasporat, si turqit dhe marokenët në Evropë apo italianët në mbarë botën, falë rrjeteve të fuqishme transnacionale; ose nga përjetësimi i "çifteve migratore" të vjetra të migrimit postkolonial (algjerianët në Francë, indianët dhe pakistanezët në Mbretërinë e Bashkuar) ose ish "punëtorët mysafirë" (Gastarbeiter) (turqit në Gjermani, meksikanët në Shtetet e Bashkuara)."<sup>114</sup> Në këtë spërkatje bën pjesë edhe populli shqiptarë, duke qenë më i vogël në numër me popujt e lartpërmendër edhe pasaojat e cënimit të shtetit kombëtar janë më të mëdha. Por si duket njohja ndërkombëtare e shtetit në OKB nuk rezikon ekzistencën e kombit por struktura e kombit në aspekt etnik mund edhe të ndryshojë.<sup>115</sup>Sipas Gallup International 39% e qytetarëve të investuar kanë shprehur dëshirë të ikin në ndonjë vend tjetër kurse 55% të jetojnë në Kosovë, kurse në Maqedoninë e Veriut 42% duan të ikin.<sup>116</sup>Në anketën e 2017 dikund 56% e shqiptarëve nga Shqipëria ishin deklaruar të jetojnë dikund tjetër.<sup>117</sup> Sipas Gallup interantional në aspekt global për të braktisur vendin në vendin e parë është Sierra leone me 84% kurse India ka vetëm 4% të atyre

---

<sup>113</sup> <https://www.coursera.org/learn/international-migrations/supplement/QqizX/> globalization-of-migrations

<sup>114</sup> <https://www.coursera.org/learn/international-migrations/supplement/QqizX/> globalization-of-migrations

<sup>115</sup> Nga më shumë se 4.5 milionë njerëz që kanë sot nënshtetësi shqiptare, vetëm 2.7 milionë jetojnë në Shqipëri. Emigracioni filloi fillimisht në vitet 1990 të trazuara, pas rënies së Perdes së Hekurt dhe ndërsa Republika aktuale e Shqipërisë luftonte për të dalë nga një prej regjimeve më të ashpra komuniste të kontinentit.

<sup>116</sup> Gallup international GIA (Aug-Oct 2022) <https://www.gallup-international.com/survey-results-and-news/survey-result/one-in-three-global-citizens-want-to-immigrate>

<sup>117</sup> Tirana Times, <https://www.tiranatimes.com/?p=132809>

që duan të jetojnë në ndonjë vend tjetër. Ajo që rrezikon të drejtat kolektive politike mbetet Maqedonia e Veriut ku këto të drejta limitohen me 20%.

Disa shtete ku migrojnë shqiptarët nuk lejojnë dyshtetësinë, prandaj ata detyrohen të heqin dorë nga shtetësia shqiptare. Diaspora e vlerësuar nga INSTAT përllongaritet 1.684.135 individë jashtë territorit të Shqipërisë, ku 884.719 individë janë meshkuj dhe 799.416 janë femra.<sup>118</sup> Gjeneratat e dyta dhe të treta të familjeve shqiptare qoftë nga Shqipëria, Kosova apo trojet tjera etnike integrohen dhe arrijnë suksese në gjitha fushat e jetës. Vlen të përmendim sa për ilustrim ndikimi i shqiptareve në botën e muzikës në aspektin global edhe pse si popull i vogël është mjaft senzitiv dhe emocional. Yjet e muzikës si Dua Lipa dhe Rita Ora që dëgjohen nga të rinjë dhe të rejat e gjithë globit, ose Mira Murati drejtoresha e laboratorit të intelecjençës artificiale dhe shumë të tjerë që sistemet e shteteve të zhvihuara u mundësojnë pa bërë dallim race, etnie apo origjine.

Diversifikimi i profileve të migrantëve ka ardhur me globalizimin e flukseve: punëtorët meshkuj, ruralë, të rinj, me kualifikim të ulët të viteve të rritjes janë zëvendësuar nga elita urbane shumë të kualifikuara, gra, të mitur të pashoqëruar, emigrantë të moshuar, azilkërkues, migrantë lavjerrës, studentë, turistë afatgjatë, më pak të kualifikuar sot janë të padokumentuarit. Ajo që frikson shtetet e vogla të Ballkanit dhe më gjerë është ikja e kadrove profesionale që janë deficitar dhe që kërkon vite për krijimin e tyre siç janë mjekët, inxhinierët, programerët etj. Qeveritë ku jetojnë shqiptarët nuk kanë marrë masa preventive të duhura për ta ruajtur "tharrjen e trurit".

### **Faktorët që nxitën migrimin global**

E drejta e posedimit të dokumentave të udhëtimit u ka mundësuar shumë njerëzve në mbarë globin të braktisin vendet e tyre. Megjithëse shumica e vendeve kanë sisteme vizash hyrëse. Nga ana tjetër mjetet audiovizuale të informimit si dhe mjetet tjera si interneti dhe komunikimi me telefona celularë janë pasqyra të komunikimit ku njerëzit joshen për një jetë më të mirë në vendet perëndimore të cilat bëhen destinacion i emigrimit.

<sup>118</sup> Diaspora e Shqipërisë nëshifra, INSTAT 2020, <https://www.instat.gov.al/media/7848/diaspora-ne-shifra-2020.pdf>

Moment historik i cili kishte ndikim të dukshëm në lëvizjet e popullatës si në Evropë ashtu edhe në aspekt global ishte edhe rënia e murit të Berlinit në vitin 1990. Miliona njerëz të mbyllur pas kufijve largoheshin nga shtëpitë e tyre (ish-sovjetikë, kinezë, shtetas të Evropës Qendrore dhe Lindore, Ballkanit). Shpërthimi i kërkesave për azil është i lidhur me përhapjen e krizave politike dhe luftërave civile që për më shumë se njëzet vjet kanë prodhuar refugjatë në përmasa të panjohura më parë: gjashtë milionë njerëz janë larguar nga Afganistani që nga fundi i viteve 1970, katër milionë Iraku që nga vitet 1990. Krizat afrikane në rajonin e Liqeneve të Mëdha, krizat në Jugosllavi, në rajonet kurde, në Lindjen e Afërt dhe të Mesme, në Sri Lanka, Haiti dhe Algjeri kanë shkaktuar një fluks azilkërkuesish në Evropë dhe Amerikën e Veriut, por edhe më shumë për vendet e varfra, fqinjët e tyre gjatë viteve 1990.<sup>119</sup>

Sipas Komisionit të Lartë për Refugjatë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNHCR), deri në fund të vitit 2021 si pasojë e persekutimit, konfliktit, dhunës, shkeljes së të drejtave të njeriut apo ngjarjeve që trazojnë rëndë rendin publik, 89.3 milionë njerëz në mbarë botën u zhvendosën me forcë. Prej tyre 53 million janë personat e zhvendosur brenda vendit, 21.3 million refugjatë, 4.6 milion azilkërkues, vetëm nga Venecuela refugjatë dhe azilkërkues janë 4.4 million, refugjatët nën mbikqyrjen e UNRWA<sup>120</sup> janë 5.8 milion.<sup>121</sup>

Turqia priti rreth 3.8 milionë refugjatë, popullsia më e madhe në mbarë botën. Kolumbia ishte e dyta me më shumë se 1.8 milionë, duke përfshirë venezuelianët e zhvendosur jashtë vendit. Uganda dhe Pakistani me nga 1.5 milion të pasuar nga Gjermania me 1.3 milion refugjatë. Më shumë se dy të tretat (68 përqind) e të gjithë refugjatëve dhe venezuelianëve të zhvendosur jashtë vendit erdhën nga vetëm pesë vende. Nga Republika Arabe Siriane 6.8 milion, Venecuela me 4.6 milion, Afganistani me 2.7 milion, Sudani Jugor me 2.4 milion dhe nga Maznamar 1.2 milion.<sup>122</sup>

<sup>119</sup>Refugee Convention 1951, <https://www.unhcr.org/1951-refugee-convention.html>

<sup>120</sup>Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Ndhimën dhe Punën për Refugjatët Palestinë në Lindjen e Afërt (UNRWA) është një agjenci ndihme dhe zhvillimi njerëzor.

<sup>121</sup>UNCHR, <https://www.unhcr.org/figures-at-a-glance.html>

<sup>122</sup>UNHCR Trendet Globale 2021, <https://www.unhcr.org/globaltrends>

Kur shikojmë këto shifra të dyndjeve të popullatave nëpër botë e kuptojmë se ne shqiptarët nuk rrezikojmë asnjë shtet në botë dhe duke qenë një vend i varfër që askush nuk e synon si vend pritës (qoftë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Luginë të Preshevës ose Mal të Zi) nuk mund të rrezikojë as shtetin komb ose unitar. Pjesa më e madhe si çak i kanë qendrat e fuqishme ekonomike të botës ku ka ofertë për punë dhe kushte më të mira jetese.

Shqiptarët kanë emigruar që herët dhe kjo ka krijuar një historik të diasporës shqiptare të hershëm.<sup>123</sup> Vetë pozita e vendit ku jetojnë shqiptarët është e tillë që i bën ata të lëvizin në drejtime të ndryshme. Diaspora shqiptare është heterogjene në dy pikëpamje: të kohës së mërgimit, si dhe në pikëpamje të regjionit prej nga kanë ardhur. Duke analizuar aspektin kohor, bashkësitë më të vjetra shqiptare përbëhen nga arbëreshët në Itali dhe arvanitasit në Greqi. Të parët kanë arritur që për shekuj të ruajnë identitetin e tyre, kurse të dytët, janë në fazën përfundimtare të asimilimit të plotë, edhe pse mbase ka shpresë që kjo bashkësi të njohë një ringjallje sado të vogël. Në radhën e këtyre bashkësive të vjetra mund të hyjë pa mëdyshje edhe bashkësia shqiptare e Egjiptit.<sup>124</sup> Pas këtyre vijnë bashkësitë shqiptare në Turqi, SHBA, Belgjikë, Australi e në ndonjë vend tjetër. Të fundit vijnë mërgimtarët e katër dekadave të gjysmës së dytë të shek. XX. Shumica e tyre janë vendosur apo bëjnë përpjekje të vendosen në shtetet e ndryshme të Evropës Perëndimore, në SHBA dhe Kanada. Këtu vlen të përmendim edhe 500 mijë qytetarë të Shqipërisë, të cilët në fillim të viteve nëntëdhjetë, pas hapjes së Shqipërisë ndaj botës, u shpërngulën në Greqi, Itali si dhe në vende të tjera evropiane. Përkundër kësaj, shteti shqiptar qëndron në pozicion të mirë në listën e shteteve që kanë më shumë zhvillim. Kosova gjithashtu paraqet shtetin më të ri qytetar ku shumica e popullatës janë shqiptarë etnik.<sup>125</sup>

---

<sup>123</sup> Ministri i Shtetit për Diasporën <http://online.fliphtml5.com/dmiin/kgyt/#p=1>

<sup>124</sup> Ibid.

<sup>125</sup> Ministri i Shtetit për Diasporën <http://online.fliphtml5.com/dmiin/kgyt/#p=1>

## Emigrimi nga Shqipëria para vitit 1945

Siç vë në pah Vullnetari pesë shekuj nën sundimin osman, i cili përfundoi me shpalljen e pavarësisë në vitin 1912, u shoqëruan me lloje të ndryshme emigracioni në akoma më shumë destinacione. Arsytet e këtyre migrameve ishin të ndryshme dhe komplekse, por ato ndahen përafërsisht në dy kategori të gjera: ato të karakterizuara nga një element detyrimi (migrame të detyruara) dhe ato të karakterizuara nga kërkimi për punë dhe kushte më të mira jetese. Megjithatë, ky dallim bëhet i paqartë kur merren parasysh kushtet e varfërisë ekstreme, shfrytëzimit dhe mjerimit në të cilat shumë shqiptarë, veçanërisht fshatarë, jetonin në zonat e tyre.<sup>126</sup>

Migrimi i popullatës shqiptare nga të gjitha trojet ku ata banojnë në Gadhullin Ilirik nuk është studiuar si fenomen, por duke pasur parasysh diasporën aq në numër në të gjithë globin, kjo kërkon një studim në terren ku mund të nxiren të dhëna empirike të cilat do të na shërbenin për studime të mëtutjeshme për arsyet, kohën dhe rrethanat e migrimit. Migrimi i shqiptarëve ka qenë vale valë ashtu si kanë ndryshuar rrethanat shoqërore, ekonomike dhe politike në trojet etnike. Periudha pesë shekullore e sundimit osman që me siguri se ka lanë gjurmë në çdo aspekt politik, social dhe kulturor të shqiptarëve, nuk ka majft të dhëna të gjurmë të cilat do të shërbejnë të argumentojnë se si kanë migruar shqiptarët mbrenda perandorisë dhe si ata kanë kontribuar në ngritjen e shtetit komb. Kjo mund të jetë një temë e veçantë studimi.

Shpërnguljet në jug të shqiptarëve në shek. XIII-XIV ndodhën me ftesë të princërve dhe zotërve vendorë që ne sot i njohim si pupullata arbërore që jeton në Greqi. "Migrimi i arbëreshëve në Greqi filloi në fund të shekullit të 13-të dhe mbaroi rreth vitit 1600 nga një rajon i quajtur Arbëria, e cila ishte pjesë e Despotit të Epirit dhe i cili sot është rajoni qendror i Shqipërisë moderne. Arbëreshët së pari migruan në Thesali rreth vitit 1325 përmes rrugëve të udhëtimit që kishin shkuar në juglindje duke kaluar pellgun e sipërme të lumit Bistricë dhe me anë të Korçës, Kosturit dhe Grebenesë

---

<sup>126</sup> Julie Vullnetari, *Albanian migration and development: state of the art review*, IMISCOE Working Papers, 18) Amsterdam, 2007, f.9, <http://eprints.soton.ac.uk/id/eprint/377326>

mbërritën në fushë të Thesalisë. Një tjetër pikëpamje mban se kjo migrimi ka ndodhur nga zbritëse jug-perëndim përmes rajonit të Janinës dhe Atolo-Akarnania dhe shkuan prej andej në Thesali.<sup>127</sup> Ata fillimisht u ngulitën në rreth 300 vende në zona në jug të Greqisë, që ska dyshim se mban gjenezën etnike shqiptare shkaku i gjuhës arbërishte që e flasin.<sup>128</sup> Kjo popullatë që e njih veten si arvanitas, por njëkohësisht si Helen ka dhënë kontributin e pamohueshëm dhe pa çmim në luftën për krijimin e Greqisë dhe shtetit komb grek. Kjo për arsye se kombi identifikohej me besimin ortodoks. Më vonë sipas Julie Vullnetarit i cili shkruan se shpërngulja masive më e hershme në kujtesën kolektive historike të shqiptarëve ndoshta kishte ndodhur në gjysmën e dytë të shekullit të XV-të, pas vdekjes së heroit kombëtar të Shqipërisë Skënderbeu në 1467. "Vlerësohet se rreth 200,000 shqiptarë u larguan nga shtëpitë e tyre gjatë viteve 1468-1506 sugjeron se kjo shifër ishte pothuajse një e katërta e popullsisë shqiptare të asaj kohe, "një eksod me përmasa biblike".<sup>129</sup>

Lëshimi i trojeve shkaku i rekrutimit të dhunshëm për Itali dhe pastaj për SHBA e sidoms implementimi *idevshirmes* e njohur si 'taksa e fëmijëve'. Sipas saj, familjeve të krishtera rurale shqiptare u kërkohet të hiqnin dorë nga një fëmijë mashkull i shëndetshëm për t'u konvertuar në Islam dhe më vonë për t'u trajnuar ose për të punuar në administratë ose për t'u bërë pjesë e korpusit elitar të jeniçerëve.<sup>130</sup>

Deportimi i shqiptarëve për në Turqi dhe në Azi kishte ndodhur edhe pas shuarjes së kryengritjes së Dervish Carës. Kryengritja e Dervish Carës e cila fillon me çlirimin e Gostivarit në nëntor të vitit 1843 e deri në maj të vitit 1844, kur u çliruan tërë trojet Lindore të banuara me shqiptarë. Kjo periudhë kohore e lirë e cila zgjati mbi gjashtë muaj, në historinë shqiptare ku ka funksionuar administrata shqiptare, në krye me Dervish Carën. Pas disfatës të Katllanova pushtetit osmanndërmori masa drastike, me qëllim për të

<sup>127</sup> Ministri i Shtetit për Diasporën <http://online.fliphtml5.com/dmiin/kgyt/#p=1>

<sup>128</sup> Armand Plaka, Shqiptarët e Greqisë dhe Grekët e Shqipërisë, Studime Albanologjike, ITSHKSH, Shkup 2018, 148

<sup>129</sup> Julie Vullnetari, *Albanian migration and development: state of the art review*, IMISCOE Working Papers, 18) Amsterdam, 2007, f.9, <http://eprints.soton.ac.uk/id/eprint/377326>

<sup>130</sup> Miranda Vickers, "The Albanians: A Modern History", I.B. Tauris, London, 1995, 12

frikësuar popullatën që ajo të nënshtrohet sa më parë. U burgosën dhe internuan me mijëra shqiptarë; në mesin e të cilëve edhe komandantin tetovarë, Dervish Care. "Të lidhur, duke ecur në këmbë deri në Selanik, prej nga me anije janë dërguar në Stamboll, për t'i nxjerrë para gjyqit. Duhet të përmendim dhe mos t'i harrojmë se një numër i madh i tyre që luftuan për çlirimin e Shqipërisë, nga lodhja maltretime dhe torturat që përjetuan gjatë rrugës, pa ujë e ushqim, vdiqën pa mbërritur në Selanik. Ata që arritën në Stamboll u shpërndanë në vende të ndryshme të Anadollisë, në ato shkretëtira të pafund, prej nga, kurrë më nuk u kthyen në vatrat e tyre, duke i thënë përgjithmonë lamtumirë Shqipërisë."<sup>131</sup>

Pasojat në këtë kryengritje ishin shumë të mëdha. Pas shuarjes së kryengritjes u likuiduan të gjithë shqiptarët që ishin me influencë, ku pati edhe familje të tëra. Një pjesë e madhe e tyre nga të gjitha qytetet shqiptare u internuan kurse popullsia e pafajshme iu nënshtrova haraçeve të ndryshme që kërkonte me forcë ushtria osmane.<sup>132</sup>

Për këtë kryengritje vlen përmendur se emigrimi i dhunshëm ose deportimi i familjeve dhe prijësve për autonominë e shqiptarëve gegë është një shembull tentim i përmbysjes së vetëdijes që po lindte, por edhe të themeleve të një shteti kombëqë do të lindë më vonë nga përpjekjet e Rilindasve shqiptarë dhe pas revoltave të vazhdueshme të shqiptarëve dhe lidhjeve për bashkim dhe autonomi siç ishte edhe Lidhja e Prizrenit e vitit 1878 si paraprijëse.

## **Ndryshimet e dhunshme të demografisë për të ngritur shtetin komb**

Territori ku jetonin shqiptarët në vitin 1912 numëronte 2 million banorë prej të cilëve pakica serbe, maqedone, greke përbënin 200 000 banorë. Shqipëria e njohur në Londër do të marrë vetëm 36% të territorit të përgjithshëm etnik në 1913.<sup>133</sup> Edhe pse ne shpesh njohim se Shqipëria u

<sup>131</sup> Vebi Xhemaili, Kryengritja e Dervish Carës parapërgatiti Lëvizjen e Prizrenit, <http://dervishcara.blogspot.com/p/dervish-cara.html>

<sup>132</sup> Po aty.

<sup>133</sup> B.Meta, M. Verli, M.Shatri, "Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX", Vëllimi 1, Tiranë 2017, 222-223



shpall në 1912, integriteti i saj territorial do të njihet tek më 1920 kur ajo do bëhet anëtare e Lidhjes së Kombeve. Trojet tjera të banuara me shqiptarë do të mbesin në Jugosllavi dhe Greqi.

Dalja e Shqipërisë si vendi i fundit i pavarur ballkanik në 1912 dhe Luftërat Ballkanike të 1912-13 u shoqëruan me zhvendosje të vazhdueshme të detyruar të popullsisë që jetonte rreth kufijve të rinj të kontestuar, pasi traktatet e njëpasnjëshme u përpoqën të vendosnin kufij për shtetet e reja ballkanike. Pothuajse një e treta e territoreve të banuara nga shqiptarët u humbën për vendet fqinje të Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, qeveritë e të cilave zhvilluan fushata të egra për të dëbuar shqiptarët që jetonin atje.<sup>134</sup>

Presionet e ndryshme dhe dhuna ndaj popullatës me qëllim të krijimit të territorit homogjen nga shtetet e reja kombe kishin rezultuar edhe me ndërimit të fesë të mijëra shqiptarëve kurse disa qindra ishin ekzekutuar për mos pranimit. Me urdhër të organeve më të larta të Serbisë dhe Malit të Zi, Ministria e punëve të Mbrendëshme në Bashkëpunim me ministrinë e Arsimet dhe të Punëve kishtare do ta kryente këtë detyrë.<sup>135</sup> Këto masa represive do të detyronin ikje të popullsisë masivisht në male, si dhe shpërngulje me dhunë në brendësi të Shqipërisë si dhe në Perandorinë Osmane. Kjo do ndërpritet me veprimin e Komisionit Ndërkombëtar të formuar nga Austro-Hungaria i cili do të detyrojë Mbretin Malazias të shpallë proklamatin për liritë fetare dhe garantimin e jetës dhe pronës me 18 prill 1913.<sup>136</sup>

Gjatë periudhës (1913-1915) u përdorën forma dhe mjete të ndryshme dhe ndër to edhe shpërngulja massive e shqiptarëve dhe kolonizimi sllav i viseve të tyre. Sipas dokumenteve serbe nga nëntori i 1912 e deri korrikun e 1914, numri i të shpërngulurve drejt Anadollit kishte arritur 412 000.<sup>137</sup> Në mars të 1914, Kryeministri serb Nikola Pasiç, deklaroi se qeveria serbe parashikonte të vendoste në tokat e të shpërngulurve 250 mijë emi-

<sup>134</sup> Mark Tirta, "Migrime të shqiptarëve, të brendshme dhe jashtë atdheut (vitet '40 të shek.XIX-vitet '40 të shek.XX)", *Etnografia Shqiptare*, Tiranë 1999, 18.

<sup>135</sup> I.Bicaj, *Marrdhëniet shqiptaro-malazeze (1881-1914)*..., f.180

<sup>136</sup> B.Meta, M. Verli, M.Shatri, "Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX", Vëllimi 1, Tiranë 2017, 222-223

<sup>137</sup> Po aty, 460

grantëekonomikë serbë, që do të vinin nga Amerika."<sup>138</sup>Kjo dhe shumë fakte historike spjegojnë se si shtetet e lindura kombëtare kanë përdorur masat e dhunëshme për të ndryshuar demografinë e territoreve të okupuara për të krijuar hapsira homogjene një kombëtare.

## Marrëveshjet për shkëmbim të popullatës

Konferenca e Versajës 1919 kishte shënuar rënien e perandorive dhe poashtu lindjen e shteteve kombe, hapja e shkollave në gjuhët zyrtare ka mundësuar ngurtësimin e një identiteti nacional. Shqiptarët kishin ngelur të ndarë në disa shtete të reja ballkanike të cilat ishin zgjeruar në territoret e Perandorisë Osmane të banuara me shumicë shqitare. Greqia e cila ishte zgjeruar në të dyja luftrat Ballkanike kishte dyfishuar popullatën në 4 734 990 banorë, por prej tyre vetëm 44,1% ishin grekë. Prandaj ajo do të fillojë me spastrimin e pakicave. Në periudhën nëntor 1912 deri në mars 1914 do të largojë nga provinca e Maqedonisë 243 807 muslimanë, ndërsa nga 10 marsi deri në fund të majit 1914 nga Selaniku do të largojë 34 570 muslimanë prej të cilëve 8 718 shqipëtarë.<sup>139</sup>Ky proces spastrimi do të përcillet me masa të dhunshme dhe tortura për të krijuar territor më homogjen grek.

Pas Versajës, një traktat që do i shkaktoj dëm të madh trungut kombëtar shqiptar është edhe **Traktati i Lozanës**, një traktat paqeje i nënshkruar në Lozanë, Zvicër, më 24 korrik 1923. Traktati i dha fund zyrtarisht konfliktit midis Perandorisë Osmane dhe Aleatëve me të mbaruar të LPB. Traktati i Lozanës i dha fund konfliktit dhe i përcaktoj kufijtë e Republikës moderne Turke. "Me një dekret Greqia përvetësoi pronat e shqiptarëve muslimanë dhe jozyrtarisht i trajtoi si popullsi shkëmbyese, ashtu siç e parashihte Marrëveshja e Lausanne-s për turqit e Greqisë. Kryeministri i atëhershëm grek Theodoros Pangalos i kishte premtuar ambasadorit shqiptar në Athinë Mit'hat Frashërit se popullsia arvanite dhe çame nuk do të prekej nga Marrëveshja e Lausanne-s dhe shqiptarët muslimanë nuk do të quheshin popullsi turke. Ky ishte një premtim bosh, sepse edhe në vitet në vijim vazh-

<sup>138</sup> Po aty...461

<sup>139</sup> B.Meta, M. Verli, M.Shatri, "Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX", Vëllimi 1, Tiranë 2017, 530-539

doi shpronësimi i çamëve."<sup>140</sup>Një pjesë e madhe e çamëve të shpronësuar sot jetojnë në Shqipëri në pamundësi për t'i kthyer pronat e të parëve.

Megjithatë në Shqipërinë Londineze, siç zbulon Roucek, një tjetër element interesant duhet argumentuar se migrimi i femrave ishte i ndaluar nga qeveritë e ndryshme shqiptare deri në fund të viteve 1930, me qëllim që të 'mbahej rritja aq e nevojshme e popullsisë', e cila ishte dëmtuar rëndë gjatë luftërave të viteve të mëparshme dhe nga emigracioni.<sup>141</sup>

### **Ikja nga diktatura komuniste**

Partia Komuniste do të merr pushtetin tërësisht në duart e saj dhe kjo do të jetë një fund për veprimin e anëtarëve dhe adhuruesëve të partive anti-komuniste siç ishte Partia e Legalitetit (Partia e Legalitetit) dhe Balli Kombëtar (Balli Kombëtar). Me mijëra do ta braktisin vendin. Disa mijëra mbështetës do të largohen me të tërhjekur trupat gjermane në disa drejtime, ose drejt Jugosllavisë, ose me anije drejt Italisë. Një numër udhëheqësish që kishin ndihmuar britanikët gjatë luftës do të ikin në Mbretërinë e Bashkuar ku do t'i bashkoheshin mbretit Zog. Mijëra mbështetës të tjerë të Ballit Kombëtar dhe Legalitetit do të largoheshin gjatë viteve 1945-46 për në SHBA. Kësaj do t'i paraprinte një qëndrim në kampe refugjatësh në Greqi, Jugosllavi dhe Itali., Nga Evropa një grup i vogël antikomunist, mes tyre anëtarë dhe adhurues të Ballit Kombëtarë dhe Ilegalitetit do të arrinte në ShBA ku do të forconin lëvizjen antikomuniste (1950-1960). Përfundimisht në ShBA do të vijjnë shqiptarë nga kampet jugosllave në vitin 1970. Gjatë këtyre viteve të fundit të LDB shqiptarët kryesisht refugjatë anti-komunistë (rreth 400 në periudhën e hershme të pas vitit 1944) do të arrijnë edhe në Australi. Gji-

<sup>140</sup> Mekulipress, <https://www.mekulipress.com/cfare-permban-traktati-i-lozanes-dhe-si-u-demtuan-shqiptaret-ne-greqi/>(E pare për here tëfundit 2.10.2022)

<sup>141</sup> Roucek, J.S. (1939a) 'New' immigration: South European states. Albanian Americans, in Brown, F. J. and Roucek, J. S. (eds) Our Racial and National Minorities. Their History, Contributions, and Present Problems. New York: Prentice-Hall, 333.

thashut një numër i madh i shqiptarëve do të vendosen në Evropë, si në Belgjikë, Francë (1956) etj.<sup>142</sup>

## Periudha e mbylljes në vete

Gjatë periudhës komuniste kur Shqipëria u prish fillimisht me ish-Jugosllavinë në vitin 1948, më pas me ish-Bashkimin Sovjetik dhe bllokun sovjetik në vitin 1961 dhe më pas së fundi me Kinën në vitin 1977. Një gardh me tension të lartë prej tre metrash u vendos përgjatë kufirit tokësor me Jugosllavinë dhe Greqinë dhe tentativa për emigrim u konsiderua si një akt tradhtie, e dënuar me vdekje ose me burgim të gjatë.<sup>143</sup> Nga ana tjetër edhe lëvizjet e shqiptarëve nga trojet tjera etnike në drejtim të shtetit shqiptar ishin me pasoja meqë regjimi kishte të rritur dozen e paranojës ndaj spiunazhit të vendeve fqinje e sidomos Jugosllavisë Titiste ku jetonte pjesa më e madhe e kombit që tani po ngriheshte vetëm në Shqipërinë Londineze. Si rezultat, emigracioni midis viteve 1950 dhe 1989 vetëm rreth 20,000 ishin në gjendje të largoheshin nga Shqipëria.<sup>144</sup> Kjo periudhë e migrimeve nuk mund të rrezikonte shtetin komb që po ngriteshte në themelet e ideologjisë komuniste. Eliminimi i oponentëve politikë do të garantonte një diktaturë afatgjatë deri në 1985.

Në trojet e okupuara nga jugosllavët ishin përpiluar elaborate famkëqija si ai i Nobelistit, Ivo Andriq (1939) dhe profesorit dhe akademikut Vasa Çubrilloviq (1944) që synonin ndarjen e Shqipërisë, dmth asgjësimin e një qendre për shqiptarët e Kosovës si dhe shpërnguljen dhe kolonizimin e trojeve ku shqiptarët do të mbeteshin pakicë lehtë e asimilueshme.<sup>145</sup>

Nga një studim krasues i Dr. Evin Pezo mund të mësojmë për marrëveshjet për shpërngulje të popullatës joslave nga e ashtuquajtura Ser-

<sup>142</sup> Julie Vullnetari, *Albanian migration and development: state of the art review*, IMISCOE Working Papers, 18) Amsterdam, 2007 <http://eprints.soton.ac.uk/id/eprint/377326>

<sup>143</sup> Julie Vullnetari, *Albanian migration and development: state of the art review*, IMISCOE Working Papers, 18) Amsterdam, 2007 <http://eprints.soton.ac.uk/id/eprint/377326>

<sup>144</sup> de Zwager, N., Gëdeshi, I., Gërmenji, E. and Nikas, C., *Competing for Remittances*, IOM, Tirana 2005

<sup>145</sup> Hivzi Islami, "Aspekti etnik i migrimeve: shqiptarët në rrjedhat e shpërnguljeve të dhunshme", *ASHAK*, Prishtinë, 2012, f.173-200

bia Jugore. "Konferenca për çështjen e "emigrimit të popullsisë me origjinë joslave nga Serbia Jugore" u mbajt tek në 20 shtator 1935, në kohën e qeverisë së Milan Stojadinoviçit. Në një kohë të shkurtër pati një aktivitet të madh në këtë çështje. Domethënë, më 24 shtator u mblodh një komision i ngushtë i asaj konferencendërmistrorë dhe më 1 tetor 1935 u mbajt konferenca e dytë ndërministrorë për këtë çështje."<sup>146</sup>

Menjëherë pas konferencës ndërministrorë të 1 tetorit, Stojadinoviç, në fjalimin e tij drejtuar përfaqësuesit mbretëror në Ankara, Branko Lazareviç, i kërkoi atij të përfitonte nga "mundësia e favorshme që po na ofrohet", duke vënë në dukje përpjekjet për homogjenizimin kombëtar turk. Përpjekjet e qeverisë për të zgjidhur çështjen demografike dhe ligji i kolonizimi i vitit 1934, sipas tij, "vuri në perspektivë mundësi të papritura lidhur me emigrimin e turqve nga shtetet e Ballkanit në Turqi" dhe hapi mundësinë e "futjes së një numri më të madh arnautësh në mesin e turqve emigrantë". Stojadinoviç, në një mënyrë, mori përsipër dhe përsëriti argumentimin e lartpërmendur se interesat kombëtare dhe ushtarake diktojnë "që kjo popullsi joslave në rajonet jugore të reduktohet në numrin më të vogël të mundshëm, në mënyrë që popullsia jonë të zhvendoset me sukses nga rajonet e tjera në Serbinë Jugore. Kjo mund të arrihej vetëm me emigrimin e elementit joslav në numër të madh dhe sipas një plani të caktuar jashtë kufijve të vendit tonë."<sup>147</sup> Vetë okupimi i Greqisë nga Italia në 1940 do ta ndërprejë shpërnguljen përmes Selanikut. Po në vitet e 50ta do të fillojë edhe një valë shpërnguljesh për në Turqi, e ashtuquajtura marrëveshje Tito-Kyprili e vitit 1953. Gjatë viteve 1950, ka pasur emigrimin më të madh të muslimanëve që nga krijimi i Jugosllavisë. Arsyeja për këtë ishte marrëveshja joformale ndërmjet Jugosllavisë dhe Turqisë e vitit 1953, e cila shpeshherë në mënyrë të pajustificueshme barazohet me konventën e vitit 1938. Modalitetet e krijimit dhe korniza përmbajtësore e asaj marrëveshjeje ishin të karakterit tjetër, dhe duhet theksuar se iniciativa në fillim të viteve pesëdhjetë erdhi nga pala turke, ndërsa Jugosllavia në këtë rast u tregua pasive. Në

<sup>146</sup> Edvin Pezo. "Komparativna analiza jugoslovensko-turske Konvencije iz 1938. i „džentlenskog sporazuma“ iz 1953. Pregovoriokoiseljavanja muslimana iz Jugoslavije". Tokoviistorije 2:97-120. <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=215073>

<sup>147</sup>Po aty, 104

vazhdimësi politikat serbo-jugosllave kan patur për qëllim mposhtjen e faktorit demografik shqiptar.<sup>148</sup>

### **Imigrimi pas viteve 1990**

Gjithashtu në Greqi ndodhet komuniteti më i madh i emigrantëve shqiptarë nga Shqipëria, të cilët u vendosën në këtë vend pas vitit 1990. Në fillim të viteve 1990 shqiptarët gjithashtu emigruan masivisht drejt Italisë, duke formuar për nga numri komunitetin e dytë më të madh të emigrantëve. Kryesisht këta emigrantë ishin ekonomik të cilët kishin braktisur vendin nga rënia e ekonomisë së vendit dhe varfëria e skajshme që e kishte kapluar. Nga emigrantët shqiptarë do të ketë edhe prej atyre të cilët do ti bashkangjiten UÇK-së dhe do luftojnë së bashku me shqiptarët e tjerë. Ndër ta vlen të theksohet Dashamir Alliu nga Librazhdi që luftoi në zonën e Llapit.<sup>149</sup>

Migracioni që do të themelojë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës do të jetë ai i diasporës në Zvicër dhe vende tjera të Evropës perendimore. Veprimtaria e kësaj ushtrie do të përshpejtojë proceset për krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Kjo mërgatë përbëhet nga shqiptarët nga Kosova dhe shqiptarët nga viset e tjera shqiptare të ish Jugosllavisë të cilëve do ju shtohen edhe shqiptarët nga Shqipëria pas vitit 1990, të cilët përbëjnë popullatën e katërt më të madhe në Zvicër. Edhe pse Kosova në rrethanat u krijuara historike u shpall si shtet qytetar përsëri korpusi politik dhe shtetror është në duart e shqiptarëve të Kosovës që përbëjnë 90% të popullatës së përgjithëshme. Gjatë vitit 2018, 24.2 mijë shqiptarë kanë fituar shtetësinë greke kurse në Itali 21.8 mijë shqiptarë kanë fituar shtetësinë italiane.

---

<sup>148</sup>Hivzi Islami, "Aspekti etnik i migriimeve: shqiptarët në rrjedhat e shpërnguljeve të dhunshme", ASHAK, Prishtinë, 2012, f.203-211

<sup>149</sup>Bota Sot për Dashamir Alliu, <https://www.botasot.info/libra-sporti/1025568/dashamir-alliu-dje-me-pushke-e-sot-me-pene/>

## Përfundimi

Lëvizjet e popullatës për shkaqe të ndryshme e kanë prekur edhe popullin shqiptarë ndër shekuj. Emigrimi ka qenë për pjesën më të madhe shkaku i dhunës së ushtruar ndaj tyre në trojet e mbetura jashtë Shqipërisë londineze filloi ekspansioni i serb, malazez dhe grek dhe sjellja e kolonëve nëpër fshatrat e braktisur të shqiptarëve. E kaluara e trazuar e okupimeve, luftimeve të ndryshme kanë shkaktuar mozaikun që e kemi kohëve të fundit. Shpërnguljet e dhunshme dhe internimet e sistemit komunist përbrenda shtetit komunist shqiptar kanë shkelur rëndë lirinë e lëvizjes të intelegjencës shqiptare.

Globalizimi ka bërë të mundëshme që shqiptarët të reflektojnë dhe të njohin veten më së miri. Pushtimet dhe ndikimet e kulturave, besimeve në etapa të ndryshme kanë sjellë që shqiptarët të mos arrijnë një vetëdijësim kombëtar dhe unifikim territorial në kohë të duhur. Identiteti unik një gjuhë, një kishë, një komb nuk ishte i mundur te shqiptarët të cilët tani ishin mozaiku multikulturor i Ballkanit. Këtë përmes forcës e kishin realizuar edhe serbët edhe grekët. Populli shqiptar duke qenë një popull i vogël dhe më pak i përgatitur dhe pa mbështetje të ndonji fuqie të kohës do bëhet objekt i projekteve të mëdha të shteteve kombe fqinje që ngriteshin në një pjesë të madhe të trojeve etnike. Kjo do të bëjë që shqiptarët të vonohen me ndërtimin e shtetit kombëtar edhe atë në një pjesë të territorit që më vonë të pasojë me një periudhë të ndërtimit të shtetit ideologjik komunist. Socializmi Titist do t'i pranojë përpjekjet e shqiptarëve për universitet (1968) pastaj do të forcojë edhe autonominë e Kosovës me Kushtetutën e 1974.

Kërkesat e shqiptarëve në 1981 që Kushtetuta tua njohë statusin e Republikës do fillojë presionin e dhunshëm sistematik të Serbisë që si konsekuencë do vijnë largime të mëdha të rinjve gradualisht deri më 1991 kur ajo diasporë e krijuar do të fillojnë procesin organizimit politik dhe ushtarak dhe kthimit në Kosovë. Ky kthim madhështorë do shaktojë gjithashtu ikje të mëdha nga frika për hakmarrje të popullatës serbe e cila do tërhiqet në enklava dhe një pjesë bukur e mirë do ikë edhe në mbrendi të Serbisë por kryesisht do koncentrohet në komunat veriore të Kosovës duke ngritur përqindjen etnike dhe duke bërë veriun një territor homogjen serb. Edhe pse Kosova

për shkaqet e ditura si rrjedhojë e Rezolutës 1244, pushteit të UNMIK-t dhe sistemi i propozuar nga Ahtisari nuk do ngrihet si një shtet nacional, por një sistem politik qytetar dhe multinacional. Kosova në përgjithsi është homogjene në të jetojnë 90% shqiptarë dhe 10% të tjerë ose vetëm 5% serb të cilët nuk mund ta destabilizojnë Kosovën pa involvim të shtetit Serb. Tendencat për të kthyer influencën serbe në Kosovë (së paku në veri të Kosovës), bazohen në parakushtet përmes një Bashkësie komunash në bazë nacionale me një imponim për entitet politik. Injorimi i shtetit të Kosovës, institucioneve, simboleve forcave të sigurisë gjenë edhe mbështetje nga figurat në pushtet tani në SHBA dhe BE edhe pse Kosova sillet si një shtet modern demokratik liberal dhe qytetar.

Në Kosovë dhe trojet shqiptare migrimi i gjeneratave të reja ndodh për arsye ekonomike, jo për arsye të mungesës së shtetit komb, për arsye se gravitimi i fuqisë punëtore bëhet në drejtim të qendrave Evropiane si ekonomi më të fuqishme. Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut nuk kanë ndonjë autonomi territoriale politike që mund të rritet në nivelin e kombit apo në një Republikë. Idetë nacionaliste të shqiptarëve janë shuar. Ata kanë pranuar sistemin konsocial të ndarjes së pushtetit dhe jetojnë si pjesë e pupullit shqiptar përkrah kombit maqedonas. Gjithashtu edhe shqiptarët në Luginën e Preshevës dhe Mal të Zi dhe në Sanxhak përbëjnë minoritete që luftojnë për më shumë të drejta në shtetet ku jetojnë. Në të gjitha këto shtete kombe, numri është shumë i madh i të rinjve që gjejnë forma të emigrojnë, ose përmes bashkimit familjar ose përmes punësimit legal ose ilegal. Në kohëra moderne shpërngulja po bëhet për arsye ekonomike dhe në kërkim të një jete më të pasur, më joshëse që e imponojnë trendet zhvillimore botërore. Gjatë kohës së ish-Jugosllavisë së Titos pjesa më e madhe do të emigronin dhe do kërkonin azil politik si të përndjekur dhe të shtypur të sistemit komunist. Pjesa e tjetër e shpërnguljeve të dhunshme (1923-1960) pastaj periudha (1968-1990) përmes marrëveshjeve xhentëlmene ose planeve shpronuese dhe dëbuese paraqet një goditje të rëndë ndaj forcave shqiptare për të bërë kombin.. Këto plane të gazepit janë pasuar me plane të kolonizimit me popullata greke ose serbe e malazeze. Pushtuesit realizonin planet dhe mega-li idetë e tyre duke u zgjeruar territorialisht dhe duke krijuar territore homogjene. Pastrimi etnik i dhunshëm i shqiptarëve nga Kosova 1999, por



edhe kthimi i tyre masiv në vendlindje përsëri ka lënë një pjesë në diasporë e cila bashkë me diasporën e mëparshme kontribuojnë në mbajtjen e ekonomisë së Republikës së Kosovës me një ekonomi të dobët përmes remitancave dhe investimeve kapitale. Gjithashtu migracioni shqiptarë të gjitha investimet i orienton në Shqipëri e sidomos në sektorin e turizmit në bregdetin shqiptar.

Lëvizjet e popujve të mëdhej qoftë si refugjatë, si investitorë apo misionarë në trojet shqiptare por edhe emigrimet e shqiptarëve në vendet perendimore alarmon për një zëvendësim dhe ndryshim të demografisë së popullatës shqiptare, por edhe më gjërë me pupuj të lindjes së afërt dhe të largët. Blerja e pronave në bregdetin shqiptarë gjithashtu rezikon demografinë etnike shqiptare. Mungesa e fuqisë punëtore si dhe aktivizimi i agjencive të punësimit po hap mundësi të shpërnguljes apo emigrimit të investitorëve, punëtorëve profesional nga trojet tona etnike. Këto mendime janë hipotetike mirëpo edhe të mundshme megjithëse kërkojnë edhe një studim të veçantë të shpërnguljes së pupujve të tjerë në vendet tona që duket se është në rritje.

Shteti komb si duket e humb kuptimin që ka pasur në fillet e shekullit XIX. Sidomos tani me eurointegrimet dhe demokracinë liberale, lëvizjen e lirë të njerëzve, mallërave dhe kapitalit mbrenda një tregu të lirë dhe të hapur.

## Bibliografia

- Hivzi** Islami, "Aspekti etnik i migriimeve: shqiptarët në rrjedhat e shpërnguljeve të dhunshme", ASHAK, Prishtinë 2012
- Hivzi** Islami, Rrjedhat demografike në Kosovë dhe shoqëria civile, Antropologjia e shoqërisë civile, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Prishtinë, 2001.
- Hivzi** Islami, Spastrimet etnike (politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve), Dukagjini, Pejë, 2003
- Hakif** Bajrami, "Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës 1844-1995", Prishtinë 1995
- Hakif** Bajrami, "Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi (dokumente)," Prishtinë 1996
- Hakif** Bajrami, "Politika serbe për rikonizimin e Kosovës me sllavë 1945-1948 (vëllimi i parë)", Prishtinë 2002
- Mark** Tirta, "Migrime të shqiptarëve, të brendshme dhe jashtë atdheut (vitet '40 të shek.XIX-vitet '40 të shek.XX)", Etnografia Shqiptare, Tiranë 1999

- Mark** Krasniqi, Savremen drustveno-geografske promene na kosovu I Metohiji, GMKM, Pristina, 1963
- Lee E**, "A theory of Migration", Demography No.3, Chicago, 1966
- B.Meta**, M. Verli, M.Shatri, "Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX", Vëllimi 1, Tiranë 2017
- Noel Malkolm, Kosova –një histori e shkurtër, koha, Prishtinë, 1998
- Rexhep** Ismajli, Shqiptarët dhe Evropa juglindore, Thema, 11, Prishtinë 1993
- de Zwager, N., Gëdeshi, I., Gërmenji, E. and Nikas, C., Competing for Remittances, IOM, Tirana 2005
- Pllana E**, Shkaqet dhe mënyra e shpërnguljes së muhaxhirëve shqiptarë nga territori i Sanxhakut të Nishit në Kosovë (1877-1878), Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1980
- Pëllumb** Xhufi, Migrimet shqiptare në Greqi në shek. XIV, Studime Historike, nr. 3-4, Instituti i Historisë Tiranë, 1991.
- Zuljic S**, Antropogeografske padvale Jovana Cvijica, Izvori velikosrpske agresije, Rasprave-dokumenti (red. B. Covic), A. Cezarec-Skolska knjiga , Zagreb, 1991
- Nga Interneti**
- Edvin** Pezo. "Komparativna analiza jugoslovensko-turske Konvencije iz 1938.i.,džentlmenskog sporazuma" iz 1953. Pregovori oko iseljavanja muslimana iz Jugoslavije ". Tokovi istorije 2:97-120.  
<https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=215073>
- Julie** Vullnetari, *Albanian migration and development: state of the art review*, IMISCOE Working Papers, 18) Amsterdam, 2007 <http://eprints.soton.ac.uk/id/eprint/377326>
- Roucek**, J.S. (1939a) 'New' immigration: South European states. Albanian Americans, in Brown, F. J. and Roucek, J. S. (eds) Our Racial and National Minorities. Their History, Contributions, and Present Problems. New York: Prentice-Hall
- Eurostat Database (2019), Immigration by age group, sex and citizenship (migr\_imm1ctz): [https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr\\_imm1ctz&lang=en](https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_imm1ctz&lang=en)
- Eurostat Database (2019), Immigration by age group, sex and country of birth (migr\_imm3ctb)  
[:https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr\\_imm3ctb&lang=en](https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_imm3ctb&lang=en)
- United States Census bureau, ACS 1-Year Estimates-Public Use Microdata Sample (2019): <https://data.census.gov/cedsci/>
- European Statistical System, Census Hub (2011) :<https://ec.europa.eu/CensusHub2/query.do?step=selectHyperCube&qhc=false>
- UNDESA (2019) International migrant stock :<https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/data/estimates2/estimates19.asp>
- Ministri i Shtetit për Diasporën, Diaspora Shqiptare <http://online.fliphtml5.com>

com/dmiin/kgyt/#p=1

France The National Institute of Statistics and Economic (2017), Foreigners - Immigrants: country of birth and detailed nationalities: <https://www.insee.fr/fr/statistiques/4510549?sommaire=4510556#consulter-sommaire>

**Ljubica** Nedelkoska and Nick Khaw (2015) "The Albanian Community in the United States, Statistical Profiling of the Albanian-Americans"

**Nagi**, Dennis L. The Albania-American Odyssey. A Pilot Study of the Albanian Community of Boston, Massachusetts, New York: AMS Press, 1988.

Dinamikat e Popullsisë (2014) "Horizonte të reja" INSTAT: [http://www.instat.gov.al/media/3074/popullsia\\_dhe\\_dinamikat\\_e\\_saj\\_-\\_horizonte\\_t\\_reja\\_demografike.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3074/popullsia_dhe_dinamikat_e_saj_-_horizonte_t_reja_demografike.pdf)

Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje në Shqipëri (2019), Giz, INSTAT, IOM <https://albania.iom.int>

**Ylberza Halili**

*Instituti Albanologjik i Prishtinës*

## **FOLKLORI URBAN: GRAFITET SI SHPREHJE E FOLKLORIT**

### **Abstrakt**

*Folklori krijohet në vazhdimësi dhe si i tillë e pasqyron jetën tonë në vazhdimësi, nga e kaluara në të tashmen. Duke qenë reflektim i botës shpirtërore të njerëzve ai është aty ku janë njerëzit, në punë, në fshat, në rrugë, në qytet, në internet. Duke qenë se folklori përfshin një gamë të shprehjeve të kulturës dhe traditës së grupeve folklorike, ai manifestohet në forma të ndryshme komunikimi, jo vetëm gojore, por edhe përmes shkrimit.*

*Nga idetë e tyre humoristike, të mençura, të pahijshme, vulgare, potencialisht armiqësore, jo tolerante dhe idetë alternative, grafitet si pjesë e folklorit dhe komunikimit urban janë simbole të një sub-kulture.*

*Grafitet në botën shqiptare paraqesin historinë dhe traditën e saj të zhvillimit, transformimit si dhe praktikat tipike të komunikimit midis grupeve shoqërore apo banorëve të atij qyteti. Situata e grafitëve në Kosovë dhe në Shqipëri është e tillë sa që, mbizotërojnë grafitet politike, por ka edhe nga ato të llojit reagues, me dimensione urbane, kulturore, sociale.*

*Grafitet i referohen çdo gjëje që është e vizatuar, pikturuar, e gërvishtur në çdo sipërfaqe të dukshme për publikun. Grafitet si komente të shkruara, anonime, të shkurtra, dhe shpesh tradicionale, të vendosura në mure publike dhe sipërfaqe të tjera të sheshta, tek ne ka kohë që komunikojnë me publikun.*



### **Folklori i shkruar**

Edhe pse termi "folklor" mendohet se i referohet kryesisht traditës gojore, ka një numër të formave tradicionale të cilat kanë qarkulluar gjithmonë në formë të

shkruar ose të shtypur. Këto përfshijnë autografët në libra, letrat zinxhirë, mbishkrimet mbi gur, grafitet, dhe baladat e kënduara apo të printuara. Për më tepër, qarkullimi i shtypur i formave të tilla si këngë popullore, përralla, shaka, tregime të gjata, fjalë të urta, gjëegjëza, gjatë shekujve, ka ndihmuar për t'i mbajtur gjallë materialet e tilla, duke kaluar poshtë e lartë në mes fjalës së shtypur dhe asaj të gojës.

Me zhvillimin e teknologjisë, dhe me ndryshimin e mënyrës së jetesës së njerëzve, kanë ndryshuar edhe konceptet dhe mendimet e studiuesve rreth oralitetit, apo kulturës gojore, me ç'rast ata janë përballur me dilemën se a duhet të vazhdojë të ekzistojë vetëm transmetimi gojor i materialit folklorik, apo të përdoren edhe medime të tjera në bartjen e materialeve folklorike, si: televizioni, radioja, printimi, shkrimi, interneti, etj., që sot konsiderohen medime të folklorit bashkëkohor. Walter Ong në librin e tij *Orality and Literacy* (Oraliteti dhe Literariteti) thekson se ai e konsideron oralitetin (gojëtarinë, kulturën e shprehur me gojë) e një kulture krejtësisht të paprekur nga çdo njohuri e shkrimit ose shtypjes dhe ky është "oraliteti primar". Është "primar" në kontrast me "oralitetin sekondar" të kulturës së sotme të teknologjisë së lartë, të cilin ai e sheh si një oralitet i ri që mbështetet nga telefoni, radioja, televizioni dhe pajisjet e tjera elektronike që varen nga ekzistenca dhe funksionimi në shkrim dhe printim. Sot kultura primare gojore në kuptimin e ngushtë vështirë se ekziston, pasi që çdo kulturë di shkrim dhe ka njëfarë përvoje të efekteve të saj. Megjithatë, në shkallë të ndryshme, shumë kultura dhe subkultura, madje edhe në një ambient të teknologjisë së lartë, ruajnë shumë nga mentaliteti i oralitetit primar.<sup>150</sup> Gjithashtu sa i takon teknologjisë dhe ndikimit të tij në folklor Alan Dundes thekson se:

*"Teknologjia nuk është zhdukja e folklorit, por është duke u bërë një faktor i rëndësishëm në transmetimin e folklorit dhe është duke siguruar një burim të mrekullueshëm të frymëzimit për brezin e folklorit të ri. Rritja e kompjuterit simbolizon ndikimin e teknologjisë mbi botën moderne. Argumenti im është se ka folklor në dhe rreth kompjuterit".*

---

<sup>150</sup>Walter J. Ong, *Orality and Literacy: The Technologizing of the World* (London, Routledge: Taylor & Francis Group, 2002), fq. 10.

## Folklori urban

Në studimin e folklorit dhe të formave të reja të komunikimit të tij duhet të merret parasysh edhe folklori urban si folklor që përfshin traditat dhe shprehjet folklorike të mjedisit urban apo historinë dhe traditat e një qyteti. Ai lind si një kombinim i folklorit i sjellur nga banorët e qytetit, pra nga shtëpitë e tyre të mëhershme, me folklorin që lind në përgjigje të jetesës në qytet. Çdo qytet është unik, duke reflektuar njerëzit që kanë ardhur aty dhe forcat gjeografike, politike, ekonomike që e kanë detyruar rritjen e tij. Duke sjellë së bashku njerëz të ndryshëm, me shumë vlera, besime, dhe zakone, qyteti krijon mundësinë e shkëmbimeve kulturore të reja, ndërveprimin e kombinimeve të veçanta të traditave, si dhe potencialin për konflikt dhe keqkuptime. Folklori gjithashtu lind në përgjigje të jetës së qytetit, shpesh në forma të vjetra, por me përmbajtje të re. Njerëzit kanë pikturuar në mure për mijëra vjet. Në qytetet amerikane të vitit 1960, pikturat e mëdha murale në ndërtesa, duke pasqyruar përvojat latine dhe afrikane u bënë pjesë e lëvizjes së artit urban. Studimi i folklorit në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara u fokusua fillimisht në artet rurale, traditat, dhe mënyrën e jetesës. Deri në vitin 1971, folkloristët amerikanë kishin debatuar nëse kishte apo jo folklor në qytete dhe, nëse po, çfarë ishte folklor. Duke filluar nga fundi i viteve '60-të deri në vitet e '70-ta, folkloristët dhe të tjerët filluan t'i kushtojnë vëmendje më serioze folklorit të qyteteve.<sup>151</sup>

Duhet të kuptojmë se, në përkufizimin e rreptë të termit "folk" (popull), nuk mund të ketë një gjë të tillë si "folklor" urban. Folklori urban do të ishte një kontradiktë në terma. Në të vërtetë, "folk" dhe "urban" ishin dhe në të vërtetë dhe ende mendohet të jenë në skajet e kundërta të një kontinuiteti teorik. Në këtë kuadër, shoqëria popullore është sinonim me shoqërinë "fshatare", fshatarët që lëvizin në qytet bëhen të urbanizuar dhe humbasin statusin e tyre si "popullore". Të flasësh për "folklorin urban" është të thuash absurditet në kontekstin e përkufizimit tradicional të "popullit".<sup>152</sup>

Termi "Folklor urban" dhe definicioni për të gjendet në shumë fjalorë enciklopedikë të folklorit amerikan dhe në njërin nga këta fjalorë thuhet se:

<sup>151</sup> Jan Harold Brunvand, *American Folklore* (New York: Garland, 1996), fq. 1502, 1503.

<sup>152</sup> Alan Dundes, Carl Pagter, *Work Hard and You Shall be Rewarded* (Detroit: Wayne State University Press, 1992), fq.xvii.

"Folklori urban, është kuptuar të jetë një simbol i një mënyre të thjeshtë, më të mirë, të jetës në të kaluarën paraindustriale dhe është ringjallur si një arratisje nga të këqijat e perceptuara të shoqërisë moderne urbane. Kështu, traditave që janë zëvendësuar nga kultura masive në vendet originale rurale – punët artizanale, kostumet, zakonet, muzika, vallet, këngët, u jepet një jetë e dytë në qytet. Identiteti etnik fiton rëndësi të veçantë kur njerëzit me prejardhje të ndryshme duhet të jetojnë dhe të punojnë në afërsi. Folklori i etnicitetit është shfaqur në mjediset publike, ku kulturat takohen, përplasen, apo i konfrontojnë traditat e zakonshme. Në qytet, ngjarje të tilla si ndejat e bllokut, pikniqet e lagjes, apo koncertet dhe tregjet lokale (ose shitjet në trotuar) janë disa nga rastet në të cilat një ndjenjë e komunitetit lokal është ndërtuar. Traditat materiale shënojnë kufijtë e enklavave brenda qytetit. Komunitetet më pak të dukshme të tilla si bandat amerikane të rrugës lënë shenja të dukshme që shënojnë territorin e tyre në gardhe ose mure"<sup>153</sup>.

Një nga tiparet më të pranuar gjerësisht të çdo folklori urban është rreflektimi i tij për ato që konsiderohen të jenë probleme sociale apo individuale. Dundes dhe Pagter merren me "folklorin urban të mbretërisë së shkrimit të dokumenteve" të bëra nga karikaturat, letrat zinxhirë, formularët dhe materiale të tjera të kopjuara dhe të përhapura midis masave punonjëse nëpërmjet fotokopjesit, faksit ose metodave të tjera elektronike të cilat, si tërësi "përbëjnë pjesën e përgjigjes së njerëzve ndaj disa sëmundjeve të jetës urbane".<sup>154</sup>

## Grafitet si formë e shprehjes folklorike

Pasi që e trajtuam folklorin në format e tij të reja shprehëse ne gradualisht kemi arritur tek grafitet. Çka janë grafitet? Cili është vendi i tyre në folklor?

Gjatë dekadave të fundit, shkencëtarët kanë filluar të hetojnë sistematikisht vendndodhjen dhe përmbajtjen e grafitëve. Kryesisht, kjo ka të bëjë me studimin e dy llojeve të mbishkrimeve - grafitet e rrugëve dhe grafitet e gjetura në muret e

<sup>153</sup> Thomas A. Green, *FOLKLORE: An Encyclopedia of Beliefs, Customs, Tales, Music and Art* (Santa Barbara, California: ABC-CLIO, 1997), fq. 817.

<sup>154</sup> Dan Imler, Ben Nagy, Tara Lyn Riordan, Asmeret Tekeste-Green, *Folklore on the Internet* <<https://www.units.miamioh.edu/psybersite/cyberspace/folklore/intro.shtml>> [shikuar së fundi më: 29.03.2023]

banjove publike – të quajtura latrinalia. Prandaj, shtrohet pyetja se a mund të përfshihen grafitet në kompetencat e folklorit? Le t'i analizojmë në vazhdim tiparet e tyre.

E para, në diskutimin se a janë grafitet gojore apo jo, studiuesi Jan Harold Brunvand thekson se shumica e folklorit "dëgjohet" duke arritur në vesh nga zërat apo nga instrumentet muzikore, mirëpo folklori i shkruar, (i tillë si grafiti apo rimat e autografit) është folklor verbal pa qenë gojor, transmetimi i tij është zakonor, jo i institucionalizuar. Siç shihet ky autor na i jep më të zgjeruar kufijtë e folklorit, duke e pasuruar atë me forma të tjera shprehëse, përtej gojores.

Po ashtu edhe Alan Dundes dhe Carl Pagter shprehen se është e gabuar pikëpamja të cilën e mbështesin folkloristët konservatorë se folklori është vetëm traditë gojore. Sipas tyre ka shumë forma folklorike që nuk transmetohen me gojë. Përveç vallëzimit popullor dhe artit popullor, që nuk mund të thuhet se transmetohen me gojë, ekziston një tërësi formash tradicionale, të tilla si vargjet e autografit të shkruara në libër dhe grafiti (duke i përfshirë edhe shkrimet tradicionale mbi muret e banjove që janë quajtur "latrinalia"). Më tutje, folkloristët theksojnë se grafitet janë tradicionale dhe transmetimi i tyre është i zakonshëm, dhe jo zyrtar. Gjithashtu, për grafitet mund të themi se përsëriten dhe ekzistojnë në versione të ndryshme. Përgjithësisht, grafitet shkruhen nga persona anonimë dhe përmbajnë të folurën formulaike dhe janë këto dy karakteristika që e lidhin me folklorin.

Ndërsa, studiuesi Jan Harold Brunvand, në studimin e tij për folklorin amerikan, e vë grafitin në kuadër të lirikës popullore dhe rimave, së bashku me rimat e lojërave, lirikat e punës, rimat e autografit, etj. "Grafitet apo shkrimet mbi mu-ret publike janë shpesh tradicionale, ndonjëherë të rimuara, por më shpesh marrin formën e komenteve të prozës së mprehtë", shkruan ky studiues.

Grafiti njihet edhe si një zhanër artistik në të cilin proverbat gjejnë vendin e tyre dhe luajnë një rol të rëndësishëm. Studiuesi Frank J. D'Angelo në punimin e tij Sacred Cows Make Great Hamburgers: the Rhetoric of Graffiti (Lopët e shenjta bëjnë hamburgerë të mirë: Retorika e grafitëve), shkruan se grafitet "në shumë mënyra i ngjajnë proverbave" në atë që: "janë koncize, të drejtpërdrejta dhe të mprehta. Ashtu si proverbat, ato përmbajnë të vërteta morale dhe etike. Ashtu si proverbat, ato janë të njohura për audiencën e tyre, sepse ato janë në



monedhën e përbashkët. Dhe si fjalë të urta, ato zakonisht krijohen nga individë, por vendosen në qarkullim nga masat".

Prandaj mund të themi se grafitet mund të konsiderohen folklor për këto arsye:

- Përbëhet nga një grup i folklorit sepse të rinjtë që e përbëjnë këtë grup ndajnë interesa, komunikim dhe zakone të përbashkëta,
- Është lloj i folklorit, sepse është produkt i popullit,
- Është një shembull i mirë i folklorit ngase zakonisht është anonim, krijues dhe shpjegues i mendimit të një individi a një grupi,
- Krijohet nga njerëz të zakonshëm, jo nga artistë profesionalë dhe studiues, që do të thotë se ai shpesh përbëhet më shumë nga mendimet e përditshme dhe idetë të cilat mund të lidhen me të gjithë,
- Përsëritet dhe shkruhet në versione të ndryshme, si dhe
- Është folklor i shkruar verbal pa qenë oral.

### **Arti i rrugës në Kosovë dhe në Shqipëri**

Shfaqja e grafitëve në Kosovë fillon në mënyrë sporadike në vitet shtatëdhjetë të shekullit XX, kurse më me intensitet në kalimin prej një shekulli në tjetrin.<sup>155</sup> Grafitet në Prishtinë, ndonëse në masë të vogël ishin të pranishme edhe para fundit të viteve '90, dëshmitë fotografike për to janë të pakta ose nuk gjenden për shkak se vetëdija për grafitin si lloj arti apo edhe për ruajtjen e tyre si dëshmi, ishte tepër e vogël ose nuk ekzistonte fare. Atmosfera e rëndë politike para luftës bënte që njerëzit të ishin të orientuar kah çështjet e mbijetesës.

Në Kosovë, çdo qytet është i mbushur me grafitë. Ato kanë të bëjnë drejtpërdrejt me përditshmërinë tonë. Problemet sociale apo politike janë në pjesën më të madhe mesazhet që trasmeton ky art urban. Grafitet janë kryesisht të shkruara në mure publike, ndërtesa, universitete, shkolla, etj. Nga fillimi i viteve 1980 kanë dominuar më shumë parullat: Kosova Republikë, Demokraci. Në atë kohë ka ekzistuar dëshira për lirin nga Serbia edhe ka shpërthyer reagimi. Kjo është edhe esenca e shkrimit të grafitit. Njerëzit e zakonshëm nuk kanë mundur ta shkruajnë në gazetë kërkesën apo ta thonë në

---

<sup>155</sup> Skender Boshnjaku, *Grafitet* (Prishtinë: Koha, 2016), fq. 6.

parlament, kështu që i vetmi medium i shprehjes ka mbetur muri, ndonëse edhe mundësia e burgosjes për shkak të shkruarjes së grafitëve ka qenë e madhe. Në Kosovë ka pasur mjaft situata politike dhe shoqërore që kanë mundur të sjellin një frymë reaguese.

Ndërsa, më vonë, diku nga fundi i viteve të 90-ta punimet e para të artistëve të rrugës që janë krijuar pas luftës, në Prishtinë, janë punuar nga Urban Gorillas. Këta të fundit kanë inspiruar gjeneratën e dytë që në atë kohë kanë qenë 13 – 14 vjeç. Dy artistë shumë të suksesshëm të artit të grafitit pas Urban Gorillas dhe që grafitet e tyre vazhdojnë të qëndrojnë në disa pjesë të Prishtinës, janë grafitet e Taulant Qerkinit dhe Jetik Dolit. Një artist tjetër që shkruan grafitë është edhe Burim Kursani i njohur me nofkën Bim Bimma, por ka edhe shumë të tjerë<sup>156</sup>. Gjithashtu në rrugët e Prishtinës gjenden të shkruara edhe grafitë reaguese me mesazhe politike të shkruara nga Lëvizja Vetëvendosje.

Lufta e fundit në Kosovë e vitit 1998-1999, por më vonë edhe pushteti kanë ndikuar të shkruhen shumë grafitë politike e më të pranishmet, për vite me radhë, janë grafitet e Vetëvendosjes. Aksionet e Vetëvendosjes që janë zhvilluar me shkrimin e parullave, duke filluar nga dita kur është themeluar Vetëvendosja, më 12 qershor 2005, ka qenë shkrimi i parullës "Jo Negociata, Vetëvendosje". Kjo parullë e shprehur përmes formës së grafitit ka treguar kundërshtinë për negociata, dhe kërkesën për vetëvendosje.

Ndërsa sa i takon artit të rrugës në Shqipëri, kushdo që ka shkruar në Tiranë, i ka parë në mure të ndryshme imazhet e grafitëve. Nga grafitet e mbledhura në rrugët e saj, kemi parë se mbizotërojnë grafitet përmbajtja e të cilave është "filozofike", mirëpo janë të pranishme edhe grafitet që përçojnë mesazhe politike ose mesazhe me përmbajtje etnike. Në përgjithësi grafitet

---

<sup>156</sup> Përpjekja ime për të kontaktuar grafitistët nuk ishte edhe aq e lehtë, sepse duke e ditur se grafitet shkruhen nga persona anonimë, dhe zakonisht konsiderohet si art jo i ligjshëm, ka qenë e vështirë për të hyrë në rrjetin e grafitistëve si në Kosovë, po ashtu edhe në Shqipëri. Kam arritur të kontaktoj dhe të realizoj intervista me shkruarit e grafitëve: Taulant Qerkinin (Taki), Agon Xhelilin, Valdrin Ahmetin, Besmir Malon (Beso) dhe Franko Dinen (Franko), të cilat edhe i kam trajtuar në këtë studim, me miratimin e tyre. Përmes këtyre intervistave kam dashur t'i takoj shkruarit e grafitëve dhe të dëgjoj për punën e tyre dhe për pikëvështrimin e tyre mbi artin e grafitëve.

në Shqipëri janë përgjigje ndaj rrethanave aktuale me të cilat ballafaqohen të rinjtë apo shkruesit e grafitëve.

## Përfundim

Folklori krijohet në vazhdimësi dhe si i tillë e pasqyron jetën tonë, nga e kaluara në të tashmen. Duke qenë reflektim i botës shpirtërore të njerëzve ai është aty ku janë njerëzit, në punë, në fshat, në rrugë, në qytet, në internet. Duke qenë se folklori përfshin një gamë të shprehjeve të kulturës dhe traditës së grupeve folklorike, ai manifestohet në forma të ndryshme komunikimi, jo vetëm gojore, por edhe përmes shkrimit. Nga idetë e tyre humoristike, të mençura, të pahijshme, vulgare, potencialisht armiqësore, jo tolerante dhe idetë alternative, grafitet si pjesë e folklorit dhe komunikimit urban janë simbole të një sub-kulture.

Grafitet në botën shqiptare paraqesin historinë dhe traditën e saj të zhvillimit, transformimit si dhe praktikat tipike të komunikimit midis grupeve shoqërore apo banorëve të atij qyteti. Situata e grafitëve në Kosovë dhe në Shqipëri është e tillë sa që, mbizotërojnë grafitet politike, por ka edhe nga ato të llojit reagues, me dimensione urbane, kulturore, sociale.

Ashtu siç u pa edhe nga trajtimi i këtij punimi, grafitet i referohen çdo gjëje që është e vizatuar, pikturuar, e gërvishtur në çdo sipërfaqe të dukshme për publikun. Grafitet si komente të shkruara, anonime, të shkurtra, dhe shpesh tradicionale, të vendosura në mure publike dhe sipërfaqe të tjera të sheshta, tek ne ka kohë që komunikojnë me publikun.

## Literatura

**Alan** Dundes, Carl Pagter, *Work Hard and You Shall be Rewarded* (Detroit: Wayne State University Press, 1992).

**Dan** Imler, Ben Nagy, Tara Lyn Riordan, Asmeret Tekeste-Green, *Folklore on the Internet* <https://www.units.miamioh.edu/psybersite/cyberspace/folklore/intro.shtml> [shikuar së fundi më: 29.03.2023]

**Jan** Harold Brunvand, *American Folklore* (New York: Garland, 1996).

Skender Boshnjaku, *Grafitet* (Prishtinë: Koha, 2016).

**Thomas** A. Green, *FOLKLORE: An Encyclopedia of Beliefs, Customs, Tales, Music and Art* (Santa Barbara, California: ABC-CLIO, 1997).

**Walter** J. Ong, *Orality and Literacy: The Technologizing of the World* (London, Routledge: Taylor & Francis Group, 2002).

**Ermal Mehmeti**

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup*

**Jeta Starova - Mehmeti**

*Fakulteti Pedagogjik - Shkup*

# **NDIKIMI I GLOBALIZIMIT NË MUZIKËN POPULLORE SHQIPTARE**

## **Abstrakt**

*Efektet pozitive dhe negative të globalizimit vërehen dukshëm në çdo sferë dhe fushë të jetës, shkaku i profesioneve tona të lidhura të ngushta me artin muzikor ne do të përqëndrohemi në ndikimin e globalizimit në muzikën popullore shqiptare në trevat tona. Globalizimi në përgjithësi merr hov te madh diku nga fundi i shekullit XX dhe duke vazhduar të rritet gjatë shekullit XXI. Globalizimi si proces ndikon pozitivisht dhe negativisht në larminë e kulturave të ndryshme të botës që ekzistojnë. Globalizimi kulturor është rezultat i një sërë masash që kërkojnë zhvillimin e vazdhueshëm të shoqërisë, i cili ka nxitur dhe rritur në masë të madhe marrëdhëniet ndërkombëtare dhe shkëmbimet kulturore, midis individëve që kërkojnë një mundësi për zhvillim individual.*

*Në të kaluarën vetëm shtetet e fuqishme si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglia mund të përhapnin muzikën e tyre, por tani me përparimin e teknologjisë, muzika shqiptare mund të dëgjohet anë e mbanë botës dhe publiku botëror mund të njihet me muzikën popullore shqiptare si një ndër stilet muzikore më të vjetra, më të veçanta dhe më të bukura në botë.*

**Fjalë çelës:** *ndikim, globalizim, muzikë popullore, muzikë shqiptare, këngë e vjetër.*



## **Ndikimi i globalizimit në muzikën popullore shqiptare në Shqipëri**

Muzika popullore shqiptare është një ndër pasuritë më të çmuara, më të vjetra dhe më të pasura që ka Shqipëria. Gjatë shekujve XVIII-XIX shumë studiues të huaj kanë hulumtuar folklorin muzikor shqiptar dhe kanë ardhur në konkluzion se pasuria kryesore e Shqipërisë është folklori muzikor. Sot e kësaj dite folklori muzikor është pjesë përbërëse në jetën e përditshme dhe gjurmet e lashtësisë së tij janë provuar që prej shekujve XIV-XIII p.e.s.

Folklori muzikor shqiptar është jashtëzakonisht i pasur çka dhe shprehet në ekzistencën e muzikës vokale që nga forma njëzërëshe e deri tek shumëzërëshi; në muzikën me instrumente popullore; muzikën me zë e vegla; muzikën për shoqërimin e valleve popullore, etj. Këtyre u shtohet dhe një fond i madh instrumentesh popullore të klasifikuara në katër grupet tashmë të njohura si: ideofone, membranofone, kordofone, areofone.

Krahasuar me vendet e tjera të rajonit apo edhe me Evropën në përgjithësi, Shqipëria ka pasur një përjasje më të ngadaltë me globalizimin. Kjo për shkak të mbizotërimit prej 45 vitesh komunizëm, gjë që solli një izolim të vendit si në aspektin ekonomik, politik dhe kulturor, megjithëse cilësia në muzikën shqiptare ka qenë e pakontestueshme në atë kohë. Muzika popullore në atë kohë është kultivuar në mënyrën më të mirë të mundshme nëpërmjet festivaleve anë e mbanë Shqipërisë duke trajtuar tërë pasurinë e folklorit shqiptar përfshirë të gjitha trevat nga Veriu në Jug. Nga rënia e komunizmit dhe hapja e shtetit ndaj botës natyrisht që ndikimi i muzikës së huaj gjen vendin e vet, si në aspektin pozitiv ashtu edhe në aspektin negativ. Në aspektin pozitiv vlen të përmendet se elementet që ju shtuan muzikës shqiptare janë ato përëndimore që ndikuan direkt në muzikën e lehtë, diçka që ishte e ndaluar gjatë periudhës së komunizmit duke i dhënë formën e vërtetë të muzikës, si për shembull: muzika rok, xhaz, alternative, r&b, e deri te muzika elektronike, sigurisht që në rrymat e tilla hasim elemente pozitive dhe negative. Kurse te muzika popullore vërehen dallime drastike të dukshme të një ndikimi lindor fenomen ky që pushtoi me hapa të shpejt tërë gadishullin balkanik madje duke u përfshirë edhe në disa pjesë të Europës perëndimore, vlen të theksohet se edhe në muzikën popullore e cila më vonë

u quajt muzikë e re e kompozuar ka edhe elemente pozitive të cilat u përdorën dhe u futën me kujdes dhe mjeshtri të madhe nga kompozitorët e kohës.

## **Ndikimi i globalizimit në muzikën popullore shqiptare në Kosovë**

Muzika në Kosovëka mjaft ndikime. Muzika ka qenë gjithmonë pjesë e kulturave shqiptare,serbesi dhe të etniciteteve të tjera në Kosovë. Muzika popullore zë një vend të rëndësishëm në shoqëri si identifikim kombëtar. Ekzistojnë shumë këngëtarë dhe ansamble popullore.Muzika klasike është prezente edhe në Kosovë.Muzika moderne në Kosovë e ka origjinën e saj në vendet perëndimore. Zhanret kryesore moderne përfshijnë: pop, hip hop, rok, xhaz...etj.

Sa i përket instrumenteve,si instrument kryesor dhe i lashtë është çiftelia (një instrument autentik shqiptar), edhe pse muzika popullore shoqërohet edhe me instrumentë si mandolina, mandola, kitarra, fizharmonika, klarineta, daullja, tupani..etj..

Në të kaluarën, poezia epike në Kosovë dhe Shqipërinë e Veriut u këndua me lahutë dhe më pas u përdor çiftelia. Muzika kosovare ishte e ndikuar nga muzika turke që kur ata e pushtuan Kosovën për pothuajse 500 vjet, por folklori kosovar ka ruajtur origjinalitetin e saj. Hulumtimet arkeologjike tregojnë se sa e vjetër është kjo traditë dhe si ajo është zhvilluar në mënyrë paralele me muzikën tjetër tradicionale në Ballkan. U gjetën shumë rrënjë që nga shekulli i 5-të përpara Krishtit, si piktura në gurë e këngëtarëve me instrumente (është i famshëm portreti "Pani" i cili mbante një instrument të ngjashëm me flautin).<sup>157</sup>

Përfaqësuesja e muzikës popullore nga Kosova është grupi popullor Shota, me këngëtarën e lartë Shkurte Fejza dhe gjithashtu një përfaqësues i Muzikës popullore dhe asaj të lehtë është Shkëlzen Jetishi, grupi muzikor Agimi dhe shumë grupe të tjera.

---

<sup>157</sup> Kruta, Beniamin (1990). *Vendi i polifonise shqiptare ne polifoninë ballkanike*. Kultura Popullore. fq. 13–14.

Si në tërë gadishullin ballkanik ashtu edhe në Kosovë, me ndryshimet politike u ndryshua edhe rrugëtimi i zhvillimit të muzikës popullore në kërkim të një tingulli të ri dhe një muzikë të re që më vonë u quajt si stil turbo-folk me origjinë nga Serbia. Kompozitorët e rinj të asaj kohe kërkonin një siguri më të madhe materiale duke modifikuar tingullin autentik popullor me elemente të shundit dhe kiçit, tingull i cili do të prodhonte më shumë zhurmë nëpër ahengjet e atëhershme me qëllim ikje nga realiteti i hidhur që krijonte situata e rëndë sociopolitikegjatë dhe pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë në fillim të viteve 90 të shekullit të kaluar në Kosovë. Ndryshime pësoi edhe muzika e lehtë Kosovare, e cila për dallim nga Shqipëria ndikimin e kishte nga Serbia dhe Perëndimi, kjo falë politikës së ish-Jugosllavisë e cila ishte e hapur ndaj botës gjë që ndikonte drejt për së drejti në krijimtarinë artistike.

## **Ndikimi i globalizimit në muzikën popullore shqiptare në Maqedoni**

Në Maqedoninë e Veriut do të përqëndrohemi ndaj dy qyteteve të cilat karakterizohen për nga tradita vokale, Prespa dhe Kërçova.

Fillimisht muzika popullore në rajonin e Prespës ka qenë dhe është mjaft prezente përmes këndimit polifonik. Përmes këndimit sinjalizohen të gjitha ahengjet familjare, kryesisht dasmat. Globalizimi ka ndikuar në këndimin polifonik në Prespë, këngët e mirënjohura pasurohen edhe me instrumente ritmike dhe melodike. Kënga popullore "Kranjë Prespë moj e bukur" është këngë e cila i këndohet Prespës, i është kushtuar Prespës dhe bukurive të saja natyrore. Kjo këngë është shembull i pasurisë polifonike që ka populli shqiptar me karakteristiken e saj e shoqëruar me iso.

Përveç pasuritë vokale që posedon rajoni i Prespës, karakteristikë tjetër e këtij rajoni janë kabatë me klarinet. Kaba është një formë muzikore e cila përdoret në Shqipërinë e Jugut në Përmet dhe në rajonin e Prespës në Maqedoninë e Veriut, zakonisht kjo formë interpretohet në violinë ose në klari-net, bëhet fjalë për shprehje emocionale muzikore të cilat përshkruajnë ndjenjat momentale që përjeton interpretuesi. Që të dyja këto forma muzikore në Prespë nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim drastik me globalizimin,

tradita është ruajtur në formën e saj ndër shekuj shkaku i eksodusit të emigracion që përjeton ky rajon.

Këndimi polifonik shqiptar i Kërçovës ndryshon nga këngët e tjera, jo vetëm për shkak të gjenezës së tij arkaike, e cila zakonisht kryhet pa shoqërim instrumental, por shoqërimi është i mundur, zakonisht sipas dëshirës së dëgjuesve, shpesh herë me kavall. Këndimi polifonik kërçovar ngjan me atë të Shqipërisë së Jugut, por ruan origjinalitetin e tij autentik dhe origjinal. Është karakteristike të theksohet se këngëtarët nga trevat e tjera kanë vështirësi në interpretimin e këngës polifonike kërçovare, duke mos arritur origjinalitetin origjinal në interpretim.

Këndimi polifonik dyzërësh i Kërçovës nuk është qendror në debatin për origjinën dhe gjenezën e këngës polifonike, siç është Labëria në Shqipërinë e Jugut, ku lulëzon kënga polifonike tre dhe katër zëshe (kjo e fundit si unike në botë), por megjithatë grupi muzikor Vëllezërit Dervishi, janë ambasadorët më të denjë të kultivimit dhe ruajtjes së pasurisë vokale që ka Kërçova. Edhe Maqedonia e Veriut e cila bënte pjesë në gjashtë Republikat e Ish Jugosllavisë, ndikimin e saj në muzikën popullore të shqiptarët si dhe muzikën e lehtë e kishte pjesërisht nga Serbia dhe lirisht mund të thuhet se ndikimi më i madh gjithsesi vjen nga lindja më saktësisht nga Turqia e sotme kjo fal ndikimit pesëqind vjeçar të perandorisë Osmane dhe lidhjet që u krijuan gjatë kësaj periudhe, ndikimi është i dukshëm në këngët që linden në Rajonin e Kumanovës, Shkupit, Dërvenit, etj....

## **Përfundim**

Muzika autoktone shqiptare duhet të ruhet duke u kultivuar nëpërmjet festivaleve të cilët do ta trajtonin këndimin dhe interpretimin e saj në formën origjinale. Muzika popullore shqiptare mund të thuhet se është në rrezik të madh për të humbur vlerën e saj monumentale duke u lënë në dorë të lirë autorëve të rinj të cilët gjithnjë e më tepër shërbehen me ndikime të huaja duke zgjedhur ato jo cilësoret në mënyrë që muzikën ta komercializojnë në atë nivel që ta sjellin si një produkt të lirë në treg për të realizuar më shumë qëllime materiale sesa ato kulturore, shpirtërore. Globalizimi mund të shihet edhe nga prizma pozitive për muzikën popullore shqiptare, për arsye



se ndihmon në mënyrë të jashtëzakonshme duke qenë në gjendje të shpërndajë atë në gjithë botën. Falë teknologjisë së sotme që kemi në dispozicion dhe e cila është në zhvillim të vazhdueshëm në transmetimin dhe shkarkimin e këngëve popullore shqiptare nëpërmjet internetit, të cilat hapin mundësinë e zhvillimit të artistëve në mënyrë individuale jashtë shtetit pa qenë të varur nga qeveritë, institucionet dhe kufizimet tjera, të cilat shpesh herë mund të vështirësojnë prezantimin e veprës muzikore.

## Literatura

- Beniamin** Kruta, Vendi i Polifonisë Shqiptare në polifoninë ballkanike, kultura popullore (1990)
- Jane S. Sugarman**, Engendering Song: Singing and Subjectivity at Prespa Albanian Singing, Chicago Studies of Ethnomusicologjies (1997)
- Vasil S.Tole**, Enciklopedia e muzikës popullore shqiptare, Tiranë (2001)

Alfred HALILAJ

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Pedagog në Fakultetin e Edukimit, Durrës

## ZHVILLIME TË FAREFISNISË NË ZONAT PARAURBANE. RASTI I SHQIPËRISË.

### Abstrakt

Zhvillimi i qyteteve të mëdha determinohet nga zhvillimi i periferive dhe detyrimisht ballafaqimi i të ardhurve me realitetin e ri shoqëror do të prodhojë një tension të pashmangshëm. Banorët e rinj vijnë kryesisht nga zonat rurale. Mënyra e jetesës e ngjizur në kujtesën sociale mban gjallë kozmologjinë e lidhjeve të mëparshme që në themel të tyre kanë farefisninë. Jeta e qytetit imponon individualitetin dhe sfumon mundësinë e ruajtjes së lidhjeve fisnore. Konflikti bëhet serioz duke marrë në konsideratë se shkrimi i hapësirën me banesat e reja të periferive korrespondon me krijimin e lagjeve të tëra me banorë që kanë lidhje gjaku mes tyre. Kjo morfologji sociale ka krijuar pak mundësi për t'u shkëputur nga lidhjet e farefisnisë dhe ndikimit të tyre. Pikërisht ky tension do të jetë objekti i këtij punimi. Që nga marrja e vendimit për t'u vendosur në një vendbanim të ri, përfytyrimi i qytetit, përzgjedhja e vendbanimit dhe shkrimi i hapësirës, ballafaqimi me vendasit dhe mënyrën e re të jetesës, lidhjet e vjetra dhe lidhjet e reja, ndikimi kozmologjisë së farefisnisë dhe tendenca për t'u shkëputur prej saj do të jenë disa nga çështjet që do të trajtohen. Si shembull do të merret zona e Kamzës, si një prej zonave më tipike paraurbane në Shqipëri dhe që përfaqëson kryesisht modelin kryesor se si u zhvilluan periferitë e qyteteve të mëdha pas rënies së diktaturës 50 vjeçare. Do të përdoren intervistat e drejtpërdrejta, anketimet, si dhe në mënyrë të veçantë do të shfrytëzohet teknika pjesëmarrjes së drejtpërdrejte e autorit në jetën e përditshme të banorëve të kësaj zone. Etnografia e fotografisë do të shfrytëzohet për të pasqyruar procese, raste, rituale, ngjarje që dëshmojnë për mënyrën e zhvillimit të tematikës që kemi marrë në analizë.

**Fjalë kyçe:** farefisni, lidhje gjaku, fqinjësi, martesë, zonë rurale, kujtesë, zonë paraurbane, qytet, Shqipëri.



## 1. Hyrje

Farefisnia përbën një nga temat kryesore të studimit të jetës njerëzore dhe ka marrë gjithnjë vëmendjen e studiuesve, pasi janë të pakëta temat që mund të përfshijnë universalisht shoqërinë dhe në të njëjtën kohëpothuaj të gjitha modalitetet e krijimit të lidhjeve sociale. Nga ana tjetër, jeta e qytetit përbën sot një temë qendrore pasi masa e njerëzve që jetojnë në qytete po tejkalon atë të fshatit. Antropologët angazhohen në debatin konceptual mbi atë që është ‘urbane’ në antropologji dhe atë që është ‘tradicionale’. Ky debat është zhvilluar në vitet ’80 të shekullit XX dhe iu dha mundësi antropologëve të vendosen në qytete, të linin fshatin dhe shoqëritë e ‘egra dhe ekzotike’, për të studiuar fenomenet e emigracionit, migracionit, etnicitetit, varfërisë, punës, etj., edhe pse nuk ishin definuar vetëm si probleme urbane, që i pëkisnin vetëm qytetit (Hanerzz, 1983). Debatit akademik vazhdon. Disa mendojnë se antropologjia urbane është thjeshtë një vazhdim i punës klasike të antropologjisë në qytete, kurse disa të tjerë e përcaktojnë qytetin si ‘*institucion social*’ të veçantë me dinamikat e marrëdhënieve sociale, politike, ekonomike dhe në këtë mënyrë e trajtojnë antropologjinë urbane si antropologji e qytetit (Prato&Pardo, 2013).

Qytetet zënë vetëm 2% të sipërfaqes së rruzullit tokësor, por ato shpenzojnë 75% të burimeve materiale dhe financiare dhe prodhojnë 75% të ndotjes së saj (Aliaj, 2008). Në vendet e Evropës Juglindore qytetet e planifikuara sipas modelit socialist e kishin të pamundur të përballonin një fluks kaq të madh të lëvizjes (Tsenkova, 2012) pas rënies së sistemit diktatorial, por secili vend ka pasur specifikën e vet. Në rastin e Shqipërisë lëvizja ishte e menjehershme dhe e pakontrolluar. Trauma e mbylljes u shoqërua me kaosin e lirisë. Refereni “ska shtet, ska ligji” (De Vaal, 2009) ndihej kudo. Lëvizja e popullsisë drejt qyteteve kryesore në vend jo vetëm që krijoi probleme të reja sociale por ballafaqimi nënkulturor ishte një sfidë e re e kulturës shqiptare. Tensioni i natyrshëm në mungesë të ligjeve dhe rendit shtetëror riktheu në zbatim norma të traditës. U diskutua aq shumë për ndikimin e kanunit, ligjit tradicional shqiptar, në qytet (Voell, 2012) sa që mendohej se

tashmë po jetohej në të shkuarën. Pati edhe paralelizma që e vendosnin shoqërinë kundër shtetit si një mungesë e theksuar e rolit të tij por duke interpretuar se atomizimi i botës fisnore është pa dyshim një nga mjetet më efikase që pengon integrimin e grupeve vendore brenda bashkësish të mëdha socio-politike dhe, më tej, një mjet për ndalimin e lindjes së shtetit, i cili, për nga natyra, është unifikues (Clastres, 2014). Ka pasur një konflikt të brendshëm dhe duhet një interpretim i gjendjeve, ngjarjeve, aspiratave, dhimbjeve, dëshirave, sfidave dhe gjithë sjelljeve e praktikave, kuptimeve e domethënieve në kontekst e shteg migrimi si të migrantit, ashtu edhe të aktorëve të tjerë në jetën e tij para, gjatë dhe pas aktit të migrimit (Canolli, 2018). Një vlerësim i saktë i efekteve të jetës urbane te njerëzit duhet të fillojë me të kuptuarit se mjedisi urban është produkt i një grupi të gjerë kauzal faktorësh (Flanagan, 2010).

Historia e zhvillimit të njeriut karakterizohet nga ndryshimi midis dy poleve: lëvizjes dhe vendbanimit (Mumford, 1961). Morfologjia sociale e zonave paraurbane, në rastin e Shqipërisë, është diktuar nga marrëdhëniet e farafisnise. Shkrimi i hapësirës është bërë duke krijuar një rrjetë lidhjesh për të mbrojtur faktin lëvizjes pa marrë miratimin e autoriteteve shtetërore. Ndërkohë në vend u krijuan “fshatra të vdekura” ose “Negro Villages” si domos në zonat e thella malore. Banorët e rinjtë periferive të qyteteve të mëdha kanë tërhequr njëri-tjetrin në funksion të legjitimitetit të këtij akti që përbente një sfidë të jashtëzakonshme edhe ndaj shtetit edhe për mënyrën se si do të ndërtonin jetesën në vendin e ri të banimit. Të qenit “të bashkuar” ishte rruga për ta përballuar.

## 2. Rasti i Kamzës

Kamza para vitit 1990 ishte një ndër fermat e mëdha në vend dhe gjatë diktaturës kishte një jetë sociale që i përgjigjej kërkesave të sistemit politik që kishte ndryshuar strukturën e banimit dhe të përdorimit të kësaj zone (Onuzi, 1982), duke ia nënshtruar proceseve proletarizuese qëu përpoqën të zhdukin realitetin dhe konceptin e pronës private në shoqërinë shqiptare (Lelaj, 2015). Një nga banorët e vendosur në Kamzë pas rënies së diktaturës, sot 68 vjeç nga verilindja e Shqipërisë shprehet: “*Ishte guxim i madh, i mora*

*fëmijët dhe erdha në fushë të hapur. Ndërtova me familjen një barakë me dërrasa dhe e mbulova me plasmas. Vetëm unë di se sa jam shterrur shpirtërisht.”*



*Foto 1. Pamje e Bathores (Kamëz-Tiranë), viti 1994. Foto e marrë nga faqja e facebook-ut të studiuesit shqiptar Besnik Aliaj.*

Mbi një pamje të tillë po ngrihej një vendbanim i ri që për pak vite do të shndërrohet në pamjen e figurës nr.2. Nuk ka pasur anjë plan urban mbi të cilin të ndërtoheshin banesat por bazuar në kozmologjinë e tyre ata kanë ndërtuar shtëpitë. Në kushtet e një lëvizjeje të tillë, qytetarët shqiptarë, nisur nga konstrukt i kulturor mbi hapësirën, qytetin dhe marrëdhëniet njerëzore, kanë vendosur banesat sipas botëformimit të tyre. Në kushtet e lirisë dhe pa rregulla, sigurisht që nuk mund të pritët zbatimi i standardeve urbane apo estetike. Vlen të përmendet në këtë pikë, kultura shqiptare e vendosjes së vendbanimit, që riaktivizohet dhe ndihmon qytetarët të vendosin piketat e rëndësishme të jetës së përbashkët si rruga, uji i pijshëm, kanalizimet e ujërave të zeza, kufijtë e tokës, etj.



*Foto 2. Pamje e Bathores, në të njejtin vend sot.*

Modeli i familjes patriarkale është dominues. Vetëm një forcë madhe, siç ishte ky rast, mund të bënte që një nga tiparet kryesore të organizmit social, “fshati ekzogam”, të ndryshonte mënyrën e vendosjes së banorëve. Tashmë në të njejtin vend do të vendosen edhe familja e burrit edhe e gruas. Nuk ka çështje më themelore për një shoqëri se sa përcaktimi i linjës së trashëgimisë. Në rastin e zonave paraurbane duhet një kujdes i madh, i njëjtë më kalimin e një ure me litar lavjerrës, pasi bashkë me lëvizjen e vendbanimit transformohen ndjeshëm edhe këto raporte, për të mos thënë që në disa raste edhe përmbysen. Në një prej rrëfimeve të informatorëve tanë, kur shprehej për mundësinë e marrjes në Tiranë të njerëzve me lidhje gjaku, kuptuam se një prej familjeve që do t’i bashkohej kësaj lëvizjeje, do të ishte familja e motrës së tij. Në këtë pikë ndryshimi është shumë i rëndësishëm. Në të shkuarën as që mendohej që miku me mikun të ishin në një fshat. Nga ana tjetër, në plan të përgjithshëm, miqësia zor se rritet në distancë. Ajo mund të lidhë fqinjët e afërt, ata që mund të ftohen nëpër festa, të cilëve mund t’ua kthesh ftesën e t’u bësh vizitë. Por me grupet e largëta, një marrëdhënie e tillë është e pamundur (Clastres, 2014). Në rastin e shoqërisë shqiptare ky shpjegim nuk është aksiomë pasi në rrethana të ndryshme ndërtohen raporte të ndryshme miqësie. Ato bëheshin në distancë dhe ishin të lidhura nga respektimi reciprok i rregullave të forta etike. Fshatrat kanë ruajtur natyrën e tyre ekzogame dhe miqësitë kanë respektuar një lloj distance me fshatin. Largësia ka qenë një faktor moral, por edhe

ekonomik e politik. Ndaj, vlen të theksohet se ndryshimi i vendbanimit nga banorët i ka vendosur në një situatë të re sociologjike dhe i ka *detyruar* t'u nënshtrohen përthyerjeve të reja ndaj rregullsive që bartin prej vendit të origjinës. Për këtë na vjen në ndihmë edhe një rrëfim i M. H, i ardhur nga Kukësi 77 vjeç, që tregon se si në fshatin e tij, në periudhën e komunizmit, një djalë brenda fshatit rrëmbeu një vajzë. Askush në fshat nuk i foli as në rrugë, e familjarët e vet ndiheshin të turpëruar. Ishte e vështirë të reagoje, pasi sistemi nuk lejonte zbatimin e rregullave të mëparshme tradicionale, siç mund të ishte dëbimi nga fshati, por ama i gjithë fshati e përbuzi. Në fillimet e demokracisë ai ishte ndër të parët që mori fëmijët dhe u largua.

Edhe rastet kur nipi mund të jetonte në shtëpinë e dajës ishin të rralla. Vetëm kur kishte një situatë të caktuar, siç është dhënia "*bir në shpirt*" e një nipi, kur daja apo gjyshi nuk kishin djem, mund të jetonte në shtëpinë e dajës si një trashëgimtar legjitim i familjes. Për mbesën as që diskutohet dhe as që ka ndonjë variant që ajo të mund të jetojë në shtëpinë e dajës. Ndërsa motra përveç rasteve kur ajo vendoste të bëhej "*burrneshë*", duke marrë atributet e një mashkulli pasi meshkujt e familjes janë shuar, me misionin që të marrë hakun e familjes e për të mbajtur derën hapur, por me rregulla të ngurta, që e shoqërojnë atë gjatë gjithë jetës, apo rasti kur motrës nuk i dilte fati të martohej, në asnjë rast tjetër nuk mund të jetonte në shtëpinë e babait apo të vëllait. Dukuria e ekzogamisë, në vendet ku ndaloheshin martesat jo vetëm brenda fshatit, por dhe brenda një krahine, me arsye të lidhjeve fiktive e jo të vërteta në gjak, pra ngaqë ishin të një vëllazërie, ose thjeshtë si "*vllaznim trojesh*" (afri me vendbanime), lidhej me shkaqe morale, të besimit, por kishte dhe sanksione juridike mjaft të rënda me dënime të tilla si djegia e shtëpisë e dëbimi nga krahina, apo deri në *grimje* (pushkatim) të atyre që prishnin rregullat e ekzogamisë. Ky mekanizëm (trifunksionësh i dukurive të traditës), juridik, moral dhe religjioz, bënte që këto norma vetëqeverisjeje, të zbatoheshin me forcë e korrektësi, por bëhej shkak të ruheshin këto dukuri arkaike në këto bashkësi fshatare (Tirta, 2003).

Po çfarë ka ndodhur në rastin që kemi në studim? Vëllai i kërkon dhëndrit, burrit të motrës, që të marrë fëmijët dhe së bashku të shkojnë në Tiranë me shtëpi. Një ndryshim radikal. As që mund të mendohej kjo thirrje në kushtet e vendbanimit të parë. Por ftesa pranohet dhe e vërteta është se

sot ata jetojnë ngjitur me njëri tjetrin si “*miq komshinj*”, siç shprehen vetë. Rrjedha e këtyre raporteve kalon në shtigje të reja. Marrëdhënia ekzogame e martesës ishte një rregull që rrallë mund të thyhej dhe shoqërohej me sanksione që bënë të pamundur jetesën në të njëjtin fshat. Pra, që të saktësojmë këtë pikë, duhet të bëjmë me dije se po flasim për një rregull, syth shumë të rëndësishëm për martesën ekzogame, patrilokale, siç është largësia hapësinore midis familjeve të çiftit. Raportet midis anëtarëve të familjes nuk mbeten të njëjtat, duke intensifikuar përballjet midis bashkëshortëve, prindërve më fëmijët, pleqve me të rinjtë, duke risjellë në vëmendje raportin midis vjehrrive dhe rejave (nuseve) në kushte të tjera, si dhe duke e kontekstualizuar raportin e familjes patriarkale me modelin e familjes nukleare të mbyllur. Brenda raporteve të farefisnisë, familja patriarkale ka banuar si derivat natyral.

### **3. Format e shfaqjes së kujtesës sociale në zonat paraurbane**

Lidhjet fisnore dhe kujtesa sociale janë themeli mbi të cilin ngrihen marrëdhëniet e reja, nën një koniunkturë të re, e cila mbart kompleksitetin më dinamik që mund të kalojnë marrëdhëniet njerëzore. Realiteti i ri ka qenë sfida e vazhdueshme. Gjatë kësaj kohe u është dashur të përshtaten, të ndryshojnë, megjithatë linja e ruajtjes së kujtesës për vendlindjen, ruajtja e lidhjeve fisnore, ka qenë prezente. Vendosija e banesave në bazë të marrëdhënieve të farefisnisë, shkaqet e së cilës janë më të komplikuar, veprimtaritë kryesore të jetës si: dasma, vdekje, lindje, etj., rithërrasin këto marrëdhënie prej banorëve. Ruajtja e kujtesës sociale shërben si mburojë për ruajtjen e identitetit. Kujtesa në çdo veprimtari jetësore. Kujtesa nuk është thjeshtë individuale, por kolektive në kuptimin që njerëzit individualisht kujtojnë gjëra në bazë të strukturave kulturore. Në shoqëri njerëzit zakonisht *fitojnë* kujtimet e tyre (Halbwachs, 1980). Në këtë drejtim farefisnia, me gjithë kompleksitetin e raporteve që imponon, luan rol themelor në mënyrën e zhvillimit të marrëdhënieve në vendbanimin e ri.



Rregullat që vijnë prej kujtesës sociale, jo domosdoshmërisht mund të aplikohen ashtu siç do të duhej të ishin sepse kemi të bëjmë me rregulla që transmetohen ‘*gojë më gojë*’, të pashkruara, të cilat kanë pësuar ndryshime edhe brenda vetes gjatë kohës, por edhe janë përshtatur, negociuar, vijuar prej vetë përdoruesve të tyre. Përballja e banorëve me kompleksitetin e shoqërisë i vë ata përballë një zgjedhjeje selektive. Shpjegimi shoqërisë moderne me *termat e kompleksitetit* të saj, ku bota është e pranishme në çdo çast si dallim ndërmjet *sensit* të aktualizuar dhe mundësive që janë të pranueshme duke u nisur nga ky sens. Bota është gjithnjë e pranishme në njëkohshmëri ndërsa forma në të cilën ndodh kjo gjë, orientohet drejt një procesi sekuencial, vijimor.]...[Si në dallimet e përgjithshme, edhe në kontekstin e dallimit që prodhon sens, në dallimin aktualitetit dhe potencialitetit, përsëritja e një operacioni ka një efekt të dyfishtë. Nga njëra anë ajo prodhon dhe kondenson identitet: përsëritja njihet si përsëritje e së njëjtës. Nga ana tjetër kjo ndodh në një kontekst në një farë mënyre të ndryshëm, të paktën më vonë në rrafshin kohor (Luhmann, de Giorgi, 2016).

Edhe në rastin tonë është e qartë se ruajtja e kujtesës sociale nuk ka shqetësim kryesor zbatimin e rregullave në vetvete, por *ruajtjen e identitetit* të banorëve përballë kompleksitetit me të cilin ballafaqohen, ndaj ai mbetet edhe objektivi parësor. Lejohen plot hapësira likuide të cilat po të analizohen me hollësi janë edhe në kundërshtim me rregullat e trashëguara, por me sa duket edhe banorëve u mjafton ky implikim fillestar dhe janë të kënaqur pasi qëllimi është realizuar. Në gjykimin tonë ata janë selektivë, pasi në çështjet e pronësisë dhe trashëgimisë mbeten të lidhur pas rregullave të së shkuarës, por nuk duan që këto rregulla të shtrihen në gjithë veprimtarinë jetësore. I pari që ka tërhequr banorët për t’u shpërngulur në Kamëz, kërkon të luajë rolin e ‘babait’, ose ruajtësit të kujtesës së prejardhjes së përbashkët. Me këtë ka realizuar parimin *ius sanguinis*, për të krijuar përfytyrimin e një babai të përbashkët dhe kjo përkatësi krijon bashkësinë e vëllezërve dhe motrave me lidhje gjaku (Bardhoshi, 2013). Kështu zbatimi i rregullave i lidh ata me të shkuarën dhe automatikisht i pajis me një identitet të caktuar, edhe në kushtet e reja urbane në të cilat do të jetojnë.

Ky identitet merr një valencë të veçantë përballë individualitetit, impersonalitetit, interesave, jetës qytetase qëofron ky realitet i ri urban. Kujtesa i pajis gjithashtu me një përfytyrim të përbashkët ndaj të ardhmes, një guidë me rregulla të përcaktuara për ta ndërtuar atë. Nathalie Clayer analizon strukturën e rrjetit fisnor në veri të Shqipërisë: *“Në veri (dhe në disa krahina të jugut, si në Labëri, në juglindje të Vlorës), shtëpia nuk ishte veçse shkalla e parë e një strukture segmentare teksa shtëpitë ishin të lidhura me njëra-tjetrën. Kështu shumë shtëpi të dala nga ndarjet e mëparshme formonin një mëhallë, d.m.th jetonin në një lagje të fshatit dhe respektonin gjithmonë ekzogaminë dhe solidaritetin në rast hakmarrjeje.”* (Clayer, 2012) Në terren kuptohet se kjo lloj vendosjeje në vendbanimin e ri është tentuar të transferohet, por jo me të njëjtën hierarki dhe gjeografi si në vendin e lindjes. Shihet se janë formuar “minimëhalla” që formohen nga disa vëllezër apo të afërm të ndryshëm që kanë tërhequr njëri-tjetrin. Jeta e tyre e përbashkët themelohet mbi parakushtin e lidhjeve sociale, më thellë akoma, lidhjeve të farefisnisë apo lidhjeve të gjakut. Kritikohen jo pak familjet e mëdha patriarkale, fiset që kanë zgjedhur të vijnë së bashku në vendbanimin e ri, apo dhe vendosja sipas lagjeve që përmendëm. Por në fakt këto lëvizje janë realizuar edhe si një reagim ndaj realitetit të ashpër ekonomik, politik dhe social të këtyre viteve.

Familja patriarkale ka bashkuar energjitë për të përballuar sfidën ekonomike dhe vendosja e re në këtë mënyrë, bashkë me njerëzit me lidhje gjaku, u siguron ambientin social ku mund të realizojnë veten dhe të mbrohen nga të tjerët, pasi nuk ishin më në vendin e tyre të origjinës. Banorët shpesh kanë tërhequr njëri-tjetrin për ta zgjeruar sa më shumë rrjetin e njerëzve të njohur. Pasi kanë thirrur së pari njerëzit me lidhje gjaku, kanë kaluar në nivelin e fshatit, krahinës, apo zonës që ky rrjet të zgjerohet sa më shumë dhe kjo reflektohet sot në lidhjet që krijohen mes banorëve. Tentohet që martesat të bëhen midis personave që vijnë nga e njëjta zonë. Lidhjet më të forta midis komshinjve janë ato të familjeve që vijnë nga zona të njëjta. Përjashtim bëjnë rastet e fatkeqësive që aktivizojnë pothuaj të gjithë banorët në shenjë solidariteti. Ky zgjerim i lidhjeve ndodh për të pasur raporte sa më të sigurta, për të mos rrezikuar të lidhen me njerëz të zonave të tjera pasi nuk ua njohin traditat, rregullat apo mënyrën e jetesës.

Preferojnë të mos kenë të papritura në të ardhmen. Në zonat paraurbane, pothuaj në të gjitha rastet babai, apo i pari i familjes që ka marrë iniciativën për të lëvizur vendbanimin, ka pasur në përfytyrimin e tij paraprak mënyrën se si do të vendosen brenda tokës së blerë djemtë, vëllezërit, apo të afërmit. Në rastin kur babai ka tre djem, gjithmonë llogaritet mënyra se si do të vendosen brenda asaj prone të blerë dhe gjithnjë llogaritet që ajo do të ndahet në tri pjesë. Ka raste të ndryshme, si për shembull, kur nuk ka tokë të mjaftueshme, atëherë shtëpia do të ndërtohejme tri kate ku secili prej djemve të ketë një kat, duke projektuar që hyrjet në çdo kat të jenë sa më të ndara nga njëra-tjetra apo në rastin kur ka tokë të mjaftueshme, secili të ketë hapësirën e vet ku do të ndërtojë shtëpinë në të ardhmen. Këtu vjen në kujtesë sistemi i ndarjes së pronës *për vëlla*, sipas të cilit vëllezërit marrin pronë në mënyrë të barabartë, ndërsa motrat dhe bijat e tjera të familjes nuk kanë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme, sidomos për tokën dhe shtëpinë (Clayer, 2012). E njëjta logjikë është ndjekur edhe kur dy vëllezër të ndarë nga njëri-tjetri, por që kanë vendosur të vijnë bashkë në vendin e ri të banimit, ndajnë në mënyrë të barabartë parcelën e tokës që babai ka blerë, duke respektuar një prej parimeve shumë të rëndësishme të së drejtën zakonore shqiptare, por jo vetëm, *parimin e barazisë*. **Ruajtja e lidhjeve të gjakut vazhdon edhe pas zhvendosjes.** Këto lidhje kanë ndryshuar natyrë duke iu dhënë me shumë hapësirë individëve të përcaktojnë sjelljet e tyre. Ndikimi vazhdon në mënyra më të moderuara. Identifikimi i lidhjeve midis tyre është lehtësisht i dallueshëm. Ka elemente të njëjta në ndërtim, siç janë modelet e njëjta të shtëpive, ngjyrat e njëjta të përdorura për lyerjen e shtëpive, portat e oborrit të njëjta, avlli të njëjta, kopshte të planifikuar në mënyrë identike, etj.



Foto 3. Modele të njëjta shtëpish. Viti 2015.

Kjo mënyre vendosjeje e shtëpive vihet re më shumë tek ata që janë vëllezër. Kjo mënyre vendosjeje e shtëpive vihet re më shumë tek ata që janë vëllezër. Kështu dallohet lehtë zbatimi i një prej parimeve kryesore të së drejtës kanunore shqiptare: **parimi i barazisë**. Duhet theksuar se tek të gjithë të intervistuarit që janë bërë banorë të Kamzës pas viteve '90, nuk ka ekzistuar ideja e zhvendosjes drejt qytetit, në kuptimin e mirëfilltë. Ata kanë kërkuar “tokë” për ta blerë, jo hyrje në pallate. Informatori tjetër M.L, 67 vjeç nga Puka shpjegon: “Këtu zuna, sepse kam tre djem, doja me pasë tokë që kur të bënim shtëpit të kishim dhe pak oborr përpara. Unë kam pesë vllazën. Atje ku kam lind, n’Gziq të Pukës, na kishte mbet vetëm nga 900 m tokë. Shpitë i kishim krejt ngjit e ishim shumë ngushtë”.



Foto 4. Modele të njëjta portash. Viti 2015.

Kur informatori ynë u pyet se cilat janë raportet midis vëllezërve (djemve) të tij, ai thotë se djemtë shkojnë shumë mirë me njëri- tjetrin. Kanë punuar jashtë dhe secili ka bërë shtëpinë e tij. Ata kanë sjellë paratë ndërsa babai ka pasur rolin e drejtuesit deri sa janë ndarë. Edhe projektin e shtëpive e kanë sjellë nga Anglia. Portat kryesore janë të njejta. Bën përshtypje fakti se përveç portave kryesore që që të nxjerrin në rrugë kanë dhe porta të vogla komunikuese midis shtëpive të tyre. “*Epo koha hik, edhe pse janë vllazën secili ka udhën e vet, kurse unë bashkë me grun kam nejt me djalin e vogël, se kështu e do tradita*”. Familja mbetet busulla orientuese e banorëve të rinj. Ata duan ta mbajnë të fortë dhe gjejnë gjithnjë mekanizma që ndihmojnë unitetin e saj. Ky objektiv me sa duket do të jetë shumë i rëndësishëm për modelimin e raporteve të reja si brenda familjes edhe jashtë saj.

Një pikë tjetër e rëndësishme është kapërcimi që bëjnë banorët në lidhje me ruajtjen e linjës së babait në vendbanimin e ri. Siç u trajtua edhe më lart, rastet kur vëllai thërret motrën që të shkojnë bashkë drejt Tiranës, për të jetuar afër njëri-tjetrit, dëshmojnë për një thyerje të fortë. Rastet kur dhëndri mund të shkonte në fshatin e gruas kanë qenë pak a shumë të qarta dhe lidhen me situata specifike, siç mund të ishte rasti kur familja e gruas nuk kishte djalë. Edhe ky rast trajtohej me kujdes sipas negociatave paraprake midis palëve pasi çështjet e trashëgimisë dhe linjës atësore identitare apo çështjet e pronës mbeteshin themelore. Në rastin tonë nuk kemi të bëjmë as me çështjet e pronësisë dhe as me ndryshimin e identitetit patriarkal të linjës atërore, por kemi të bëjmë me një situatë krejtësisht të re. Një thirrje që ka projeksion jetesën e përbashkët midis tyre, duke vendosur para nesh një situatë që rrallë mund të gjendej nëpër Shqipëri në të shkuarën.

Një mënyrë tjetër e shfaqjes së ruajtjes së kujtesës është e *folura në dialekt*. Gjuha lind nëpërmjet ripërdorimit të tingujve, në rrjedhën e ripërdorimit ajo prodhon, nga njëra anë, identitetin e fjalëve, pra kondenson identitete të veta të gjuhës; nga ana tjetër, me të njëjtat operacione i pranon këto kondensime në gjendje gjithnjë të reja, pra i përgjithëson. Ky proces i formimit të gjuhës çon në diferencimin e një vetëqëndrimi të sistemit të komunikimit dhe, më tej, në një rend të përceptimeve të ndërjegjes së veçantë që varet nga gjuha.[...] gjuha lind në një farë *self-fulfilling prophecy*, por duke nënkuptuar këtu jokonceptin në kuptimin klasik të Mertonit që

nuk i referohet një problemi të thjeshtë të metodës së hulumtimit shoqëror empirik, por pikërisht përbërësit të shoqërisë (Luhmann, De Giorgi, 2016). Pothuaj në çdo shoqëri, njerëzit i përvetësojnë spontanisht shumicën e elementëve, edhe të rregullave të komunikimit simbolik joverbal. Një përvetësim i tillë është përgjithësisht i ngadalshëm dhe shoqërohet me gabime që përsëriten dendur, sidomos në fazat e para të shoqërizimit të njerëzve (Dervishi, 2008).

Përdorimi i zhargonit, të folmeve të ndryshme apo dialekteve apo komunikimit joverbal, aq më tepër kur gjuhët dallojnë krejtësisht nga njëra-tjetra, përbën shenjën dalluese të subkulturave nga njëra-tjetra dhe nga shoqëria. Kështu, ato mund të përdoren si kriter i përkatësisë së grupit të cilit i përkasin apo të zonës nga vijnë. Dihet se të folmet e varianteve dialektore komunikojnë mes tyre në varësi të distancës gjeografike dhe mundësisë së kontakteve dhe komunikimit. Ndaj zona si Kukësi, Dibra, Tropoja, Hasi etj., dhe banorët që vijnë nga këto zona, e kanë më të lehtë të identifikohen me njëri-tjetrin. Por njihet gjithashtu që distanca dhe pamundësia e komunikimit krijojnë vështirësi në kuptimin e të folmeve dhe dialekteve sidomos në të shkuarën aq sa shpesh mund të krijohet ideja që nuk kemi të bëjmë me të njëjtën gjuhë. Largësia midis shtëpive dhe fshatrave ka qenë një faktor i rëndësishëm që ka ndikuar në këtë proces. Shpesh bëhet një keqkuptim lidhur me gjuhën standarde dhe përdorimin e saj. Ajo mund të stabilizojë gjuhën kombëtare në kuadrin e një projekti shtetëror, por ajo nuk është *gjuha amtare*. Kjo e fundit është gjuha që mësohet prej nënës, qëkur lind fëmija duke e përdorur këtë të folme gjatë komunikimit të përditshëm. Ndërkohë që arsimi masiv, përmes gjuhës standarde, ia ka dalë të bashkojë popullin dhe në një farë mënyre ajo është bërë “popullore”. Nga ana tjetër elita e diferencon veten duke mësuar gjithnjë një gjuhë të huaj, që mund të jetë, e njohur ndërkombëtarisht, por një gjuhë e panjohur nga populli.

Në fillimet e ardhjes në Kamëz, ndihej një farë *inferioriteti gjuhësor* nga banorët e ardhur, sidomos tek nxënësit e shkollave. Jo rrallë viheshin në tallje e bullizoheshin për këtë shkak, por me kalimin e kohës kjo u zbeh. Vihet re se nuk është shqetësim ndryshimi i dialektit në drejtim të gjuhës standarde letrare. Në rrugët e Kamzës dëgjon të flitet i gjithë koloriti i dialekteve të gjuhës shqipe. Në shkollat fillore dhe 9-vjeçare, gjatë kohës së

pushimit të gjatë është vërejtur se fëmijët flasin në dialekt. Në shkollat e mesme disa gjimnazistë, me të cilët kemi kontaktuar, e shikojnë të folurën në dialekt si një mënyrë për të treguar vendin se nga vjen. Një prej tyre shprehet: “Unë du me kallzu se jam prej Kuksi, e vetëm qeshtu mirret vesh”. Në ambiente familjare gjithashtu e folura në dialekt është e zakonshme. Ndjehet që dialektet ndikojnë në kujtesën psiko-kulturore të banorëve.

Një tjetër mënyrë e shfaqjes së ruajtjes së kujtesës sociale ndër këta banorë është edhe kultura materiale, sidomos në formën e saj të luajtshme. Mbi këtë logjikë shpjegohet lidhja me vendin e lindjes, me traditën, lidhja shpirtërore me origjinën e gjakun e të parëve, ndikimi i tyre në jetën e tanishme dhe në të përditshmen e tyre. Nga bisedat dhe intervistat në terren kuptohet se një rëndësi të veçantë, në momentin kur njerëzit janë bërë gati të lëvizin drejt vendbanimit të ri, kanë pasur objektet e luajtshme me vlerë simbolike, historike, apo të trashëgimisë për familjen. Në morinë e materialeve që janë marrë me vete, ato që janë ruajtur me kujdes të veçantë, kanë qenë: veshjet e vjetra popullore të krahinës apo zonës; objekte apo sende të përdorura nga gjyshërit; librat si: Kanuni, Bibla apo Kurani; vegla muzikore, fotografi, dëshmi kualifikimi apo dekorata; takëmet e kafes, llulla për duhan, ora, kasaforta apo monedha të hershme; punë artizanale si: qilima, sixhade; punë dore si: perde, çentro, jastëkë, zbukurime të ndryshme, vazo; stoli të ndryshme si: unaza, zinxhirë, xherdanë, rripa mesi, etj. Vetëm vlerësimi i jashtëzakonshëm ndaj tyre, bën që ta zhvendosin vëmendjen tek këto objekte. Në kushtet e një tensioni të jashtëzakonshëm që banorët kanë kaluar në momentin e përgatitjes dhe ngritjes së plaçkave prej shtëpisë ku kanë banuar më parë kanë qenë shumë të vëmendshëm për t'i marrë këto objekte. Kjo dëshmon për vlerën e madhe shpirtërore, gjurmën e thellë, madje një lloj besimi që këto objekte u japin për të ardhmen që i pret. Marrja e tyre me vete do të thoshte marrjen me vete të identitetit, besimit, fjalës së dhënë, copëzat e së shkuarës, por dhe të ardhmes. Njëri prej informatorëve shprehet se ka marrë me vete takëmet e burrnisë së gjyshit: mullirin e kafes, kutinë e duhanit, llullën, çiftelinë. Këtë e ka bërë në respekt, por edhe për të ruajtur emrin e mirë të tij, si dhe për të dëshmuar se është një trashëgimtar i denjë.



Foto 15. Llulla, mulliri i kafes, shishe raki, çifteli të përdorura në zonat e Shqipërisë së Veriut. Viti 2014.

Thellësia e përjetimit nëse një “burrë” apo “familje” nuk i ka këto, është shumë e lartë. Përmes posedimit të tyre statusi dhe mençuria marrin jetë, meqënëse pasja e kafes dhe e duhanit u japin mundësinë e bisedave të gjata, të cilat gjithnjë duhet të kenë vlerë dhe të shprehin zgjuarsinë e bashkëbiseduesve. Ato shërbejnë për të realizuar komunikimin simbolik, joverbal në procesin e shoqërizimit. Për shembull kafja e ëmbël, e mesme apo pa sheqer ishin në të njëjtën kohë edhe sinjale për zgjidhjen e problemeve. Pothuaj në çdo shoqëri, njerëzit i përvetësojnë spontanisht shumicën e elementëve, të rregullave të komunikimit simbolik joverbal. Një përvetësim i tillë është përgjithësisht i ngadalshëm dhe shoqërohet me gabime që përsëriten dendur, sidomos në fazat e para të shoqërizimit të njerëzve (Dervishi, 2008). Banorët në vendin e ri të banimit i kanë ruajtur me kujdes, pikërisht për të ruajtur identitetin, dinjitetin, dijet, statusin e familjes dhe origjinën e tyre.

“Oda e miqve”, në të cilën pritet miku i shtëpisë (Riza, 1983), oxhaku i ndezur, filxhani i kafesë, kutia e duhanit, shishja e rakisë, janë disa elementë që në kulturën tradicionale shqiptare vlerësohen si shënjuese të statusit që kishte një familje. Edhe në zonën paraurbane të Kamzës këto elemente janë të rëndësishme për mënyrën se si do të kompozohet shtëpia. Pothuaj në të gjitha shtëpitë e vizituara për efekt të këtij punimi, është vërejtur se “dhoma e pritjes”, ose “oda e miqve” është e veçantë, e mobiluar në një mënyrë të



tillë që i përshtatet pritjes së miqve, si dhoma më e bukur dhe më e kuruar e shtëpisë. Pra, e kanë transferuar edhe këtu, ndoshta duke lënë ambiente të tjera të papërfunduara, duke sakrifikuar edhe ambiente më funksionale, me qëllim që sipas traditës mikut t'i ofrohet komoditeti, respekti, intimiteti (pasi edhe do të flejë aty!), por ndërkohë edhe një lloj ndarjeje nga pjesa tjetër e familjes, qoftë nga fëmijët, por edhe nga gratë në rastet kur miku është i largët.

Veshjet tradicionale, të zonave nga vijën, janë një tjetër mënyrë përmes së cilës ruhet identiteti, origjina, prejardhja e banorëve. Gjen në familjet e Kamzës veshje të tilla që mbahen me kujdes dhe vishen prej tyre në raste festash, kryesisht në dasma dhe fejesa, por edhe në raste të tjera gëzimi. Në dasmat që realizohen në Kamëz, pas vëzhgimeve të bëra është pothuaj e zakonshme që dasmorët të vishen më veshje tradicionale, kryesisht gratë dhe vajzat, por vërehet se edhe nusja me dhëndrin e kanë kthyer në një element të rëndësishëm të dasmës së tyre. Veshjet popullore kthehen në simbol të identifikimit dhe ruajtjes së identitetit pasi ato mund të përcaktojnë identitete lokale, por edhe nacionale e më gjerë. Por ndryshe nga shekulli i XIX, veshja kombëtare nuk është e përdorimit të përditshëm, por ka një funksion mbi të gjitha festiv dhe dëfryes (Thiesse, 2004), që verifikohet lehtë nga veprimtaritë në të cilat përdoren ato.



Foto 18. Detaje zbukurimesh të përdorura në veshjet popullore të krahinave të ndryshme. Viti 2014.

Në kulturën shqiptare njihet variacioni i madh i veshjeve në fshatra, qytete apo zona si: fustanella, plisi i bardhë, veshja me xhubletë etj., të cilat janë kthyer në mjet identifikimi etnik, kombëtar. Prej veshjeve mund të kuptohet se nga vjen bartësi i veshjeve. Gjithashtu përmes veshjeve mund të dallohet lehtë statusi social, profesioni që kryen, përkatësia fetare a klasore i personit (Onuzi, 2008). Mbuloja e kokës është si *kartë identiteti* tek burrat dhe tek gratë mbahet edhe kur ndryshojnë pjesët e tjera të veshjes tradicionale. Mbjajtja e shamisë dhe veshjeve tradicionale tek gratë e moshuara është pothuaj e zakonshme, pavarësisht trysnisë nga brezi i ri për heqjen dorë prej tyre, duke krijuar dhe klishe të tilla si *“hiqe shaminë se kemi ardhë në Tiranë”*, apo në rastin e pleqve që mbajnë qeleshe duke u shoqëruar me kërkesën *“hiqe qeleshen se jemi në fushë”*. Megjithatë, ky brez i ka rezistuar këtij presioni pa mëdyshje, duke e bërë të qartë se nuk heqin dorë nga tradita kudo që të shkojë. Ndërsa në brezin e dytë, që përkon edhe me brezin e 50-65 vjeçarëve të sotëm i cili përgjithësisht ka marrë përsipër iniciativën e zhvendosjes, ka një zhvillim interesant në lidhje me ruajtjen e këtyre veshjeve apo simbolikave që transmetojnë ato. Ky brez ka provuar një dyzim të vazhdueshëm. Ata përjetuan intensivisht qoftë periudhën e komunizmit, qoftë edhe zhvillimet e vrullshme të demokracisë e duke qenë nën ndikimin e vazhdueshëm si të traditës e cila diktohet kryesisht nga brezi paraardhës, ashtu edhe të zhvillimeve moderne. Ky presion vjen nga njëra anë prej *“pleqve”* apo *“opinionit”* i cili i gjykon për mosruajtjen e traditës në veshje, nga ana tjetër vjen nga konteksti i ri i jetesës. Ndikimi i fëmijëve të cilët e shikojnë mbajtjen e shamisë apo qeleshes në kokë si shenjë të prapambetjes. Ashtu si vendi i punës apo pazari, daljet publike imponojnë një përshtatje të re me veshjen.

Ky dyzim reflektohet edhe në mënyrën se si i kanë përshtatur dhe thjeshtësuar disa nga veshjet popullore të cilat i përdorin në moment të caktuara të ditës dhe që nuk janë tipike të traditës, por element simbolizues i atyre veshjeve. Për shembull H.H. 65 vjeçe, nga Kukësi, me profesion mësuese dhe që e ka ushtruar këtë profesion në vendlindje por edhe në Kamëz, na tregon se vishej në bazë të normave të kohës kur shkonte në punë apo për çdo dalje tjetër jashtë shtëpisë, por në momentin që hynte në shtëpi, vinte shaminë e bardhë rreth kokës, vishte një fund të gjatë me një përparëse të

thjeshtë përpara, “*se babës i bahej qejfi*”. Kjo përshtatje për hir të respektit ndaj të vjetërve krijon një traditë të re të ruajtjes së këtyre elementëve, pasi ajo edhe sot vazhdon të kryejë të njëjtin ritual edhe pse vjehri (baba) ka 20 vjet që ka vdekur, por njëkohësisht shfaqet në mënyrë dinjitoze në jetën e saj publike jashtë shtëpisë. E gjithë kjo pamje nga ana tjetër e mban në kontakt të vazhdueshëm brezin e ri me traditën, veshjen, mënyrën e përdorimit, respektin ndaj kësaj tradite dhe të vjetërve që e përfaqësojnë atë, pasi modelet e prindërve të tyre ndikojnë në ngulitjen e frymës së vlerësimit, si dhe ngjallin herë pas here edhe dëshirën për t’i përdorur edhe ata veshje të tillanë rastet e gëzimeve, dasmave, etj.

#### 4. Fqinjë dhe kushërinj

Midis fqinjëve supozohet në parim se nuk ka lidhje gjaku dhe praktikisht kjo *nyje* i kalon marrëdhëniet në një rrafsh krejt tjetër. Marrëdhëniet e fqinjësisë nuk kanë *norma detyruese reciproke* që imponohen nga rrjeta e marrëdhënieve fisnore. Marrëdhëniet njerëzore të zgjedhohen në disa nivele sipas lidhjeve detyruese të veçanta që kanë bashkësitë e njerëzve në familje, fis, fshat etj (Bardhoshi, “Gurtë e Kufinit”, vepër e cituar, 2011). Perceptimi se këto zona janë unikeështë i gabuar dhe përgjithsimi të problematikave nuk arrin në shpjegimin e realitetit. Prandaj është i domosdoshëm vëzhgimi në terren për të përfutur një situatë sa më të qartë.

Që në fillim nga i pari që është vendosur në Kamëz, është menduar për mundësinë që edhe vëllai i tij, kushërinjtë apo të afërm me lidhje gjaku të mund të vendoseshin pranë tij. Në një prej rasteve që kemi marrë në analizë, u vendos vëllai, tre djemtë e xhaxhait dhe motra me familjen e saj. U krijua kështu një lagje në të cilën u vendosën në rresht njëri pas tjetrit. Ata ranë dakord që të lënë rrugën e përbashkët për të dalë në rrugën kryesore. Ajo që bie në sy gjatë bisedës me informatorin tonë I.V, 67 vjeç, është se të gjithë, por më së shumti informatori ynë që ishte më i vjetri në moshë dhe iniciatori i kësaj lëvizjeje, i kishin kushtuar rëndësi vendimmarrjes për gjërat e përbashkëta si ndarja qartë e të drejtave dhe detyrimeve, pasi siç shprehet ai: “*Ne nuk duhet me na ndodhë si në fshat ku ziheshim për një vijë uji, për një shteg, për kufirin e gjëra si këto. Këtu jemi n’Tiranë dhe nuk duhet me*

*lanë gjana të paqarta*". Përcaktimi i rrugës së përbashkët me gjerësi 4-5 m, kjo për të mundësuar një kalim të lehtë të automjeteve duke qenë se aty do të ndërtoheshin shtëpitë kësisoj makinat e mëdha ta kishin të lehtë hyrjen në tokë. U vendos që ajo do të shtrohej bashkarisht dhe me mbarimin e parcelës së tyre *nuk do të kishte rrugë të mëtejshme*, pra rruga mbaron me shtëpinë e fundit të "lagjes", tashmë lagjja e tyre. Arsyet e këtij vendimi ishin të qarta: *"Nuk duam që njeri tjetër të futet në shtëpitë tona"*. U vendos që të investonin bashkarisht për ujin i pijshëm, energjinë elektrike, shtrimin e rrugës, kanalizimet e ujërave të zeza etj. Lagje të tilla ku rruga mbyllet vetëm për banorët me lidhje gjaku (si kufi i mbyllur), në zonën e Kamzës janë të shpeshta.



Foto 5. Lagje që mbyllet me përfundimin e rrugës. Bathore, viti 2016.

U krijuan hapësira të reja sociale ku palët në fis me lidhje gjaku ndajnë hapësirën fizikisht, vendosin rregullat mbi të cilat do të veprohej për ta menaxhuar atë dhe kjo i hapte rrugë një sjelljeje krejt tjetër për të gjithë. Tashmë nuk kishin vetëm lidhjet e gjakut, por ishin edhe fqinjë në një vend të ri banimi dhe si të tillë duhet të sillen duke zbatuar normat e reja shoqërore. *"Secili në shtëpinë e vet e di vetë se ç'bën, por ne jemi bashkë dhe për gjërat e përbashkëta duhet të kemi të gjithë përgjegjësi"* - është vizioni mbi të cilin pretendohet të shkohet përpara. Kështu është konceptuar e ardhmja sipas informatorit tonë. Ka pasur probleme me mentalitetin e transferuar nga fshati në qytet. Informatori ynë I.V 67 vjeç shprehet: *"Kurthi ku ramë ne*

*ishte se ashtu siç ishim, erdhëm këtu. Se ne ishim të njëjtët njerëz. Nuk ndryshon njeriu në një ditë, as në një vit, duhet kohë. Siç thotë një fjalë, fshatarin prej fshati e heqim, por fshatin prej fshatarit nuk e heqim dot”.*

Në zonë ka lagje që kanë lidhje fisnore dhe prejardhje të përbashkët dhe kjo është reflektuar edhe në emërtimet e lagjeve, si: “lagjja e tropojanëve”, “lagjja e kuksianëve”, “lagjja e gramshalinjve”, etj. Kjo logjikë është ndjekur edhe në periferitë e qyteteve të mëdha shqiptare. Kjo nuk do të thotë se vendosja është e tillë kudo, por përcaktime të tilla janë pasojë e vendosjes fillestare të banorëve, ku është theksuar numri i atyre me prejardhje të njëjtë dhe njerëzit vetë e kanë bërë përcaktimin pa sforco, duke e marrë si referencë lagjen, bazuar në numrin e banorëve me origjinë të njëjtë. Vlen të theksohet se lidhjeve të gjakut iu mbivendosen edhe lidhjet krahinore. Megjithatë brenda këtyre lagjeve gjenden plot banorë që kanë origjinë të ndryshme prejardhjeje dhe fakti që thirren si banorë të një lagjeje të caktuar, nuk i shqetëson. Për shembull në zonën e “Frutikulturës” ndodhet një lagje që emërtohet prej njerëzve si “lagjja e gramshalinjve”, për shkak se aty ndodhet një grumbull shtëpish me banorë që vijnë nga kjo zonë. Por përreth lagjes ka plot shtëpi që e kanë prejardhjen nga Dibra, Kukësi, Burreli e megjithatë ky përcaktim ka ardhur natyrshëm dhe është pranuar prej të gjithëve.

Aktualizimi i sjelljeve bazuar në kushtet e reja, diktuar nga rrethanat dhe nevojat, thyerja e traditave dhe ndryshimi i normave dhe rregullave, bëhet në mënyrë të vazhdueshme me një dinamizëm të shpeshtë që e ndryshon shumë shpejt fotografinë sociale të momentit. Në kontekstin e fqinjësisë brenda lidhjeve të gjakut është hapur një shteg të cilin të rinjtë po e çajnë me sukses, aq sa shpesh po ndodh një lloj izolimi i tyre duke mënjanuar të gjitha lidhjet. Të rinjtë nuk janë më të lidhur siç ishin më parë në fshat, ku përveç kushërinjve dhe fisit nuk kishte alternativa të tjera për të lidhur miqësi. Ata sot e duan njëri-tjetrin, por mundësitë e reja që sjell koha, bëjnë që të mos kenë primare raportet me të afërmit me lidhje gjaku. Televizioni, interneti, telefoni dhe rrjetet sociale ku kalojnë shumë kohë ua shtojnë mundësinë e lidhjeve të reja. Shkolla nga ana tjetër jep mundësi për njohje dhe miqësi me të tjerë bashkëmoshatarë përtej lidhjeve të gjakut.

## 5. Kalimi nga lidhjet e fqinjësisë tek lidhjet e gjakut (miqësisë)

Banorët e zonave periferike nuk përbëjnë grupe shoqërore homogjene, as nga pikëpamja kulturore, as nga ajo krahinore apo ekonomike (Fuga, 2004). Duke u përpjekur të hulumtohet sa më shumë mbi lidhjet e gjakut dhe fafëfisnisë, specifikisht mbi martesat që përjashtojnë ekzogaminë jashtë fshatit, rast që zonat paraurbane e përmbushin mjaft mirë, janë vërejtur lidhje të reja miqësie që janë vendosur midis komshinjve. Ata nuk kanë lidhje gjaku me njëri-tjetrin dhe asgjë nuk i ka ndalur të rinjtë të kenë marrëdhënie dashurie midis tyre. Në kushtet e reja tradita rishpiket (Hobsbawn&Ranger, 2014) në funksion të realitetit të ri social. Kalimi nga fshati në qytet sjell ndryshime kulturore të rëndësishme. Shoqëria urbane bazohet në kulturën bashkëkohore, e cila zë vendin kryesor në jetën e saj. Elementet e reja të kulturës janë të shumta dhe asimilohen relativisht më shpejt nga shoqëria urbane (Muçaj, 2013).

*‘Të bësh mik një komshi’, është ndoshta përjetimimë i rëndë që ka kaluar L. O. nga Puka 65 vjeç, kur tregon mbi lidhjen që kishte pasur vajza e tij me djalin e komshiut nga Kukësi. “Nuk kisha çfarë me ba se ata i kishin kry punt e tyne dhe unë nuk mundesha me marrë asnjë vendim, edhe pse nuk e dojsa një miqësi të tillë. Unë parashikoj pasojat që mund të dalin dhe jo përfitimet që mund të vijnë prej kësaj miqësie. Nuk jem msu ne me pas mikun n’der t’shpisë.”* -shprehet ai. Rrëfimi i dy të martuarve tashmë, është plot emocion kur tregojnë netët pa gjumë që kalonin prej frikës se mos kapeshin prej familjarëve, tek shigjetonin në ballkonet përkatëse, dashurinë pasionante mes tyre. Sot të dy janë pjesë e firmës që ka babai i vajzës, pra miku-komshi. Raste të tilla në Kamëz janë të shpeshta, që duket si një përfundim logjik pasi siç është argumentuar jo gjithmonë komshinjtë janë me lidhje gjaku dhe lidhjet e dashurisë midis të rinjve mund të ndodhin krejt normalisht, por gjithashtu edhe për faktin se kufijtë e fqinjësisë janë disi të papërcaktuar, ato lëvizin sipas lidhjeve që krijohen, mund të jenë deri në fund të rrugës, mund të jenë të lokalizuar deri në dy-tre shtëpi larg, etj. Janë disi më të pra-

nueshme martesat që kanë një distancë midis miqve të rinj, dhe kjo është shprehje e kozmologjisë së përgjithshme.

Këto lidhje janë refuzuar në momentin e parë nga familjet pasi ishte diçka larg botëkuptimit të tyre por me kalimin e kohës duke qenë përballë lumturisë së fëmijëve, e kanë pranuar lidhjen duke u ndërgjegjësuar për faktin se tashmë, në vendbanimin e ri nuk mund të praktikohet martesat patri-lokale. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që nuk ka pasur zona ku është praktikuar martesat brenda fshatit. Arsyet e refuzimit fillestar lidhen edhe me ecurinë e raporteve të fqinjësisë, konfliktet apo mospëlqimet e mundshme midis palëve gjatë viteve të bashkëjetesës në një lagje të përbashkët. Informatorja E. I, rreth të 50-tave nga Dibra, tregon momentin kur djali i kishte folur lidhur me dashurinë që kishte për fqinjen, nënën e të cilës zonja në fjalë nuk e pëlqente aspak, madje, duke mos pasur dijeni për lidhjen e djalit të saj me vajzën e fqinjës, ato kishin pasur edhe një konflikt verbal, rrëfen se kur u ballafaqua me faktin, u ndje keq, reagoi ashpër me fjalët: *“Jo, nuk mundet me ndodhë kështu, unë nuk e duroj dot nanën e saj kur kalon në rrugë, e jo ma me na ardhë përditë në shpi”*. Por, me kalimin e kohës u detyrua të pranojë këtë lidhje. Sot djali i saj e ka marrë nusen në shtëpi dhe zonja është detyruar të kapërdijë gjithçka ka ndodhur me krushkën në fillim kur ishin vetëm fqinje, për ta pritur dhe respektuar tashmë atë si mikeshë. Mund të thuhet lirisht se kapërcimi nga fqinjësia në lidhjet e miqësisë nuk pritet mirë nga familjarët e të dyja palëve. Refuzimi i lidhjeve të tilla kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm, si prejardhja, raporti midis familjeve, niveli arsimor, ecuria e fqinjësisë së re, kufijtë gjeografikë të lagjeve, por më i rëndësishëm duket fakti se përzierja e fqinjësisë me miqësinë mund të sjellë konflikte në të ardhmen.

Ka raste kur logjika e prejardhjes është përdorur individualisht nga banorët për të emërtuar pronën private, për të risjellë një copëz të vendlindjes në realitetin e tyre të ri, siç janë emërtimet e bareve, restoranteve apo bizneseve në tërësi. Ka edhe raste kur emërtimet bëhen në kuadër të prezantimit të vëllazërisë apo fisit për të treguar se është një biznes familjar, por mbi të gjitha për të dëshmuar lidhjet e tyre farefisnore. Rastet dëshmojnë se lidhja e këtyre banorëve me origjinën, me vendlindjen, me farefisnin, me mbiemrin është e fortë dhe kjo bëhet për të glorifikuar disi prejardhjen e tyre. Për të

lartësuar vendin nga vjen, vendoset emri i zonës (përgjithësisht përzgjidhet emri që e përfaqëson më shumë këtë zonë), dhe emri i vëllazërisë apo fisit të cilit i përket dhe njëkohësisht marrin përsipër ta ruajnë dhe përfaqësojnë denjësisht.



Foto 6. Emërtim i një kompleksi në Kamëz. “Bar Kafe KANUNI”. Viti 2018

Vlen të ndalemi në kundërvënien dhe kontrastin që krijon emërtimi i këtij kompleksi në raport me pjesën tjetër të bareve dhe rrugëve të qytetit. Vjen si kundrapeshë, në një përpjekje të pandalshme për të mbajtur gjallë identitetin. Tendanca e këtyre banorëve për të sjellë elemente nga origjina, është një tregues i qartë i ruajtjes së lidhjeve me vendin e lindjes, origjinën, traditën dhe kozmologjinë e farefisnisë.

Duke lënë mënjanë të gjitha këto zhvillime qeveria shqiptare i ka klasifikuar zonat periferike të ndërtuara pas vitit 1990 si “informale”, duke hartuar ligje specifike të bazuara në procesin e legalizimit i frymëzuar nga Hernando de Soto. Duke iu referuar vendeve të tjera, si përgjigje ndaj varfërisë (De Soto, 2000) ai propozonte legalizimin dhe çertifikimin e pronave të banorëve të periferive, megjithëse këto pretendime “tronditëse” për nxjerrjen nga varfëria të banorëve urban janë të pavërtetuara (Payne, 2004). Gjithsesi ky proces që ka nisur zyrtarisht në vitin 2006 edhe në vitin 2021 vazhdon të jetë “në proces”, pa verifikuar konkretisht se cili është efekti përveç faktit të



njohur të përdorimit politik. Nuk kanë munguar edhe qasjet *libertariane* që kërkojnë njëzgjdhje të drejtë dhe të moralshme që pronarët e tokës të përfitojnë truallin dhe familjet që kanë ndërtuar t'iu njihet pronësia mbi ndërtesën (Kaprata, 2017). Duhet theksuar fakti që ndërkohë këto procese vegjetojnë qyteti ka nevojë të zhvillohet nuk duhet anashkaluar *identiteti i qytetit* (Lerner, 2016), pikat e veta të referimit, historia e tij e hershme dhe e re, për të ruajtur një profil që e bën atë një hapësirë të harmonisë dhe diversitetit. Në të gjitha rastet, çdo plan, duhet të vendosë në qendër *njeriun*.

## 6. Përfundime

Sot më shumë se 50% e njerëzve në botë jetojnë në qytete ndaj dhe studimet urbane dhe në mënyrë të veçantë studimet mbi jetën e qytetit, janë të domosdoshme. Antropologjia duke pasur objekt “njeriun” jep kontributin e saj në studimet urbane edhe pse ajo “hyri vonë” në qytet. Pas rënies së diktaturave në lindje, të cilat kishin mbajtur popullsinë të shtrënguar rreptësisht duke mos lejuar lëvizjen e vendbanimit, ndodhi një lëvizje e mënjëherëshme demografike duke u orientuar drejt qyteteve të mëdha dhe periferive të tyre. Rasti i Shqipërisë shembullizohet me zonën e Kamzës që është vetëm shtatë kilometër larg qendrës së Tiranës. Lëvizja kaotike u shoqëruar jo vetëm me probleme të varfësisë, mungesës së kushteve më themelore dhe shërbimeve por edhe me ndryshime kulturore të cilat bashëduhëtojnë me njeriun.

Në kontekstin e ri social raportet e farefisnisë dhe lidhjet e gjakut gjinden në presionin e vazhdueshëm të një modeli të ri jetese, që ndryshon cilësisht nga vendi i origjinës. Kushërinjtë janë fqinjë dhe të tjerë fqinjë janë të panjohur. Familja patriarkale ruan boshtin e funksionimit të saj në strukturë dhe në përmbajtje. Ky model familjeje dhe solidariteti brenda saj ka ndikuar shumë në përballimin e sfidës së ndryshimit të vendbanimit. Janë krijuar lagje të tëra me banorë që kanë lidhje farefisnie me njëri-tjetrin, pasi mekanizmi i vendosjes ka qenë pikërisht tërheqja e njëri-tjetrit drejt vendit të ri të banimit. Një pikë me rëndësi është ruajtja e identitetit nga banorët e ardhur. Ky identitet shfaqet në veprimtaritë jetësore që ata kryejnë. Kujtesa sociale që banorët ruajnë, i ndihmon në shfaqjen e këtij identiteti. E folura në

dialekt që ruhet prej banorëve si shenjë e identitetit, por edhe si një fushë ku ata mund të përshfaqin veten më të plotë. Kultura materiale e luajtshme, objekte të veçantatë cilat kanë pasur rëndësi për familjen dhe individët janë marrë me vete, edhe pse tensioni i përgatitjes për të lënë vendin e lindjes ka qenë i lartë. Objekte të tilla, si: veshje tradicionale të zonës apo krahinës nga vijinë, vegla muzikore të ndryshme, objekte të trashëguara të familjes, fotografi, libra të vjetër (fetarë ose jo), etj., janë marrë me vete dhe ruajtur me kujdes. Ruajtja e tyre me fanatizëm dëshmon për lidhjen me të shkuarën dhe ruajtjen e identitetit të tyre.

Ka ndodhur një thyerje me rëndësi në raportet ekzogamike dhe patrilokale pasi ka raste kur vëllai me motrën tashmë banojnë afër njëri-tjetrit. Nga ana tjetër kemi një thyerje të marrëdhënieve të miqësië dhe shfaqen rastet e miqësive të krijuara midis fqinjëve që përbën një shfaqje të re të këtyre raporteve, duke mbajtur gjithnjë parasysh faktin se ndër shqiptarët dominon “fshati ekzogam”. Theksojmë se pjesa më e madhe e këtyre banorëve vijinë nga zonat rurale. Pavarësisht se banorët kanë tre dekada që bëjnë në periferitë e qyteteve ata trajtohen si “ilegal” që dëshmon për tensionin nën të cilin jetojnë. Procesi i legalizimit që ka nisur që në vitin 2006 akoma nuk është mbyllur dhe qasjet, qoftë për trajtimin e pronës, qoftë për zhvillimin e zonave të tilla nuk kanë prodhuar zgjidhje të qëndrueshme.

## 7. Referenca

- Aliaj, Besnik, “Misteri i gjashtë”, Universiteti Polis, Tiranë, 2008.
- Bardhoshi, Nebi, “Gurtë e Kufinit”(Vepër e cituar), UET Pres, Tiranë 2011.
- Bardhoshi, Nebi, ‘Kujtesa sociale në skajet e kufirit politik’, Shoqata ‘Gjon Buzuku’, Ulqin 2013.
- Canolli, Arsim, “Me ra s’kie ku shkon, me nejt s’kie ku rrin”- Një pamje etnografike i migrimit të brendshëm fshat-qytet në Kosovë”, Studime Shoqërore, Prishtinë, 2018.
- Clayer Nathalie, “Në fillimet e nacionalizmit Shqiptarë”, botimet Përpjekja, Tiranë, 2012.
- Clastres, Pierre, “Shoqëria kundër shtetit”, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2014.
- De Soto, Hernando, “Misteri i Kapitalit”, Co-Plan, Instituti për zhvillimin e

- habitatit, 2000.
- De Waal, Clarissa, "Shqipëria pas rënies së komunizmit", Insituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, 2009.
- Dervishi, Zyhdi, "Lente të ndërveprimit simbolik", Ermal, Tiranë, 2008.
- Flanagan, G. William, "Urban Sociology Images and Structure", Rowman & Littlefield Publishers, 2010.
- Fuga. Artan, "Shoqëria Periferike", Botime 'ORA', 2004.
- Hanerzz, Ulf, Explorin the city, New York: Columbia University Press, 1983.
- Halbwachs, Maurice, The collective memory, New York, Harper & Row Colophon Books, 1980, f.182.
- Hobsbawn, Eric dhe Terence, Ranger, "Shpikja e Traditës", Pika pa sipërfaqe, Tiranë 2014.
- Jaime, Lerner, "Apukunturë Urbane", Ombra GVG, 2016.
- Kaprata, Gentian, "Qeveria Rama dhe reforma e legalizimit", gjendet në linkun: <https://qeveriarama.blogspot.com/2017/12/qeveria-rama-dhe-reforma-e-legalizimit.html>
- Lelaj, Olsi, "Nën shenjën e modernitetit", Pika pa Sipërfaqe, 2015.
- Muçaj, Agim, "Sociologjia rurale dhe urbane", Universiteti Bujqësor i Tiranës, Tiranë, 2013.
- Mumford, Lewis, "The city in history", LIBRARY OF CONGRESS, New College of California, 1961.
- Luhmann, Niklas, Raffaele de Giorgi, "Teoria e shoqërisë", Pika pa sipërfaqe, Tiranë 2016.
- Onuzi, Afërdita, "Ndryshime në mënyrën e jetesës së klasës punëtore në fermën 'Ylli i Kuq', Kamzë", "Etnografia shqiptare", nr.12, 1982.
- Onuzi, Afërdita, "Veshjet Popullore, Simbol Identifikimi" (Fund i shek.XIX Fillimi i shek.XX), Kultura Popullore, Nr 1-2, 2008.
- Payne, Geoffrey, "Land tenure and property rights: an introduction", Habitat International 28 (2004).
- Prato, Giuliana B. and Pardo, italo. 'Urban Anthropology' Urbanities, Vol. 3 • No 2 • November 2013.
- Riza Emin, "Oda e miqve në banesën qytetare Shqiptare", Revista 'Etnografia Shqiptare', Nr 13, 1983
- Tirta, Mark, "Etnologjia e Shqiptarëve", GEER, Tiranë, 2003.
- Tsenkova, Sasha, "Urban Planning and Informal Cities in Southeast Europe", Journal of Architectural and Planning Research, 24:9, Winter 2012.
- Thiesse, Anne-Marie, "Krijimi i identiteteve kombëtare", Dukagjini, Pejë, 2004.
- Voell, Stephane, "The Kanun in the city", Anthropos 98, 2003.

Alban Dobruna

*Instituti i Historisë "Ali Hadri" Prishtinë*

# BASHKËSIA E TARIKATEVE TË KOSOVËS DHE SFIDAT NDAJ GLOBALIZIMIT

## Abstrakt

*Bashkësia e Tarikateve të Kosovës (BTK) - institucioni që përfaqëson komunitetin e dervishëve dhe tarikateve në Kosovë. Në Kosovë ekzistojnë nëntë tarikate. Bashkësia e Tarikateve të Kosovës ka një komunitet prej më se 200.000 vetash në vend dhe 40.000 në diasporë. Mëse 60.000 prej tyre marrin udhëzim shpirtëror në rreth 70 teqe në Kosovë. BTK i ruan elementet e traditës dhe kulturës së tarikateve si: ritualet e dervishëve, elementet etnografike, veshjet, muzikën vokale dhe instrumentale, shkrimet filozofike, fetare dhe mistike, vallëzime të dervishëve, poezinë, kaligrafinë, pastaj tregime dhe fjalime metaforike dhe alegorike etj. Në BTK kultivohet interpretimi paqësor dhe autentik i Islamit. Për tarikatet globalizimi si procesi i integritimit që mundësohet nga shkëmbimi i pikëpamjeve, produkteve, ideve dhe fushave të tjera kulturore nga mbarë bota, nuk është i huaj, pasi gjatë historisë tarikatet i kushtuan rëndësi shtrirjes gjeografike duke përfshirë një numër të madh të popujve dhe grupe etnike myslimane me kontradikta brenda popullsisë myslimane. Shtrirja gjeografike dhe kohore e mendimit të dervishëve e bëri atë të begat me individë të shquar me preferenca të ndryshme shpirtërore. Misionarët e tarikateve, u përgjigjen sfidave dhe u përballen me kulturën, gjuhën, etninë, nivelin social dhe intelektual të popullatave ku ata predikuan. BTK-ja është adaptuar mjaft mirë në sistemin laik në Kosovë. BTK-ja mbështet institucionet e Kosovës në ndërtimin e shtetit juridik kundër korrupsionit, neglizhencës, keq menaxhimit, jo barazisë, përjashtimit dhe jo transparancës në shoqëri. Në kuader të integritimit të institucioneve të Kosovës, BTK-ja në Kuvendin e saj të fundit të mbajtur më 23 prill 2022 në Rahovec shprehu dëshirën e saj që të punoi me institucionet vendore në ndërtimin e një shoqërie pa paragjykime të cilat i njohim si racizmi, urrejtja etnike, homofobia, mizogonia, islamofobia, sufifobia, dhe forma tjera përjashtëuse që prishin mibësimin në*

*shoqëri, kjo është në përputhshmëri me një ndër synimet e globalizimit sinxhitës i levizshmerisë së madhe të njerëzve nga një vend me një tjetër dhe ka bere që të kemi një ndërthurje të kulturave nëpërmjet pershtatjes kulturore dhe sociale të tyre.*



## Hyrje

Bashkësia e Tarikateve të Kosovës (më tej BTK) - institucioni që përfaqëson komunitetin e dervishëve dhe tarikateve në Kosovë. Në Kosovë ekzistojnë nëntë Tarikate: Kaderi, Rifai, Saadi, Shazeli, Nakshibendi, Sinani, Bektashi, Halveti dhe Melami. Shtrirja gjeografike dhe kohore e mendimit të dervishëve e bëri atë të begat me individë të shquar me preferenca të ndryshme shpirtërore. Pasi edhe ata kanë kaluar në tri periudha: atë klasike, mesjetare dhe moderne<sup>158</sup>. Misionarët e tarikateve, u përgjigjen sfidave dhe u përballen me kulturën, gjuhën, etninë, nivelin social dhe intelektual të popullatave ku ata predikuan, pasipërvoja historike e pjesës më të madhe të popujve dëshmon se njësia e fesë ishte ndër faktorët e rëndësishëm në procesin e integritimit të perandorive mesjetare, kurse roli i feve në integrimin e njësive etnokulturore e gjeopolitike kombëtare do të shfaqet në filliet e kohës së re, në periudhën e renesansës, me një rëndësi të shtuar gjatë Humanizmit, Iluminizmit dhe Rilindjes Kombëtare<sup>159</sup>. Aktivistët e Rilindjes Kombëtare Shqiptare treguan një ndjeshmëri të jashtëzakonshme ndaj korenteve kulturore në Europën modernae, që kërkonin një pozicionim të ri, gjithsesi reduktiv, të fesë në jetën politike e shoqërore. Nga koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur u ngjiz së pari ideja e shtetit kombëtar shqiptar, e deri në ditët tona përqafoi një verision racinal e të moderuar të qasjes ndaj fesë, duke

<sup>158</sup> Nexhat Ibrahim, *Fjalor encikopedik islam*, Shkup, Prishtinë, Tiranë: Logos-A, 2017, f.180.

<sup>159</sup> Muhmat Pirraku, *Roli i Islamit në integrimin e Shqipërisë Etnike dhe të Kombit Shqiptar*, Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët, (Simposium ndërkombëtar), Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 1995, f.41.

vendosur laicizmin në themel të ekzistencës së tij<sup>160</sup>. BTK-ja është adaptuar mjaft mirë në sistemin laik në Kosovë. BTK-ja mbështet institucionet e Kosovës në ndërtimin e shtetit juridik kundër korrupsionit, neglizhencës, keq menaxhimit, jo barazisë, përjashtimit dhe jo transparencës në shoqëri. Në kuader të integritimit të institucioneve të Kosovës, BTK-ja në Kuvendin e saj të fundit të mbajtur më 23 prill 2022 në Rahovec shprehu dëshirën e saj që të punoi me institucionet vendore në ndërtimin e një shoqërie pa paragjykime të cilat i njohim si racizmi, urrejtja etnike, homofobia, mizogonia, islamofobia, sufifobia, dhe forma tjera përjashtëuse që prishin mirbësimin në shoqëri<sup>161</sup>, kjo është në përputhshmëri me një ndër synimet e globalizimit sinxites i levizshmerisë së madhe të njerëzve nga nje vend me nje tjetër dhe ka bere që të kemi një ndërthurje të kulturave nëpërmjet pershtatjes kulturore dhe sociale të tyre.

Shpejtësia me të cilën kryhen ndryshimet në epoken e globalizimit në të gjitha fushat kryesore të ekonomisë, të teknologjisë dhe të informacionit, shpesh krijon marramendje dhe shqetësim. Kështu, ndërsa në fillim përpjekjet për afim dhe koordinim mbarëbotëror, BTK-ja e përkrah rrugën e demokracisë dhe ndërtimin e shtetit modern, si një realizim i vizionit Profetik

---

<sup>160</sup> Pëllumb Xhufi, *Feja dhe shteti*, 100 vjet pavarësi, Vëllimi I, Aktete e konferencës shkencore ndërkombëtare, Tiranë, më 26-27 nëntor 2012, Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike: Instituti i Historisë, 2014, f.15.

<sup>161</sup> *Mesazhi për institucionet e Kosovës nga Kuvendi i Bashkësisë së Tarikateve*, [https://btkonline.net/?fbclid=IwAR2liLk4R480Zh0WS\\_AkH9SP6nmQHDdM8FaU1B\\_pEmFgg-wkmS1qZZsaQoFaqja](https://btkonline.net/?fbclid=IwAR2liLk4R480Zh0WS_AkH9SP6nmQHDdM8FaU1B_pEmFgg-wkmS1qZZsaQoFaqja) e internetit e Bashkësisë së Tarikateve të Kosovës ka hyrë në Biblioteka e Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për t'u përfshirë në koleksionin historik të materialeve të internetit në lidhje me Arkivin e Uebit të Çështjeve Politike dhe Sociale të Kosovës. Duke e konsideruar faqen e BTK-së të internetit si një pjesë të rëndësishme të këtij koleksioni dhe të të dhënave historike. Biblioteka e Kongresit ruan artefakte të rëndësishme kulturore dhe ofron akses të qëndrueshëm në to. Funkcionet tradicionale të Bibliotekës, përvetësimi, katalogimi, ruajtja dhe shërbimi i materialeve koleksionuese me rëndësi historike për të nxitur arsimin dhe studimin, shtrihen në materialet dixhitale, duke përfshirë faqet e internetit. Arkivat e Kongresit të internetit janë të rëndësishme sepse ato kontribuojnë në të dhënat historike, duke kapur informacione që përndryshe mund të humbasin. Me rritjen e rolit të internetit si një medium me ndikim, regjistrimet e ngjarjeve historike mund të konsideroheshin të paplota pa materiale që ishin "lindur dixhitale" dhe kurrë nuk ishin shtypur në letër.

për një shoqëri të diturisë, një shoqëri të solidaritetit, tolerancës dhe barazisë, shoqëri të sendërtimit të vlerave etke, ndërgjegjes dhe respektit gjithëpërfshirës, dhe si shoqëri e cila e kultivon të bukuren. Bota e sotme karakterizohet nga ndërvarësi dhe kooperim ndërmjet popujve, grupeve, institucioneve dhe kombeve. Në të njëjtën kohë, konfliktet etno-fetare dhe ndërftare, si dhe instrumentalizimi dhe përdorimi politik i feve kanë shkakuar dhe shkaktojnë shumë konflikte<sup>162</sup>. Duke qenë të vetëdijshëm se laiciteti përmban një ideal universalist të organizimit të qytetit dhe rregullimin juridik, që bazohet mbi tri kërkesa të pandashme: liria e ndërgjegjes që del nga emancipimi personal, barazinë e të gjithë qytetarëve pa dallim origjine, race, seksi ose bindjesh shpirtërore dhe synimi i interesit të përgjithshëm, si e vetmja arsye e të qenit shtet<sup>163</sup>. Bashkësitë fetare në Kosovë ende nuk e kanë të realizuar statusin juridik dhe funksionojnë ilegalisht, çka ju mundëson që disa prej tyre të punojnë edhe pa përgjegjësi duke përfituar nga situata. Institucionet e Kosovës duhet me marrë këtë çështje me seriozitet. Pamundësia e ekzistencës juridike dhe mungesa e përgjegjësisë që vjen me atë, i krijoj kushtet në të cilat Kosova u reshtua në radhën e shteteve eksportues të terrorizmit, me pasojat ngecjen në integritime Euro-Atlantike. Kuvendi i Bashkësisë së Tarikateve të Kosovës poashtu i bëri thirrje institucioneve të Kosovës që ta hapin derën për komunikim dhe dialog shoqërorë i cili në fushen e bashkësive fetare mungon, sepse nuk ekziston demokracia me veshët e shurdhët dhe dyer të mbyllura. Me lutje për prosperitet shpirtërorë të shoqërisë Kosovare, për mirëqenie të gjithmbarshme dhe për liri autentike, BTK-ja shprehu dëshirën e qeverisjes sësuksesshme dhe shërbimin e ndërgjegjshëm ndaj popullit.

BTK-ja dhe sfidat ndaj globalizimit. Globalizimi vjen si rezultat e një ndërlihdshmërie ndërkombëtare pa precedent. Rritja e tregëtisë ndërkombëtare këmbim i informatave, ideave, ndërthurja e kulturave, lëvizja e njerëzëve janë përcjellur me aspekte të veta kulturore dhe shoqërore. Nga aspekti i komuniteteve fetare dhe bashkësive të tyre situata ndryshojn,

<sup>162</sup> Gjergji Sinani, "Liria e fesë në kontekstin e modelit evropian të marrëdhënive ndërmjet shtetit dhe fesë", *Zani i naltë* Tiranë: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Viti. II(XVI), Nr.2 (155), 2013, f.80.

<sup>163</sup> *Po aty*.

disa bashkësi fetare arriten ta ruajnë traditën por jo gjithmonë edhe afërsinë me ndjeksit e tyre. Kohëra të reja kërkuar nga Bashkësia e Tarikateve të Kosovës të përshtatje, si nga ato teknike, organizative, deri te ato shoqërore, duke përfshi edhe rileximin dhe riinterpretimin dogmatik të rrugës dhe metodës së sufive e gjithmonë pa humbur autencitetin e besimit. Pasi rritja e integritetit global mund të ketë të bëjë edhe me përvojat subjektive të ndryshueshme në lidhje me hapësirën e kohës që e shoqërojnë këtë proces<sup>164</sup>, kështu sfidat konkrete për Bashkësinë e Tarikateve të Kosovës në periudhën pas luftës janë: Sufifobia e trashiguar nga Islami politik me agresivitetin dhe mos tolerancën e tij kërkon pozicionimin ndaj tij dhe ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që ai bjen, dhe bashkëpunimin me struktura të mbrojtjes shoqërore (Komuna, Policin, Agjencia e Kosovare e Intelejences (AKI), ...) është i nevojshëm. Çështjet e pronës dhe trashëgimisë janë të vjetra por njësoj aktuale edhe pse gjeneratat ndërrohen e kalojnë. Shteti i ri me pak provojë në legjislacion e sidomos në domenin fetar. Kjo pastaj përcjellët në ligjin për liri fetare, mungesa në regjistrimit të popullatës ku nuk ekziston mundësia e deklarimit të natyres fetare, mungesa në protokoli shtetërorë etj. Nevoja për arsimim të kuadrit të ri fetar duke ikur nga ideologjia e islamizimit (islamit politik) dhe duke ruajtur traditën dhe natyrën e frymes fetare ku zë pjesë edhe ilustrimi i radheve. Emigrimi i vrullshëm kërkon zhvillimin e infrastruktures e re dhe i sfidon financimin e aktiviteteve. Organizimi i ri, i nevojshëm në kushtet e reja, e posaqërisht mundësive në domenin e komunikimit modern me internet dhe ekspozimit ndaj tij. Këtu duhet thonë se kohra të reja e kanë përparësinë në domenin e komunikimit dhe çasjes ndaj informatave, por sfidojnë me dezinformata, antipropagandë dhe me media mashtruese (fake news).

Korniza e veprimit shoqëror e BTK-së është bashkësia fetare e dytë me madhësi në vend. BTK-ja është e ndërtuar mbi traditën e gjatë të kultivimit të besimit të kulluar, shërbimit ndaj Krijuesit, shërbimit për komb dhe për atdhe. Në modestinë e vet të paraqitjes publike, BTK-ja nuk ka hyrë në debate dhe konflikte ditore shoqërore, duke besuar se shoqërinë e përparojmë më së miri duke përparuar vetën si qytetar dhe duke ngritur vetën si besimtar.

<sup>164</sup> Njazi Uka, *Fjalor i diplomacisë*, Tiranë: Botime "Ilari", P.F, 2011, f.101.



Me parimet e paraqitur më poshtë e Bashkësia ka sqaruar anëtarësinë dhe publikun mbi kornizën e veprimtarisë shoqërore të BTK-së: 1. BTK-ja beson në ko-ekzistencën aktive të komuniteteve të ndryshme në shoqëri. 2. Lirinë fetare do ta kërkojnë për veti dhe për të tjerë derisa kjo liri është e shprehur me ndërgjegje dhe qëllim paqësor. 3. Ekuidistancën e shtetit ndaj komuniteteve do ta kërkojmë si kusht për harmoninë shoqërore. 4. Zgjidhjen e problemeve në shoqëri do e kërkojmë brenda komunitetit por edhe në publikë, gjithmonë duke u bazuar në parimet e lirisë, barazisë dhe vëllazërisë njerëzore para Zotit. 5. Ndërtimi i mirëbesimit dhe dialogu i mirinformuar do janë metodat e preferuara. 6. Parimin që të keqen ta largojmë me më të mirën do të jetë trajektorja e përpjekjeve të bashkësis. 7. Bashkësia e Tarikateve nuk mirret me politik-bërje por do të jetë shoqërisht aktive atje ku i takon zëri. 8. Anëtarësia është e lirë të vepron politikisht, por vetëm si individ, jashtë petkut dhe titullit fetar, dhe sipas parimeve brenda kësaj deklarate. 9. Ndërtimi i paqes dhe harmonizimi i interesave në vend dhe regjion për BTK-në do jetë gjithmonë prioritet. 10. Aleatin e dëshmuar në ditët e vështira do ta ruajnë dhe respektojnë, armikun e penduar do ta falim dhe afrojmë, problemet e botës në shtëpi nuk do ti çojnë. 11. Do të jena kundër përhapjes së fjalës së urrejtjes, shpifjeve, përbuzimit, genjeshtres, keq prezantimit dhe manipulimit me informata. 12. Në këtë drejtim do ta vlerësojmë institucione dhe mediat e lira kur lirinë e keqpërdorin, fetarishtë anojnë ose kur lejojnë që njerëz jo profesional, lajmin dhe opinionin e krijojnë. Inkriminimpër bindje fetare e konsiderojmë krim.

Globalizimi, në një kuptim pozitiv, po tenton të shtrihet kudo. Por, nga ana tjetër, ai po krijon standarde kulturore me prirje homogjene. Kjo është dhe ana e errët e tij: ushqimi i homogjenizimit njerëzorë. Në mënyrë të ngjashme, sekularizmi, modernizimi dhe "Perëndimizimi" i shoqërive në zhvillim ka krijuar jo pak probleme edhe mbi identitetin fetar. Kjo ka çuar, në një mënyrë apo në tjetrën, në prirje ndarëse e centrifugale në të gjitha fete monoteiste. Secila prej tyre pretendon se ka marrëdhënie speciale me Zotin, duke i përjashtuar të tjerat. Me një përafim e shikim të tillë, krijohen kushtet

për fundamentalizëm dhe ushqehet radikalizmi<sup>165</sup>. Andaj sfida kryesore BTK-së në epoken globale është sufi-fobia.

Sufi-fobia është një formë e përhapur e fanatizmit, zakonshme në mesin (por jo domosdoshmërisht të mbajtur nga) muslimanët që nuk janë sufi. Forma kryesore e paraqitjes së sufi-fobisë është dyshim, frika ose urrejtja ndaj sufive (dervishëve), pra në përgjithësi një paragjykim ndaj muslimanëve sufite ose sufizmit (tasawuf) nga bashkë-fetaret e tyre muslimanë. Kjo zakonisht rezulton në një antipati dhe shmangie por mund të paraqitet e përshkallëzuar në forma të ndryshme të abuzimit. Forma më virulente e Sufi-fobisë është përhapur nga ekstremistët militantë muslimanë, të cilit i konsiderojnë sufite si qafirë, heretikë dhe tradhtarë të Islamit dhe tradhtar e kauzave të islamit politik dhe me këto e legjitimojnë sulmin ndaj tyre. Më e zakonshme se sa Sufi-fobia e egër e militantëve ekstrem islamistë janë thjesht akuza dhe përbuzje nga ata muslimanë të ndikuar nga Vehabizmi, Salafizmi – për të cilit sufizmi është bid'a (një risi e dëmshme jo-islamike, e cila duhet të kundërshtohet sepse do të rezultojë në zjarr për praktikuesit e saj dhe ata të ndikuar nga ajo) dhe/ose akuzat se sufi/dervishët nuk janë muslimanë "të vërtetë". Po-ashtu disa forma të islamizmit modernist e akuzojnë, pa argumente, sufizmin dhe sufite se janë përgjegjës për pa fuqizimin politik dhe prapambetjen intelektuale të muslimanëve në botën moderne. .... Ndër pasojat e shumta të formave të tilla të Sufi-fobisë janë fenomene të tilla si, "mikro-agresione" dhe sjellje agresivitetit pasiv siç janë vërejtjet nënçmuese dhe përfolja në xhami, tjetërsimi shoqëror, kundërshtimi ndaj praktikave të dashura nga sufistët siç është festimi i ditëlindjes së Profetit (a.s.), zjarete (vizitat) faltoret e shenjtëve dhe evliave të sufive, dhikra (përkujtime të Zotit) vokale, akuza për kulturizëm, diskriminim fetar, akuza ndaj sufistëve nga muslimanët jo sufite për abuzimin kundër tyre, .... Tragjedia më e madhe e Sufi-fobisë nuk është padrejtësia e bërë ndaj muslimanëve Sufi por përkundrazi, lobotomizimi shpirtëror dhe psikoterapeutik i muslimanëve jo sufistë mbi veten e tyre, duke rezultuar, në të paktën, në degjenerimin e inteligjencës emocionale të muslimanëve jo sufite<sup>166</sup>.

<sup>165</sup> Rexhep Meidani, *Rendi global dhe shteti-komb*, Tiranë: "Mileniumi i ri", 2018, f.156.

<sup>166</sup> Shejh Lulzim Shehu, *Sufifobia, rasti i Kosovës*, Materiali i Kuvendit zgjedhor 2022, Bashkësia e Tarikateve të Kosovës, f.47.

Qëllimet e BTK-së në epoken globale është përpjekja që ta afirmojmë prezencën tyre në shoqërinë Kosovare, për këtë BTK-ja ka definua një numër qëllimeve si: Afirmimi dhe mirëmbajtja e prezencës së komunitetit të dervishëve në shoqëri si e barabart me bashkësi tjera. Ruajtja e trashëgimisë kulturore të tarikateve, kultivimi i elementeve të identitetit tyre. Puna në pajtimin dhe zvogëlimin e konfliktit nëpërmjet procesit të prezervimit të trashëgimisë kulturore si një alternativë të emigrimit. Kthimi i njerëzve të komunitetit nga diaspora nga vendetjo mikpritëse nga vendet e migrimit. Prezantimi i trashëgimisë kulturore si pjesë e diversitetit tradicional dhe të harmonisë e bashkëjetesës. Rritja e ofertës kulturore dhe me të promovimi i Kosovës në përgjithësi. Prezantimi i vlerave shpirtërore të komunitetit të dervishëve si pjesë e diversitetit të Kosovës të cilën e ndajnë me realitete tjera shpirtërore, që do të jetë e kundërta e monokulturës së regjimentizuar të islamit politik i cili edhe pse minor është i zëshëm dhe i dukshëm në disa dekada të fundit. Fuqia reale e kundërvënies të narrativit ekstremist është në duar të dervishëve të Kosovës ku shikojnë të angazhohem më dukshëm pasi vendosen në vend çështje themelore. Çështja themelore është votimi i Ligjit të Ri (të Plotësuar) për Liritë Fetare në Kuvend, i cili pastaj do të bëhet themel i trajtimit barabartë të komunitetit fetare në gjitha domene si: çështje pronësore, financiare, protokollare dhe barazinë në përfaqësim dhe këshillime kur diskutohet për çështje fetare nga ana e institucioneve. Në këtë qëllim e BTK-ja ka përkrahjen e Opinionit të Komisionit të Venedikut, institucioneve dhe ambasadave ndërkombëtare, Avokatit të Popullit dhe pengesa dhe obstrukcione nga islami reduksionist dhe islami politik i përfaqësuar nga BIK-ut<sup>167</sup>.

Për fund BTK-ja synon të jetë bashkësi e pavarur fetare e cila vepron në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës, ligjeve të vendeve ku do të regjistrohet, Statutit, traditës së vet në interpretimin paqësor dhe autentik të Islamit në frymën e mëshirës dhe bamirësisë së tarikateve dhe në tolerancë me traditat fetare tjera.

---

<sup>167</sup> Shejh Lulzim Shehu, *Qëllimet e BTK-së*, Materiali i Kuvendit zgjedhor 2022, Bashkësia e Tarikateve të Kosovës f.43.

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË  
SHQIPTARËVE – SHKUP

BALLKANOLOGJIA - Edicioni V  
“Ballkani dhe globalizimi”

Redaktor përgjegjës: Sevdail Demiri  
Redaktore gjuhësore: Florentina Fetahi  
Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: DataPons – Shkup  
Rr. 1550, nr. 52, Vizbeg  
Tirazhi: 500 copë

*Ky edicion botohet me vendimin e Këshillit të ITSHKSH–Shkup, nr. 0201-32/5,  
të datës 19.01.2023, si pjesë e programit të punës së Institutit për vitin 2023.*

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски

316.32(497)(062)

BALLKANOLOGJIA. 5, Ballkani dhe globalizimi : akte të Konferencës  
shkencore ndërkombëtare, Shkup, 27 tetor 2022 / [redaktor përgjegjës  
Sevdail Demiri]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e  
kulturore të Shqiptarëve, 2023. - 204 стр. : илустр. ; 25 см. -  
(Biblioteka Ballkanologji)

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон трудовите

ISBN 978-608-4897-85-9

а) Глобализација -- Балкан -- Собири

COBISS.MK-ID 61386245